

**KONTRATA E SIGURIMIT SIPAS KODIT CIVIL
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

(Punim Doktorature)

PËRGATITI:

MASTER LUAN HASNEZIRI

UDHËHEQËS SHKENCOR

PROF DR ARDIAN NUNI

Tiranë, Korrik 2011

| | |
|---|-------------|
| Përmbajtja | faqe 2-3 |
| Parathënie | faqe 4-5 |
| Hyrje | faqe 6-8 |
| Kapitulli 1. Kuptimi dhe karakteristikat e kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil në fuqi. | |
| 1.1. Kuptimi i kontratës së sigurimit. | faqe 9-10 |
| 1.2. Karakteristikat e kontratës së sigurimit. | faqe 10-11 |
| 1.3. Elementet e policës së sigurimit. | faqe 11-14 |
| 1.4. Karakteri aleator ose fator i kontratës së sigurimit. | faqe 14-15 |
| 1.5. Kontrata e sigurimit si kontratë ad’hezioni ose aderimi. | faqe 15-16 |
| 1.6. Rëndësia e afatit tek kontrata e sigurimit. | faqe 16 |
| 1.7. Kontrata e sigurimit vullnetar ose të detyrueshëm. | faqe 16-17 |
| 1.8. Ekzistenca e shkakut të ligjshmëm, si kusht për lidhjen e kontratës së sigurimit... faqe 17 | |
| 1.9. Lidhja e kontratës së sigurimit në dobinë e personit të tretë. | faqe 17-18 |
| 1.10. Momenti i veçantë i hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit. | faqe 18 |
| 1.11. Zgjidhja e kontratës së sigurimit të pasurisë, si pasojë e tjetërsimit të saj nga një subjekt tek një tjetër. | faqe 18-19 |
| 1.12. Interesi pasuror në objektin e siguruar, si kusht për vlefshmërinë e kontratës së sigurimit..... | faqe 19 |
| 1.13. Rrethi i kufizuar i ngjarjeve që sigurohen me kontratën e sigurimit. | faqe 19-20 |
| Kapitulli 2. Kontrata e sigurimit të pasurisë. | |
| 2.1. Elementët e kontratës së sigurimit të pasurisë. 2.1.1. Subjektet ose palët në kontratën e sigurimit të pasurisë. | faqe 20-26 |
| 2.1.2. Objekti i kontratës së sigurimit të pasurisë. | faqe 26-27 |
| 2.1.3. Përmbajtja e kontratës së sigurimit të pasurisë. Të drejtat dhe detyrimet e të siguarit në kontratën e sigurimit të pasurisë. | faqe 27-38 |
| 2.1.4. Të drejtat dhe detyrimet e siguresit në kontratën e sigurimit të pasurisë. | faqe 38 -51 |
| Kapitulli 3. Kontrata e sigurimit të personit. | |
| 3.1. Subjektet e kontratës së sigurimit të personit. | faqe 52-55 |
| 3.2. Objekti i kontratës së sigurimit të personit. | faqe 55-58 |
| 3.3. Përmbajtja e kontratës së sigurimit të personit. Të drejtat dhe detyrimet e të siguarit në këtë kontratë. | faqe 58-68 |
| Kapitulli 4. Disa veçori të kontratës së sigurimit sipas legjislacionit të shteteve të cammon-loë ose anglo-sakson. | |
| 4.1 Kuptimi dhe veçoritë e kontratës së sigurimit sipas sistemit anglo-sakson. | faqe 69-70 |
| 4.2. Kushtet ligjore për lidhjen e kontratës së sigurimit sipas sistemit cammon laë. ... | faqe 71-72 |
| 4.3. Llojet kryesore të sigurimit sipas sistemit cammon laë. | faqe 73-76 |
| Kapitulli 5. Kontrata e sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil italian. | |
| 5.1. Kuptimi i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian. | faqe 77-78 |
| 5.2. Forma e lidhjes së kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian | faqe 78-82 |
| 5.3. Ekzistenca e rrezikut të sigurimit, si kusht për lidhjen e kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian. | faqe 82-83 |
| 5.4. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën e sigurimit të pasurisë sipas Kodit Civil italian..... | faqe 83-92 |
| 5.5. Disa veçori të kontratës së sigurimit të personit sipas Kodit Civil italian. | faqe 92-95 |

| | |
|---|--------------|
| Kapitulli 6. Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare, në lidhje me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë. | faqe 95-112 |
| Konkluzione dhe rekomandime | faqe 113-122 |
| Abstrakt | faqe 123-124 |
| Bibliografia. | faqe 125 |

Parathënie

Ky punim për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, ka si qëllim që të trajtojë nga pikëpamja juridike dhe praktike, kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, të parashikuara nga dispozitat e Kodit Civil. Në kushtet e ekonomisë së tregut dhe të zhvillimit të lirë të mardhënieve kontraktore ndërmjet subjekteve të së drejtës, kontrata e sigurimit po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe, si një nga kontratat më të rëndësishme në qarkullimin civil, e cila ka si qëllim ofrimin e shërbimit të sigurimeve nga njëra anë, dhe sigurimin e personit dhe pasurisë nga rreziqet e sigurimit, nga ana tjetër.

Që në fillim duhet thënë se objekt i këtij punimi është vetëm trajtimi juridik dhe praktik i kontratës së sigurimit sipas dispozitave të Kodit Civil shqiptar, duke e ballafaquar atë edhe me praktikën gjyqësore në Shqipëri dhe jo trajtimi i kontratave të sigurimit të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e detyrueshëm të personit dhe pasurisë, sipas ligjeve të veçanta. Në këto kushte në trajtimin e kësaj teme, unë kam qëndruar strikt vetëm në rregullimin ligjor që ka bërë Kodi Civil për kontratën e sigurimit, në të cilin parashikohet sigurimi vullnetar i personit dhe pasurisë dhe nuk jam referuar në ligje të tjera, të cilat rregullojnë lloje të ndryshme të kontratave të detyrueshme të sigurimit, sepse kjo do të dilte jashtë objektit të temës time.¹

Punimi i mëposhtëm përbëhet nga katër pjesë kryesore; pjesa e parë dhe më e rëndësishme trajton rregullimin ligjor të kontratës së sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil shqiptar në fuqi. Në këtë pjesë do të trajtohen disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me kuptimin dhe veçoritë e kontratës së sigurimit, me të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë, ku në veçanti do të trajtohen detyrimet e të siguarit në kontratën e sigurimit, si dhe të drejtat e siguruesit në këtë kontratë.

Pjesa e dytë e këtij punimi i kushtohet, në mënyrë të përmbledhur, konceptit dhe veçorive të kontratës së sigurimit sipas sistemit ligjor anglo-sakson. Në këtë pjesë do të trajtohet kuptimi që ka kontrata e sigurimit sipas këtij sistemi ligjor, kushtet apo elementët që duhet të ekzistojnë në mënyrë që të jemi para një kontrata sigurimi, si dhe llojet kryesore të kontratës së sigurimit të pasurisë sipas sistemit anglo-sakson.

Pjesa e tretë e këtij punimi i referohet rregullimit të kontratës së sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil italian, nga trajtimi i të cilës do të konstatojmë se një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit Civil shqiptar, janë marrë pikërisht nga Kodi Civil italian dhe trajtimi i shumë çështjeve juridike që kanë të bëjnë me këtë kontratë, është bërë në mënyrë të njëjtë, megjithatë, do të shohim se ka edhe ndryshime ndërmjet tyre. Trajtimi i kontratës së sigurimit sipas ligjit italian do të bëhet edhe në aspektin krahasues, duke e ballafaquar atë me Kodin Civil shqiptar, në mënyrë që të shikohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këtyre legjislacioneve, dhe të nxirret eventualisht ndonjë e metë e ligjit shqiptar dhe të pasqyrohet nevoja dhe mënyra sesi mund të rregullohen këto të meta në të ardhmen, në trajtimin ligjor të kontratës së sigurimit.

Pjesa e fundit e këtij punimi përbëhet nga analiza e praktikës gjyqësore shqiptare, të gjykatave të tre niveleve, më posaçërisht të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, të gjykatës së apelit Tiranë, për

¹ Ashtu siç do të shihet më poshtë një nga llojet më të rëndësishme të sigurimit të detyrueshëm të pasurisë, parashikohet në dekretin nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjetëve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, miratuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 01.12.1992 “Për miratimin me ndryshime të këtij Dekreti”, dekret-ligj i cili nuk do të trajtohet nga ana ime në këtë punim, pikërisht sepse del jashtë objektit të temës.

periudhën e viteve 2005-2010, si dhe të Gjykatës së Lartë për të gjithë periudhën pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil. Nga trajtimi i praktikës gjyqësore shqiptare në lidhje me kontratën e sigurimit, të rregulluar nga Kodi Civil, do të konstatohet nëse nga gjykatat shqiptare janë kuptuar si duhet dispozitat ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, nëse rastet e praktikës gjyqësore janë të shumta apo të pakta në lidhje me këtë kontratë, dhe nëse vendimet gjyqësore e dhëna nga gjykatat në lidhje me këtë çështje janë të bazuar në prova e ligj dhe nëse janë të arsyetuara si duhet apo jo.

Hyrje

Kontrata e sigurimit është një nga kontratat më të rëndësishme në qarkullimin civil, rëndësia e të cilës po rritet vazhdimisht, me rritjen e ritmeve të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Sa më i madh të jetë zhvillimi ekonomik, social, kulturor i shoqërisë njerëzore, aq më e madhe bëhet rëndësia e kontratës së sigurimit në qarkullimin juridiko-civil, midis subjekteve të së drejtës. Kjo për faktin se me rritjen e prosperitetit të shoqërisë në drejtimin ekonomik dhe shoqëror, rritet edhe sasia e sendeve, objekteve dhe mallrave të cilat mund të sigurohen me kontratën e sigurimit, e po ashtu rritet edhe vlera e jetës njerëzore në kuptimin e nevojës që ajo të jetë sa më e sigurtë dhe e garantuar, dhe për rrjedhojë rritet edhe numri i personave që sigurojnë veten e tyre, nga shkaktimi i vdekjes dhe dëmtimi i shëndetit prej aksidenteve personale.

Nisur nga sa më sipër, mund të kostatojmë se kontrata e sigurimit po bëhet në ditët e sotme një nga kontratat më të përdorura në qarkullimin civil, përhapja e së cilës po rritet gjithnjë e më shumë, me rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë njerëzore dhe me rritjen e cilësisë dhe vlerës së jetës së njeriut. Kjo nuk do të thotë se pasuria dhe jeta e personit konsiderohen si të rëndësishme vetëm në periudhën e sotme pasindustriale dhe në kushtet e shoqërisë së konsumit. Kjo sepse jeta dhe pasuria janë konsideruar si themelore për njeriun që në periudhat më të lashta të njerëzimit, që para se të krijoheshin institucionet e shtetit dhe, janë konsideruar si të tilla edhe në periudhat e antikitetit, të mesjetës dhe të kapitalizmit të hershëm.

Që në organizimet fisnore dhe të tribuve, ka patur norma dhe rregulla që mbronin dhe garantonin jetën dhe pasurinë e personit, si një nga gjërat më të rëndësishme për ekzistencën e shoqërisë njerëzore dhe këto norma kanë ekzistuar akoma më me hollësi në antikitet dhe mesjetë, në kushtet e një shoqërie të organizuar në formën e **organizmit politik që ishte shteti**. Por vetëm në ditët tona, në kushtet e një shoqërie moderne dhe të zhvilluar, lindi e nevojshme që nga ana e shoqërisë dhe shtetit, të përcaktohen norma të cilat parashikojnë sigurimin e jetës së personit si dhe të pasurisë së tij. Këto parashikime që kishin të bëjnë me mënyrën e sigurimit të jetës së personit si dhe të pasurisë së tij, erdhën si kërkesë imediate e shoqërisë së sotme, e cila në kushtet e një zhvillimi dhe komunikimi të vazhdueshëm, e kishte të domosdoshme sigurimin e jetës së personit dhe të pasurisë së tij.

Në këto rrethana mund të konkludojmë se kontrata e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë është **një institut i kohëve moderne** që është e lidhur ngushtë me shoqërinë pasindustriale dhe të konsumit. Kjo do të thotë se ne nuk mund të gjejmë elementë të rregullimit juridik të kësaj kontrate, as në periudhën e antikitetit, ku i referohemi kryesisht të drejtës romake, as në periudhën e mesjetës dhe as në fazën e kapitalizmit të hershëm. Madje po t'i referohemi traditës juridike shqiptare, mund të konstatojmë se kjo kontratë nuk ishte parashikuar as nga Kodi Civil i vitit 1929, i cili duhet pranuar se ishte një nga kodet më moderne për kohën dhe rregullimi i parë juridik që i është bërë kësaj kontrate është me ligjin nr. 2359, datë 15.11. 1956 "*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*". Si një institut i kohëve moderne, kontrata e sigurimit të jetës dhe pasurisë, ka si qëllim të saj kryesor që të kontribuojë në sigurinë, në qarkullimin civil midis subjekteve të së drejtës, me anë të sigurimit të jetës dhe pasurisë së personit.

Parë në këndvështrimin historik, legjislacioni shqiptar, ashtu siç u citua më lart, e ka rregulluar për herë të parë me ligjin nr. 2359, datë 15.11. 1956 "*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*". Duke iu referuar këtij ligji të miratuar rreth 50 vjet më parë se Kodi Civil aktual që ka hyrë në fuqi me 1 nëntor 1994, konstatohet se një numër i madh dispozitash që rregullojnë kontratën e sigurimit të

Kodit Civil në fuqi, janë identike me dispozitat ligjore të ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”. Jo vetëm aq, por mund të konstatohet me lehtësi se pjesa më e madhe e çështjeve që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, të rregulluara nga Kodi Civil në fuqi, kanë qenë rregulluar në mënyrë identike nga ana e ligji të veçantë “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”.

Këtu unë do të ndalem dhe do të përmend vetëm disa prej çështjeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me rregullimin juridik të kontratës së sigurimit sipas këtyre dy ligjeve të kohëve dhe sistemeve të ndryshme, por, që çuditërisht kanë shumë të përbashkëta dhe ngjashmëri ndërmjet tyre. Kështu duke filluar që me kuptimin e kontratës së sigurimit, përkufizimi që i jep Kodi Civil kontratës së sigurimit është i njëjtë me kuptimin që i jep kësaj kontrate, ligji i mësipërm “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, duke bërë të dy ligjet në mënyrë identike që në përkufizim ndarjen e kontratës së sigurimit në kontratë të sigurimit të pasurisë dhe të personit dhe duke përcaktuar kuptimin e secilës prej këtyre llojeve të kontratave. Po ashtu, po t’i rfererohemi formës së lidhjes së kontratës së sigurimit, të dy ligjet si Kodi Civil në fuqi edhe ligji i mësipërm, përcaktojnë në mënyrë identike të njëjtën formë të lidhjes së kontratës, që është forma shkresore, konkretisht dëshmia e sigurimit (polica e sigurimit) që siguruesi i lëshon të siguruarit, duke përcaktuar se mosrespektimi i kësaj forme e bën kontratën të pavlefshme.

Në të njëjtën kohë, po t’i referohemi elementeve që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit ose polica e sigurimit, konstatohet se të dy ligjet e mësipërme, përcaktojnë në mënyrë identike të njëjtat elementë, çka tregon edhe njëherë se shumë dispozita të Kodit Civil në fuqi që rregullojnë kontratën e sigurimit janë marrë nga ligji nr. 2359, datë 15.11. 1956 “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”. Por, këtu vlen të bëjmë një konstatim që ka të bëjë me faktin që ndërsa ligji “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, përcakton në mënyrë të shprehur si një nga elementët e domosdoshëm që duhet të përmbajë kontrata e sigurimit edhe **shumën e sigurimit**, Kodi Civil në fuqi nuk e parashikon një element të tillë, gjë që mendoj që përbën të metë të ligjit në fuqi e cila duhet të rregullohet.

Për të mos vazhduar më tej me krahasimin ndërmjet dispozitave ligjore të Kodit Civil në fuqi dhe ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, krahasim i cili nuk është objekt i kësaj teme, mund të konstatohet se këto dispozita ligjore janë shumë të ngjashme dhe disa herë identike edhe në lidhje me përmbajtjen e kontratës së sigurimit, me të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë, me llojet e kontratës së sigurimit dhe me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve në këtë kontratë. Nga ajo që u tha më lart, **mund të arrijmë në konkluzionin se, dispozitat ligjore të Kodit Civil në fuqi që rregullojnë kontratën e sigurimit, përveçse nga Kodi Civil italian, janë marrë në një pjesë të madhe të tyre edhe nga ligji nr. 2359, datë 15.11. 1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”.**

Duke iu referuar në mënyrë shumë të përmbledhur trajtimit historik të kontratës së sigurimit sipas legjislacionit shqiptar, konstatojmë se kjo kontratë është rregulluar edhe nga Kodi Civil i vitit 1982. Veçoria e parë që të bie në sy në lidhje me trajtimin e kësaj kontrate nga ana e Kodit Civil të vitit 1982, është fakti se konstatohet një regres ose kthim mbrapa në lidhje me rregullimin juridik që i është bërë kontratës së sigurimit, krahasuar me rregullimin që i bënte ligji “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, kësaj kontrate, regres i cili konstatohet në dy drejtime kryesore:

Së pari: Kodi Civil i vitit 1982, në ndryshim nga ligji “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, ka rregulluar vetëm kontratën e sigurimit të pasurisë, dhe nuk ka asnjë dispozitë apo paragraf për rregullimin juridik të kontratës së sigurimit të personit, çka përbënte realisht një të metë shumë të madhe të këtij Kodi;

Së dyti: Edhe rregullimi juridik i kontratës së sigurimit të pasurisë nga ana e Kodit Civil të vitit 1982 është bërë në mënyrë shumë të cinguar (në rrjedhën normale të gjërave duhej të kishte

ndodhur e kundërta, sepse si rregull, sa më i ri të jetë ligji, aq më mirë i rregullon ai çështjet juridike për të cilat ai nxirret). Një gjë e tillë mund të konstatohet lehtë po të shikojmë numrin e dispozitave që rregullonin kontratën e sigurimit sipas ligjit “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”, ku kjo kontratë rregullohet nga 40 nene, nga neni 430 deri në nenin 469 të këtij ligji, ndërsa sipas Kodit Civil të vitit 1982, kontrata e sigurimit rregullohet nga vetëm 8 nene, nga neni 258 deri në nenin 265 të këtij Kodi. Ky regres në rregullimin e kontratës së sigurimit që kostatohet në Kodin Civil të vitit 1982, ishte në përputhje të plotë me rregjimin totalitar të asaj kohë, ku prona private ishte zhdukur plotësisht, dhe për pasojë edhe kontrata e sigurimit që shërben për sigurimin e kësaj pronë, shihej si një atavizëm i sistemit kapitalist i cili nuk kishte pse të ekzistonte dhe nëse duhej të ekzistonte, ajo duhej të rregullohej sa më pak nga ana juridike dhe thejsht vetëm formalisht.

Për t’u kthyer tek rregullimi ligjor i kontratës së sigurimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, kjo kontratë rregullimin e saj kryesor e gjen në Kodin Civil, por edhe në disa ligje të veçanta nga të cilët ndër më kryesorët mund të përmendim, ligjin “*Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit*”, dekretin nr. 295, datë 15.09.1992 “*Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjetëve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë*”, miratuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 01.12.1992 “*Për miratimin me ndryshime të këtij Dekreti*”, ligjin nr. 7506, datë 31.07.1991 “*Për institutin e sigurimeve dhe statutin e tij*”, etj. Në këtë punim unë do të trajtoj **kontratën e sigurimit vullnetar të pasurisë dhe personit të rregulluar vetëm nga dispozitat e Kodit Civil në fuqi** dhe nuk do të jenë objekt i këtij punimi kontrata sigurimi të veçanta të parashikuara nga ligje të tjera.

Kapitulli 1.

Kuptimi dhe karakteristikat e kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil në fuqi.

1.1. Kuptimi i kontratës së sigurimit.

Në Kodin Civil në nenin 1113 të tij, jepet kuptimi i kontratës së sigurimit në të cilin parashikohet:

“Me kontratën e sigurimit, njëra palë (siguruesi), në qoftë se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet:

a) në rastin e sigurimit të pasurisë t’i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës së parashikuar në kontratë;

b) në rastin e sigurimit të personit t’i paguajë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, shumën e sigurimit që është parashikuar në kontratë.

I siguruari detyrohet të paguajë primin (çmimin e sigurimit) të caktuar në kontratë. Siguruesi mund të jetë person publik ose privat”.

Nga formulimi i kësaj dispozite konstatojmë së ligjvënësi me anë të saj ka përcaktuar kuptimin si të kontratës së sigurimit të pasurisë së personit fizik apo juridik, ashtu edhe kontratën e sigurimit të jetës dhe shëndetit të personit fizik. Kuptimi i kontratës së sigurimit të pasurisë jepet në paragrafin “a” të nenit 1113 të këtij Kodi, sipas të cilit siguruesi, në rast se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë apo rasti i sigurimit, është i detyruar që t’i shpërblejë të siguruarit, ose një personi të tretë, në dobi të të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar ose shpërblimin e sigurimit, brenda kufijve të shumës së parashikuar në kontratë. Nga ana tjetër i siguruari është i detyruar që të paguajë primin e sigurimit ose çmimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë, në favor të siguruesit.

Kuptimi i kontratës së sigurimit të jetës dhe shëndetit të personit jepet në paragrafin “b” të nenit të mësipërm, sipas të cilit siguruesi, në rast se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë apo rasti i sigurimit, është i detyruar që t’i shpërblejë të siguruarit, ose një personi të tretë, në dobi të të cilit është lidhur kontrata, shumën e sigurimit që është parashikuar në kontratë, kundrejt detyrimit që ka i siguruari që të paguajë primin e sigurimit ose çmimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë, në favor të siguruesit.

Nga përcaktimi që u ka bërë ligjvënësi kuptimit të kontratës së sigurimit të pasurisë dhe të personit, vihet re se përveç ndryshimeve që kanë këto kontrata në objektin e tyre, ku në rastin e parë objekt i kontratës së sigurimit është pasuria e personit fizik ose juridik, ndërsa në rastin e dytë objekti i kësaj kontrate është jeta dhe shëndeti i personit fizik, si dhe përveç ndryshimeve që ekzistojnë në lidhje me rastet e ndryshme të sigurimit të cilat zbatohen për sigurimin e pasurisë dhe të personit, **detyrimet e siguruesit në lidhje me pagimin e shumës së sigurimit nuk janë të njëta në këto dy kontrata.** Kështu në rastin e sigurimit të pasurisë, siguruesi është i detyruar që t’i shpërblejë të siguruarit dëmin e pësuar nga ndodhja e rastit të sigurimit, kuptohet brenda shumës së përcaktuar në kontratë, ndërsa në rastin e sigurimit të personit, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, siguruesi nuk shpërblen dëmin në favor të të siguruarit, por është i detyruar që t’i paguajë një shumë të caktuar, sipas kushteve të përcaktuar në kontratë.

Kjo për faktin se dëmi që i shkaktohet të siguruarit nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit në jetën ose shëndetin e tij, është i pamundur të vlerësohet në të holla, pasi jeta dhe shëndeti i personit janë

të pazëvendësueshme dhe nuk mund të kovertohen në para, sado që të jetë shuma e tyre. Është kjo arsyeja pse ligjvënësi në rastin e sigurimit të personit ka parashikuar që i siguruari është i detyruar, që me ndodhjen e rastit të sigurimit, të paguajë në favor të të siguarit shumën e sigurimit të parashikuar në kontratë dhe jo t'i shpërblejë atij dëmin e pësuar, pasi siç u shpjegua më lart dëmi që i shkaktohet personit në jetën ose shëndetin e tij nuk mund të llogaritet në të holla e për pasoja as nuk mund të shpërblehet në të holla.

1.2. Karakteristikat e kontratës së sigurimit.

Përpara se të trajtoj elementët përbërës të kontratës së sigurimit të pasurisë dhe personit sipas dispozitave të Kodit Civil, çmoj me vend që të trajtoj fillimisht **karakteristikat kryesore të kësaj kontrate**, karakteristika të cilat janë të përbashkta, si për kontratën e sigurimit të pasurisë, ashtu dhe për kontratën e sigurimit të personit. Trajtimi i këtyre karakteristikave do të bëjë të mundur që të kuptohen më mirë elementët e kontratës së sigurimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet që kanë palët në këtë kontratë. Një ndër karakteristikat kryesore të kontratës së sigurimit është fakti se ajo **është kontratë formale solemne**.

Kjo karakteristikë është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Kodin Civil, sipas të cilit kontrata e sigurimit duhet lidhet në formë shkresore, konkretisht, në formën e **dëshmisë së sigurimit ose policës së sigurimit, sepse në rast të kundërt kjo kontratë është e pavlefshme**.² Kjo do të thotë se për këtë kontratë ligjvënësi ka parashikuar që vullneti i palëve të shfaqet në anën e jashtme, duke u manifestuar detyrimisht në formë shkresore, përndryshe në mungesë të kësaj forme shkresore, kontrata është e pavlefshme. Në këtë rast forma e kontratës është për efekt vlefshmërie (*ad substantiam*) dhe është pjesë e përmbajtjes, gjë që është e detyrueshme që të respektohet nga palët, në mënyrë që ata të lidhin një kontratë të vlefshme.

Në lidhje me formën e kontratës së sigurimit, duhet të sqarojmë se ligji ka parashikuar që ajo jo vetëm që duhet të bërë në formë shkresore, sepse në të kundërt është e pavlefshme, por ka përcaktuar edhe formën konkrete të mënyrës se si duhet të hartohet kjo kontratë. Sipas ligjit kontrata e sigurimit duhet bërë me shkresë, **në formën e dëshmisë së sigurimit apo policës së sigurimit, që siguruari i lëshon të siguarit**. Nga kjo rezulton se ligjvënësi jo vetëm ka kufizuar autonominë e vullnetit të palëve, në kuptimin që kjo autonomi e vullnetit duhet të vishet në një formë të caktuar që është **forma shkresore**, por ka parashikuar edhe mënyrën konkrete se si duhet të hartohet kjo kontratë dhe që është **dëshmia e sigurimit ose policia e sigurimit**. Në këto kushte mund të konkludojmë se **kontrata e sigurimit duhet që të hartohet jo vetëm në formë shkresore, por edhe konkretisht në formën e policës së sigurimit ose të dëshmisë së sigurimit të cilin siguruari i lëshon të siguarit, përndryshe është e pavlefshme**.

Në interpretim të kësaj dispozite duhet të pranojmë se kjo kontratë është e pavlefshme edhe në rastet edhe kur ajo hartohet nga noteri, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuar për hartimin e kontratave ose kur ajo hartohet me shkresë të thjeshtë, por që nuk përmban formën konkrete të **dëshmisë së sigurimit**. Për shembull, në rast se personi A me cilësinë e të siguarit dhe personi B me cilësinë e siguresit shkojnë para noterit dhe hartojnë një kontratë sigurimi, duke iu referuar dispozitave të Kodit Civil për kontratën e sigurimit, ose hartojnë jashtë zyrës së noterit një kontratë sigurimi duke iu referuar të njëjtave dispozitave si para noterit, por që kontrata e tyre nuk është **në formën e dëshmisë së sigurimit dhe nuk përmban elementët që ligji parashikon për dëshminë e sigurimit**, kjo kontratë do të jetë e pavlefshme për mungesë të formës, pavarësisht se është lidhur me akt noterial apo më shkresë të thjeshtë.

² Neni 1114 i Kodit Civil përcakton: “Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që siguruari i lëshon të siguarit, përndryshe është e pavlefshme”.

Arsyeja pse ligjvënësi ka parashikuar që kjo kontratë të lidhet në formë shkresore për efekt vlefshmërie, buron nga rëndësia e madhe që ka kjo kontratë në qarkullimin civil, si dhe për rrethin e gjerë dhe të madh interesave të cilat kjo kontratë mbulon. Një arsye tjetër është se duke qenë vullneti i palëve i manifestuar në formë shkresore, palët dhe gjykata në rast konflikti, e ka shumë më të lehtë që të zbatojnë kushtet e kontratës të cilat janë të shkruara, si dhe gjykata e ka më të lehtë që të interpretojë kushtet e një kontrate, kur ato janë të shprehura qartë në formë shkresore, në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis palëve. Si arsye të tretë mund të përmendim faktin se, kontrata e shkruar krijon më tepër siguri në qarkullimin civil midis palëve, duke bërë të mundur realizimin me të lehtë të qëllimeve të saj për të cilat ajo krijohet.

Nga ana tjetër mund të shtojmë se arsyeja pse nga ana e ligjvënësit është parashikuar edhe **forma konkrete si duhet të hartohet kjo kontratë, që është dëshmia e sigurimit ose policia e sigurimit, është nevoja për të standartizuar mardhëniet juridike që lindin nga kjo kontratë midis subjektëve të së drejtës**, të cilat kanë një karakter të veçantë dhe specifik në raport me kontratat e tjera. Ky parashikim është bërë edhe për faktin se si palë siguroese për këtë kontratë është gjithmonë një person juridik, i cili është i pajisur me njohuri të posaçme në fushën e sigurimeve dhe është pala që është e detyruar që të lëshojë dëshminë e sigurimit. Duke qenë se si siguroes mund të dalin një numër i ndryshëm subjektësh, çka është provuar edhe nga praktika e krijuar në fushën e sigurimeve deri tani, në mënyrë që të mos krijohet konfuzion në këto mardhënie, ligjvënësi ka parashikuar që kjo kontratë të hartohet në formën e policës së sigurimit, duke përcaktuar edhe elementët e domosdoshëm të saj.

1.3. Elementet e policës së sigurimit.

Ligji ka përcaktuar shprehimisht edhe elementët që duhet të përmbajë policia e sigurimit ose dëshmia e sigurimit, sepse në të kundërt ajo është e pavlefshme. Duke u nisur nga rëndësia që paraqet kontrata e sigurimit në qarkullimin civil, në ligj janë parashikuar konkretisht edhe elementët që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, elementë të cilët janë të përbashkët si për kontratën e sigurimit të jetës dhe shëndetit, ashtu edhe për sigurimin e pasurisë, elementë të cilët në mënyrë të përmbledhur janë:³

a. Emri i siguroesit, që sipas ligjit duhet të jetë gjithmonë një person juridik, i cili është themeluar dhe funksionon në formën e një shoqërie anonime apo aksionare. Si siguroes mund të jetë një person juridik publik apo person juridik privat, vendas apo i huaj, i krijuar sipas ligjit.

b. Emri i personit të siguar, në rastin e sigurimit të personit. Ky emër duhet detyrimisht të përfshijë gjeneralitet e plotë dhe të sakta të personit të siguar, vendbanimin e plotë të tij dhe mjetin e saktë të identifikimit.

c. Lloji konkret i pasurisë së siguar, karakteristikat kryesore të kësaj pasurie, si dhe vendodhjen e saktë të saj, në rastin e sigurimit të pasurisë. Kështu në rast se objekt i sigurimit është një pasuri e paluajtshme, një apartament banimi, në kontratën e sigurimit duhet të përcaktohen karakteristikat themelore të kësaj pasurie, si vendodhja e saj, madhësia apo sipërfaqja, kufizimet e

³ Paragrafi i parë i nenit 1115 të Kodit Civil përcakton: “Në dëshminë e sigurimit duhet të tregohen sidomos:

a) emri i siguroesit;

b) emri i personit të siguar, në rastin e sigurimit të personit, pasuria e siguar dhe vendi ku ndodhet kjo pasuri në rastin e sigurimit të pasurisë;

c) ngjarja me vertetimin e të cilës siguroesi të përmbushë detyrimin që ka marrë në kontratë;

ç) fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit (afati i sigurimit);

d) koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguroesit;

e) vlerësimi i pasurisë në ato raste që kjo gjë kërkohet për një lloj të caktuar sigurimi;

ë) primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre”.

sakta të pasurisë, viti i ndërtimit të saj, si dhe çdo karakteristikë tjetër që çmohet nga palët që i shërben kontratës së sigurimit. Në rast se objekt i sigurimit është një send i luajtshëm, konkretisht për shembull, një gjerdan floriri, në kontratë duhet të përcaktohen me hollësi veçoritë që e dallojnë këtë objekt, peshën e tij, llojin e materialit të çmuar nga i cili përbëhet, vendi konkret ku do të qëndrojë ky objekt, si dhe çdo karakteristikë që shërben për identifikimin e plotë dhe të saktë të këtij objekti.

d. Ngjarjen me vertetimin e të cilës siguruasi detyrohet të përmbushë detyrimin që ka marrë përsipër. Kjo ngjarje quhet ndryshe edhe **rasti i sigurimit** dhe është e ndryshme në varësi të llojit të kontratës së sigurimit dhe e ndryshme nga lloji konkret i objektit që sigurohet. Kështu në rastin e sigurimit të pasurisë, ngjarjet e sigurimit janë të ndryshme nga ato që parashikohen për sigurimin e personit. Kështu është jo logjike që të mendosh të sigurosh pasurinë nga aksidentet personale, por është normale që të sigurosh personin nga këto aksidente, ashtu siç është jo logjike të mendosh të sigurosh personin nga zjarri, por është normale të mendosh të sigurosh pasurinë nga zjarri. **Ngjarja e sigurimit ose rasti i sigurimit është një ngjarje atmosferike, natyrore apo sociale e parashikuar në kontratë, me vertetimin e të cilës siguruasi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit.** Rasti i sigurimit si rregull u referohet **ngjarjeve të papritura dhe të pamundura për t'u parandaluar edhe me përkujdesjen maksimale të njeriut.** Si të tilla mund të përmendim aksidentet, zjarrin, përmytjet, e të tjera ngjarje të cilat janë të ndryshme në varësi të llojit të kontratës së sigurimit dhe në varësi të objektit që sigurohet.

e. Fillimin dhe mbarimin e kontratës së sigurimit. Kontrata e sigurimit ashtu si shumica e kontratave në qarkullimin civil, ka një datë fillimi dhe mbarimi, por ky element është parashikuar jo pa qëllim nga ligjvënësi si element i domosdoshëm që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, pasi në rast se në dëshminë e sigurimit nuk parashikohet fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit, kjo kontratë është e pavlefshme.

ë. Koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguruasit. Kjo kohë është koha kur kontrata fillon që të sjellë efektet e saj dhe është e domosdoshme që palët të parashikojnë në kontratë kohën se kur fillon përgjegjësia e siguruasit. Në praktikë kjo përgjegjësi e siguruasit fillon në momentin kur i siguruari paguan primin e sigurimit ose çmimin e sigurimit.

f. Vlerësimin e pasurisë në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji ose aktet nënligjore për atë lloj sigurimi. Në rastet se në ligj apo në akte nënligjore është parashikuar që për objektin për të cilin do të bëhet sigurimi, duhet të bëhet edhe vlerësimi i këtij objekti, atëherë palët janë të detyruar që të bëjnë këtë vlerësim, si dhe vlerën e tij ta shënojnë në dëshminë e sigurimit.

g. Primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre. Primi i sigurimit është shuma që i siguruari është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit, në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Kjo shumë parashikohet në kontratë në bazë të tarifave të përcaktuara nga Ministri i Financave. Kjo do të thotë se palët janë të detyruar që në përcaktimin e primit të sigurimit, t'i referohen këtyre tarifave dhe nuk janë të lira që të vendosin me vullnetin e tyre çdo prim sigurimi që ata dëshirojnë. Ky prim mund të parashikohet në dëshminë e sigurimit se do të paguhet menjëherë apo me këste.

Nga trajtimi i elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, konstatojmë se neni 1115 i Kodit Civil, i cili ka parashikuar këto elemente, nuk ka përfshirë si element të domosdoshëm që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, **shpërblimin e sigurimit apo shumën e sigurimit** që siguruasi detyrohet t'i paguajë të siguruarit me ndodhjen e rastit të sigurimit. Duke iu referuar nenit 1113 të këtij Kodi, i cili jep kuptimin e kontratës së sigurimit, në të cilin përmendet shprehimisht **shuma e sigurimit shpërblimi i sigurimit**, si një nga elementët e kontratës së sigurimit, mendoj se mos parashikimi nga ana e ligjvënësit që ky element të jetë pjesë

përbërësë e elementëve që përcaktojnë vlefshmërinë dëshmisë së sigurimit, është një harrësë nga ana e ligjvënësit dhe nuk është bërë qëllimisht.

Pavarsisht këtij fakti, çmuj se mospërcaktimi i shumës së sigurimit ose shpërblimit të sigurimit nga ana e ligjvënësit, si një element të domosdoshëm që duhet të përmbajë kontrata e sigurimit, është një e metë e këtij neni e cila duhet plotësuar. Kjo për faktin se shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit ka të njëjtën vlerë me primin e sigurimit, të cilin e paguan i siguruari dhe nuk është gjë tjetër veçse vlera në të holla që paguan siguruasi në favor të të siguruarit, me ndodhjen e rastit të sigurimit. Duke qenë se nga ana e ligjvënësit është parashikuar si element i domosdoshëm i dëshmisë së sigurimit, primi e sigurimit, nga ana e tij duhej të ishte parashikuar edhe shuma e sigurimit si element i domosdoshëm i kësaj kontrate, e cila përfaqëson vlerën që siguruasi i paguan të siguruarit, me ndodhjen e rastit të sigurimit të parashikuar në kontratë.

Nga ana tjetër duhet theksuar fakti se pavarsisht që ligjvënësi nuk e ka parashikuar shpërblimin e sigurimit si element të domosdoshëm të dëshmisë së sigurimit, kjo nuk do të thotë që shpërblimi i sigurimit nuk është element i domosdoshëm i kontratës së sigurimit, pasi Kodi Civil në nenet 1113, 1136 e 1137 të tij, jo vetëm e përcakton atë si element të domosdoshëm të kontratës së sigurimit, por përcakton edhe mënyrën e llogaritjes së saj. Konkretisht sipas këtyre dispozitave **shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit nuk mund të jetë asnjëherë më e madhe se vlera e objektit të siguar, ajo mund të jetë e barabartë me vlerën e objektit të siguar ose dhe më e vogël dhe në rastin e fundit jemi para sigurimit të pjesshëm të pasurisë.**

Duke iu referuar mënyrës sesi e ka rregulluar ligji çështjen e shumës së sigurimit, konstatojmë se ajo llogaritet në dy mënyra apo siteme:⁴

E para: Sistemi proporcional dhe

E dyta: Sistemi i rrezikut të parë.

Sipas **sistemit proporcional** shpërblimi i sigurimit nuk mund të jetë më i madh se shuma e sigurimit dhe as më i madh se dëmi efektiv që i është shkatuar të siguruarit.⁵ Në rastet kur shuma e sigurimit është më e vogël se vlera e pasurisë së siguar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjestim me raportin ndërmjet shumës së sigurimit dhe vlerës së pasurisë së siguar. Në këtë rast i siguruari ose person i tretë, në dobi të të cilit është lidhur kontrata, do të marrin shpërblim vetëm për atë pjesë të dëmit që i korespondon pasurisë së siguar.

Kështu për shembull, në rast se personi A.G siguron apartamentin e tij me vlerë prej dhjetëmilion lekësh, vetëm për dymilion e pesëqindmijë lekë dhe ndodh rasti i sigurimit duke i shkatuar një dëm prej katërmilion lekësh, personi A do të marrë si shpërblim sigurimi vetëm njëmilion lekë, **sepse pasurinë e tij e kishte siguar vetëm për një të katërtën pjesë dhe sipas sitemit proporcional dhe shpërblimin e sigurimit do ta marrë vetëm për këtë një të katërtën pjesë të pasurisë së siguar.**

Sipas **sistemit të rrezikut të parë**, dëmi i shkaktuar duhet të shpërblehet plotësisht pa u marrë në konsideratë fakti i përpjestimit, midis shumës së sigurimit dhe vlerës reale të pasurisë së siguar. Siguruasi në këtë rast merr përsipër që të paguajë të gjithë dëmin e pësuar edhe për ato pjesë të pasurisë së pasiguar, por gjithmonë brenda shumës së sigurimit të parashikuar në kontratë.

Kodi ynë Civil ka pranuar në dispozitat e tij sistemin proporcional, por kjo nuk do të thotë se sistemi i rrezikut të parë është i ndaluar, pasi ky sistem është parashikuar me dispozita lejuese, çka

⁴ Shih për më tepër: Semini, Marjana; “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e posaçme”, Tiranë, 2002, faqe 181.

⁵ Paragrafi i parë i nenit 1136 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vleftha e pasurisë. Kjo vlefthë, për disa lloje sigurimi, mund të jetë e përcaktuar në kontratën e sigurimit edhe ma anë të vlefthësisë të pasurisë”

do të thotë që palët me marrëveshje midis tyre mund të parashikojnë edhe sistemin e rrezikut të parë⁶. Në rast se palët me marrëveshje parashikojnë se do të zbatohet sistemi i rrezikut të parë, atëherë ky parashikim është plotësisht i vlefshëm dhe shuma e sigurimit do të llogaritet sipas këtij sistemi.

1.4. Karakteri aleator ose fator i kontratës së sigurimit.

Kjo karakteristikë e kontratës së sigurimit do të thotë që kjo kontratë karakterizohet nga **pacaktueshmëria në përmbushjen e detyrimeve të sigurvearit, ndaj të sigurvearit.**⁷ Karakteri i papërcaktueshëm i kësaj kontrate shprehet në faktin se në momentin e lidhjes së kontratës, palët nuk e dinë nëse do të ndodhë ose jo ngjarja e sigurimit dhe për pasojë nëse sigurveari do të përmbushë detyrimet, ndaj të sigurvearit. Në rast se gjatë kohëvazhdimin të kontratës, ndodh rasti i sigurimit i parashikuar në kontratë, atëherë lind detyrimi i sigurvearit që të paguajë shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë në favor të të sigurvearit.

Fakti që kontrata e sigurimit është një kontratë aleatore ose fatore, domethënë, që është një kontratë e cila karakterizohet nga pacaktueshmëria, rezulton nga vetë përmbatja e nenit 1113 të Kodit Civil, i cili jep kuptimin e kësaj kontrate sipas të cilit *“me kontratën e sigurimit, njëra palë (sigurveari), në qoftë se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet...”*. Mënyra si është formuluar kjo dispozitë duke përdorur mënyrën kushtore: *“në qoftë se”*, tregon qartë se në këtë kontratë jemi para një elementi të papërcaktuar të përmbajtjes së saj. **Pacaktueshmëria është një nga karakteristikat themelore që e dallon kontratën e sigurimit nga të gjitha kontratat e tjera në qarkullimin civil.**

1.5. Kontrata e sigurimit si kontratë ad’hezioni ose aderimi.

Kjo do të thotë që **kushtet e kësaj kontrate hartohen vetëm nga njëra palë që është pala sigurveare, në formën e dëshmisë së sigurimit**, për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit dhe për çdo lloj objekti që sigurohet, ndërsa pala tjetër, i sigurveari, zakonisht ka vetëm të drejtën e nënshkrimit të kësaj kontrate. Fakti që kontrata e sigurimit është një kontratë ad’hezioni, rezulton edhe nga përmbatja e nenit 1114 të këtij Kodi, i cili parashikon formën e kësaj kontrate dhe në të cilin ndër të tjera thuhet se kontrata e sigurimit hartohet me anë të dëshmisë së sigurimit **që sigurveari i lëshon të sigurvearit.**

Nga kjo dispozitë rezulton e qartë se kjo kontratë është një kontratë ad’hezioni ose aderimi, sepse e vetmja mënyrë e vlefshme për t’u hartuar kjo kontratë është me anë të dëshmisë së sigurimit që sigurveari i lëshon të sigurvearit. Kjo do të thotë se kushtet e kësaj kontrate hartohen nga sigurveari, ndërsa i sigurveari ka vetëm të drejtën që të nënshkruajë ose jo atë, domethënë, ka vetëm të drejtën që të shfaqë vullnetin, nëse do ta lidhë ose jo këtë kontratë.

Në lidhje me **kontratat e ad’hezionit** në literaturën juridike ka patur dhe ka diskutime nëse në këto kontrata autonomia e vullnetit të palës e cila nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës është e lirë apo jo? Në lidhje me këtë çështje autorët janë ndarë në dy grupe: **Grupi i parë** i autorëve pranon se në kontratat e ad’hezionit, autonomia e vullnetit të palës e cila nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës, është e kufizuar pasi kjo palë nuk shfaq vullnetin e saj në hartimin e kushteve të kontratës, por, është e detyruar që të pranojë ose jo kushtet e hartuara nga pala tjetër dhe, përderisa ndodhemi para faktit që të dy palët nuk janë në kushte të barabarta, kemi cënim të autonomisë së vullnetit të palës, e cila nuk merr pjesë në hartimin e kontratës.

⁶ Paragrafi i parë i nenit 1137 i Kodit Civil përcakton: *“Kur pasuria e sigurvearit humbet ose dëmtohet, shpërblehet, sipas rastit, vlefë e saj brenda kufijve të shumës së sigurimit ose pakësimi i vlefës së pasurisë, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe”*.

⁷ Shih për më tepër tek *“Obligimet dhe kontratat përgjithësisht”*, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Durrës, 1932, faqe 52-54.

Grupi i dytë i autorëve, përkundrazi, pranojnë se në këto kontrata nuk kemi cënim të autonomisë së vullnetit të palës e cila nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës, pasi është e vertetë që kjo palë nuk shfaq vullnetin në hartimin e kushteve të kontratës, por, ajo është e lirë që të shfaqë vullnetin e saj nëse do ta lidhë apo jo këtë kontratë, vullnet i cili është shumë i rëndësishëm dhe në mungesë të këtij vullneti, kontrata nuk mund të lidhet. Këta autorë arsyetojnë se duke qenë se pala e cila nuk harton kushtet e kontratës, është e lirë të shfaqë vullnetin e saj nëse do ta lidhë apo jo këtë kontratë, atëherë nuk kemi cënim të autonomisë së vullnetit të kësaj pale, për më tepër që kjo palë ka të drejtë që të shtojë kushte të tjera në këtë kontratë ose të ndryshojë një pjesë të kushteve të hartuara nga pala tjetër.

Personalisht jam i mendimit se tek kontratat e ad'hezionit nuk kemi cënim të autonomisë së vullnetit të palës e cila nuk harton kushtet e kontratës, pasi kjo palë e shfaq mjaft qartë vullnetin e saj, qoftë kur vendos të lidhë ose jo këtë kontratë, qoftë edhe me të drejtën që ka kjo palë për të shtuar elementë të tjerë të kontratës ose për të ndryshuar elementët e hartuara më parë, kuptohet si për çdo kontratë tjetër në marrëveshje me palën tjetër. Pavarsisht nga kjo, mendoj se në mënyrë që të mos ndodhemi para cënimit të autonomisë së vullnetit të palës e cila nuk harton kushtet e kontratës, duhet që të plotësohet edhe një kusht tjetër që është: **duhet të ekzistojë kokurenca e lirë në treg dhe të mos ndodhemi në kushtet e monopolit**. Pra, duhet që shërbimi i sigurimit që ofrohet nga pala e cila harton kushtet e kontratës, të mos ofrohet vetëm nga një subjekt i vetëm, qoftë ai publik ose privat, por, në treg të ketë edhe subjekte të tjera që e ofrojnë këtë shërbim dhe në këto kushte pala e cila nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës, të ketë mundësi zgjedhjeje. Në tregun e sigurimeve një gjë e tillë tashmë është zgjidhur, pasi ka disa subjekte private dhe një shtetëror, i cili së fundmi po shkon edhe ai drejt privatizimit⁸ të cilët ofrojnë shërbime në fushën e sigurimeve, kështu që pala që nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës ka të drejtën e zgjedhjes.

Në këto kushte mund të pohojmë me siguri se tek kontrata e sigurimit nuk kemi cënim të autonomisë së vullnetit të palës e cila nuk merr pjesë në hartimin e kushteve të kontratës. Megjithatë, jam i mendimit se tek kjo kontratë nuk mund të mohohet se për shkak të njohurive profesionale, për shkak të pozitës së saj në treg, për shkak të potencës së saj financiare, pala siguroes, e është gjithmonë më e privilegjuar se pala e siguruar.

Arsyeja pse ligjvënësi ka parashikuar që kjo kontratë të jetë një kontratë ad'hezioni, mendoj se është nevoja për të krijuar një rregullshmëri dhe uniformitet në qarkullimin civil. Duke qenë një kontratë e rëndësishme me anë të të cilës realizohen interesa të rëndësishme të qytetarëve, por, që edhe mund të çojë në cënimin e këtyre interesave, ligjvënësi e ka parë të dobishme që ta standartizojë një kontratë të tillë dhe çmoj se zgjedhja e tij është e drejtë. Me anë të standartizimit të kësaj kontrate, krijohet jo vetëm një rregullshmëri në qarkullimin civil midis subjektëve të së drejtës në lidhje me këtë shërbim, por realizohet edhe mbrojtja e të drejtave të ligjshme të palës së siguruar, e cila është më e dobët se pala siguroese në këtë kontratë.

Kështu që mund të pohojmë se arsyeja e dytë pse ligjvënësi e ka përcaktuar këtë kontratë si kontratë ad'hezioni, është **mbrojtja e interesave të të sigurvearit**. Kjo kontratë kërkon njohuri të posaçme juridike dhe teknike në hartimin dhe zbatimin e saj, prandaj ligjvënësi ka parashikuar që kjo kontratë duhet të hartohet nga pala siguroese, e cila i ka këto njohuri të posaçme dhe është e

⁸ Është fjala për shoqërinë e sigurimeve INSIG, e cila për disa vite me radhë ishte person juridik shtetëror dhe kishte monopolin në fushën e sigurimeve, shoqëri e cila me liberalizimin e tregut të sigurimeve dhe me daljen e shoqërive private të sigurimeve, po shkon edhe ajo drejt privatizimit.

detyruar që të informojë edhe palën tjetër për kuptimin e të gjithë kushteve të kontratës, si dhe të pasojave që sjell lidhja e kësaj kontrate.

1.6. Rëndësia e afatit tek kontrata e sigurimit.

Kontrata e sigurimit është në të gjitha rastet një kontratë me afat strikt të përcaktuar. Kjo karakteristikë rezulton nga përmbajtja e nenit 1115 pika “ç” e Kodit Civil sipas të cilës dëshmia e sigurimit duhet të përmbajë fillimin dhe mbarimin e kontratës së sigurimit. Afati në kuptimin juridiko-civil, është ai çast i caktuar në kohë, kur fillojnë ose mbarojnë pasojat juridike të kontratës.⁹ Tek **kontrata e sigurimit afati ka rëndësi thelbësore dhe mungesa e përcaktimit të afatit të fillimit dhe mbarimit të kontratës, e bën kontratën të pavlefshme.** Afati konkret i kohëzgjatjes së kontratës së sigurimit është në varësi nga lloji i kontratës dhe nga lloji i objektit që sigurohet. Afati më i zakonshëm i kontratës së sigurimit është një vjeçar, por, ky afat mund të jetë më shumë ose më pak se një vit; për shembull, gjashtë muaj për produktet bujqësore ose për ndërtesat, afati mund të jetë nga një deri në pesë vjet.

Kodi Civil në fuqi nuk ka parashkuar ndonjë afat maksimal, të cilin palët duhet ta respektojnë për lidhjen e kësaj kontrate, kështu palët mund të lidhin një kontratë sigurimi duke parashkuar një afat maksimal që ata dëshirojnë, me përjashtim të rasteve kur në dispozita të veçanta ligjore ose nënligjore, është përcaktuar një afat maksimal brenda të cilit duhet të lidhet kontrata e sigurimit. Në rastin kur dispozitat të veçanta ligjore apo nënligjore nuk parashikojnë ndonjë afat maksimal për lidhjen e kontratës së sigurimit, palët janë të lira që të lidhin këtë kontratë, me çdo afat që ato dëshirojnë.

Në qoftë se palët lidhin një kontratë sigurimi pa afat dhe me dispozita ligjore ose nënligjore nuk është parashkuar afati maksimal i lidhjes së kësaj kontrate, ligji ka përcaktuar se kur afati i kontratës është mbi dhjetë vjet, palët me kalimin e këtij afati dhe në rast se nuk kanë ndonjë marrëveshje të kundërt, kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata, duke bërë një paralajmërim palës tjetër gjashtë muaj më parë.¹⁰ Në ligj është përcaktuar po ashtu, se kjo kontratë mund të ripërtërihet në heshtje një ose disa herë, por, çdo ripërtitje nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet, si dhe ky rregull nuk zbatohet tek kontrata e sigurimit të jetës, e cila nuk mund të ripërtërihet në heshtje.

1.7. Kontrata e sigurimit vullnetar ose të detyrueshëm.

Kontrata e sigurimit është vullnetare kur ajo lidhet vetëm duke u bazuar tek vullneti i lirë i palëve kontraktuese. Kjo kontratë mund të shfaqet në formën e kontratës së sigurimit të personit ose të sigurimit të pasurisë, e cila përfshin në vetëvete sigurimin e çdo lloji pasurie. Pikërisht **kontrata e sigurimit vullnetar të personit ose të pasurisë është objekt rregullimi në Kodin Civil dhe përbën në të njëjtën kohë objektin e trajtimit të temës tonë.**

Kontrata e sigurimit është e detyrueshme kur vullneti për lidhjen e saj nuk buron nga personi apo subjektet e së drejtës, por buron nga ligji. Në këtë rast është vullneti i ligjit dhe jo i subjektit që bën që të lindë kontrata e sigurimit dhe subjektet janë të detyruar që të lidhin këtë kontratë, pavarësisht vullnetit të tyre. Në këtë rast mund të themi se **ligji imponon vullnetin e personit** dhe kjo është një nga përjashtimet e rralla në fushën e të drejtës civile, ku ligji ndërhyr në vullnetin e personit, duke e detyruar që të lidh një kontratë, pasi në pothuajse të gjitha rastet e tjera, është vullneti i palëve që çon në krijimin e një kontrate dhe jo vullneti i ligjit.

⁹ Neni 89 i Kodit Civil përcakton: “Afati i veprimt juridik është ai çast i caktuar, nga i cili fillon ose pushon fuqia juridike ose disa nga efektet e tij”.

¹⁰ Paragrafi i dytë i nenit 1124 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur afati i kontratës është mbi dhjetë vjet, palët me kalimin e këtij afati dhe në rast se nuk kanë ndonjë marrëveshje të kundërt, kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata, duke bërë një paralajmërim gjashtë muaj më parë”.

Kontrata e sigurimit të detyrueshëm, të cilin unë do të preferoja ta quaja **kontrata e sigurimit ligjor** mund të shfaqet si në formën e sigurimit të jetës ashtu edhe në formën e sigurimit të pasurisë. Kështu si kontratë të sigurimit ligjor (të detyrueshëm) të personit mund të përmendim rastet e sigurimit të jetës, në rast të transportimit ajror apo detar dhe automobilistik. Si rast të sigurimit ligjor të pasurisë mund të përmendim rastet e sigurimit të detyrueshëm të automjetëve që bëhen në bazë të dekretit nr. 295, datë 15. 09. 1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjetëve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, miratuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 01.12.1992, ose rastet e sigurimit të ndërtesave pronë shtetërore që jepen me qira.

1.8. Ekzistenca e shkakut të ligjshëm, si kusht për lidhjen e kontratës së sigurimit.

Si çdo kontratë edhe kontrata e sigurimit duhet të ketë një shkak juridik dhe ky shkak duhet të jetë i ligjshëm. Kështu ligji ka parashikuar në mënyrë të shprehur se për lidhjen e kontratës së sigurimit duhet të ekzistojë në çdo rast **interesi i ligjshëm** për lidhjen e saj, duke u shprehur se kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se vertetohet se rreziku i sigurimit ose risku i sigurimit nuk ka ekzistuar ndonjëherë ose ky risk pushon së ekzistuari përpara mbarimit të kontratës.¹¹ Pra, në rast se palët kanë lidhur një kontratë sigurimi, por, në kohën kur ata e kanë lidhur këtë kontratë rreziku i sigurimit nuk ekziston apo nuk ka ekzistuar asnjëherë, ose pushon së ekzistuari, para lidhjes së kontratës, do të thotë që palët nuk kanë shkak të ligjshëm për lidhjen e kontratës.

Dihet që palët në lidhjen e një kontrate shtyhen nga arsye të ndryshme, por **si shkak i kontratës do të konsiderohet ai shkak tipik që është i njëjtë për çdo lloj kontrate dhe që i çon palët në lidhjen e saj.**¹² Çdo kontratë ka shkakun e saj tipik, i cili konsiderohet edhe si shkak i ligjshëm i saj dhe në rastin e kontratës së sigurimit ky shkak tipik është **përfitimi i të siguruarit i shumës së sigurimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, si dhe përfitimi i siguruesit i primit të sigurimit me lidhjen e kësaj kontrate.** Pavarsisht se arsyet që i shtyjnë palët për lidhjen e kontratës së sigurimit mund të jenë të ndryshme, si dhe pavarsisht nga lloji i kontratës së sigurimit dhe nga lloji i objektit që sigurohet, shkakun e kësaj kontrate është i njëjtë dhe është përfitimi nga ana e të siguruarit të shumës së sigurimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe përfitimi nga ana e siguruesit i primit të sigurimit me lidhjen e kësaj kontrate.

Siç shihet kontrata e sigurimit është e lidhur në mënyrë të pandarë me **ngjarjen e sigurimit ose me rrezikun e sigurimit** dhe në qoftë se ky rrezik nuk ka ekzistuar asnjëherë ose ka pushuar së ekzistuari para lidhjes së kontratës, atëherë rezulton se personi nuk ka shkak të ligjshëm për lidhjen e kontratës dhe kemi një kontratë pa shkak, e për pasojë të pavlefshme.¹³ Për më tepër në ligj është parashikuar se, kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se shkakun e kontratës ose rrezikun e sigurimit, pushon se ekzistuari pas lidhjes së kontratës. Në këto raste siguruesi ka të drejtë që të kërkojë nga i siguruari që t’i paguhen primitet e sigurimit, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit, t’i jetë njoftuar atij në mënyrë të drejtpërdrejtë nga i siguruari, ose t’i jetë bërë e ditur në ndonjë me çdo formë tjetër të ligjshme.¹⁴

1.9. Lidhja e kontratës së sigurimit në dobinë e personit të tretë.

¹¹ Neni 1121 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se vertetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar asnjëherë ose ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës”.

¹² Shih për më tepër: Nuni, Ardian; “Veprimet juridike”, Tiranë 2000, faqe 168.

¹³ Për më tepër shih: “Obligimet dhe kontratat përgjithsisht”, botim i Minsitrisë së Drejtësisë, Durës, 1932, faqe 203, 204, 205.

¹⁴ Neni 1122 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së qeni pas përfundimit të kontratës, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primeve, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit t’i jetë njoftuar ose t’i jetë bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër”.

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme e kontratës së sigurimit është fakti se ajo mund të lidhet edhe në dobi të një personi të tretë. Një gjë e tillë rezulton nga përmbajtja e nenit 1113 të Kodit Civil, në të cilën jepet kuptimi i kësaj kontrate dhe ku është përcaktuar ndër të tjera se, siguruesi në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguarit ose **në favor të personit të tretë, në dobi të të cilit është lidhur kontrata**. Kontrata e sigurimit në dobi të personit të tretë mund të lidhet si në rastin e sigurimit të pasurisë, ashtu dhe në rastin e sigurimit të personit.

Që kontrata e sigurimit në dobi të personit të tretë të jetë e vlefshme, duhet që personi i tretë, të jetë i huaj, domethënë, të mos jetë palë në lidhjen e kontratës, si dhe **të ketë interes pasuror në objektin e siguruar**. Nuk kanë rëndësi për të drejtën motivet që i shtojnë palët për lidhjen e kontratës së sigurimit, në dobi të personit të tretë, e rëndësishme është që kjo kontratë të ketë përcaktuar qartë personin e tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, pasurinë e cila sigurohet, si dhe të provohet fakti se personi i tretë ka interes pasuror të ligjshëm në këtë pasuri të siguruar, në rastin e sigurimit të pasurisë.

1.10. Momenti i veçantë i hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit.

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në një moment tepër të veçantë që është konkretisht ora 24 e ditës së përfundimit të kontratës dhe mbaron në orën 24 të ditës së fundit të kohëzgjatjes së kontratës.¹⁵ Kjo do të thotë se kjo kontratë fillon të sjellë efekte për palët në orën 24.00 të ditës kur është lidhur kontrata dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të afatit të kontratës. Për shembull, në rast se personi N.C lidh një kontratë sigurimi nga aksidentet personale me shoqërinë e sigurimeve B, me datë 12.09.2002, me afat një vit, kjo kontratë do të hyjë në fuqi në orën 24.00 të datës 12.09.2002 dhe do të mbarojë në orën 24.00 të datës 11.09.2003. E veçova kohën e hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit, si një nga karakteristikat e saj, për dy arsye:

E para: Vetëm tek kjo kontratë paraqet një interes të veçantë edhe ora tepër e saktë e hyrjes së saj në fuqi, madje edhe minuti dhe sekondi i hyrjes në fuqi, kjo për faktin se fillimi i zbatimit të kësaj kontrate është i lidhur me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, e cila nuk varet aspak nga vullneti i palëve dhe e cila mund të ndodhë edhe brenda një ore, një gjysëm ore, për disa minuta, madje edhe për disa sekonda;

E dyta: Vetëm në këtë kontratë ka një rëndësi të veçantë koha e saktë e përfundimit të kontratës, kohë e cila është e përcaktuar, që në momentin e lidhjes së kontratës, jo vetëm me datë të saktë, por, edhe me orë, minuta dhe sekonda dhe përcaktimi i saktë i afatit të fillimit dhe mbarimit të kontratës, si në asnjë kontratë tjetër, është kusht për vlefshmërinë ose jo të kontratës.

1.11. Zgjidhja e kontratës së sigurimit të pasurisë, si pasojë e tjetërsimit të saj nga një subjekt tek një tjetër.

Në qoftë se një subjekt ka siguruar pasurinë e tij dhe më pas këtë pasuri e kalon në pronësi të një subjekti tjetër, kontrata e sigurimit do të zgjidhet. Në këtë rast primi i paguar nga i siguruari, i kthehet atij, në përpjestim me kohën që mbetet deri në mbarimin e afatit të kontratës së sigurimit. Për shembull, në rast se personi L.N ka siguruar banesën e tij me datë 08.08.2004, për një afat një vit, duke paguar një prim sigurimi prej 12000 lekësh dhe me datë 08.10.2004 e shet këtë banesë tek personi B, kontrata e sigurimit do të konsiderohet e zgjidhur. Në këtë rast personi A do të marrë në përpjestim me kohën e mbetur primin e sigurimit që ka paguar tek shoqëria e sigurimit dhe në rastin konkret duke qenë se primi i sigurimit që ka paguar personi A është 12000 lekë dhe koha e mbetur

¹⁵ Paragrafi i parë nenit 1124 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24 të ditës së përfundimit të kontratës dhe mbaron në orën 24 të ditës së fundit të kohëzgjatjes së kontratës”.

deri në mbarimin e kontratës është dhjetë muaj, atëherë personi A do të marrë nga shoqëria siguruese shumën prej 10000 lekësh si pjesë e primit të paguar prej tij.

Sipas dispozitave ligjore rregulli i mësipërm sipas të cilit kontrata e sigurimit të pasurisë zgjidhet kur pronësia e objektit të siguruar kalon nga një person tek tjetri, nuk zbatohet për automjetet. Në këtë rast, kur objekti i siguruar është një automjet, pavarësisht faktit se pronësia e tij kalon nga një person tek tjetri, kontrata e sigurimit do të vazhdojë të ketë efekte edhe për pronarin e ri deri në afatin e mbarimit të saj.

1.12. Interesi pasuror në objektin e siguruar, si kusht për vlefshmërinë e kontratës së sigurimit.

Në kontratën e sigurimit të pasurisë të pasurisë, personi i cili lidh kontratën duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar, në të kundërt kontrata është e pavlefshme. Ky është një përcaktim i bërë shprehimisht në ligj dhe i referohet rregullit të përgjithshëm sipas të cilit në mënyrë që palët të lidhin një kontratë, duhet që të kenë një interes të ligjshëm për të realizuar dhe për ta lidhur atë. Pala që lidh një kontratë të sigurimit të pasurisë, duhet të ketë një interes pasuror mbi objektin e siguruar, sepse në të kundërt mungesa e interesit pasuror e bën kontratën të pavlefshme.¹⁶

Pasja e një interesi pasuror mbi objektin e siguruar do të thotë që kjo palë duhet të ketë një lidhje apo raport ligjor përkatësie me këtë objekt, domethënë, ose të jetë pronar i objektit të siguruar ose duhet të jetë uzufruktar i këtij objekti ose duhet të jetë enfiteozmarrës, ose të ushtrojë një të drejtë servituti, si dhe në përgjithësi interesi pasuror nënkupton çdo të drejtë reale ose çdo të drejtë tjetër që duhet të ketë personi mbi objektin e siguruar. Në rast se një person lidh një kontratë sigurimi për të siguruar një objekt për të cilin nuk ka asnjë interes pasuror, kjo kontratë do të shpallet e pavlefshme, pikërisht për faktin se personit i mungon interesi i ligjshëm pasuror mbi objektin e siguruar.

1.13. Rrethi i kufizuar i ngjarjeve që sigurohen me kontratën e sigurimit.

Kontrata e sigurimit nuk zbatohet për çdo ngjarje sigurimi, por vetëm për ato ngjarje të cilat palët kanë parashikuar në kontratë. Kjo karakteristikë e kontratës së sigurimit tregon se kontrata e sigurimit ka një objekt konkret specifikisht të përcaktuar dhe zbatohet vetëm për ato ngjarje të cilat ndodhin brenda objektit të saj dhe jo për ngjarje të tjera. Pra, **kontrata e sigurimit ka vlerë vetëm për një numër konkret ngjarjesh të sigurimit që palët kanë parashikuar në kontratë dhe jo edhe për ngjarje të tjera të cilat nuk janë parashikuar në kontratë.** Specifikimi në kontratë me saktësi i numrit të ngjarjeve të sigurimit, për të cilat do të zbatohet kontrata, është me rëndësi themelore, pasi numërimi i këtyre rasteve është më natyrë ezauruese ose shteruese, domethënë, kontrata zbatohet vetëm dhe vetëm për ato ngjarje të parashikuara në kontratë dhe jo edhe për ngjarje të tjera.

As i siguruari e as gjykata në rast konflikti, nuk ka të drejtë që të shtojë ndonjë ngjarje tjetër sigurimi, përveç atyre të cilat palët kanë parashikuar shprehimisht në kontratë. Për shembull, në rast se personi S.L ka siguruar banesën e tij **vetëm nga zjarri**, dhe ndodh që brenda periudhës së sigurimit, banesa e tij të shkatërrohet nga **përmytja**, në këtë rast i siguruari nuk ka të drejtë që të përfitojë shpërblimin e sigurimit, sepse shkatërrimi i banesës nuk ka ardhur nga ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë dhe as **gjykata nuk ka të drejtë që me anë të interpretimit**, duke konsideruar që përmytja ka ndodhur brenda periudhës së sigurimit, **të shtojë vetë si ngjarje të sigurimit edhe përmytjen**, në mënyrë që i siguruari të marrë shpërblimin e sigurimit.

¹⁶ Neni 1134 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit është lidhur kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme”.

Kapitulli 2. Kontrata e sigurimit të pasurisë.

2.1. Elementët e kontratës së sigurimit të pasurisë.

2.1.1. Subjektet ose palët në kontratën e sigurimit të pasurisë.

Subjektet e kontratës së sigurimit të pasurisë janë përcaktuar shprehimisht në ligj dhe janë; **siguruesi** dhe **i siguruari** dhe në raste të caktuara edhe **personi i tretë**. **I siguruari** është personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili siguron pasurinë e tij, duke paguar primin e sigurimit dhe i cili ka të drejtë që të marrë shumën e sigurimit nga siguruesi, në rast se vertetohet ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë. I siguruari duhet të ketë interes pasuror nga lidhja e kontratës së sigurimit të pasurisë.

Siguruesi është pala e cila merr përsipër që kundrejt përfitimit të primit të sigurimit të paguar nga i siguruari, që të bëjë sigurimin e pasurisë së të siguruarit, si dhe të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit ose në favor të personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, në rast se ndodh ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë. Ligji ka përcaktuar se si sigurues mund të jenë vetëm personat juridikë, qofshin këta persona juridikë publikë ose privatë. Në një ligj të veçantë konkretisht në ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 *“Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”* përcaktohen kriteret që duhet të ketë një subjekt për të dalë si sigurues në një kontratë sigurimi. Konkretisht neni 1 të këtij ligji, i titulluar **“Përkufizime”** në pikat “10” e “11” të këtij neni përcakton se me termin **“i siguruar” nënkuptohet personi, i cili ka nënshkruar një kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimi** dhe me termin **“sigurues” nënkuptohet shoqëria e sigurimit, e licencuar sipas dispozitave të këtij ligji**. Në pikën “7” të nenit 1 të po këtij ligji, përcaktohet se me **shoqëri sigurimi nënkuptohet një person juridik me seli qëndrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, i licencuar për të ushtruar veprimtari sigurimi nga Autoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve, në përputhje me këtë ligj**. Nga dispozitat e këtij ligji rezulton që siguruesi në një kontratë sigurimi nuk mund të jetë kurrë një person fizik dhe në mënyrë që një subjekt të dalë si sigurues në një kontratë sigurimi duhet të plotësojë dy kushte:

Së pari: Të jetë person juridik;

Së dyti: Të jetë themeluar në formën e një shoqërie aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe e organizuar sipas dispozitave të parashikuara në ligjin *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*.¹⁷

Në vendin tonë si sigurues deri para pak vitesh ka qenë vetëm një person juridik publik, konkretisht INSIG, ndërsa sot përveç tij ka dhe një numër të konsiderueshëm personash juridik privat, të cilat po operojnë me sukses në fushën e sigurimeve. Si persona të tillë juridik privat që dalin sot si sigurues në kontratën e sigurimit mund të përmendim; shoqërinë e sigurimeve **“SIGMA”**, shoqërinë e sigurimeve **“SIGAL”**, shoqërinë e sigurimeve **“ATLANTIK”**, shoqërinë e sigurimeve **“INTERSIG”** etj. Të gjitha këto shoqëri dhe shumë të tjera të reja që janë futur dhe po futen vazhdimisht në tregun e sigurimeve, tregojnë për rëndësinë gjithnjë e më të madhe që po merr sot kontrata e sigurimit, si një fenomen i kohëve moderne, si dhe tregojnë faktin se ne kushtet e një konkurrence të lirë dhe të vazhdueshme, pala tjetër që është i siguruari, e ka më të madhe mundësinë për të zgjedhur për lidhjen e kësaj kontrate dhe shërbimi që ofrohet në fushën e sigurimeve po bëhet gjithnjë edhe më cilësor.

¹⁷ Shih nenin 14 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 *“Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”*.

Si sigures sipas dispozitave të ligjit të mësipërm mund të jetë një person juridik shqiptar apo i huaj, i cili duhet të ketë selinë e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të plotësojë kushtet sipas legjislacionit shqiptar të cilat do të trajtohen më poshtë. Për të ushtruar veprimtarinë në fushën e sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, **personi juridik ose dega e personit juridik të huaj, duhet të licencohen nga Autoriteti i Mbikqyerjes së Sigurimeve.** (këtej e tutje Autoriteti)¹⁸ E drejta e shoqërisë për fillimin e veprimtarisë së sigurimit dhe/ose risigurimit lind vetëm pasi shoqëria dhe/ose dega e shoqërisë së huaj të sigurimit, janë pajisur me licencë nga Autoriteti. Shoqëria licencohet si:

- 1) shoqëri sigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
- 2) shoqëri risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
- 3) shoqëri sigurimi dhe risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj sigurimi dhe risigurimi.

Licencimi i shoqërisë së sigurimeve kalon në dy faza:

a) faza e miratimit paraprak;

b) faza e dhënies së licencës.¹⁹

Kushtet që duhet të plotësojë shoqëria **për miratimin paraprak të licencës** janë të ndryshme në varësi të faktit nëse shoqëria është person juridik shqiptar apo degë e një personi juridik të huaj. Në rastet kur shoqëria është person juridik shqiptar, në mënyrë që ajo të marrë miratimin paraprak për licencë, duhet që t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Autoritetit për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e sigurimeve.²⁰ Kjo kërkesë me shkrim duhet që të shoqërohet me këto akte dhe dokumente:

- a) aktin e themelimit të personit juridik;
- b) projektstatutin e shoqërisë së sigurimit;
- c) emrin e propozuar të shoqërisë së sigurimit dhe selinë qendrore të saj;
- ç) listën e aksionarëve;
- d) të dhëna për llojin e aksioneve;
- dh) të dhëna për vlerën nominale të aksioneve;
- e) përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar;
- ë) vertetimin nga autoritet përkatës për shlyerjen e detyrimeve të tatim-taksave nga aksionarët;
- f) programin e veprimtarisë;
- g) listën e anëtarëve të propozuar për organet drejtuese të shoqërisë së sigurimeve së bashku me informacionin përkatës për to;
- gj) strukturën organizative në qendër dhe në degë, së bashku me listën e personave të propozuar për drejtuesit kryesor në qendër;
- h) vertetimin e depozitimit të gjysmës së kapitalit themeltar;
- i) projekt kontratat për dhënie në sipërmarrje të funksionëve të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë të tretëve, në rast se shoqëria ka planifikuar sipërmarrje të tilla;
- j) emrat e bankave me të cilat do të operojë.

Një nga aktet më të rëndësishme të cilat duhet të shoqërojnë kërkesën me shkrim të shoqërisë për pajisjen me licencë, është **programi i veprimtarisë së shoqërisë**. Ky program i veprimtarisë duhet që të hartohet për tre vitet e para dhe duhet detyrimisht të përmbajë:

- a) klasat e sigurimeve për të cilat shoqëria kërkon të licencohet;

¹⁸ Shih paragrafin e parë të nenit 20 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

¹⁹ Shih nenin 22 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Per veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime".

²⁰ Shih nenin 23 të ligjit të mësipërm.

- b) parashikimet për kalimet në risigurime, duke përfshirë tabelat e mbulimeve maksimale për të gjitha klasat e sigurimeve;
- c) llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese;
- ç) parashikimi i detajuar i shpenzimeve të nisjes;
- d) kushtet e përgjithshme të kontratave të sigurimit për klasat që kërkon të liçenohet;
- dh) tarifat dhe primet që parashikon të zbatojë përklasat që kërkon të licenohet dhe mënyrat e llogaritjes së tyre;
- e) planin e biznesit.

Nga ana e tij **plani i biznesit** hartohet për tre vitet e para dhe duhet të përmbajë:

- a) formën e shkurtuar të bilancit dhe pasqyrat financiare;
- b) parashikimet për primet dhe dëmshpërblimet;
- c) pasqyrën e rrjedhjes së parasë;
- ç) burimet financiare për të përmbushur detyrimet që do të marrë përsipër shoqëria dhe për të mbajtur nivelin e kërkuar të aftësisë paguese;
- d) fitimin e parashikuar;
- dh) llogaritjen e provigjioneve teknike²¹ dhe metodat e përdorura për llogaritjen e tyre.

Shoqëria e cila kërkon që të ushtrojë veprimtari në sigurimin e jetës dhe në fusha aksesore që lidhen me sigurimin e jetës, duhet që planin e veprimtarisë si dhe planin e biznesit ta hartojë për shtatë vitet e para.²² **Kushtet për të marrë miratimin paraprak për liçencë janë të ndryshme për një shoqëri të huaj**, e cila kërkon që të ushtrojë veprimtari në fushën e sigurimeve në Shqipëri. Në qoftë se një shoqëri e huaj don që të ushtrojë në Shqipëri veprimtari në fushën e sigurimeve, ajo duhet të paraqesë në Autoritet një kërkesë me shkrim në gjuhën shqipe për liçencimin e degës së saj. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këto akte dhe dokumente:

- a) vendimin e organit më të lartë drejtues të shoqërisë së huaj të sigurimit për hapjen e degës në Republikën e Shqipërisë;
- b) vërtetimin se shoqëria ka ushtruar veprimtari sigurimi të paktën 5 vjet në shtetin e origjinës;
- c) vendimin e emërimit të administratorit të degës, kompetencat e tij për përfaqësimin në mardhënie me organet shtetërore dhe gjykatat shqiptare;
- ç) aktin e themelimit të shoqërisë dhe statutin e saj;
- d) liçencën për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit, dhënë nga autoriteti përkatës në vendin ku ndodhet selia e shoqërisë;
- dh) miratimin zyrtar për hapjen e degës së shoqërisë së huaj, dhënë nga autoriteti mbikqyrës i vendit ku ndodhet selia e saj;
- e) programin e veprimtarisë së degës, të hartuar sipas kërkesave të ligjit shqiptar;
- ë) raportet financiare të shoqërisë për tre vitet e fundit të revizionuara, sipas kriterëve të autoritetit mbikqyrës ku ndodhet selia e saj;
- f) vërtetimin se ka vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë aktive në vlerë të barabartë me ½ e fondit minimal të garancisë, depozitimin e ¼ së këtij fondi në mjete monetare, në një bankë që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, të kthyeshme në rast moslicencimi;
- g) deklaratën në lidhje me mardhëniet financiare midis degës dhe shoqërisë së huaj;
- gj) deklaratën për mbajtjen e të gjithë dokumentacionit të brendshëm dhe korespondencës midis degës dhe shoqërisë mëmë, në gjuhën shqipe.

²¹ Me provigjon teknik kuptojmë një shumë të llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave matematikore dhe statistikore të caktuara, e cila i shërben siguruesit për të mbuluar përgjegjësitë që lindin nga kontratat e sigurimit.

²² Shih nenin 24 të ligjit të mësipërm.

Organi i cili vendos për miratimin paraprak të licencës, qoftë për shoqërinë shqiptare, qoftë për degën e shoqërisë së huaj që kërkon të ushtrojë aktivitet në fushën e sigurimeve në Shqipëri, si dhe për dhënien përfundimtare të saj, është **Autoriteti i Mbykqyerjes së Sigurimeve**. Mënyra e organizimit dhe kompetencat e këtij organi janë përcaktuar në një ligj të veçantë, i cili është ligji nr. 9268, datë 29.07.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbykqyrës të Sigurimeve”. Në këtë ligj përcaktohet se Autoriteti ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) liçencon veprimtarinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin drejtëpërdrejt nga këto veprimtari;

b) mbikqyr veprimtarinë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin drejtëpërdrejtë nga kjo veprimtari;

c) bën analiza financiare të veprimtarisë së sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit;

ç) ndërmerr masa korigjuese të përshtatshme dhe në kohën e duhur në rast se një shoqëri sigurimi ose risigurimi, nuk arrin nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, ose konstaton raste të paaftësisë paguese, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi, për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

d) ndërmerr të gjitha hapat ligjorë për ndalimin e veprimtarisë së paligjshme e të pandershme në tregun e sigurimeve dhe njofton publikun për mbrojtjen e interesave të të siguruarve;

e) përgatit studime, analiza, publikime për zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe mbajtjen e tij të qëndrueshëm, efikas, transparent dhe të ndershëm;

f) merr pjesë si anëtar në Shoqatën Ndërkombëtare të Autoritetëve Mbikqyrës të Sigurimit;

g) ushtron edhe kompetenca të tjera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe të legjislacionit në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.²³

Organet drejtuese të Autoritetit janë dy:

Këshilli i Autoritetit dhe Drejtori Ekzekutiv. Këshilli i Autoritetit është organ kolegjal dhe përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët nuk janë të punësuar në Autoritet. Anëtarët e Këshillit dhe Kryetari i tij, emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave, për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë riemërimi. Vetëm për mandatin e parë, katër anëtarë emërohen me mandat katërvjeçar dhe tre anëtarët e tjerë emërohen me mandat dy vjeçar.²⁴

Këshilli i Autoritetit është organi kryesor vendimmarrës i Autoritetit dhe ushtron këto kompetenca:

a) vendos për dhënien ose refuzimin e liçencës;

b) vendos për tërheqjen e pjesësshme ose tërësore të liçencës;

c) vendos për transferimin e portofolit, administrimin e përkohshëm, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë së sigurimit;

ç) vendos sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

d) vendos për masat e mbikqyerjes në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;

e) vendos për kufizimin ose ndalimin e investimeve të shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit, kur vertetohet se këto investime nuk janë në përputhje me raportet rregullatore të vendosura dhe kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë;

²³ Shih nenin 6 të ligjit nr. 9268, datë 29.07..2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

²⁴ Shin nenin 9 të ligjit nr. 9268, datë 29.07.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”.

ë) vendos brenda një muaji për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit, për çdo kontratë, që shoqëria e sigurimit kërkon që të hedhë në treg;

f) vendos për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimit dhe të risigurimit;

g) vendos për propozimin që i bëhet Minsitrit të Financave për ndryshimin e tarifave të primit të sigurimit të detyrueshëm, kur niveli i tyre është i pamjaftueshëm për mbulimin e rrezikut për shoqërinë e sigurimit;

gj) vendos për miratimin dhe shpërndarjen e standarteve kontabël, si dhe format e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit;

h) vendos për miratimin e bilancit vjetor, të projektbuxhetit dhe të organogramës së Autoritetit;

i) vendos për miratimin e rregulloreve dhe udhëzimeve, kur legjislacioni në fuqi përcakton se ato dalin nga Autoriteti;

j) vendos për delegimin, në raste të veçanta, të kompetencave të veta Drejtorit Ekzekutiv, me përjashtim të kompetencave për dhënien dhe heqjen e liçencës së shoqërisë së sigurimit, të shoqërisë së risigurimit dhe shoqërisë së brokerimit²⁵, si dhe shpalljen e procedurave të falimentimit dhe likuidimit.²⁶

Këshilli i Autoritetit vendos për miratimin paraprak të liçencës së shoqërisë së sigurimit në rast se shoqëria ka plotësuar njëkohësisht këto kushte:

a) është organizuar dhe funksionon si shoqëri aksionare me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të ligjit *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*.

b) objekti i veprimtarisë së saj kufizohet vetëm në veprimtari sigurimi, risigurimi dhe operacione që rrjedhin drejtëpërdrejt nga këto veprimtari, duke përjashtuar çdo veprimtari tjetër tregtare;

c) zotëron fondin e garancisë;

d) aksionarët të cilët mund të jenë persona fizikë ose juridikë plotësojnë kërkesat e kërkuar nga ligji dhe Autoriteti, sidomos nuk janë subjekte të procedurave të falimentimit dhe/ose likuidimit dhe nuk e kanë të ndaluar me ligj që të jenë themelues të një shoqërie tregtare;

ç) anëtarët e Drejtorisë përmbushin kriteret profesionale dhe ligjore për të qenë të tillë, si dhe nuk kanë asnjë rast papajtueshmërie apo pazgjedhshmërie në emërimin e tyre të parashikuara nga ligji;

d) programi i veprimtarisë së shoqërisë është hartuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga ky ligj;

e) llogaritjet e primeve dhe të provigjioneve teknike ose matematike janë të mjaftueshme.²⁷

Në rast se shoqëria nuk përmbush qoftë edhe një nga kushtet e mësipërme, Këshilli i Autoritetit vendos refuzimin e dhënies paraprake të liçencës. **Këshilli i Autoritetit është i detyruar që të shpjegojë me shkrim arsyet në bazë të të cilave informacioni i paraqitur nga shoqëria vlerësohet i pamjaftueshëm dhe përbën shkak për refuzimin e miratimit paraprak të liçencës.** Ky vendim i Këshilit të Autoritetit duhet t'i njoftohet personit që ka paraqitur kërkesën brenda 10 ditëve nga marrja e këtij vendimi. **Kundër këtij vendimi për refuzimin e miratimit paraprak të liçencës, i interesuari mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin e Procedurës Civile.**

²⁵ Me shoqëri brokerimi kuptojmë një person juridik, të licensuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Sigurimeve dhe i autorizuar nga i siguruari për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime dhe risigurime në emër të tij.

²⁶ Shih nenin 14 të ligjit nr. 9268, datë 29.07.2004 *“Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve”*.

²⁷ Shih nenin 26 të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 *“Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”*.

Në rastet kur shoqëria i plotëson kushtet e mësipërme dhe kur Këshilli i Autoritetit merr vendim për miratimin paraprak të licencës, shoqëria regjistrohet në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri sigurimi. Por, nuk është ky momenti kur ajo fiton personalitet në fushën e sigurimeve dhe/ose risigurimeve, **pasi ajo ka përmbushur vetëm fazën e parë të liçencimit, atë të miratimit paraprak.**

Në mënyrë që shoqëria e regjistruar, tashmë në regjistrin tregtar si shoqëri sigurimi, të fitojë personalitet juridik, **duhet që të kalojë fazën e dytë që është marrja e licencës nga Këshilli i Autoritetit.** Për marrjen e licencës për të ushtruar aktivitetet në fushën e sigurimeve, subjekti pas miratimit paraprak që i është bërë nga Autoriteti i Mbikqyerjes së Sigurimeve dhe pas regjistrimit të tij në regjistrin tregtar, duhet që të dorëzojë në Këshillin e Autoritetit këto akte dhe dokumente:

a) vendimin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si shoqëri sigurimi, së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë së sigurimit, të depozituara në regjistrin tregtar;

b) vërtetimin e depozitimit të gjysmës tjetër të kapitalit themeltar dhe të fondit të shpenzimeve të nisjes;

c) vërtetimin e pronësisë ose të kontratës së qirasë për mjediset ku do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit;

ç) aktin e emërimit të anëtarëve të drejtorisë dhe të këshillit mbikqyrës, së bashku me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre, si dhe vërtetimet e nënshkrimit;

d) aktin e emërimit të ekspertit kontabël të miratuar;

dh) specimentet e kontratave të sigurimit, sipas klasve të kërkuara prej saj.²⁸

Këshilli i Autoritetit është i detyruar që të shqyrtojë kërkesën për licencim brenda dy muajve nga data e depozitimit të dokumenteve nga shoqëria e sigurimeve. Këshilli ka të drejtë që të shtyjë afatin e shqyrtimit të kërkesës vetëm një herë, deri në tre muaj, për rastet kur objektivisht vërtetohet se atij i duhet kjo kohë për shqyrtimin e kërkesës. **Me plotësimin e kushteve të përmendura më lart, Këshilli i Autoritetit jep vendim për dhënien e licencës.** Në rast se ky Këshill vendos refuzimin e kërkesës për dhënien e licencës, kërkuuesi ka të drejtë që të ankohet në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi i Procedurës Civile.

Në qoftë se Këshilli i Autoritetit vendos për dhënien e licencës personit kërkuar, ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare. Autoriteti është i detyruar që të dërgojë për botim vendimin për dhënien e licencës brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit. **Vendimi për dhënien e licencës hyn në fuqi menjëherë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.** Shoqëria e sigurimit fillon punë brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës dhe është e detyruar që të njoftojë me shkrim Autoritetin për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.²⁹

Me botimin e vendimit të Këshillit të Autoritetit për dhënien e licencës në Fletoren Zyrtare, shoqëria e sigurimeve fiton personalitet të plotë juridik dhe ka zotësi të plotë për të vepruar në fushën e sigurimeve. Gjatë gjithë kohës së veprimtarisë së saj shoqëria duhet ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me licencën e dhënë, si dhe të njoftojë Autoritetin për çdo ndryshim të mundshëm të aktivitetit të saj, për të cilin sipas ligjit të mësipërm, është e detyruar që ta kryejë. Në rastet kur shoqëria e sigurimeve nuk e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me licencën e dhënë dhe me detyrimet ligjore të përcaktuara nga ligji i mësipërm, **Këshilli i Autoritetit ka të drejtë që t'i heqë asaj licencën dhe ta vendosë atë në proces falimentimin ose likuidimi.** Me heqjen e licencës,

²⁸ Shih nenin 29 të ligjit të mësipërm.

²⁹ Shih nenin 32 të ligjit të mësipërm.

shoqëria e sigurimeve e humbet personalitetin e saj juridik dhe është e detyruar që të mos kryejë më veprimtari në fushën e sigurimeve dhe/ose risigurimeve.

Në ligjin e mësipërm është përcaktuar se licenca për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit tërhiqet, pra, shfuqizohet nga Autoriteti në rastet e mëposhtme:

a) kur shoqëria e sigurimit nuk fillon veprimtarinë brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e hyrjes në fuqi të licencës;

b) kur shoqëria e sigurimit i nënshtrohet procedurave të falimentimit;

c) kur shoqëria e sigurimit pezullon veprimtarinë për një periudhë më të gjatë se 6 muaj;

c) kur shoqëria e sigurimit i nënshtrohet procedurave të likuidimit;

ç) kur transferohen tërësisht kontratat e sigurimit, në një shoqëri tjetër sigurimi;

d) kur shoqëria e sigurimit heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë;

dh) kur vertetohet se dokumentet e depozituara për dhënien e licencës janë të fallsifikuara ose të rreme.³⁰

Në fillim të kësaj çështje përmendëm se si palë në kontratën e sigurimit të jetës, shëndetit dhe pasurisë mund të jetë edhe **personi i tretë**, kur një gjë të tillë e kanë parashikuar shprehimisht palët në kontratë. Në mënyrë që personi i tretë të jetë palë në këtë kontratë, ai duhet që të plotësojë të gjitha kushtet për të qenë palë në këtë kontratë, ashtu si edhe i siguruari. Personi i tretë del si palë në këtë kontratë me cilësinë e përfituesit ose të beneficiarit, duke përfutuar vetëm të drejta dhe duke mos marrë përsipër detyrime nga kontrata. Ky person i tretë megjithëse, nuk është palë në lidhjen e kontratës, **fiton cilësinë e palës, e cila ka vetëm të drejta**, të drejta të cilat ekzekutohen me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, duke fituar të drejtën që të marrë nga siguresi shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë.

2.1.2. Objekti i kontratës së sigurimit të pasurisë.

Objekti i kontratës së sigurimit përbëhet nga tërësia e veprimeve që kanë të bëjnë me pagimin e primit të sigurimit ose të primeve të sigurimit nga pala e siguar, si dhe të shpërblimit të sigurimit apo të shumës së sigurimit nga ana e palës siguroese, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit. Si objekt të kësaj kontrate janë edhe vetë shumat në të holla që përbëjnë primin e sigurimit ose primet e sigurimit, të cilat paguhet nga i siguruari në momentin e lidhjes së kontratës dhe ose gjatë vazhdimit të kontratës, **si dhe shpërblimi i sigurimit**, i cili paguhet nga siguresi me vertetimin e ngjarjes së sigurimit të parashikuar në kontratë.

Rastet për të cilat mund të lidhet kontrata e sigurimit të pasurisë janë të ndryshme në varësi nga lloji konkret i pasurisë e cila do të sigurohet. Në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, pasuria mund të sigurohet nga këto rreziqe:

a) Ndërtesat, makineritë, automjetet, mallrat, prodhimet bujqësore, sendet shtëpiake mund të sigurohen: nga zjarri, nga rrufeja, nga shpërthimet, nga tërmetet, nga përmbytjet, nga breshëri, nga shiu, nga shtërngatat, nga tufani, dëbora, orteqet, nga shkarjet e dheut, nga vjedhjet, nga prishjet e urdhëruara prejorganet e pushtetit vendor, në mënyrë që të ndalohet përhapja e zjarrit, **atomjetet sigurohen përveç rastëve të mësipërme edhe nga përplasjet dhe rrëzimet;**

b) Kulturat bujqësore dhe/ose produktet blegtorale sigurohen: nga breshëri, nga shtërngata dhe nga përmbytja, si dhe nga nrgicat **për periudhën nga 01 prilli deri më 30 shtator.** Ky sigurim përfshin në këtë rast vetëm dëmtimet mekanike që u janë shkatuar prodhimeve bujqësore dhe blegtorale prej rreziqëve të mësipërme;

³⁰ Shih nenin 34 të ligjit të mësipërm.

c) Kafshët e punës dhe të prodhimit sigurohen: nga ngordhjet e shkatuara nga sëmundjet dhe aksidentet, si dhe në rastet kur ato thehen detyrimisht me urdhër të organëve kompetente për shkak se nga sëmundja kjo therje është e pashmangshme ose për të penguar përhapjen e një sëmundje të tillë. Raste të therjes së detyruar për shkak të sëmundjes ndodhën në vendin tonë në vitet 2005-2006, ku si pasojë e sëmundjes H.5.N.1, i quajtur në gjuhën e përditshme si “gripi i shpendëve”, u therën me qidra e mijra shpendë, sidomos në zonat kufitare të Shqipërisë, pikërisht për të parandaluar përhapjen e kësaj sëmundje, e cila parqiste rrezikshmëri të lartë edhe për njerëzit.

Ligji ka përcaktuar edhe grupimet kryesore të sigurimeve të cilat për sigurimin e pasurisë mund të përmbliidhen në gjashtë grupe:

Së pari: Sigurimet motorrike. Në këtë grup përfshihen; *mjetet tokësore duke përjashtuar ato që lëvizin mbi shina, mallrat në transport dhe përgjegjësitë nga përdorimi i atomjetëve;*

Së dyti: Sigurimi i marinës dhe i transportit. Në këtë grup përfshihen: *mjetet lëvizëse mbi shina, anijet detare, lumore dhe të liqenëve, mallrat në transport të cilat transportohen me këto mjete si dhe përgjegjësitë civile për anijet;*

Së treti: Sigurimi i avionëve. Në këtë grup përfshihen: *aksidentet e ndodhura gjatë transportit ajror, mallrat që transportohen me anë të këtij transporti, sigurimi i vetë avionit si objekt, si dhe përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve;*

Së katërti: Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë. Në këtë grup përfshihen: *çdo dëmtim nga zjarri të mjeteve motorrike, çdo dëmtim nga zjarri që ndodh në transport, çdo dëmtim nga zjarri që ndodh në mjete tokësore, avionë, anije, çdo dëmtim i shkaktuar nga shpërthimet, nga stuhitë dhe forcat e tjera të natyrës, çdo dëmtim i shkaktuar nga energjia nukleare, nga shkarja e tokës, si dhe dëmtimet e pasurisë nga breshëri, ngrica dhe vjedhja;*

Së pesti: Sigurimi i përgjegjësive. Në këtë grup përfshihen: *sigurimi i përgjegjësive civile nga mjetet motorrike, nga anijet, avionët si dhe sigurimi i përgjegjësive civile të përgjithshme;*

Së gjashti: Sigurimi i kreditit dhe i garancisë. Në këtë grup përfshihen: *sigurimi i paaftësisë paguese të përgjithshme, sigurimi i garancive, humbjet financiare nga qiratë, nga ulja e vlerës së tregut, nga moti i keq etj, sigurimi i fondeve të investimëve.*

2.1.3. Përmbajtja e kontratës së sigurimit të pasurisë. Të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë.

Si për çdo kontratë tjetër edhe për kontratën e sigurimit të pasurisë, përmbajtja e saj përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve, domethënë, nga të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit dhe të siguresit, si dhe nga të drejtat e personit të tretë, në rastet kur ai është palë në kontratë. Duke qenë se personi i tretë ka vetëm të drejta të cilat janë pothuajse të njëta me ato të të siguruarit, si dhe duke qenë se ai nuk është kurdoherë palë në kontratën e sigurimit të pasurisë, madje në praktikën tonë gjyqsore, ai rrallë paraqitet si palë në këtë kontratë, unë do të ndalem në trajtimin me hollësi vetëm të të drejtave dhe detyrimeve të të siguresit dhe të siguresit. Trajtimin e përmbajtjes së kontratës së sigurimit të pasurisë do ta nis me të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit.

Të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë mund të përmbliidhen:

a) Detyrimi i të siguruarit që në momentin e lidhjes së kontratës, t'i njoftojë siguresit çdo rrethanë për të cilat ai ka dijeni dhe që ka rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut.

Ky detyrim është një nga detyrimet kryesore të të siguruarit, i cili është i parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj sipas të cilit i siguruari në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit duhet që t'i njoftojë siguresit të gjitha faktet dhe rrethanat për të cilat ai ishte në dijeni në momentin e

lidhjes së kontratës, fakte dhe rrethana të cilat kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës së rrezikut dhe madhësisë së rrezikut.³¹ Se cilat do të konsiderohen si rrethana të cilat kanë një rëndësi thelbësore në përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, përcaktohet rast pas rasti në varësi të llojit të kontratës së sigurimit dhe të llojit konkret të objektit që sigurohet. Por, në përgjithësi duhet të pranojmë si rrethana të cilat konsiderohen thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, çdo rrethanë e cila mund të luajë një rol të madh në shtimin e masës së rrezikut, në shpejtimin e ardhjes së rrezikut, në rritjen e mundësisë së ardhjes së rrezikut, si dhe në rritjen e sasisë së dëmëve që mund të shkatohet nga ndodhja e rrezikut ose e ngjarjes së sigurimit.

Në ligj është përcaktuar se **do të konsiderohen si rrethana të cilat kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e masës dhe natyrës së rrezikut, të gjitha rrethanat për të cilat siguruari ka pyetur me shkrim të siguruarin.** Nga kjo rezulton se ligji i ka lënë detyrimin siguruarit për të përcaktuar se cilat janë rrethanat që ai i çmon thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, si dhe detyrimin që për këto rrethana, siguruari duhet që të pyesë me shkrim të siguruarin.

Lind pyetja: Çfarë ndodh në rastet kur i siguruari nuk i përgjigjet të gjitha pyetjeve me shkrim të bëra nga siguruari në lidhje me rrethanat thelbësore të cilat përcaktojnë natyrën dhe masën e rrezikut, kontrata e sigurimit të pasurisë në këto raste do të jetë apo jo e vlefshme? Kësaj pyetje i jep përgjigje në mënyrë të shprehur paragrafi i tretë i neni 1117 i Kodit Civil, sipas të cilit në rast se kontrata e sigurimit lidhet pa marrë përgjigje për ndonjë nga pyetjet që kanë të bëjnë me sqarimin e rrethanave thelbësore, kjo kontratë nuk mund të jetë e pavlefshme vetëm për këtë shkak. Kjo do të thotë që në rast se i siguruari nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të bëra nga siguruari, në lidhje me rrethanat thelbësore të cilat kanë rëndësi për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, kontrata e sigurimit e lidhur në mungesë të këtyre përgjigjeve të të siguruarit, është e vlefshme dhe do të sjellë pasojat juridike që dëshirojnë palët.

I siguruari ka detyrimin ligjor që në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit t'i njoftojë me saktësi dhe vertetësi siguruarit të gjitha rrethanat për të cilat ai ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut. Në rast se pas lidhjes së kontratës së sigurimit rezulton se i siguruari me dijeni dhe me qëllim ka dhënë informata jo të sakta për rrethanat thelbësore dhe në bazë të këtyre informatave jo të sakta, siguruari ka lidhur kontratën e sigurimit të pasurisë, siguruari ka të drejtë:

Së pari: Të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të ndryshojë masën e shumës së sigurimit ose të ndryshojë afatin e sigurimit. Ndryshimi i masës së primit të sigurimit, në këtë rast i referohet të drejtës që ka siguruari që të kërkojë rritjen e primit të sigurimit nga i siguruari dhe kjo rritje kërkohet për shkak të zbulimit të rrethanave të cilat ndikojnë në natyrën dhe masën e rrezikut dhe të cilat me dashje nuk ishin treguar nga i siguruari. Ndryshimi i masës së shumës së sigurimit, i referohet të drejtës që ka siguruari për të kërkuar zvogëlimin e shumës së sigurimit që ai do të paguajë në favor të të siguruarit, për shkak të zbulimit të rrethanave që ndikojnë në natyrën dhe masën e rrezikut të sigurimit, të cilat ishin fshehur me dashje nga ana e të siguruarit. Ndryshimi i afatit të sigurimit i referohet të drejtës së siguruarit për të kërkuar zvogëlimin e afatit të sigurimit të pasurisë, për shkak të zbulimit të rrethanave të fshehura me dashje nga ana e të siguruarit dhe që ndikojnë në përcaktimin e natyrës dhe masës së sigurimit.

Së dyti: Të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se zbulohen rrethana të tilla, të cilat po t'i dinte siguruari nuk do të kishte lidhur kontratën e sigurimit. Kjo e drejtë e siguruarit nuk

³¹ Paragrafi i parë i neni 1117 të Kodit Civil në fuqi përcakton: *"I siguruari duhet t'i njoftojë siguruarit me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ai ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut"*.

zbatohet në çdo rast, por vetëm në ato raste kur **i siguruari me dashje i ka fshehur siguruesit rrethana aq të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me natyrën dhe masën e rrezikut, sa po t'i kishte ditur siguruesi nuk do ta kishte lidhur fare kontratën e sigurimit.** Në këtë rast primet e sigurimit që janë paguar deri në kohën kur kërkohet zgjidhja e kontratës, si dhe primi i sigurimit i cili duhet të paguhet për vitin e parë të kontratës, nuk i kthehen të siguruarit.

Siguruesi ka të drejtë që të realizojë dy mundësitë e mësipërme **brenda tre muajve** nga dita që merr dijëni për ekzistencën e rrethanave të cilat me dashje i janë fshehur nga ana e të siguruarit. Ky afat është është caktuar në mënyrë që siguruesi të realizojë të drejtat e tij brenda një afati të arsyeshëm, si dhe në mënyrë që të mbrohen edhe interesat e ligjshme të të siguruarit. Në rast se siguruesi nuk i realizon këto dy mundësi apo të drejta brenda këtij afati, atëherë do të thotë se ai edhe pse është vënë në dijëni të rrethanave të fshehura nga i siguruari, këto rrethana të fshehura nuk kanë ndikuar në lidhjen e kontratës së sigurimit, apo nuk kanë ndikuar në përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut.

Në rast se i siguruari me dashje ka fshehur rrethana të cilat janë thelbësore në përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, dhe në rast se ngjarja e sigurimit ndodh në kohën kur nuk janë zbuluar këto rrethana ose ndodh pa kaluar tre muaj nga zbulimi i tyre, **siguruesi nuk është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit shumën e sigurimit.** Kjo do të thotë se, në rast se siguruesi lidh një kontratë sigurimi pasurie më të siguruarin dhe i siguruari me dashje nuk i njofton të siguruarit rrethana të rëndësishme të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, në rast se ngjarja e sigurimit ndodh para se të zbulohen këto rrethana ose pa kaluar afati tre muaj nga zbulimi i tyre, siguruesi ka të drejtë që të mos i paguajë shpërblimin e sigurimit të siguruarit.

Lind pyetja: Çfarë ndodh në rastet kur kontrata e sigurimit të pasurisë është lidhur për disa objekte konkrete dhe për një ose disa objekte janë dhënë informata të sakta për natyrën dhe masën e rrezikut, ndërsa për një ose disa objekte konkrete, i siguruari me dashje, nuk ka dhënë informata të cilat kanë rëndësi thelbësore për natyrën dhe masën e rrezikut, a do të jetë e vlefshme kontrata e sigurimit apo jo? Në një rast të tillë për objektet për të cilat nga ana e të siguruarit janë dhënë me vertetësi të gjitha informatat që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së sigurimit, kontrata do të konsiderohet e vlefshme, ndërsa për objektet për të cilat i siguruari nuk ka dhënë të dhëna e duhura ose ka dhënë me dije të dhëna të rreme, siguruesi ka të drejtë që të kërkojë ose zgjidhjen e kontratës, ose ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose të afatit të sigurimit të kontratës. Kjo zgjidhje është parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj sipas të cilit në qoftë se kontrata e sigurimit është lidhur për më shumë se një person ose objekte, ajo mbetet e vlefshme vetëm për ato persona ose objekte, të cilët nuk u referohen deklaratimet të pasakta të bëra me dashje nga i siguruari ose mosdhënien me dashje të të dhënave që këna rëndësi thelbësore për lidhjen e kontratës.³²

Siguruesi ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kontratës së sigurimit, ose të kërkojë ndryshimin e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit apo të afatit të kontratës, vetëm **në rastet kur i siguruari me dashje, domethënë, me qëllim ka dhënë informata të rreme apo ka heshtur me dashje për ekzistencën e rrethanave të cilat kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut.** Në rast se i siguruari jep të dhëna të pasakta ose hesht për rrethana të cilat kanë shërbyer si bazë për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe **vertetohet se ai nuk e ka bërë një gjë të**

³² Paragrafi i fundit i nenit 1118 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur kontrata e sigurimit është lidhur për më shumë se një person ose sende, ajo mbetet e vlefshme për ato persona ose sende, të cilëve nuk u referohen deklaratimet e pasakta apo heshtja”

tillë me dashje ose pakujdesi të rëndë, siguruesi nuk ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës së sigurimit, por, ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar të siguruarin me shkrim, brenda tre muajve nga marrja dijëni për ekzistencën e këtyre rrethanave.

Në rast se ngjarja e sigurimit vertetohet përpara se pasaktësitë e informatave ose lënia në harresë e tyre, të vertetohen nga siguruesi, ose përpara se të jetë deklaruar heqja dorë nga kontrata, shuma e sigurimit ulet në përpjestim me diferencën midis shumës së caktuar në kontratë dhe shumës së sigurimit që do ishte zbatuar nëse do të njihej gjendja e vërtetë e fakteve. Kështu për shembull, në rast se siguruesi K lidh një kontratë sigurimi pasurie me të siguruarin B.G duke përcaktuar si shumë sigurimi vlerën 5000.000 lekë dhe vertetohet se i siguruari ka heshtur ose nuk ka dhënë informata që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut jo me dashje ose pakujdesi të rëndë, në rast vertetohet ngjarja e sigurimit para se të zbulohen këto rrethana, shuma e sigurimit ulet në përpjestim me diferencën midis shumës së sigurimit të caktuar në kontratë dhe shumës së sigurimit që do ishte përcaktuar në kontratë nëse do të dihehin këto rrethana. Kjo do të thotë se nëse shuma e sigurimit që do të caktohej në kontratë në rast se do të dihehin rrethanat e fshehura ose të padeklaruara pa dashjen ose pakujdesinë e rëndë të të siguruarit, do të ishte 3000.000 lekë, atëherë shuma e sigurimit që do të paguajë siguruesi do të ulet me diferencën e shumës së sigurimit që është parashikuar në kontratë që në rastin konkret është 5000.000 lekë, me shumën e sigurimit që do të ishte caktuar po të ishin ditur këto rrethana që në rastin konkret do të ishte 3000.000 lekë, domethënë, shuma e sigurimit do të ulet me 5000.000 minus 2000.000 lekë, e barabartë me 3000.000 lekë.

Në këtë rast do të **duhet të bëjmë dallimin midis rastit kur i siguruari me dashje hesht ose nuk i njofton rrethanat të cilat kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, me rastin kur i siguruari nuk i njofton këto rrethana pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë,** sepse të drejtat që kanë palët janë krejt të ndryshme. Në rastin e parë siguruesi ka të drejtë që të zgjedhë dy nga alternativat e përmendura më lart ose të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit apo afatin e sigurimit, ose të kërkojë zgjidhjen e kontratës. Në rastin e dytë siguruesi nuk ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kontratës, por ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, brenda tre muajve, nga marrja dijëni e rrethanave duke njoftuar të siguruarin me shkrim për këtë heqje dorë.

Po ashtu, dallimi midis rastit kur i siguruari me dashje ose pakujdesi të rëndë nuk i njofton rrethanat që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut dhe rastit kur i siguruari pa dashje ose me pakujdesi të lehtë nuk ia njofton këto rrethana siguruesit qëndron edhe tek pasojat që sjell ky mosnjoftim. Në rastin e parë, në rast se ndodh ngjarja e sigurimit, siguruesi **nuk është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit,** ndërsa në rastin e dytë **shuma e sigurimit ulet në proporcion me diferencën midis shumës së caktuar në kontratë dhe shumës që do ishte caktuar në qoftë se do të ishte njohur gjendja e vërtetë e fakteve.**

b) Detyrimi i të siguruarit që gjatë vazhdimit të kontratës t'i njoftojë siguruesit ndryshimin e të gjitha rrethanave për të cilat ka marrë dijëni që mund të ndikojnë në shtimin e rrezikut të sigurimit.

Ky është një tjetër detyrim kryesor i të siguruarit, i cili është i lidhur me kohën kur kontrata e sigurimit është lidhur midis palëve dhe po vazhdon që të zbatohet sipas kushteve të përcaktuara prej tyre. Edhe detyrimi i mësipërm është i parashikuar në ligj i cili shprehet se i siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, është i detyruar që t'i njoftojë të siguruarit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijëni pas lidhjes së kontratës, dhe të cilat janë të atilla që mund të

ndikojnë në shtimin e rrezikut të ndodhjes së rastit të sigurimit ose të ngjarjes së sigurimit.³³ Në këtë rast bëhte fjalë si për rrethana të cilat mund të kenë ekzistuar para lidhjes së kontratës së sigurimit, por, për të cilat i siguruari ka marrë dijëni pasi është lidhur kontrata, ashtu edhe për rrethanat të cilat kanë lindur pas lidhjes së kontratës së sigurimit, rrethana, të cilat kanë sjellë ndryshime që mund të influencojnë në shtimin e rrezikut të ndodhjes së rastit të sigurimit. Në mënyrë që siguruari të përmbushë këtë detyrim ndaj të siguarit duhet të plotësohen dy kushte:

Së pari: Rrethanat të kenë ekzistuar që para lidhjes së kontratës së sigurimit, por i siguruari të ketë marrë dijëni pas lidhjes së kontratës, ose rrethanat të kenë lindur pas lidhjes së kontratës së sigurimit, të cilat kanë sjellë një situatë të ndryshme nga situata që ekzistonte në momentin e lidhjes së kontratës;

Së dyti: Duhet që këto rrethana të ndikojnë drejtëpërdrejtë në shtimin e rrezikut të ndodhjes së rastit të sigurimit.

Në rast se pas lidhjes së kontratës së sigurimit, kemi ndryshim të rrethanave të cilat nuk kanë lidhje me shtimin e rrezikut të sigurimit, i siguruari nuk është i detyruar që të njoftojë siguresin për ndryshimin e këtyre rrethanave, ose në rast se që para lidhjes së kontratës së sigurimit, ekzistonin rrethana që nuk kanë lidhje me shtimin e rrezikut, për të cilat i siguruari vihet në dijëni pas lidhjes së kontratës, edhe në këtë rast i siguruari nuk është i detyruar që t'ia njoftojë këto rrethana të siguarit.

Në qoftë së i siguruari gjatë vazhdimit të kontratës nuk i njofton të siguarit ndryshimin e rrethanave, të cilat shtojnë rrezikun e sigurimit, atëherë siguruari që nga koha e shtimit të rrezikut të sigurimit ka të drejtë:

- a) të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit apo afatin e sigurimit ose
- b) të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Kodi Civil ka përcaktuar se në rastet kur i siguruari nuk paranon që të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, të afatit të kontratës ose nuk pranon që të zgjidhë kontratën e sigurimit, i siguruari ka të drejtë që t'i drejtohet me padi gjykatës për të realizuar dy nga mundësitë e përmendura më lart.

c) Detyrimi i të siguarit që të paguajë në favor të siguresit primin e sigurimit të parashikuar në kontratë.

Ky përbën një nga detyrimet me të rëndësishme të cilin ligji ka parashikuar për të siguarin në kontratën e sigurimit të pasurisë. Siç është sqaruar tek elementët që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit apo polica e sigurimit, primi i sigurimit është shuma në të holla që i siguruari duhet të paguajë në favor të siguresit për sigurimin e pasurisë. Ky prim i sigurimit paguhet nga i siguruari në shumën e përcaktuar në kontratë. Primi i sigurimit mund të paguhet nga i siguruari, menjëherë, në total, apo me këste.

Mospagimi në afat ose mospagimi fare i primit të sigurimit nga ana e të siguarit sjellë si pasojë pezullimin e zbatimit të kontratës së sigurimit. Një gjë e tillë rezulton nga përmbatja e fjalisë së dytë të nenit 1125 të Kodit Civil e cila parashikon: “... Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet. ...”.

Kjo pjesë e dispozitës e cila u citua jo pa qëllim nga ana ime mendoj se paraqet probleme në kuptimin e saj. Siç është sqaruar kur është folur për karakteristikat e kontratës së sigurimit, kemi

³³ Paragrafi i parë i nenit 1123 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi detyrohet t'i njoftojë siguresit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijëni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe mund të influencojnë mbi shtimin e rrezikut”

konstatuar se kontrata e sigurimit ka një moment tepër të veçantë të hyrjes së saj në fuqi, i cili është ora 24 e ditës kur paguhet primi i sigurimit ose kësti i parë i tij. Në rastin kur jemi para pagimit të primit të sigurimit njeherazi ose me këste, në qoftë se nuk paguhet primi i sigurimit ose kësti i parë i tij, kontrata e sigurimit mendoj se konsiderohet se nuk është e lidhur dhe nuk pezullohet ashtu siç parashikon paragrafi i parë i nenit 1125 i Kodit Civil. Kjo për faktin se përderisa kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24 të ditës së pagimit të primit të sigurimit ose të këstit të parë të tij dhe, përderisa i siguruari nuk ka paguar primin e sigurimit ose këstin e parë të tij, nuk mund të kemi pezullim të kontratës, pasi kjo kontratë nuk është lidhur akoma, pra, nuk ekziston dhe nuk mund të pezullohet një kontrata që nuk ekziston. Për këtë arsye mendoj se fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 1125 të Kodit Civil ose të hiqet fare si e panevojshme, sepse situata juridike që ka dashur të rregullojë është rregulluar mjaft qartë në pargarfin e dytë të këtij neni, ose të modifikohet në këtë mënyrë: **“Në qoftë së primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet, kontrata e sigurimit konsiderohet se nuk është lidhur midis palëve kontraktuese”.**

Në rastet kur në kontratën e sigurimit është parashikuar se primi i sigurimit do të paguhet me këste dhe në rast se pas pagimit të këstit të parë nga ana e të siguruarit, i siguruari nuk paguan këstet në vazhdim, sipas afatëve të përcaktuara, **kontrata e sigurimit pezullohet nga ora 24 e ditës së pesëmbëdhjetë, pas mbarimit të afatit të pagimit dhe me kalimin e këtij afati siguruari ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.** Kjo do të thotë se në rastet kur jemi para një kontrate sigurimi të pasurisë në të cilën është parashikuar që primi i sigurimit të paguhet me këste dhe i siguruari ka paguar këstin e parë të primit, por nuk paguan këstet në vazhdim sipas afatëve dhe shumave të parashikuara në kontratë, kontrata pezullohet me kalimin e orës 24 të ditës së pesëmbëdhjetë të mbarimit të këtij afati. Le ta konkretizojmë këtë me një shembull konkret. Ta zëmë se personi Q.T me cilësinë e të siguruarit lidh me shoqërinë B me cilësinë e siguruarit, me datë 12.08.2005 një kontratë sigurimi pasurie në të cilën është parashikuar që primi i sigurimit të paguhet me katër këste, ku kësti i parë do të paguhet me datë 12.08.2005, kësti i dytë me datë 12.10.2005, kësti i tretë me datë 12.12.2005 dhe kësti i katërt me datë 12.02.2005 për një shumë nga 10000 lekë secili. Ta zëmë se i siguruari paguan këstin e parë me datë 12.08.2005 dhe në këtë moment fillon zbatimi i kontratës së sigurimit. Me datë 12.10.2005 kur do të paguhej kësti i dytë i kontratës së sigurimit, i siguruari nuk e paguan atë. Në këtë rast **kontrata e sigurimit do të vazhdojë të ketë efekt deri me kalimin e orës 24 të ditës së pesëmbëdhjetë**, pra, deri në orën 24 të datës 27.12.2005 dhe pas kalimit të këtij afati siguruari ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Në këtë rast shtrohen për diskutim dy çështje: e para çfarë ndodh në rastin kur ngjarja e sigurimit ndodh në periudhën e ndërmjetme, midis datës kur është caktuar të paguhet kësti i primit të sigurimit, që në shembullin e dhënë është data 12.10.2005 dhe datën kur fillon pezullimi i kontratës që në rastin e dhënë është ora 24 e datës 27.10.2005? Për shembull, ta zëmë se në rastin e dhënë më lart, ngjarja e sigurimit ndodh me datë 20.10.2005, a detyrohet siguruari që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit? Çështja e dytë shtrohet nëse detyrohet siguruari që të paguajë shpërblimin e sigurimit në rastet kur ngjarja e sigurimit ndodh pasi kontrata është pezulluar, për shembull ndodh në rastin e dhënë si shembull me datë 30.10.2005?

Në lidhje me çështjen e dytë problemi është më i qartë, përderisa kontrata e sigurimit është e pezulluar për shkak të veprimeve me faj të të siguruarit, atëherë siguruari nuk detyrohet që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, në rast se ngjarja e sigurimit ndodh në kohën kur kontrata është e pezulluar. Për sa i përket çështjes së parë problemi është më i diskutueshëm, megjithatë duke i referuar dispozitës konkrete, çmoj se në këtë rast siguruari është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit në rast se ngjarja e sigurimit ndodh në periudhën e

ndërmjetme prej pesëmbëdhjete ditësh midis datës së caktuar për pagimin e primit të sigurimit dhe datës së pezullimit të kontratës.

Kjo për faktin se dispozita konkrete i ka lënë një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh të siguruarit që të ketë mundësi që të paguajë primin e sigurimit pas skadimit të afatit të pagimit të tij dhe me kalimin e orës 24 të ditës pesëmbëdhjetë, në qoftë se i siguruari nuk e paguan këstin e primit të sigurimit, kontrata e sigurimit pezullohet. Në rast se ngjarja e sigurimit ndodh gjatë kësaj periudhe pesëmbëdhjetë ditore, e cila i është lënë si mundësi të siguruarit që të paguajë këstin e primit të sigurimit, siguruari detyrohet të paguajë shpërblimin e sigurimit, pasi kontrata është ende në fuqi dhe sjellë të gjitha pasojat të cilat kanë parashikuar palët.

c) I siguruari me vertetimin e ngjarjes së sigurimit, është i detyruar që të njoftojë siguruasin për këtë fakt, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Kur kemi folur për karakteristikat e kontratës së sigurimit kemi përmendur se një karakteristikat më kryesore të kësaj kontratë është papërcaktueshmëria,³⁴ domethënë, që detyrimet e siguruarit janë të papërcaktuara që me lidhjen e kontratës dhe janë të varura nga fati, nëse do të vertetohet ose jo ngjarja e sigurimit e përcaktuar në kontratë. Në rast se vertetohet ngjarja e sigurimit e përcaktuar në kontratë, atëherë lindin detyrimet e siguruarit në kontratën e sigurimit. Kodi Civil në mënyrë të shprehur ka përcaktuar se është detyrim i të siguruarit që me vertetimin e ngjarjes së sigurimit, të njoftojë të siguruarin për këtë fakt. Jo vetëm aq, por ligji ka parashikuar edhe pasojat që sjellë moszbatimi i këtij detyrimi nga ana e të siguruarit, duke përcaktuar se në qoftë se i siguruari nuk e njofton siguruasin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, siguruari ka të drejtë që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit të parashikuar në kontratë.³⁵

Në lidhje me afatin ose periudhën brenda të cilës nga vertetimi i ngjarjes së sigurimit, i siguruari është i detyruar që të njoftojë siguruasin, kjo periudhë varet nga lloji konkret e kontratës së sigurimit të pasurisë, megjithatë, Kodi Civil ka parashikuar rregullin e përgjithshëm sipas të cilit, **i siguruari duhet të njoftojë siguruasin për vertetimin e ngjarjes së sigurimit brenda afatit të parashikuar në kontratë.** Kjo do të thotë që kontrata e sigurimit të pasurisë duhet që të përmbajë si element të saj edhe parashikimin e afatit brenda të cilit, me vertetimin e ngjarjes së sigurimit, i siguruari është i detyruar që të njoftojë siguruasin.

Në rast se në kontratë nuk është bërë një parashikim i tillë, atëherë për afatin e njoftimit të siguruarit, për vertetimin e ngjarjes së sigurimit, do të zbatohen dispozitat nënligjore nëse ka të tilla ose rregullat e përgjithshme të përcaktuara nga shoqëria e sigurimeve për njoftimin e ngjarjes së sigurimit. Për shembull, **në ratin e sigurimit të ndërtesave apo mallrave**, dispozitat nënligjore (udhëzimet e Ministrit të Financave) parashikojnë që i siguruari duhet që të njoftojë siguruasin për vertetimin e ngjarjes së sigurimit, **brenda pesë ditëve nga ndodhja e saj.**

Në rastet kur palët në kontratë nuk kanë përcaktuar ndonjë afat për njoftimin e siguruarit për vertetimin e ngjarjes së sigurimit dhe kur një gjë e tillë nuk rezulton as nga aktet nënligjore, atëherë duhet të pranojmë që i siguruari duhet që të njoftojë siguruasin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, **brenda një afati të arsyeshëm.** Sa sa duhet të jetë konkretisht ky afat i arsyeshëm, kjo varet nga rrethanat konkrete që kanë të bëjnë me llojin e pasurisë së siguruar, me llojin e ngjarjes së sigurimit të ndodhur, me vendodhjen e të siguruarit në kohën e vertetimit të ngjarjes së sigurimit, me distancën që ekziston midis të siguruarit dhe siguruarit dhe një sërë rrethanash konkrete.

³⁴ Për këtë arsye këtë kontratë e kemi quajtur kontratë aleatore ose fatore.

³⁵ Neni 1126 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur vertetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të njoftojë siguruasin brenda afatit të parashikuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk bën këtë njoftim, siguruari ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit”.

E përgjithshmeja që duhet thënë është se i siguruari duhet që ta njoftojë siguresin, sa më shpejt që të jetë e mundur për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, sepse është në interesin e tij që duke bërë këtë njoftim të marrë shpërblimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë. Në të kundërt çdo qëndrim neglizhent apo i pakujdesshëm i të siguarit, për të njoftuar të siguarin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, është i pajustificuar nga e drejta dhe me pasoja për të siguarin.

Në lidhje me formën se si i siguruari duhet ta njoftojë siguresin për vertetimin e ngjarjes së sigurimit, në Kodin Civil nuk është parashikuar ndonjë formë e caktuar. Kjo do të thotë që i siguruari mund ta njoftojë siguresin për vertetimin e rastit të sigurimit, me çdo lloj forme të ligjshme të shfaqjes së vullnetit, me shkrim, me gojë apo edhe me veprime konkludente, mjafton që të provohet se siguresi është njoftuar në një nga mënyrat e ligjshme të shfaqjes së vullnetit nga i siguruari, për vertetimin e ngjarjes së sigurimit. Për formën e njoftimit mendoj se është mirë që i siguruari ta njoftojë më shkrim siguresin për vertetimin e ngjarjes së sigurimit. Kjo do ta ndihmonte të siguarin që të provonte më lehtë këtë fakt, në rast se shtrohej për diskutim një gjë e tillë, nisur edhe nga fakti se **barrën e provës për të provuar se siguresi është njoftuar për vertetimin e ngjarjes së sigurimit, e ka i siguruari.**

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore që rregullojnë detyrimin e të siguarit për të njoftuar siguresin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, rezulton se mos kryerja e këtij detyrimi nga ana e të siguarit është më pasojë të rënda këtë të fundit. Konkretisht, në qoftë se se i siguruari nuk e bën këtë njoftim, siguresi ka të drejtë që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguarit.

Në këtë kuptim duhet kuptuar detyrimi i mësipërm edhe në rastet kur i siguruari nuk e bën njoftimin e vertetimit të ngjarjes së sigurimit, brenda afateve të përcaktuara në kontratë apo në aktet nënligjore, ose brenda afatit të arsyeshëm, sipas rrethanave konkrete ose kur ai nuk arrin të provojë se e ka njoftuar siguresin për vertetimin e ngjarjes së sigurimit. Në të gjitha këto raste, siguresi ka të drejtë që të refuzojë pagimin e shpërblimit të sigurimit në favor të të siguarit. Prandaj në kontratën e sigurimit të pasurisë, i siguruari duhet që të përmbushë me kujdes dhe korrektësi të madhe detyrimin e tij që të njoftojë siguresin brenda afateve të përcaktuara nga palët ose ligji, për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, në të kundërt ai mund të humbasë të drejtën për të përfituar shpërblimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë.

d) Detyrimi i të siguarit që të provojë ngjarjen e sigurimit, si dhe sasinë e dëmit të pësuar.

Ky është një tjetër detyrim i rëndësishëm i të siguarit, i cili me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit është i detyruar që të provojë ndodhjen e saj, si dhe të provojë faktin se nga kjo ngjarje i është shkatuar një dëm pasurisë së siguarit, si dhe vlerën e dëmit të shkatuar. Ky detyrim i të siguarit parashikohet në mënyrë të shprehur në ligj, sipas të cilit i siguruari detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit, si dhe duhet të provojë sasinë e dëmit të pësuar nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit.³⁶ Në këtë rast barrën e provës (onus probandi) për të provuar se ka ndodhur ngjarja e sigurimit, si dhe për të provuar dëmin e shkaktuar nga kjo ngjarje, ligji ia ka ngarkuar të siguarit.

Kjo për faktin se është i siguruari, i cili e ka në pronësi ose në përdorim pronën e siguarit dhe është ai që ka kontakte direkte me pronën dhe për këtë arsye e ka shumë më të lehtë që të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit, si dhe të provojë dëmin që i është shkaktuar pasurisë së siguarit. Për më tepër është në interesin e tij të drejtëpërdrejtë, për ta provuar një gjë të tillë, pasi me provimin e

³⁶ Paragrafi i parë i nenit 1127 të Kodit Civil në fuqi përcakton: *“I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në sigurimin e pasurisë, të provojë edhe sasinë e dëmit, si dhe t’i njoftojë siguresit, sipas kërkesës së tij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vertetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor”*

ngjarjes së sigurimit dhe të dëmit të shkaktuar pasurisë së tij të siguruar nga kjo ngjarje, ai ka të drejtë që të marrë nga i siguruari shpërblimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë. Në këtë rast i siguruari është i detyruar që të provojë:

Së pari: Se ka ndodhur ngjarja e sigurimit, e parashikuar në kontratë;

Së dyti: Se nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit, pronës së siguruar, i është shkatuar një dëm i caktuar;

Së treti: Vlerën e dëmit të pësuar.

Mjetet apo provat që mund të përdorë i siguruari për të vertetuar sa më sipër, janë nga më të ndryshmet, me çdo lloj prove, e cila njihet e tillë nga Kodi i Procedurës Civile, si provat me dëshmitarë, provat shkresore, mendimet e ekspertëve etj. Zakonisht për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkatuar mbi pasurinë e siguruar, kërkohet gjithmonë mendimi i ekspertëve, si provë e specializuar, krahas provave të tjera.

Detyrimi i të siguruarit për të provuar ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe të dëmit të pësuar, është i lidhur edhe me detyrimin tjetër të tij, që t'i japë siguruesit të gjitha informacionin që ai është në dijeni dhe që ka lidhje me vertetimin e ngjarjes së sigurimit. Për këtë informacion ligji parashikon se i siguruari është i detyruar që t'ia japë siguruesit, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet shprehimisht nga ana e siguruesit. Dhënia e këtij informacioni është e domosdoshme në mënyrë që edhe nga ana e siguruesit të hetohet nëse ngjarja e sigurimit ka ndodhur me të vërtetë apo është e simuluar nga ana e të siguruarit, ose prej ndonjë personi të tretë.

Në Kodin Civil parashikohet që detyrimi për të provuar ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe vlerës së dëmit të pësuar, bie jo vetëm mbi të siguruarin por, edhe mbi personin e tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata. Në rastet kur kontrata është lidhur **në dobi të personit të tretë, detyrimin për të provuar ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe vlerës së dëmit të shkatuar e ka personi i tretë dhe jo i siguruari**, i cili ka dalë si palë në kontratën e sigurimit. Ky është kuptimi që duhet t'i japim pjesës së parë të pragrafit të parë të nenit 1127 të Kodit Civil i cili shprehimisht përcakton se: *"I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë..."*.

Siç shihet ligjvënësi ka përdorur pjesëzën "ose" dhe jo lidhësen "dhe", çka do të thotë se jemi para një detyrimi alternativ të subjekteve; i siguruari detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe vlerën e dëmit të pësuar dhe ky është rregulli i përgjithshëm që ndodh në një kontratë sigurimi. Si përjashtim nga rregulli, personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, në rast se jemi para kontratës së sigurimit në dobi të personit të tretë, duhet të provojë ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe sasinë e dëmit të shkaktuar dhe ky është përjashtimi nga rregulli në një kontratë sigurimi.³⁷ Personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, po ashtu si i siguruari ka të drejtë

³⁷ Me këtë rast më duhet të sqaroj se kur kam folur për kontratën e sigurimit kam thënë se një nga karakteristikat e kësaj kontrate, është që ajo mund të lidhet në dobi të personit të tretë dhe se personi i tretë nuk është palë në këtë kontratë dhe **përfiton vetëm të drejta**. Fakti që personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, përfiton vetëm të drejta i referohet argumentit se ai nuk është i detyruar që të përmbushë ndonjë detyrim para lidhjes së kontratës së sigurimit ashtu si i sigurari si për shembull; të paguajë primin e sigurimit apo të njoftojë siguruesin për rrethana që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut, etj. Por, në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, edhe personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, merr përsipër detyrime, siç është ai i trajtuar më sipër **për të provuar ndodhjen e rastit të sigurimit dhe të vlerës së dëmit të pësuar**. Në këtë rast, pozita e personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, është e njëjtë më pozitën e të siguruarit. Megjithatë, duhet të dallojmë se ky detyrim i personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, është i lidhur ngushtë si një kusht pa të cilin "sine qua non", me të drejtën e tij që të përfitojë shpërblimin e sigurimit, pasi pa provuar ndodhjen e e ngjarjes së sigurimit dhe të dëmit të pësuar, personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të pretendojë shpërblimin e sigurimit nga ana e siguruesit.

që më çdo provë të provojë ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe të dëmit të pësuar prej saj. Po ashtu personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, është i detyruar që me kërkesë të sigurvearit, të japë çdo informacion që ai di, në lidhje me vertetimin e ngjarjes së sigurimit.

Në Kodin Civil parashikohet se në rastet kur i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk arrin që të provojë ndodhjen e rastit të sigurimit, si dhe të vlerës së dëmit të pësuar, sigurveari ka të drejtë që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit.³⁸ Prandaj në këto raste është detyrim i të sigurvearit ose personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, që të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe vlerën e dëmit të pësuar nga kjo ngjarje, në të kundërt ai mund të humbasë të drejtën për të përfituar shpërblimin e sigurimit. Në përcaktimin e dëmit të pësuar dhe të vlerës së tij, i siguruari ose personi i tretë është i detyruar që të provojë njëkohësisht këto kushte:

Së pari: Faktin se dëmi i shkatuar ka ardhur nga ngjarja e sigurimit, e parashikuar në kontratë;

Së dyti: Faktin se pasuria e siguar është dëmtuar ose zhdukur, pikërisht nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit e parashikuar në kontratë;

Së treti: Faktin e ekzistencës së lidhjes shkaksore të drejtëpëdrejtë, midis ngjarjes së sigurimit të parashikuar në kontratë dhe dëmit të pësuar në pasurinë e siguar.

f) Detyrimi i të sigurvearit që gjatë vazhdimit të kontratës së sigurimit, të ruajë më kujdes pasurinë e siguar.

Ky detyrim i të sigurvearit është i parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj, sipas të cilit i siguruari duhet që të ruajë me kujdes pasurinë e siguar.³⁹ Kur kemi trajtuar subjektet e kontratës së sigurimit të pasurisë, kam përmendur se si palë e siguar ose si i siguar mund të jetë pronari i një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme, por, edhe personi i cili zotëron një të drejtë reale apo të drejtë tjetër, mbi këto pasuri si për shembull, uzufuktari, enfiteozmarrësi, qiramarrësi etj. Këto subjekte e kanë si detyrim për shkak të cilësisë që kanë mbi sendin që ta ruajnë me kujdes atë. Kështu pronari është i detyruar që ta ruajë me kujdes sendin e tij, sepse ai është i tij dhe vetëm në këtë mënyrë mund që ta gëzojë në mënyrë sa më të plotë atë. Po ashtu uzufuktari, enfiteozmarrësi apo qiramarrësi, janë të detyruar që të ruajnë me kujdes sendin që kanë në gëzim, sepse janë të detyruar nga kontratat respektive si dhe vetëm në këtë mënyrë mund të përfitojnë sa më shumë nga sendi.

Megjithatë, Kodi Civil ka parashikuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e sigurvearit, që i siguruari është i detyruar që të ruajë më kujdes sendin apo pasurinë e siguar. Ky detyrim i të sigurvearit fillon nga momenti i lidhjes së kontratës së sigurimit, deri në momentin e mbarimit të saj. Ruajtja me kujdes e pasurisë së siguar nga ana e të sigurvearit, nënkupton në radhë të parë detyrimin e të sigurvearit që ta mirëmbajë pasurinë e siguar duke kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme që duhen për ekzistencën e sendit në gjendjen normale.

Po ashtu, ruajtja me kujdes e pasurisë së siguar nga ana e të sigurvearit, nënkupton detyrimin e tij që të mos lejojë të tjerët që të dëmtojnë pasurinë, që ta shkatërrojnë atë apo që ta zhdukin ose t'ia marrin nga posedimi të sigurvearit. Kjo nënkupton edhe detyrimin e të sigurvearit që të ngrejë çdo padi për të mbrojtur pronën e siguar dhe moscënimin e saj nga personat e tretë. Ruajtja me kujdes e pasurisë së siguar nënkupton, po ashtu, edhe detyrimin e të sigurvearit që të bëjë ruajtjen e

³⁸ Paragrafi i fundit i nenit 1127, Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur nuk përmbushen detyrimet e mësipërme, sigurveari ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit”.

³⁹ Paragrafi i parë i nenit 1140 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “I siguruari duhet të ruajë me kujdes pasurinë e siguar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe veterinare”.

pasurisë sipas dispozitave kundër zjarrit, si dhe kur jemi para sigurimit të prodhimeve bujqësore apo blegtorale, të bëjë ruajtjen e pasurisë në përputhje me rregullat agronomike dhe veterinarë.

Detyrimi i të siguruarit për të ruajtur me kujdes pronën e siguruar, i jep të drejtë siguresit që të kryejë verifikime të herëpashershme, nëse i siguruari i zbaton të gjitha rregullat për ruajtjen me kujdes të pasurisë së siguruar. Kështu siguresi ka të drejtë që të kontrollojë pasurinë e siguruar dhe të kërkojë nga i siguruari marrjen e masave për të ruajtur me kujdes pasurinë, si dhe marrjen e masave për zhdukjen e çrregullimeve të konstatuara.

Kjo do të thotë se në rast se në një kontratë sigurimi pasurie, për shembull, për prodhimet bujqësore, konstatohet nga siguresi, se i siguruari nuk merr masat e nevojshme për të ruajtur me kujdes pasurinë duke mos u zbatuar nga i siguruari rregullat agronomike, siguresi ka të drejtë të kërkojë nga i siguruari zbatimin e këtyre rregullave, si dhe zhdukjen e problemeve që mund të jenë shkaktuar nga mozbatimi i tyre. Në rast se i siguruari edhe pas konstatimit nga ana e siguresit për mosruajtjen me kujdes të pasurisë, si dhe edhe pas kërkimit nga ana e siguresit që i siguruari të marrë masat e nevojshme për ruajtjen sipas rregullave të pasurisë, i siguruari përsëri nuk merr masat e duhura, ligji parashikon se siguresi ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kontratës së sigurimit.

Duhet të kemi parasysh se e drejta e siguresit për të zgjidhur kontratën e sigurimit në këtë rast, zbatohet jo menjëherë pasi siguresi konstaton se i siguruari nuk po merr masat e duhura për të ruajtur me kujdes pasurinë, por vetëm pasi siguresi i ka konstatuar këto të meta në ruajtjen e pasurisë së siguruar dhe i ka kërkuar të siguruarit ndreqjen e tyre dhe përsëri i siguruari nuk ka marrë masat e duhura për ruajtjen me kujdes të pasurisë. Vetëm në këtë rast siguresi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit për faj të të siguruarit, duke i kërkuar edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar në rast se nga zgjidhja e kontratës, siguresit i është shkaktuar ndonjë dëm.

g) Detyrimi i të siguruarit që me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, të marrë të gjitha masat, në mënyrë që të ndalohet ose të pakësohet dëmi.

Ndodhja e ngjarjes së sigurimit është një fakt juridik i cili sjell të drejta dhe detyrimet për të dy palët në kontratë. Nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit lind e drejta e të siguruarit që të kërkojë nga siguresi shpërblimin e sigurimit, si dhe detyrimi i siguresit që t'i paguajë të siguruarit shpërblimin e sigurimit, sipas kushteve të përcaktuar në kontratë. Por, nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit nuk lindin vetëm të drejta për të siguruarin dhe vetëm detyrime për siguresin. Siç e kemi parë, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i siguruari ka një sërë detyrimesh si; të njoftojë të siguruarin për këtë fakt, të provojë ndodhjen e ngjarjes së sigurimit si dhe të dëmit të shkaktuar prej saj, etj.

Një nga detyrimet kryesore që ka i siguruari, sipas dispozitave ligjore, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, është që të marrë të gjitha masat e mundshme për të ndaluar ose pakësuar dëmin e shkaktuar.⁴⁰ Kështu për shembull, në rast se jemi para sigurimit të pasurisë nga zjarri dhe ndodh ngjarja e sigurimit, duke rënë zjarr mbi objektin e siguruar, marrja e të gjitha masave nga i siguruari për të ndaluar ose pakësuar dëmin e shkaktuar, nënkupton të gjitha veprimet e tij që kanë të bëjnë me shuarjen e zjarrit, me largimin e sendeve të ndryshme me vlerë që ndodhen brenda objektit të siguruar, kur një gjë e tillë është e mundur, me njoftimin menjëherë të shërbimit të zjarrfikësëve, si dhe çdo masë të nevojshme për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë me qëllim ndalimin ose pakësimin e dëmit të shkaktuar. Çdo qëndrim indiferent apo neglizhent i të siguruarit, me arsyen se pasurinë e kam të siguruar, kur provohet se ka patur mundësi objektive që të marrë masa për ndalimin ose

⁴⁰ Paragrafi i parë i nenit 1141 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Kur vertetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet që të marrë të gjitha masat që varen nga ai për të shpëtuar ose ruajtur pasurinë e siguruar me qëllim që të ndalohet ose të pakësohet dëmi".

pakësimin e dëmit, është me pasoja për të siguruarin dhe i jep të drejtë të siguruarit që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit për atë pjesë të dëmit që është shkatuar nga mosmarrja prej të siguruarit e masave, të cilat mund të merreshin prej tij për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar.

Detyrimi i të siguruarit për të marrë të gjitha masat në mënyrë që të ndalohet ose të pakësohet dëmi mbi pasurinë e siguruar, i jep të drejtë atij që të kërkojë nga siguroesi të gjitha shpenzimet që ai ka bërë për të shpëtuar ose ruajtur pasurinë e siguruar, pavarësisht nëse i ka arritur ose jo qëllimit, përveç kur siguroesi arrin të provojë se shpenzimet e bëra dhe mjetet e përdorura janë bërë ose përdorur pa kujdes. Kështu në shembullin e dhënë më lart për objektin e siguruar nga zjarri, në rast se pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i siguruari në mënyrë që të shpëtojë dhe ruajtur pasurinë e siguruar, si dhe me qëllim që të pakësojë ose ndalojë dëmin, prish një objekt kioskë, në pronësi të ligjshme po të të siguruarit, sepse vetëm në këtë mënyrë zjarrëfiksjat mund të afrohej tek objekti për të shuar zjarrin dhe pavarësisht nga kjo, megjithë përpjekjet e zjarrëfikses zjarri nuk u shua, siguroesi është i detyruar që t'i shpërblejë të siguruarin vlerën e kioskës, pasi ajo është shkatërruar me qëllim që të shpëtohet dhe ruhet pasuria e siguruar.

Por, në rast se siguroesi arrin të provojë se prishja e kioskës në pronësi të të siguruarit është bërë në mënyrë krejt të panvojshme, pasi mjete të zjarrëfikses mund të kalonte nëpër një rrugë tjetër për të shkuar tek objekti i siguruar, e cila është afër me këtë objekt, atëherë ai nuk është i detyruar që të paguajë vlerën e kioskës së të siguruarit, pasi ky shpenzim është bërë pa qenë i nevojshëm ose pa kujdes. Po ashtu siguroesi është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit të gjitha dëmet materiale të shkaktuara mbi sendet e siguruar nga mjetet e përdorura nga i siguruari, për të shmangur ose zvogëluar dëmet e ndodhura në ngjarjen e sigurimit, me përshtim të rasteve kur ai arrin të provojë se mjete të tilla janë përdorur pa kujdes dhe pa qenë të domosdoshme.

Kështu në shembullin e dhënë më lart, në sigurimin e një objekti kundër zjarrit, në rast se me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i siguruari për të shmangur ose zvogëluar dëmet mbi objektin e siguruar, përdor disa materiale të ngurta, si rërë apo materiale të tjera ndërtimi, si tulla apo tjegulla, siguroesi është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit vlerën këtyre materialeve. Por, në rast se i siguruari për të shuar zjarrin përdor mjete të papërshtashme të cilat nuk ndikojnë në shuarjen e zjarrit, siguroesi nuk është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit vlerën e tyre, pasi mjete të tilla janë përdorur pa kujdes dhe nuk kanë qenë të domosdoshme.

2.1.4. Të drejtat dhe detyrimet e siguroesit në kontratën e sigurimit të pasurisë.

Kontrata e sigurimit të pasurisë duke qenë një kontratë e dyanshme, përmban të drejta dhe detyrime si për të siguruarin, ashtu edhe për siguroesin. **Të drejtat dhe detyrimet e siguroesit në kontratën e sigurimit të pasurisë duhen parë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, të cilat u trajtuan më lart, në kuptimin që ato që përbëjnë detyrime për të siguruarin, përbëjnë të drejta për palën tjetër që është siguroesi dhe anasjelltas.** Në këtë kuptim kur kemi sqaruar detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë, kemi sqaruar njëkohësisht edhe të drejtat e siguroesit në këtë kontratë, sepse detyrimet e të siguruarit lidhen pikërisht, me përmbushjen e të drejtave konkrete ndaj siguroesit.

Pavarësisht nga kjo, në këtë çështje unë do të ndalem në një trajtim të përmbledhur të të drejtave dhe detyrimeve të siguroesit në kontratën e sigurimit të pasurisë, kuptohet duke u përpjekur që të mos bëj përsëritje me ato çfarë kam thënë për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, por dua të paralajmëroj lexuesin se shmangja në mënyrë absolute e përsëritjes, në aspekte të veçanta të këtij trajtimi, është e pamundur, përderisa po bëhet trajtimi i dy anëve të një çështjeje juridike.

Në parantezë, më duhet të them se të drejtat dhe detyrimet e sigurvecit në këtë kontratë janë më të kufizuara se ato të të siguruarit, prandaj dhe do të zënë një vend më të vogël në këtë trajtim, kjo edhe për faktin tjetër se një pjesë e të drejtave dhe detyrimeve të sigurvecit janë trajtuar si pjesë e pashmangshme kur është folur për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit. Në mënyrë të përmbledhur të drejtat dhe detyrimet e sigurvecit në kontratën e sigurimit të pasurisë janë:

a) Detyrimi i sigurvecit që t'i paguajë të siguruarit shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.

Detyrimi kryesor që ka sigurveci ndaj të siguruarit është që **me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, ai të paguajë shpërblimin e sigurimit** sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Ky detyrim i sigurvecit rezulton nga vetë përmbatja e kontratës së sigurimit të pasurisë, pavarësisht se në Kodin Civil, në dispozitat që rregullojnë këtë kontratë, nuk ka një dispozitë konkrete që të parashikojë detyrimin e sigurvecit, që me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, të paguajë në favor të të siguruarit shpërblimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, ky detyrim i sigurvecit rezulton nga vetë kuptimi që Kodi Civil i jep kontratës së sigurimit të pasurisë, në të cilin është përcaktuar se me vertetimin e ngjarjes së parashikuar në kontratë, sigurveci është i detyruar t'i shpërblejë palës tjetër, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është përcaktuar në kontratë.⁴¹ Jo vetëm aq, por, Kodi Civil në një numër dispozitash në mënyrë indirekte flet për këtë detyrim të sigurvecit, duke parashikuar një numër rastesh kur sigurveci nuk është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguruarit.⁴²

Shpërblimi i sigurimit paguhet nga sigurveci sipas kushteve dhe në shumën e përcaktuar në kontratë. Shpërblimi i sigurimit duhet të paguhet nga i siguruari brenda afatit të caktuar në kontratë dhe në rast se në kontratë palët nuk kanë përcaktuar afatin brenda të cilit sigurveci duhet të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, shpërblimi i sigurimit paguhet brenda afatit të përcaktuar në dispozita të veçanta ligjore ose nënligjore. Afati për pagimin e shpërblimit të sigurimit nga sigurveci fillon nga dita që është provuar ngjarja e sigurimit dhe është provuar vlera e dëmit të shkatuar prej saj.

Për përcaktimin e vlerës së shpërblimit të sigurimit, palët mbështeten në njërin nga dy sistemet e shpërblimit të sigurimit atë **proporcional** apo **atë të rrezikut të parë**, në varësi të llojit të sistemit që palët kanë zgjedhur në kontratë. Në përcaktimin e vlerës konkrete të shpërblimit të dëmit, marrin pjesë si rregull të dy palët, sigurveci dhe i siguruari dhe për përcaktimin konkret të saj zakonisht është e nevojshme mendimi i ekspertëve përkatës. Në rast se i siguruari nuk është dakort për vlerën konkrete të shpërblimit të sigurimit, ai ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës, e cila është ajo që vendos përfundimisht për sasinë e shpërblimit të sigurimit që sigurveci, duhet që të paguajë ndaj të siguruarit.

Në kontratën e sigurimit të pasurisë duhet që të përcaktohet si rregull afati brenda të cilit, sigurveci duhet që të bëjë pagimin e shpërblimit të sigurimit, ndaj të siguruarit. Në këtë rast kur palët kanë parashikuar në kontratë këtë afat, sigurveci duhet që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, brenda këtij afati të përcaktuar nga palët, ose t'i kthejë përgjigje me shkrim të siguruarit se nuk do t'i paguajë këtë shpërblim, duke përcaktuar edhe arsyet e marrjes së një vendimi të tillë.

Në rast se palët në kontratë nuk kanë parashikuar afatin brenda të cilit sigurveci do t'i paguajë shpërblimin e sigurimit të siguruarit, **dispozitat nënligjore parashikojnë që sigurveci është i detyruar që të realizojë pagesën në favor të të siguruarit, brenda 30 ditëve nga marrja e**

⁴¹ Shih nenin 1113 pika "a" e Kodit Civil në fuqi.

⁴² Për këtë fakt shih nenet 1128; 1129; 1136; 1137; 1139; 1142; 1143 e 1146 të Kodit Civil në fuqi.

dokumentacionit që provon ngjarjen e sigurimit dhe vlerën e dëmit të shkaktuar prej saj. Këto dispozita parashikojnë që siguruasi brenda këtij afati në rast se mendon se janë rastet kur ai nuk duhet të paguajë shpërblimin e sigurimit, duhet që t'i njoftojë me shkrim të siguruarit arsyet e mospagimit të tij. Kundër vendimit të siguresit për të mos paguar shpërblimin e sigurimit, në favor të të siguruarit, i siguruari ka të drejtë të ankohet në gjykatë dhe është gjykata ajo që vendos përfundimisht nëse siguruasi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguruarit dhe nëse po edhe sa është vlera konkrete e këtij shpërblimi të sigurimit.

Në Kodin Civil është parashikuar një status i veçantë i shpërblimit të sigurimit, që siguruasi duhet të paguajë jo në favor të të siguruarit, por **në favor të personit të tretë**, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata. Sipas dispozitave të Kodit Civil shpërblimi i sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguruarit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet me qëllim që të përmbushen detyrimet që ka i siguruari ndaj siguresit dhe/ose personave të tretë.⁴³

Kjo do të thotë që pavarësisht faktit që i siguruari mund të ketë detyrime, si ndaj siguresit ose dhe ndaj personave të tretë, personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, do të përfitojë shpërblimin e sigurimit dhe shuma e këtij shpërblimi nuk mund të sekuestrohet për të shlyer detyrimet e të siguruarit. Ky parashikim është bërë nga ligji për të mbrojtur pozitën e personit të tretë, i cili nuk është palë në kontratën e sigurimit dhe përfiton vetëm të drejta nga kjo kontratë dhe nuk ka pse të cënohet e drejta e tij për të përfituar shpërblimin e sigurimit, nga fakti se i siguruari, i cili ka lidhur kontratën në dobi të tij, ka detyrime ndaj të tretëve apo ndaj siguresit.

Ky parashikim duhet të mbahet parasysh nga ana e përmbartës gjyqësor, i cili bën ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, mbi pasurinë e të siguruarit që ka detyrime ndaj të tretëve, pasi shpërblimi i sigurimit që duhet t'i paguhet personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, futet tek sendet të cilat nuk mund të sekuestrohen. Kjo përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, sipas të cilit në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga siguri.⁴⁴ Kjo dispozitë zbatohet në rastet kur kontrata e sigurimit është lidhur mbi këto sende nga i siguruari, në dobi të tij dhe ky zbatim përbën rregullin, por nuk zbatohet kur kontrata e sigurimit është lidhur nga i siguruari, në dobi të personit të tretë dhe ky moszbatim përbën përjashtim nga rregulli i parashikuar nga neni 530 i Kodit të Procedurës Civile.

b) Siguruasi është i detyruar që të paguajë në favor të të siguresit shpërblimin e sigurimit vetëm brenda vlerës së përcaktuar në kontratë ose që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Shpjegoam më lart se një nga detyrimet më kryesore të siguresit në kontratën e sigurimit, është detyrimi i tij që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit. Ky detyrim i siguresit zbatohet vetëm pasi ka ndodhur ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë dhe vetëm pasi i siguruari të ketë provuar këtë ngjarje, si dhe vlerën e dëmit që i është shkaktuar pasurisë së siguruar nga kjo ngjarje. Por, fakti që siguruasi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit me vertetimin e ngjarjes së sigurimit, nuk do të thotë që ai do të paguajë si shpërblim siguri, çdo lloj shume e cila mund të pretendohet nga i siguruari, apo që siguruasi, në çdo rast, pavarësisht faktit nëse pasuria është siguruar plotësisht apo pjesërisht, do të paguajë si

⁴³ Paragrafi i parë i nenit 1128 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguruarit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet për borgjet e të siguruarit”

⁴⁴ Neni 530 i Kodit të Procedurës Civile në fuqi përcakton: “Në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga siguri”.

shpërblim sigurimi, një shumë të tillë, e cila të mbulojë të gjitha dëmet që i janë shkaktuar pasurisë së personit të siguruar, nga ngjarja e sigurimit.

Në lidhje me vlerën konkrete të shpërblimit të sigurimit që siguroesi do të paguajë në favor të të siguruarit, zbatohet rregulli i përgjithshëm sipas të cilit **siguroesi do të paguajë si shpërblim sigurimi në favor të të siguruarit, atë shumë që është përcaktuar nga palët në kontratë**. Pra, në çdo rast kur palët në kontratë kanë përcaktuar vlerën konkrete të shpërblimit të sigurimit, si dhe mënyrën e llogaritjes së tij, siguroesi do të paguajë në favor të të siguruarit atë shpërblim sigurimi që është përcaktuar në kontratë dhe ky shpërblim sigurimi do të llogaritet sipas asaj mënyrë që është përcaktuar në kontratë.

Në rast se palët në kontratë nuk kanë përcaktuar vlerën konkrete të shpërblimit të sigurimit që siguroesi do të paguajë në favor të të siguruarit dhe as mënyrën e llogaritjes së tij, Kodi Civil në disa dispozita ka vendosur rregulla për përcaktimin e shpërblimit të sigurimit apo të shumës së sigurimit, që siguroesi duhet të paguajë në favor të të siguruarit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për palët për t'u zbatuar, si në rastin kur ato e përcaktojnë në kontratë vlerën konkrete të shumës së sigurimit dhe të mënyrës së llogaritjes së saj, ku palët duhet të kenë parasysh këto përcaktime ligjore, ashtu edhe në rastet kur palët nuk e kanë përcaktuar në kontratë vlerën konkrete të shumës së sigurimit dhe të mënyrës së llogaritjes së saj.

Kështu i parë i parashikuar në Kodin Civil në lidhje me përcaktimin e shpërblimit të sigurimit është se **shpërblimi i sigurimit apo shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar**. Kjo do të thotë se pavarësisht faktit se pasuria është e siguruar plotësisht, si dhe pavarësisht faktit se nga ngjarja e sigurimit pasuria e siguruar është shkatërruar tërësisht, shuma që do të paguajë siguroesi në favor të të siguruarit, nuk mund të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar. **Ky përcaktim vlen për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit të pasurisë dhe ka karakter urdhërues**, domethënë, duhet të zbatohet nga palët kur ato hartojnë kontratën e sigurimit të pasurisë dhe bëjnë përcaktimin e vlerës së shumës së sigurimit që duhet të paguajë siguroesi.

Në qoftë se palët në kontratë parashikojnë se vlera e shumës së sigurimit do të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar, kjo klauzolë e kontratës do të jetë e pavlefshme për pjesën e shumës së sigurimit, që kalon vlerën e pasurisë së siguruar, ndërsa kontrata në tërësi mund të jetë e vlefshme në rast se plotëson kushtet e tjera të përcaktuara nga ligji. Për shembull, në rast se vlera e pasurisë së siguruar është 8.000.000 lekë dhe palët përcaktojnë në kontratë që shuma e sigurimit që do të paguajë siguroesi është 10.000.000 lekë, vlera që përbën diferencën $10.000.000 - 8.000.000 = 2.000.000$ lekë, është një vlerë që bie në kundërshtim me ligjin, prandaj nuk mund të paguhet nga siguroesi dhe vlera maksimale e shumës së sigurimit që mund të paguajë siguroesi në rastin konkret është 8.000.000 lekë.

Në ligj është përcaktuar se vlera e pasurisë së siguruar për disa lloje të veçanata të sigurimit të pasurisë, mund të përcaktohet në kontratën e sigurimit të pasurisë me anë të vleftësismit të pasurisë. Kjo do të thotë që përcaktimi i vlerës konkrete të pasurisë të bëhet me anë të ekspertëve vlerësues, të cilët mbi bazën e veçorive specifike të pronës, bëjnë dhe përcaktimin e vlerës konkrete të saj. Përcaktimi i vlerës konkrete të pasurisë që do të sigurohet është një moment i rëndësishëm i kontratës së sigurimit të pasurisë, pasi siç u tha më lart kjo vlerë shërbën si kufi maksimal për përcaktimin e vlerës së shumës së sigurimit, e cila mund të jetë më e vogël se vlera e pasurisë së siguruar, por nuk mund të jetë asnjëherë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar.

Në rastet kur është siguruar vetëm një pjesë e vlerës së pasurisë, shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar. Pra, **shuma e sigurimit në këtë rast është në proporcion me vlerën e pasurisë së siguruar, duke mos e kaluar asnjëherë vlerën e pasurisë së siguruar**. Për shembull, në rastin e dhënë më lart, për një pasuri me vlerë 8.000.000 lekë, në qoftë

se është siguruar vetëm $\frac{1}{4}$ e kësaj pasurie, pra, në qoftë se pasuria është siguruar vetëm për një vlerë prej 2.000.000 lekë, shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se 2.000.000 lekë, pavarësisht nga dëmi më i madh që mund të ketë shkaktuar ngjarja e sigurimit.

Në qoftë se palët në kontratë shkëlin kushtet e mësipërme, domethënë, parashikojnë në kontratë që shuma e sigurimit të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar, apo kjo shumë të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar, në rastet kur është siguruar vetëm një pjesë e pasurisë, kontrata e sigurimit është e vlefshme vetëm për një shumë të barabartë me vlerën e pasurisë së siguruar ose me pjesën e vlerës së pasurisë së siguruar.

Kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet, ligji ka përcaktuar se shpërblehet ose vlera e pasurisë së siguruar brenda kufijve të shumës së sigurimit ose pakësimi i vlerës së pasurisë, me përjashtim të rasteve kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.⁴⁵ Siç shihet për përcaktimim e vlerës konkrete të shumës së sigurimit, kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet në rast se palët nuk kanë përcaktuar ndryshe në kontratë, Kodi Civil përcakton se shuma e sigurimit, që siguroesi do t'i paguajë, të siguroarit përbëhet:

a) Nga vlera që ka patur pasuria e siguruar, e cila është dëmtuar ose ka humbur, ose

b) Nga vlera që përbën pakësimin e vlerës së pasurisë së siguruar, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.

Në rastin e gërmës “a)”, shuma e sigurimit do të përbëhet nga vlera që ka patur pasuria e siguruar, e cila ka humbur ose është dëmtuar plotësisht. Për shëmbull, në rast se pasuria e siguruar është me vlerë 8.000.000 lekë dhe kjo pasuri ka humbur ose është dëmtuar plotësisht, shuma e sigurimit do të jetë 8000.000 lekë. Në këtë rast shuma e sigurimit mund të jetë edhe më e vogël se 8000.000 lekë, në qoftë se kufiri i shumës së sigurimit është përcaktuar nga palët më i vogël se vlera e pasurisë së siguruar.

Kur pasuria e siguruar është dëmtuar pjesërisht, pavarësisht se në Kodin Civil nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur një situatë e tillë, nga interpretimi i dispozitave të tjera që rregullojnë sigurimin e pasurisë, mendoj se shuma e sigurimit nuk do të jetë jo më e madhe se vlera e pasurisë së dëmtuar. Për shëmbull, në rast se është siguruar një pasuri me vlerë 8.000.000 lekë dhe nga ngjarja e sigurimit kjo pasuri është dëmtuar pjesërisht për një vlerë prej 4.000.000 lekë, shuma e sigurimit mund të jetë më e vogël se 4.000.000 lekë (në rast se pasuria është siguruar në mënyrë të pjesshme), por asnjëherë më e madhe se 4.000.000 lekë.

Në rastin e parashikuar nga gërma “b)”, shuma e sigurimit do të përbëhet nga vlera që është pakësuar pasuria e siguruar. Kështu për shëmbull, në qoftë se është siguruar një pasuri me vlerë 8.000.000 lekë dhe nga ngjarja e sigurimit kjo pasuri është pakësuar në vlerën 2.000.000 lekë, atëherë shuma e sigurimit do të jetë 2.000.000 lekë, aq sa është pakësimi i vlerës së pasurisë së siguruar.

Në Kodin Civil, është parashikuar parimi sipas të cilit **siguroesi përgjigjet për fitimin e munguar, vetëm në qoftë se një gjë e tillë është parashikuar shprehimisht në kontratë**. Kjo do të thotë se si rregull, siguroesi nuk përgjigjet për fitimin e munguar, të cilin do të kishte nxjerrë i siguroari nga pasuria e siguruar, në rast se nuk do të kishte ndodhur ngjarja e sigurimit, e cila sjellë humbjen ose shkatërrimin e sendit. Nga ana tjetër siguroesi, si përjashtim do të përgjigjet për fitimin e munguar të pasurisë së të siguroarit, në qoftë se palët e kanë parashikuar një gjë të tillë shprehimisht në kontratë.

⁴⁵ Paragrafi i parë i nenit 1128 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet, shpërblehet, sipas rastit, vlefshme e saj brenda kufijve të shumës së sigurimit, ose pakësimi i vlerës së pasurisë, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe”.

Koncepti i fitimit të munguar nuk jepet në dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e sigurimit të pasurisë, dhe as në ndonjë dispozitë tjetër të Kodit Civil, por përcaktimi i këtij koncepti i është lënë shkencës së të drejtës civile. Si fitim i munguar do të konsiderohet jo vlera e pasurisë së siguruar, por vlera që do të fitohej nga kjo pasuri në të ardhmen, në qoftë se nuk do të kishte ndodhur rasti i sigurimit dhe pasuria do të përdorej nga personi konkret. Le ta thjeshtëzojmë me një shembull përgjegjësine që ka siguruasi për fitimin e munguar. Ta zëmë se siguruasi A, ka lidhur një kontratë sigurimi me të siguruarin N.D, ku objekt i kontratës është sigurimi i produkteve bujqësore nga ngricat, breshëri dhe përmbytjet. Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, siguruasi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit, në shumën e përcaktuar në kontratë dhe nuk është i detyruar që të paguajë edhe fitimin e munguar, i cili është vlera që do të kishin këto produkte bujqësore, nëse ato do të shiteshin në treg, në rast se nuk do të kushte ndodhur ngjarja e sigurimit.

Në këtë rast siguruasi nuk përgjigjet për fitimin e munguar, pasi palët nuk e kanë parashikuar shprehimisht në kontratë, që siguruasi do të mbajë përgjegjësi edhe për fitimin e munguar të pasurisë së siguruar. Në rast se në kontratë palët do të kishin përcaktuar që siguruasi do të përgjigjet edhe për fitimin e munguar, atëherë siguruasi do të përgjigjej edhe për fitimin e munguar dhe do të paguante në favor të të siguruarit, përveç shpërblimit të sigurimit, brenda kufijve të vlerës së përcaktuar në kontratë, edhe fitimin e munguar, pra, konkretisht edhe vlerën që do të kishin këto produkte bujqësore, në rast se do të përdroreshin normalisht sikur të mos kishte ndodhur ngjarja e sigurimit.

Në Kodin Civil është parashikuar një situatë e veçantë që ka të bëjë me humbjen pjesërisht ose dëmtimin e pasurisë së siguruar, ku siguruasi paguan pjesërisht shumën e sigurimit apo shpërblimin e sigurimit. Në një situatë të tillë, në qoftë se pasuria e siguruar ka humbur pjesërisht ose është dëmtuar pjesërisht dhe për këtë siguruasi ka paguar shumën e sigurimit jo në mënyrë të plotë, pasuria që ka mbetur konsiderohet e siguruar, deri në fund të afatit të caktuar në kontratë, për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe shpërblimit që është paguar.⁴⁶

Nga vertetimi i ngjarjes së sigurimit mund të ndodhë që pasuria e siguruar të humbasë pjesërisht ose të dëmtohet kuptohet po pjesërisht. Në këtë rast ligji i njeh të drejtë siguruasit që të paguajë vetëm një pjesë të shumës së sigurimit, ndërsa pjesa tjetër e shumës së sigurimit do të shërbejë për sigurimin e pjesës tjetër të pasurisë që ka ngelur dhe ky sigurim do të vazhdojë deri në fund të afatit të caktuar në kontratë.

Për ta kuptuar më mirë përmbajtjen e kësaj situate ligjore le ta sqarojmë atë më një shembull. Ta zëmë se personi N.K, me cilësinë e të siguruarit, lidh një kontratë sigurimi me shoqërinë B, me cilësinë e siguruasit, ku objekt i kontratës është sigurimi i një fabrike të prodhimit të vajit, nga zjarri. Në kontratë është parashikuar që periudha e sigurimit do të jetë nga 12.04.2005, deri më 11.04.2006 dhe shuma e sigurimit do të jetë 10.000.000 lekë. Me datë 12.06.2005 bie zjarr në objektin e siguruar, ku si pasojë fabrika dëmtohet pjesërisht. Siguruasi paguan në favor të të siguruarit si shumë sigurimi vlerën prej 4.000.000 lekë. Në këtë rast kontrata e sigurimit do të vazhdojë për pjesën e mbetur të pasurisë së siguruar, deri me datë 12.06.2006 dhe shuma e sigurimit do të jetë diferenca midis shumës së sigurimit që është në rastin tonë 10.000.000 lekë dhe shpërblimit të paguar që është 4.000.000 lekë, pra shuma e sigurimit që do të paguajë siguruasi në

⁴⁶ Neni 1138 i Kodit Civil në fuqi përcakton: *“Kur pasuria e siguruar ka humbur pjesërisht ose është dëmtuar dhe për këtë është paguar shuma jo e plotë e sigurimit, pasuria që ka mbetur quhet e siguruar gjer në fund të afatit të caktuar në kontratë për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe shpërblimit që është paguar”*.

favor të të siguruarit për pjesën e mbetur të pasurisë në qoftë se gjatë periudhës së sigurimit ndodh rasti i sigurimit i parashikuar në kontratë do të jetë 10.000.000-4.000.000=6000.000 lekë.

Kemi sqaruar më sipër, disa herë, se shuma e sigurimit nuk mund të jetë kurrë më e madhe se vlera e pasurisë së siguruar, ajo mund të jetë ose e barabartë me vlerën e pasurisë së siguruar ose më e vogël se vlera e pasurisë së siguruar. **Në rastin kur shuma e sigurimit është e barabartë me vlerën e pasurisë së siguruar, atëherë themi se kemi të bëjmë me sigurim të plotë të pasurisë, ndërsa në rastin kur shuma e sigurimit është më e vogël se vlera e pasurisë së siguruar jemi para sigurimit të pjesshëm të pasurisë.**

Në Kodin Civil parashikohet se në rastet kur ndodhemi para sigurimit të pjesshëm të pasurisë, shpërblimi i dëmit i cili shërben si shumë sigurimi, caktohet në përpjestim me raportin midis shumës së sigurimit dhe vlerës së pasurisë së siguruar, me përjashtim të rasteve kur palët në kontratë kanë parashikuar ndryshe. Në këtë rast shuma e sigurimit që do t'i paguhet të siguruarit, është në përpjestim me vlerën e pasurisë së siguruar, në kuptimin që sa më e madhe të jetë vlera e pasurisë së siguruar, aq më e madhe do të jetë shuma e sigurimit dhe anasjelltas.

Për shembull në rast se jemi para një kontrate sigurimit të një pasurie, e cila ka një vlerë prej 9.000.000 lekësh dhe i siguruari e siguron këtë pasuri pjesërisht për një vlerë prej 6.000.000 lekësh dhe ndodh ngjarja e sigurimit duke i shkaktuar një dëm të siguruarit në pasurinë e siguruar me vlerë 3.000.000 lekë, atëherë vlera që siguruari do të paguajë është në përpjestim me raportin midis shumës së sigurimit, e cila në rastin konkret është 6.000.000 lekë dhe vlerës së pasurisë së siguruar, e cila në këtë rast është 9.000.000 lekë. Shuma konkrete që do të paguajë siguruari në këtë rast është 2.000.000 lekë për faktin se përderisa pasuria është siguruar vetëm për 2/3 e vlerës së saj (2/3 e 9.000.000=6.000.000) edhe shuma e sigurimit do të jetë e barabartë me 2/3 e vlerës së dëmit të shkaktuar (2/3 e 3.000.000=2000.000 lekë).

c) E drejta e siguruarit që ka paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, që të kërkojë kthimin e shumës së paguar, nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Siguruari nga kontrata e sigurimit të pasurisë i rrjedhin jo vetëm detyrime, por edhe të drejta. Një nga të drejta është e drejta e siguruarit që në rastet që ai ka paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personi ose personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit të siguruarit.⁴⁷ Në mënyrë që siguruari të kërkojë kthimin e shumës nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit të siguruarit, është e domosdoshme që ai të ketë paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit. Vetëm pasi siguruari të ketë paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, atij i lind e drejta që të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Shuma që ka të drejtë të kërkojë siguruari ndaj personit të tretë përgjegjës për shkaktimin e dëmit, është e barabartë me shumën që siguruari ka paguar në favor të të siguruarit si shpërblim të sigurimit, plus edhe vlerën e shpenzimeve të ndryshme, ku përfshihen edhe ato gjyqësore, nëse ka patur të tilla, që kanë qenë të nevojshme për përcaktimin e vlerës së shpërblimit të sigurimit. Në këtë rast është e domosdoshme që shpërblimi i sigurimit i paguar nga siguruari, në favor të të siguruarit, të ketë ardhur si rrjedhojë e ndodhjes së një ngjarje sigurimi të parashikuar në kontratë, dhe jo të çdo lloj ngjarje dhe dëmi të jetë shkaktuar nga të tretët, në mënyrë që siguruari t'i drejtohet personit përgjegjës për shkaktimin e dëmit, për kthimin e shumës së paguar prej tij në favor të të siguruarit, si shpërblim të sigurimit.

⁴⁷ Neni 1142 i Kodit Civil në fuqi përcakton: "Siguruari që ka paguar shpërblimin e sigurimit ka të drejtë që të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit".

Kur dëmi është shkatuar nga persona të tretë me anë të veprimeve të kryera me faj prej tyre, veprime të cilat përbëjnë nga ana e tyre, një nga rastet e sigurimit të parashikuar në kontratë, siguruesi është i detyruar që t'i shpërblejë këtë dëm të siguruarit si shpërblim sigurimi dhe më pas t'i drejtohet personave të tretë për kthimin e kësaj shume të paguar në favor të të siguruarit për faj të këtyre personave. Kërkohet domosdoshmërisht që veprimi i personave të tretë që kanë shkaktuar dëmin të përbëjë një nga rastet e sigurimit të parashikuar në kontratë, pasi në të kundërt, në qoftë se veprimi i personave të tretë nuk futet në një nga rastet e parashikuara nga palët në kontratë si ngjarje e sigurimit, siguruesi nuk është i detyruar që t'i paguajë shpërblimin e sigurimit të siguruarit.

Kur veprimi i të tretëve i cili shkakton dëm në pasurinë e siguruar, kategorizohet në një nga ngjarjet e sigurimit të parashikuar në kontratë, siguruesi nuk mund të pretendojë së nuk do të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, me arsyetimin se ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga veprime me faj të personave të tretë dhe i siguruari t'ua kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar personave të cilët kanë shkaktuar këtë dëm. Në këtë rast siguruesi është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit dëmin e pësuar si shpërblim sigurimi dhe ka të drejtë që po në bazë të kësaj dispozite t'i drejtohet me padi këtyre personave për kthimin e shumës së paguar të siguruarit për faj të tyre.

Le ta konkretizojmë me një shembull konkret, të drejtën e siguruesit për të kërkuar kthimin e shumës së paguar të siguruarit, nga personi i cili është përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Ta zëme se personi L.T ka siguruar produktet e tij bujqësore nga përmbytjet, ngricat dhe breshëri. Në kohën që kontrata e sigurimit është në zbatim, pra, gjatë periudhës së sigurimit, personi C.F i cili ka në pronësi një rezervuar vaditës, ngjitur me pronat e personit L.T, si pasojë e veprimeve nga pakujdesia të personit C.F, rezervuari shpërthen dhe për pasojë përmbyten produktet bujqësore të personit A. Në këtë rast siguruesi është i detyruar që t'i paguajë shpërblimin e sigurimit personit L.T, pasi ka ndodhur ngjarja e sigurimit, e parashikuar në kontratë edhe pse kjo ka ndodhur për faj të personave të tretë. Në këtë rast, pas pagimit të shpërblimit të sigurimit ndaj personit L.T, siguruesi ka të drejtë që t'i kundrejtohet personit C.F si person përgjegjës për shkaktimin e dëmit, për kthimin e shumës së paguar për faj të tij, në favor të personit L.T.

Siguruesi nuk do të detyrohet që të paguante shpërblimin e sigurimit në shembullin e dhënë më sipër, në favor të personit L.T, në rast se dëmi do të shkatohej mbi produktet bujqësore të këtij personit, si pasojë e hyrjes së bagëtisë së personit C.F, të cilat shkatërrojnë të gjitha produktet bujqësore të personit L.T. Kjo për faktin se në rastin e dhënë më lart dëmtimi apo shkatërrimi i produkteve bujqësore nga veprimet e kafshëve apo bagëtive, nuk është parashikuar në kontratë si një nga ngjarjet e sigurimit. Duke qenë se dëmi i shkaktuar personit L.T nga personi C.F nuk është shkaktuar nga veprime të cilat kategorizohen në një nga ngjarjet e sigurimit të parashikuar në kontratë, siguruesi nuk është i detyruar që t'i paguajë shpërblimin e sigurimit personit L.T. Në këtë rast personi L.T ka të drejtë që t'i drejtohet me padi për shpërblim dëmi konform neneve 608 e 640 të Kodit Civil, personit C.F dhe nuk mund të kërkojë shpërblimin e sigurimit nga siguruesi, duke u bazuar në kontratën e sigurimit të lidhur midis tyre.

d) E drejta e siguruesit që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit në rast se ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të të siguruarit.

Në pikën "c" të kësaj çështjeje sqaruar se siguruesi ishte i detyruar që të paguante shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit shkatohej nga personat e tretë dhe më pas siguruesi kishte të drejtë që t'u drejtohej këtyre personave për kthimin e shumës së paguar në favor të të siguruarit për faj të tyre. Kodi Civil ka përcaktuar nga ana tjetër se, **siguruesi ka të drejtë që të shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të**

siguruesit, në qoftë se ngjarja e sigurimit apo rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të të siguruarit ose me dashje ose pakujdesi të rëndë të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata.⁴⁸ Në rast se ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga veprime të kryera me dashje ose pakujdesi të rëndë të të siguruarit, siguruesi nuk është i detyruar që të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të të siguruarit, duke mos paguar shpërblimin e sigurimit, përderisa ky dëm është shkaktuar nga veprimet e kryera me faj të të siguruarit.

Kjo dispozitë në veprimet me faj të të siguruarit përfshin veprimet e kryera **me dashje dhe nga pakujdesia e rëndë**, duke futur një koncept të ri në krahasim me konceptin e fajit që përdor e drejta penale dhe që është koncepti i **pakujdesisë së rëndë**. Këtë term e kemi hasur edhe në dispozita të tjera që rregullojnë kontratën e sigurimit të pasurisë, prandaj çmoj me vend të sqaroj se çduhet kuptuar me termin pakujdesi të rëndë. Për të sqaruar se ç' duhet kuptuar me pakujdesi të rëndë duhet të kemi parasysh se e drejta civile konceptin e fajësisë e merr nga e drejta penale, ku siç dihet në nenin 14/2 të Kodit Penal përcaktohet koncepti i fajësisë duke parashikuar se quhet me faj personi që kryen veprën me dashje ose me pakujdesi.

Në dispozitat e tjera të Kodit Penal si dhe nga shkenca e të drejtës penale forma e fajësisë “dashja” ndahet në; dashje direkte dhe indirekte, ku jepet dhe kuptimi i secilës prej tyre, ndërsa “pakujdesia”, ndahet në pakujdesi në formën e vetëbësimit të tepruar dhe të neglizhencës, duke u përcaktuar po ashtu kuptimi i secilës prej tyre.

Koncepti i pakujdesisë së rëndë që përdor e drejta civile nuk ka të bëjë me anën subjektive dhe qëndrimin psikik dhe të vullnetit që mban personi ndaj veprimit që kryen dhe pasojave që vijnë, të cilat janë aq të rëndësishme për të drejtën penale, por me anën e jashtme të veprimit dhe me sasinë e pasojave të ardhura, si dhe me mënyrën se si reagon personi për parandalimin apo pakësimin e këtyre pasojave. Kështu në konceptin e pakujdesisë së rëndë të përdorur nga e drejta civile, sa më e madhe të jetë sasia e dëmit të ardhur, si pasojë veprimit të kryer prej personit dhe, sa më i pakujdeshëm që tregohet ai për parandalimin e dëmit ose në pakësimin e tij, aq më e madhe është fajësia e personit.

Kështu një person do të konsiderohet se vepron me pakujdesi të rëndë, sipas kuptimit që i jep e drejta civile, në rast se nga veprimi i tij ka ardhur një sasi e madhe dëmi, si dhe në rast se ky person ka treguar një shkallë të madhe mosinteresimi në parandalimin e këtij dëmi, ose në pakësimin e vlerës së tij. Në të kundërt në rast se nga veprimi i personit vjen një sasi e vogël dëmi, si dhe shkalla e mosinteresimit të personit për parandalimin e dëmit ose pakësimin e tij është e vogël, në këtë rast jemi para pakujdesisë së lehtë.⁴⁹

Në kuptim të Kodit Civil, siguruesi shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar shpërblimin e sigurimit, në qoftë se ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të të siguruarit. Në qoftë se **ngjarja e sigurimit është shkaktuar me pakujdesi të lehtë apo pa faj të të siguruarit, siguruesi nuk shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit.**

Arsyeja pse ligji ka parashikuar që siguruesi nuk shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, kur ngjarja e sigurimit shkaktohet nga pakujdesia e lehtë e të siguruarit, ka të bëjë me faktin se ngjarja e sigurimit si rregull ndodh në mënyrë të papritur dhe pa paralajmërim, kështu që është e lejueshme, nga e drejta (ligji) një farë mungese

⁴⁸ Paragrafi i parë i nenit 1143 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “*Siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e dëmit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose e personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit*”.

⁴⁹ Për më tepër në lidhje me dallimet ndërmjet termave “pakujdesi e rëndë dhe pakujdesi e lehtë”, shih tek: Semini, Marjana; “*E drejta e detyrimeve dhe kontratatave*”, Tiranë 2002, faqe 214.

vëmëndjeje nga ana e të sigurvearit dhe një shkallë shpërqëndrimi e tij, si pasojë e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Kjo për faktin se i sigurveari nuk ka qenë më parë i përgatitur për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, dhe në këto kushte e drejta justifikon një mungesë vëmëndjeje minimale, në veprimet e tij dhe për pasojë e detyron sigurvearin që kur i sigurveari e shkakton rastin e sigurimit me pakujdesi të lehtë, ai është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të sigurvearit.

Në ligj është përcaktuar se **për kontratat e sigurimit të cilat kanë si objekt sigurimin e pasurisë së personave fizikë, sigurveari shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të sigurvearit.** Ky përcaktim është bërë për faktin se kur jemi para pasurisë së personit fizik, kjo pasuri mund të administrohet edhe nga anëtarë të tjerë madhorë të familjes së të sigurvearit, prandaj në ligj është përcaktuar se kur ngjarja e sigurimit shkaktohet me dashje ose pakujdesi të rëndë të këtyre pjestarëve madhorë të familjes së të sigurvearit, sigurveari shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit.

Në lidhje me faktin se cilët do të konsiderohen anëtarë madhorë të familjes, do të duhet t' i referohemi Kodit tek Familjes, i cili përcakton si rregull se kush janë personat që përfshihen brenda një familjeje. Nga dispozitat e Kodit të Familjes nuk gjejmë ndonjë dispozitë të shprehur që të përcaktojë se cilët persona konsiderohen si anëtarë të një familje, por nisur nga kuptimi i një numri të madh dispozitash të Kodit të Familjes, mund të konkludojmë se si anëtarë të një familjeje konsiderohen bashkëshortët, fëmijët e tyre, si edhe prindërit apo vëllezërit dhe motrat, në rast se plotësojnë kushtin që jetojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme së bashku me të sigurvearin, në një ekonomi të përbashkët dhe në një banesë të përbashkët.

Në lidhje me kuptimin e termit “anëtarë madhorë të familjes”, ky është më i thjeshtë për të kuptuar, si të tillë do të konsiderohen të gjithë anëtarët e familjes së të sigurvearit që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Si përfundim mund të themi se në të gjitha rastet kur ngjarja e sigurimit shkaktohet me dashje ose pakujdesi të rëndë të anëtarëve mbi 18 vjeç të familjes së të sigurvearit, në rastet kur kemi të bëjmë me sigurimin e pasurisë së personave fizikë, sigurveari shkarkohet nga detyrimi për pagimin e shpërblimit të sigurimit në favor të të sigurvearit.

Në Kodin Civil është përcaktuar se **sigurveari shkarkohet nga përgjegjësia për pagimin e shpërblimit të sigurimit edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga veprimet e kryera me dashje ose pakujdesi të rëndë të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, në rastet kur kontrata e sigurimit të pasurisë është lidhur në dobinë e personit të tretë.** Në rastet kur kontrata e sigurimit të pasurisë është lidhur në dobi të personit të tretë, personi i tretë është në të njëjtën pozitë si i sigurveari, përballë sigurvearit dhe në rast se ngjarja e sigurimit shkaktohet si pasojë e veprimeve të kryera me dashje ose pakujdesi të rëndë të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, sigurveari shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar shpërblimin e sigurimit.

Kjo për faktin se sigurveari nuk mund të detyrohet të paguajë shpërblimin e sigurimit për veprime të kryera me dashje ose pakujdesi të rëndë nga ana e personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata. Në rast se ngjarja e sigurimit ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së lehtë të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, sigurveari është i detyruar si në rastin kur ndodhet përballë të sigurvearit, që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të personit të tretë.

Në ligj nuk është parashikuar në mënyrë të qartë, nëse në rastet kur kemi të bëjmë me një kontratë të sigurimit të pasurisë, të lidhur në dobi të personit të tretë, sigurveari shkarkohet nga përgjegjësia për pagimin e shpërblimit të sigurimit, vetëm kur ngjarja e sigurimit shkaktohet nga personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, apo sigurveari shkarkohet nga kjo përgjegjësi edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit shkaktohet, nga personi i sigurvearit, i cili ka lidhur kontratën në

dobi të personit të tretë. Në këto raste jam i medimit se siguruasi do të shkarkohet nga përgjegjësia për pagimin e shpërblimit të sigurimit vetëm në rastin kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, ndërsa kur ngjarja e sigurimit shkaktohet nga i siguruari që ka lidhur kontratën në dobi të personit të tretë, me dashje ose pakujdesi të rëndë, siguruasi duhet të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata dhe më pas t'i drejtohet të siguarit që ka lidhur kontratën në dobinë e personit të tretë, për kthimin e shumës së paguar për faj të tij, konform nenit 1142 të Kodit Civil. Kjo për faktin se pavarsisht se i siguruari i cili ka lidhur kontratën e sigurimit të pasurisë, në dobinë e personit të tretë, është palë në kontratën e sigurimit, shpërblimi i sigurimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, do t'i paguhet personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, **prandaj pozita e të siguarit në këtë rast është e njëjtë me atë të çdo personi tjetër që është i huaj dhe nuk ka asnjë lidhje me siguruasin, përse i përket pagimit të shpërblimit të sigurimit, personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata.**

Mund të ndodhë që për të të njëtin rrezik ose rast sigurimi, për një pasuri të caktuar, i siguruari të ketë lidhur në mënyrë të veçantë disa kontrata sigurimi, në sigures të ndryshëm. Në këtë rast ligji ka parashikuar që i siguruari është i detyruar që të njoftojë secilin sigures për të gjitha sigurimet e bëra prej tij mbi këtë pasuri.⁵⁰ Në qoftë se i siguruari me qëllim nuk njofton çdo sigures për secilën kontratë sigurimi, siguresit nuk janë të detyruar që të paguajnë shpërblimin e dëmit. Kështu për shembull, në rast se personi E.S me cilësinë e të siguarit, ka siguruar me datë 12.03.2005 banesën e tij nga zjarri pranë shoqërisë sigures B, dhe me datë 12.04.2005 po këtë banesë e siguron nga zjarri, pranë shoqërisë sigures C, dhe me datë 12.05.2005 të njëtin banesë e siguron nga i njëti rrezik pranë shoqërisë sigures D, personi E.S, duhet që të njoftojë siguresit C dhe D për sigurimet që ka bërë për të njëtin objekt dhe për të njëtin rrezik, më parë, në të kundërt shoqëritë sigures nuk janë të detyruar që të paguajnë shpërblimin e sigurimit, në rast se ndodh ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë.

Në rastet kur vertetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari është i detyruar që të njoftojë të gjithë siguresit, duke i treguar çdo siguresi emrin dhe adresën e plotë të secilit sigures tjetër. I siguruari në këtë rast ka të drejtë që të kërkojë nga secili sigures shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, **por, gjithësesi shumat e shlyera nga një ose disa apo të gjithë siguresit së bashku, nuk mund të kalojnë shpërblimin e sigurimit të përcaktuar në kontratë.** Për shembull në rast se personi i mësipërm E.S ka siguruar banesën e tij nga zjarri në tre sigures B, C dhe D, për një shumë sigurimi prej 5.000.000 lekësh, ai ka të drejtë që të kërkojë shumën e 5.000.000 lekëve nga secili prej siguresve veç e veç ose edhe ndaj të treve së bashku, por shpërblimi maksimal i sigurimit që mund të marrë ai nuk mund ta kalojë vlerën 5.000.000 lekë.

Nga ky parashikim që bën ligji, rezulton se në këtë rast **përgjegjësia e siguresve për të paguar shpërblimin e sigurimit përballë të të siguarit, është përgjegjësi solidare.** Një gjë e tillë rezulton në mënyrë më të qartë në Kodin Civil, në të cilin përcaktohet se siguresi që ka paguar shumën e dëmit, për llogari të siguresve të tjerë, ka të drejtën e regresit ndaj këtyre siguresve për ndarjen e shumës së detyruar që përbën shpërblimin e sigurimit të paguar sipas kontratave respektive të lidhura me të siguarin.⁵¹ Kuptohet se një institut i tillë si e drejta e regresit është i pranishëm vetëm në detyrimet solidare dhe nga kjo rezulton se siguresit kanë përgjegjësi solidare

⁵⁰ Paragrafi i parë i nenit 1145 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Kur për të njëtin rrezik janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigures të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigures, për të gjitha sigurimet".

⁵¹ Paragrafi i parë i nenit 1146 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Siguresi që ka paguar shumën e dëmit ka të drejtën e regresit ndaj siguresve të tjerë për ndarjen e shumës së detyruar sipas kontratave përkatëse".

ndaj të siguruarit për pagimin e shpërblimit të sigurimit kur i siguruari e ka siguruar pasurinë në të njëjtën kohë në disa sigurues dhe për të njëjtat rreziqe sigurimi.

Në këtë rast siguruari i cili ka paguar plotësisht shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit, ka të drejtë të kërkojë ndaj tyre kthimin e jo të gjithë shumës së paguar prej tij, por kthimin e asaj shume që i korespondon ndarjes së shumës së detyruar midis të siguarve, sipas kontratave përkatëse, ose thënë më thjesht, siguruari që ka paguar të tërë shumën e sigurimit ka të drejtë të kërkojë nga siguruarit e tjerë, kthimin e asaj shume të cilën këta të fundit ishin të detyruar që të paguanin në favor të të siguruarit. Në rastet kur një siguruar është me paafësi paguese, pjesa që duhet të paguante ai ndahet ndërmjet sigurve të tjerë.

Për shembull, në qoftë se në bazë të kontratave të sigurimit siguruarit A, B dhe C, do të paguajnë ndaj të siguruarit një shumë prej 2.000.000 lekësh secili, dhe në rast se vertetohet se siguruari C ndodhet në paafësi paguese, atëherë shuma që do të paguante ai prej 2.000.000 lekësh do të ndahet midis sigurve A dhe B të cilët do të paguajnë në favor të të siguruarit, përveç pjesës së tyre nga 2.000.000 lekë edhe nga 1.000.000 lekë secili si pjesë e siguruarit C, duke paguar në total në favor të të siguruarit një shumë prej 3.000.000 lekësh. Kuptohet se në këtë rast siguruarit A dhe B, kanë të drejtën e regresit ndaj siguruarit C për të kërkuar shumën prej 2.000.000 lekësh të paguar në emër të tij, kurdoherë që ky siguruar të bëhet me aftësi paguese dhe, në rast se ky siguruar nuk bëhet asnjëherë i aftë për të paguar, siguruarit A dhe B e humbasin përfundimisht shumën prej 2.000.000 lekësh që kanë paguar në emër të këtij siguruari.

e) Siguruari ka përgjegjësi të veçantë për pagimin e shpërblimit të sigurimit, në rastet kur objekt i kontratës së sigurimit është sigurimi i mallrave gjatë transportit.

Në Kodin Civil në disa dispozita janë parashikuar rregulla të veçanta për rastet kur objekt i kontratës së sigurimit është **sigurimi i mallrave nga rreziqet e transportit tokësor, ujqor të brendshëm dhe ajror**. Kështu në ligj është përcaktuar se **sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportit rrugor, ujqor të brendshëm dhe ajror përfshin të gjitha llojet e dëmeve që mund të pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, pavarësisht nëse ngjarja e sigurimit që i ka shkaktuar ato, me përjashtim të rasteve kur ligji e ka përjashtuar në mënyrë të shprehur përgjegjësinë e siguruarit**.⁵²

Kjo do të thotë se në rastet kur objekt i kontratës së sigurimit është sigurimi i mallrave nga rreziqet e transportit rrugor, ujqor të brendshëm apo ajror, siguruari është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguruarit, në qoftë se ndodh dëmtimi ose shkatërrimi i mallrave **për çfarë do lloj ngjarje sigurimi**. Pra, në këtë rast siguruari është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit, pavarësisht se cili ka qenë shkaku apo cila ka qenë ngjarja konkrete e sigurimit, mjafton që të provohet fakti se mallrat janë dëmtuar ose shkatërruar gjatë transportit, me përjashtim të rasteve kur ligji e ka përjashtuar në mënyrë të shprehur siguruarin nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Kur objekt i kontratës së sigurimit është sigurimi i mallrave gjatë transportit rrugor, ujqor të brendshëm apo ajror, palët nuk përcaktojnë në kontratë se cilat do të jenë ngjarjet konkrete të sigurimit për të cilat do të përgjigjet siguruari, pra, **kush do të konsiderohet si rast i sigurimit, pasi si rast i sigurimit do të konsiderohet çdo rrethanë ose faktor që i shkatëron dëmtuesisht pasurinë gjatë transportit**. Nga ky rregull i përgjithshëm ka vetëm një përjashtim, siguruari nuk përgjigjet

⁵² Neni 1147 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “*Sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportimit tokësor, ujqor të brendshëm dhe ajror përfshin të gjitha dëmet që mund të pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, përveç kur është caktuar ndryshe në ligj*”.

për ato dëme ose ngjarje të sigurimit të cilat ndodhin gjatë transportit për të cilat ligji ka përjashtuar shprehimisht të siguruarin nga kjo përgjegjësi.

Në rastet kur ligji shprehimisht nuk e ka përjashtuar siguruesin nga rreziqe apo ngjarje të veçanta, siguruesi përgjigjet për dëmtimin e mallrave gjatë transportit, jo vetëm kur një gjë e tillë ka ndodhur për faj të tij, por, edhe në rastet kur ato janë shkaktuar nga rasti faktor ose forca madhore.⁵³ Le ta konkretizojmë këtë përgjegjësi të siguruesit me nga një shembull të thjeshtë për secilin nga llojet e transportit që ka parashikuar Kodit Civil.⁵⁴

Kështu në rastin e transportit tokësor të mallrave, në rast se mallrat pasi i janë dorëzuar transportuesit, shkatërrohen si pasojë e përmblyetjes, e cila përbën forcë madhore, ose humbasin gjatë kohës që shoferi po ecte në rrugën automobilisike, pasi shembet një pjesë e rrugës në atë moment, duke u shkatërruar makina dhe mallrat, e cila përbën po ashtu forcë madhore, siguruesi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguruarit. Në rastin e transportit ujor të brendshëm, në rast se mallrat humbasin si pasojë e mbytyes së anijes për shkak të dallgëve të mëdha dhe të paparashikuara, çka sigurisht që përbën forcë madhore, siguruesi përgjigjet para të siguruarit për shpërblimin e dëmit, ose në rastin e transportit ajror, në qoftë se mallrat humbasin si pasojë e goditjes nga rrufeja të avionit, i cili përsëri përbën forcë madhore, siguruesi është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit ndaj të siguruarit.

Në Kodin Civil për shkak të rëndësisë së madhe që ka përcaktimi i momentit kur hyn në fuqi **kontrata e sigurimit, e cila ka për objekt sigurimin e mallrave kundër rreziqeve të transportit**, është përcaktuar se kjo kontratë **hyn në fuqi që nga çasti që mallrat i janë dorëzuar transportuesit dhe vazhdon derisa këto mallra t'i dorëzohen pritësit, më përjashtim të rasteve kur palët në kontratë kanë parashikuar ndryshe.**⁵⁵ Kjo do të thotë se si rregull përgjegjësia e siguruesit në rastin kur objekt i kontratës, është sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportit, fillon që nga momenti që këto mallra i dorëzohen transportuesit dhe vazhdon deri në momentin që transportuesi ia dorëzon këto mallra pritësit. Për gjatë gjithë kësaj kohe dhe për çdo ngjarje apo shkak, siguruesi është përgjegjës ndaj të siguruarit për pagimin e shpërblimit të sigurimit në rast se mallrat dëmtohen.

Siç shihet nga përmbajtja, kjo dispozitë është me karkater lejues në kuptimin që palët mund të parashikojnë edhe ndryshe në kontratë. Ky parashikim ndryshe i palëve me vullnetin e tyre i referohet jo llojit të ngjarjes apo shkakut për të cilat do të përgjigjet siguruesi, pasi një parashikim të tillë mund ta bëjë vetëm ligji, por i referohet periudhës se kur mund të hyjë në fuqi kontrata e sigurimit apo periudhës sa mund të zgjasë përgjegjësia e transportuesit. Për shembull, palët me marrëveshje mund të parashikojnë që kontrata e sigurimit në këtë rast hyn në

⁵³ Si **rast faktor** nga doktrina e të drejtës civile është konsideruar ajo ngjarje, ajo rrethanë e cila nuk mund të parashikohet, të ndalet apo të mënjanohet me përkujdesjen normale të një njeriu të zakonshëm.

Si **forcë madhore** është konsideruar ajo ngjarje apo rrethanë e cila nuk mund të parashikohet e as të parandalohet edhe me vemendjen maksimale dhe përkujdesin maksimal qoftë edhe të një njeriu me aftësi të jashtëzakonshme, domethënë, çdo ngjarje e cila është jashtë mendjes dhe vullnetit njerëzor.

⁵⁴ Të bie në sy fakti se neni 1147 i Kodit Civil ka parashikuar një përgjegjësi të tillë për siguruesin vetëm për rreziqet e transportit tokësor, ujor të brendshëm dhe ajror dhe nuk ka përfshirë rreziqet që vijnë nga transporti ujor ndërkombëtar nga njëri shtet në tjetrin apo nga njëri kontinent në tjetrin. Mendoj se ky fakt nuk është një harresë e ligjvënësit, por një zgjedhje e drejtë e tij, pasi në transportin ujor ndërkombëtar rreziqet që mund të vijnë gjatë transportit janë të shumta dhe të mëdha dhe ngarkimi me një përgjegjësi të tillë e siguruesit, do të përbente një detyrim të rëndë dhe të padrejtë për të, krahasuar me detyrimet e të siguruarit.

⁵⁵ Neni 1148 të Kodit Civil në fuqi në fuqi përcakton: *“Kontrata e sigurimit të mallrave kundër rreziqeve të transportimit hyn në fuqi që nga çasti që mallrat i janë dorëzuar transportuesit dhe vazhdon gjer sa këto t'i dorëzohen pritësit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe”*.

fuqi, jo në momentin që mallrat i dorëzohen transportuesit, por në momentin që transportuesi fillon transportimin e tyre, ose mund të parashikojnë që përgjegjësia e transportuesit zgjat jo deri sa mallrat t'i dorëzohen pritësit, por, pasi është bërë vetëm transportimi i tyre.

Në Kodin Civil janë përcaktuar edhe detyrime për pritësin e mallit, detyrime të cilat janë të kombinuara midis kontratës së transportit dhe kontratës së sigurimit të mallrave gjatë transportit si kontrata të lidhura midis tyre.⁵⁶ Kështu sipas kësaj dispozite pritësi i mallrave është i detyruar që të hartojë një procesverbal për marrjen në dorëzim të mallrave në të cilin duhet të pasqyrojë me hollësi dëmtimet e mundshme që mund t'u kenë ndodhur mallrave gjatë transportit. Në rast se mallrat e transportuara merren në dorëzim nga pritësi pa u mbajtur procesverbali i mësipërm, siguruesi nuk përgjigjet për dëmtimin ose mungesën e mallrave, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj.

⁵⁶ Neni 1149 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kur mallrat e transportuara merren në dorëzim nga pritësi pa u mbajtur në këtë rast procesverbal, siguruesi nuk përgjigjet për dëmtimin ose mungesën e mallrave, përveç kur është parashikuar ndryshe në ligj”.

Kapitulli 3.

Kontrata e sigurimit të personit.

Përveç sigurimit të pasurisë, Kodi Civil në dispozitat që lidhen me kontratën e sigurimit, rregullon edhe sigurimin e personit, për pasojë edhe kontrata e sigurimit të personit do të jetë objekt trajtimi nga ana jonë. Para se të filloj me trajtimin e kësaj kontrate duhet të them, në parantezë, se ato çfarë janë thënë në lidhje me **veçoritë e kontratës së sigurimit të pasurisë vlejné edhe për kontratën e sigurimit të personit** dhe për arsye mospërsëritje nuk do të trajtohen tek kontrata e sigurimit të personit. Po ashtu edhe **trajtimi që është bërë në lidhje me subjektet e kontratës së sigurimit të pasurisë, vlen edhe për subjektet e kontratës së sigurimit të personit**, pasi në këtë rast vlejné të njëtat parashikime dhe rregulla ligjore dhe po për arsye të mospërsëritjes nuk do të trajtohet përsëri.

Veç kësaj, edhe pjesa më e madhe e atyre që është thënë dhe trajtuar në lidhje me **përmbajtjen e kontratës së sigurimit të pasurisë, pra, me të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë, vlen edhe për kontratën e sigurimit të personit**, pasi edhe në rastin e sigurimit të personit, palët kanë pothuajse të njëtat të drejta dhe detyrime kryesore, me disa përjashtime të vogla, të cilat do të jenë objekt i këtij trajtimi. Për këtë arsye edhe lidhur me përmbajtjen e kontratës së sigurimit të personit nuk do të trajtohen ato të drejta dhe detyrime të cilat janë shumë të rëndësishme, por, që janë të njëta me kontratën e sigurimit të pasurisë, por, do të trajtoj vetëm veçoritë dalluese të përmbajtjes së kontratës së sigurimit të personit, të cilat janë karakteristike vetëm për këtë kontratë.

Në këto kushte është e logjikshme që volumi i trajtimit të kontratës së sigurimit të personit, të jetë më i vogël se ai e trajtimit të kontratës së sigurimit të pasurisë, sepse një pjesë e rëndësishme e çështjeve të cilat do të trajtoheshin tek kontrata e sigurimit të personit, janë të njëta me kontratën e sigurimit të pasurisë dhe janë trajtuar kur është folur për kontratën e sigurimit të pasurisë. Pavarsisht nga kjo, në trajtimin që do t'i bëhet kontratës së sigurimit të personit, do të përpiqem që të jap elementët më të rëndësishëm dhe specifik të kësaj kontrate duke u përpjekur që të ndriçoj edhe ndonjë dispozitë të "errët" të Kodit Civil që ka të bëjë me rregullimin e kësaj kontrate.

3.1. Subjektet e kontratës së sigurimit të personit.

Ashtu si dhe tek kontrata e sigurimit të pasurisë, edhe tek kontrata e sigurimit të personit, subjektet ose palët në këtë kontratë janë dy: **siguruesi** dhe **i siguruari**. Në lidhje me siguruesin, cilësitë e siguruesit në kontratën e sigurimit të personit, janë të njëjta me ato të siguruesit, tek kontrata e sigurimit të pasurisë dhe duke qenë se për cilësitë e siguruesit në kontratën e sigurimit të personit, vlejné të gjitha ato çfarë këmi thënë për siguruesin tek kontrata e sigurimit të pasurisë, nuk do të ndalemi fare për të sqaruar pozitën dhe cilësitë e tij në këtë kontratë. Në këtë rast do të mjaftohemi duke thënë se **si sigurues në kontratën e sigurimit të personit mund të jetë çdo person juridik vendas apo i huaj, i cili plotëson kushtet e parashikuara nga legjisalcioni shqiptar në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.**

Pala tjetër në këtë kontratë është **i siguruari**. I siguruari në kontratën e sigurimit të personit paraqet disa specifika dalluese në krahasim me të siguruarin tek kontrata e sigurimit të pasurisë, prandaj do të ndalemi për ta sqaruar me më hollësi cilësitë dhe statusin e tij në kontratën e sigurimit të personit. Kështu dallimi i parë midis të siguruarit si palë në kontratën e sigurimit të personit, në krahasim me kontratën e sigurimit të pasurisë, qëndron tek rrethi i subjekteve. Ndërsa **tek kontrata e sigurimit të personit, si palë e siguruar mund të paraqitet vetëm personi fizik, shtetas shqiptar apo i huaj, apo pa shtetësi, në kontratën e sigurimit të pasurisë si palë e siguruar**

mund të jetë jo vetëm personi fizik shqiptar apo i huaj, por edhe personi juridik vendas apo i huaj, madje edhe vetë shteti shqiptar, i përfaqësuar nga organet e tij, në varësi të pasurisë që mund të sigurohet.

Jo vetëm aq, por, **në dispozitat nënligjore është përcaktuar se jo të gjithë personat fizikë mund të sigurojnë veten e tyre nga aksidentet personale, domethënë, jo të gjithë personat fizikë janë të aftë që të lidhin kontratën e sigurimit personal në emër dhe në favor të tyre.** Kështu sipas këtyre dispozitave nënligjore, nuk mund të dalin si të siguruar në kontratën e sigurimit të personit këto persona:

a) Personat që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi ose sëmundje mendore të pashërueshme si skizofrenia, psikozat manjako-depresive, gjendjet paranoiake apo sindromat organike cerebrale. Përfshihet i këtyre personave nga e drejta për të dalë si të siguruar në kontratën e sigurimit të personit, ka të bëjë me pamundësinë e tyre objektive për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryejnë, si dhe me pamundësinë e tyre për tu kujdesur normalisht për jetën dhe shëndetin e tyre.

b) Personat të cilët kërkojnë kujdes të përhershëm shëndetësor. Në këtë kategori personash futen invalidët e grupit të parë, si për shembull, paraplegjikët, tetraplegjikët, të verbërit etj, të cilët janë persona të cilët kërkojnë në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme kujdesin e një personi tjetër. Përfshihet i këtyre personave nga e drejta për të dalë si të siguruar, lidhet me problemet e tyre shëndetësore, të përhershme dhe me rrezikun më të madh që u kanoset atyre në lidhje me shëndetin dhe jetën, për shkak të sëmundjes anatomo-fizike që ata kanë.

c) Personat të cilët kanë arritur moshën 70 vjeç. Përfshihet i kësaj kategorie personash nga mundësia për të dalë si të siguruar kuptohet se lidhet me moshën e madhe të tyre dhe më faktin se në këtë moshë, shtohen në mënyrë të vazhdueshme problemet shëndetësore dhe mjekësore të tyre. Në rast se një person ka lidh një kontratë sigurimi personal, kur ka qenë nën 70 vjeç, me arritjen e moshës 70 vjeç, kontrata e sigurimit do të jetë në fuqi, deri në mbarimin e periudhës së sigurimit të përcaktuar në kontratë. Për shembull, në rast se personi D.V me datë 02.02.2005, lidh një kontratë sigurimi personal me afat një vjeçar dhe ky person me datë 02.04.2005 mbush 70 vjeç, kontrata e sigurimit do të vazhdojë deri me datë 19.02.2006 kur mbaron afati i saj, sipas marrëveshjes së përcaktuar nga palët dhe nuk do të mbaroj me datë 02.04.2005, kur personi A arrin moshën 70 vjeç.

c) Personat të cilët nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Edhe kjo kategori personash përfshihet nga e drejta për të dalë si të siguruar për shkak të moshës së tyre të mitur, pasi janë të paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryejnë. Megjithatë, personat e moshës 16-18 vjeç, mund të dalin si të siguruar në kontratën e sigurimit të personit, në rast se ata janë në mardhënie pune sipas ligjit. Kjo e drejtë që u njihet këtyre personave ka të bëjë me faktin se përderisa këto persona janë në mardhënie pune, ata kanë mundësi që të nxjerrin vetë të ardhura, si dhe nga mardhëniet e punës përfitojnë një sërë të drejtash dhe detyrimesh, një prej të cilave është dhe e drejta për t'u siguruar nga aksidentet në punë, por edhe nga të gjitha llojet e aksidentëve të tjera sipas ligjit.

Po ashtu, mund të jenë si të siguruar në kontratën e sigurimit të personit edhe personat që nuk kanë arritur moshën 18 vjeç, por që kanë lidhur martesë ligjore me autorizim të gjykatës, qoftë djali ose vajza para kësaj moshe. Në një konkluzion të tillë arrihet, duke u nisur nga fakti se përderisa sipas ligjit me anë të martesës, djali ose vajza nën 18 vjeç fitojnë zotësi të plotë për të vepruar, kjo

zotësi e plotë për të vepruar nënkupton edhe të drejtën që ato kanë për të lidhur kontratë të sigurimit të personit.⁵⁷

Në Kodin Civil është përcaktuar se kontrata e sigurimit të personit mund të lidhet edhe duke siguruar jetën apo shëndetin e një personi të tretë.⁵⁸ Në këtë rast caktimi i personit të tretë mund të bëhet ose nga palët në kontratën e sigurimit, ose me një deklaratë me shkrim, të mëvonshme ose edhe me anë të testamentit. Nga kjo dispozitë rezulton se tek kontrata e sigurimit të personit, lejohet lidhja e kontratës në dobi të personit të tretë, ashtu siç lejohet edhe tek kontrata e sigurimit të pasurisë dhe kjo përbën një nga të përbashkëtat e shumta midis tyre. Kjo dispozitë përcakton se tek kontrata e sigurimit të personit, kjo kontratë mund të lidhet në dobi të një personi të tretë, në një nga këto mënyra:

Së pari: Me anë të përcaktimit të emrit të personit të tretë në dobinë e të cilit lidhet kontrata në kontratën e sigurimit. Kjo është mënyra e zakonshme e lidhjes së kontratës së sigurimit personal, në dobi të një personi të tretë, ku pala e siguruar deklaron se me anë të kësaj kontrate, siguron jo jetën apo shëndetin e tij, por jetën dhe/ose shëndetin e një personi të tretë, duke shënuar emrin e personit të tretë, në dobinë e të cilit lidhet kontrata, në kontratën e sigurimit.

Së dyti: Me anë të një deklaratë me shkrim të mëvonshme të cilën i siguruari ia drejton siguresit. Në këtë rast kontrata e sigurimit personal në dobinë e personit të tretë, merr fuqi juridike në momentin që deklarimi me shkrim i të siguarit, i arrin siguresit dhe ky i fundit është dakort për të lidhur këtë kontratë.

Së treti. Me anë të testamentit. Kjo përbën një rast specifik të lidhjes së kontratës së sigurimit në dobinë e personit të tretë dhe kjo kontratë fillon të sjellë pasoja juridikë vetëm pas vdekjes së testamentlënësit dhe pas çeljes së dëshmisë testamentare. Për shembull, personi L.R me datë 12.10.2003 harton një testament me anë të të cilit ndër të tjera përcakton se një pjesë e pasurisë së tij pas vdekjes do të shërbeje për të siguruar jetën e personit të tretë D.J. Me datë 12.10.2006 personi L.R vdes dhe hapet trashëgimia testamentare dhe nga ky moment e në vazhdim personi D.J ka të drejtë që të kërkojë që më një pjesë të pasurisë së personit L.R, të sigurojë jetën e tij, sipas përcaktimeve të bërë në testament.

Me ndodhjen e rastit të sigurimit të parashikuar në kontratën e sigurimit personal, në rastet kur kontrata e sigurimit është lidhur në dobinë e personit të tretë, shumica e sigurimit i paguhet jo personit që ka lidhur kontratën, por, personit të tretë në dobi të të cilit është lidhur kontrata. Kjo shumë siguri, që pas vdekjes së të siguarit, është caktuar t'i paguhet personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, sipas Kodit Civil nuk përfshihet në pasurinë trashëgimore të të siguarit.⁵⁹ Kjo do të thotë se në qoftë se vdes i siguruari, në rastin kur i siguruari ka lidhur

⁵⁷ Fjalja e parë e paragrafit të dytë të nenit 6 të Kodit Civil përcakton: “Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç”.

Me këtë rast në lidhje me këtë përcaktim që bën fjalja e parë e paragrafit të dytë të nenit 6 të Kodit Civil, nuk mund të mos lëmë pa përmendur nevojën urgjente që ka kjo fjali e ligjit për t'u përditësuar dhe për t'u harmonizuar me Kodin e Ri të Familjes të vitit 2003, i cili përcakton se martesë të ligjshme mund të lidhë për shkaqe me rëndësi dhe gjithmonë me autorizimin e gjykatës, jo vetëm gruaja që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, por, edhe djali nën këtë moshë. Për pasojë duhet të pranojmë se sipas këtij paragrafi të nenit 6 të Kodit Civil, zotësi të plotë për të vepruar fiton jo vetëm vajza, por, edhe djali kur ai martohet nën moshën 18 vjeç.

⁵⁸ Neni 1152 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “Kontrata e sigurimit është e vlefshme edhe kur sigurohet jeta e një të treti. Caktimi i personit bëhet në kontratën e sigurimit, ose me deklaratë me shkrim të mëvonshme, që i njoftohet siguresit, ose me testament”.

⁵⁹ Neni 1160 të Kodit Civil në fuqi përcakton: “Shuma e sigurimit, që pas vdekjes së të siguarit është caktuar t'i paguhet personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, nuk përfshihet në pasurinë trashëgimore të të siguarit”.

kontratë sigurimi personal në dobinë të personit të tretë, shuma e sigurimit nuk do të përfitohet nga trashëgimtarët e të siguruarit, por do t'i paguhet personit të tretë. Për shembull, në rast se personi T.C, ka lidhur një kontratë sigurimi personal në dobi të personit të tretë K.D dhe i siguruari vdes duke lënë si trashëgimtarë personat C.V, D.V, E.V dhe F.V, shuma e sigurimit nuk do të përfshihet në pasurinë trashëgimore, domethënë, nuk do të përfitohet nga trashëgimtarët e të siguruarit, por do t'i kalojë personit të tretë K.D.

3.2. Objekti i kontratës së sigurimit të personit.

Sic u trajtua më lart objekti i kontratës së sigurimit të personit është një nga elementët e rëndësishëm të kësaj kontrate, i cili dallon nga objekti i kontratës së sigurimit të pasurisë. Në lidhje me objektin e kontratës së sigurimit të personit Kodi Civil përcakton **objekt i kësaj kontrate janë ngjarjet që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguruarit.**⁶⁰ Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kontrata e sigurimit të pasurisë mund të lidhet vetëm për dy raste:

Së pari: Për ngjarje të cilat kanë të bëjnë me jetën e personit dhe në këtë rast jemi para sigurimit të jetës së personit;

Së dyti: Për ngjarje të cilat kanë të bëjnë me aftësinë për punë të të siguruarit dhe në këtë rast kemi të bëjmë me sigurimin e shëndetit të personit.

Në kontratën e sigurimit të personit, ngjarja e sigurimit quhet aksident. Kuptimin e konceptit aksident nuk e gjejmë në Kodin Civil, por e përcakton doktrina e të drejtës civile dhe në këto kushte duhet sqaruar se çduhet të kuptojmë me aksident, për efekt të kontratës së sigurimit të personit. Sipas doktrinës së të drejtës civile, por edhe mendimit të autorëve të ndryshëm me **aksident** do të kuptojmë **çdo ngjarje që ndodh për një shkak rastësor, të dhunshëm dhe të jashtëm, i cili shkakton dëmtime fizike objektivisht të vertetueshme, si pasojë e të cilave mund të vertetohet vdekja, paaftësia e përhershme apo e përkohshme në punë.**⁶¹ Nga ky përcaktim rezulton së që të ndodhemi para një aksidenti ne kuptimin e kontratës së sigurimit personal duhet të kemi një **ngjarje**, e cila duhet të plotësojë njëkohësisht këto kushte:

a) Ngjarja duhet të jetë shkaktuar nga një shkak rastësor, domethënë, nuk duhet të jetë shkaktuar në mënyrë të paramenduar, as nga i siguruari e as nga ndonjë person tjetër, por, duhet që të të shkaktohet rastësisht nga natyra ose nga ndonjë shkak tjetër, por, që është gjithmonë i rastit dhe jo e planifikuar.

b) Ngjarja duhet të jetë shkaktuar nga një shkak i dhunshëm, domethënë, që ajo të jetë shkaktuar pa vullnetin e të siguruarit apo të çdo personi tjetër.

c) Ngjarja të jetë shkatuar nga një shkak i jashtëm, domethënë, që nuk i referohet mardhënieve juridike të të siguruarit, me veten e tij apo me personat e tretë.

c) Ngjarja duhet të shkaktojë dëmtime, të cilat duhet të jenë dëmtime fizike, domethënë, dëmtime të cilat shkaktojnë pagosjen e lehtë apo të rëndë të të siguruarit apo vdekjen e tij. **Në Kodin Civil në fuqi nuk përfshihen në konceptin e aksidentit ato ngjarje të cilat shkaktojnë dëmtime morale apo psiçike.**

d) Ngjarja duhet të shkaktojë dëmtime fizike objektivisht të vertetueshme, domethënë, të cilat mund të konstatohen dhe të vertetohen nga i siguruari. Në rast se nga ngjarja të siguruarit i

⁶⁰ Neni 1150 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Kontrata e sigurimit të personit mund të lidhet për rastin e vertetimit të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguruarit".

⁶¹ Shih Mariana Semini, "E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave, (Pjesa e Posaçme)", Tiranë 2002, faqe 187.

shkaktohen dëmtime, të cilat janë objektivisht të pavartetueshme, atëherë nuk ndodhemi ligjërisht përpara një aksidenti në kuptim të Kodit Civil.⁶²

dh) Ngjarja duhet të shkaktojë vdekjen, ose paaftësinë e përhershme ose paaftësinë e përkohshme për punë të të siguruarit. Veretimi i shkaktimit të vdekjes si rregull bëhet kurdoherë me raportin përkatës të mjekut kompetent, ndërsa vertetimi i paaftësisë së përhershme apo të përkohshme të të siguruarit bëhet nga eksperti përkatës sipas rregullave ligjore.

Në Kodin Civil është përcaktuar se në kontratën e sigurimit të personit, shumica e sigurimit caktohet me marrëveshje të palëve duke respektuar dispozitat ligjore mbi sigurimet. Arsyeja pse ligjvënësi ka përcaktuar se shumica e sigurimit tek kontrata e sigurimit të personit caktohet me marrëveshje të palëve, është se siç e kemi përmendur, tek sigurimi i personit, siguruari me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit (aksidentit), nuk i shpërblehet dëmin e pësuar të siguruarit, sepse nuk mund të llogaritet në para dëmtimi i shëndetit dhe sidomos humbja e jetës së të siguruarit dhe për pasojë nuk mund të përcaktohen ndonjë vlerë konkrete e dëmit që ka pësuar i siguruari, në mënyrë që ky dëm të shpërblehet më pas nga siguruari.

Për këtë arsye ligjvënësi ka përcaktuar se, tek kontrata e sigurimit të personit, siguruari me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i paguan një shumë të caktuar të hollash të siguruarit, e cila përbën shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit dhe që caktohet me marrëveshje të palëve. Në praktikën e deritanishme në fushën e sigurimeve nga aksidentet personale, shumica e sigurimit është e përcaktuar në mënyrë të njëanshme nga siguruari dhe palës tjetër, të siguruarit nuk i mbetet gjë tjetër ose të lidhë kontratën ose të gjejë një sigures tjetër në treg për lidhjen e kontratës. Kjo tregon edhe një herë tjetër karakterin aderiv ose standart të kontratës së sigurimit në përgjithësi, sipas Kodit Civil, ku përfshihet edhe kontrata e sigurimit të personit, ku kushtet e kontratës përcaktohen nga njëra palë, që është siguruari, ndërsa pala tjetër ka vetëm të drejtë të zgjedhë nëse dëshiron apo jo të lidhë kontratën.⁶³

Në kontratën e sigurimit të personit, ngjarja apo rasti i sigurimit nuk përfshin çdo aksident, por, vetëm ato ngjarje të cilat palët përcaktojnë në kontratë, në marrëveshje midis tyre. Në përgjithësi nisur nga praktika e deritanishme në fushën e sigurimeve të personit, **sigurimi nga aksidentet personale përfshin këto raste:**

a) aksidentet që shkaktohen nga helmimi akut, si rrjedhojë e thithjes së substancave të ndryshme kimike;

b) aksidentet që shkaktohen nga mbytja;

c) aksidentet që vijnë si rrjedhojë e ngrirjes;

ç) aksidentet e shkaktuara nga dëmtime që vijnë nga sforcime fizike, më përjashtim të hernies apo infraktit;

d) aksidentet e shkaktuara nga asfiksia me origjinë patologjike;

dh) aksidentet e pësuar në gjendje sëmundje të përhershme të të siguruarit;

e) aksidentet e pësuar nga mungesa e përvojës apo e pakujdesisë së të siguruarit;

ë) aksidentet e shkaktuara nga trazirat masive apo terroriste, me kusht që i siguruari të mos jetë pjesëmarrës aktiv në to;

f) aksidentet e shkaktuara nga infeksionet që ka marrë i siguruari, si rezultat i hyrjes së trupave të infektuar nëpërmjet palgëve të shkaktuara nga aksidenti.

⁶² Personalisht mendoj se është kjo një nga arsyet pse ligjvënësi ka përjashtuar nga koncepti i aksidentit dëmtimet psiçike apo morale, pasi ato janë të vështira për t'u vertetuar objektivisht, sidomos shkalla e dëmtimit të tyre, e për pasojë ngelen dëmtime objektivisht të pavartetueshme.

⁶³ Për më tepër shiko trajtimin që është bërë në këtë punim në çështjen I.1. "Kuptimi dhe karakteristikat e kontratës së sigurimit".

Në aktet nënligjore, kryesisht rregullore të Ministrisë së Financave, është përcaktuar se edhe cilat janë ngjarjet të cilat nuk konsiderohen aksident, për efekt të ligjit dhe për pasojë nuk mbulojnë nga siguruesi. Duke iu referuar këtyre Rregulloreve si dhe praktikës së deritanishme në fushën e sigurimeve, mund të konstatojmë se kontrata e sigurimit të personit, nuk përfshin aksidentet e shkaktuara nga këto ngjarje:

a) aksidentet e shkaktuara nga drejtimi i çfarëdo mjeti motorik me motor, kur i siguruari nuk është pajisur me dëshminë përkatëse të aftësisë;

b) aksidentet e shkaktuara nga drejtimi apo bashkëdrejtimi i një mjeti motorik ose mjeti lundrimi me motor;

c) aksidentet e shkaktuara nga qëndrimi si pasagjer gjatë pjesëmarrjes së të siguarit në gara apo konkurime sportive, si dhe edhe në provat përkatëse;

ç) aksidentet e shkaktuara gjatë ushtrimit të boksit, atletikës së rëndë, mundjes, ngjitjes në shkëmbin apo në akuj;

d) aksidentet e shkaktuara prej kërcimit nga trampolina me ski apo hidroski;

dh) aksidentet e shkaktuara gjatë eksplorimit të shpellave;

e) aksidentet e shkaktuara gjatë ushtrimit të skive akrobatike, rrekbisë si dhe zhytjes me bomba oksigjeni;

f) aksidentet e shkaktuara gjatë parashutizmit dhe/ose sporteve të tjera ajrore;

g) aksidentet e shkaktuara nga pjesëmarrja në garat dhe/ose sportive të futbollit, hipizmit, ciklizmit, me përjashtim të rasteve kur këto gara ose prova kanë karakter çlodhës dhe argëtues;

h) aksidentet e shkaktuara nga ndërhyrje kirurgjikale kontrolluese ose të kujdesit mjekësor, të cilat nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me aksidentin e pësuar;

i) aksidentet e shkaktuara prej akteve me dashje të kryera nga i siguruari;

j) aksidentet e shkaktuara si rezultat i dehjes, teprimit me medikamente qetësuese, përdorimit të drogës ose halicinantëve, në rastet kur një përdorim i tillë vjen në kundërshtim me rregullat e sigurimit teknik apo me dispozita të tjera ligjore;

k) aksidentet e shkaktuara nga lufta, kryengritja, përmbytjet, zhvendosjet e tokës dhe shpërthimet vullkanike;

l) aksidentet e shkaktuara nga shpërthimet dhe rrezatimet bërthamore natyrore ose të provokuara.

Pavarsisht nga ajo që u trajtua më lart, disa nga aksidentet e përmendura më sipër si të pambuluara nga kontrata e sigurimit të personit, **mund të përfshihen në kontratën e sigurimit të personit, duke u mbuluar prej saj, me kusht që këto aksidente të kenë ndodhur tek i siguruari, i cili ushtron veprimtari profesionale në një nga këto fusha:**

a) ushtron veprimtari profesionale si profesionist në drejtimin e një mjeti motorik në garat sportive;

b) ushtron veprimtari profesionale si futbollist profesionist dhe aksidenti ndodh gjatë stërvitjes apo ndeshjes së futbollit;

c) ushtron veprimtari profesionale në sportin e ciklizmit;

ç) ushtron veprimtari profesionale në sportin e hipizmit;

d) ushtron veprimtari profesionale si boksier apo mundës;

dh) ushtron veprimtari profesionale në sportin e atletikës së rëndë;

e) ushtron veprimtari profesionale në alpinizëm, si në përgjithësi në çdo lloj sporti i ngjashëm me sportet e përmendura më lart.

Në këtë rast në mënyrë që aksidenti i shkaktuar nga një ose disa sporte të mësipërme të përfshihet në kontratën e sigurimit, kërkohet që jo vetëm i siguruari të ushtrojë një ose disa nga këto sporte si profesionist, por kërkohet edhe që një gjë e tillë të jetë parashikuar shprehimisht në

kontratën e sigurimit, si dhe kërkohet që aksidenti të ndodhë gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti. Me plotësimin e këtyre tre kushteve:

- a) ushtrimi i sportit si profesionist nga i siguruari;
- b) parashikimi i këtyre rasteve të sigurimit në kontratë dhe
- c) ndodhja e rastit të sigurimit gjatë ushtrimit të aktivitetit sportiv, siguruesi me ndodhjen e aksidentit, është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit në favor të siguruesit.

3.3. Përmbajtja e kontratës së sigurimit të personit. Të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në këtë kontratë.

Përmbajtja e kontratës së sigurimit të personit përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratë, pra, nga të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit dhe të siguruesit. Duke qenë se të gjitha të drejtat dhe detyrimet e siguruesit në kontratën e sigurimit të personit, janë të njëta me të drejtat dhe detyrimet e siguruesit në kontratën e sigurimit të pasurisë, si dhe duke qenë se këto të drejta dhe detyrime janë trajtuar kur është folur për kontratën e sigurimit të pasurisë, ato për efekt të mospërsëritjes nuk do të trajtohen te kontrata e sigurimit të personit. Po ashtu, duke qenë se pjesa më e madhe e të drejtave dhe detyrimeve të të siguruarit, në kontratën e sigurimit të personit, janë të njëta me të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë, në këtë punim unë do të ndalem vetëm tek ato të drejta dhe detyrime të veçanta që ka i siguruari në kontratën e sigurimit të personit, të cilat janë të ndryshme, nga të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë.⁶⁴ Si të drejta dhe detyrime të veçanta që ka i siguruari në kontratën e sigurimit të personit, mund të përmendim:

a) E drejta e të siguruarit që të caktojë një person tjetër për të përfitur shumën e sigurimit, me ndodhjen e rastit të sigurimit.

Kjo e drejtë është parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj, sipas të cilit i siguruari, mund të caktojë në kontratën e sigurimit që në rast se ai vdes, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar i familjes së tij, një personi tjetër, shtetit, ose një personi juridik publik, por, jo edhe një personi juridik privat.⁶⁵ Kjo do të thotë që i siguruari ka të drejtë që në momentin që nënshkruan kontratën e sigurimit, të përcaktojë në kontratë që, në rast se nga ngjarja e sigurimit i shkaktohet vdekja e tij, shumën e sigurimit që siguruesi ishte i detyruar që t'ia paguante atij sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, siguruesi t'ia paguajë një anëtar i familjes së tij, një personi tjetër, shtetit ose një personi tjetër juridik publik.

Në rastin kur i siguruari ka përcaktuar në kontratë se pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar i familjes së tij, është e domosdoshme që ai të përcaktojë në kontratë edhe anëtarin konkret të familjes, konkretisht nëse ai është babai, nëna, bashkëshorti/tja apo fëmijët, sepse këto konsiderohen si rregull si anëtarë të familjes. Megjithatë, për të përcaktuar me saktësi se kush konsiderohet si anëtar i familjes duhet t'i referohemi dispozitave të Kodit të Familjes, të cilat përcaktojnë konkretisht se kush konsiderohet si anëtar i familjes.

Pavarsisht nga kjo edhe në rastin kur i siguruari ka përcaktuar që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij, t'i paguhet një personi tjetër jashtë anëtarëve të familjes, përsëri ky përcaktim është i

⁶⁴ Për më tepër për përmbajtjen e kontratës së sigurimit të personit shih tek çështja: *"Përmbajtja e kontratës së sigurimit të pasurisë"*.

⁶⁵ Neni 1153 i Kodit Civil në fuqi përcakton: *"I siguruari mund të caktojë në kontratën e sigurimit që, në rast se ai vdes, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar i familjes së tij, një personi tjetër, shtetit ose një personi juridik publik"*.

vlefshëm pasi sipas dispozitës përkatëse i sigurari ka të drejtë që të përcaktojë që pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet edhe kujdo personi tjetër fizik ose shtetit. E rëndësishme në këtë rast është që i siguruari kur përcakton se pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar të familjes, ai duhet të përcaktojë konkretisht emrin konkret të anëtarit të familjes, pasi në të kundërt ky përcaktim është i pavlefshëm dhe shuma e sigurimit do t'u paguhet të gjithë trashëgimtarëve të tij, në përputhje me rregullat mbi trashëgiminë.

Kështu për shembull, në qoftë se i sigurari ka përcaktuar se pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar të familjes, por, pa specifikuar konkretisht emrin e tij dhe lidhjen e tij gjinore me të siguruarin, ky përcaktim nuk është i vlefshëm dhe në këtë rast shuma e sigurimit do t'u paguhet të gjithë trashëgimtarëve të të siguruarit, sipas rregullave mbi trashëgiminë. Pavarësisht se ligji është shprehur që i siguruari ka të drejtë që të përcaktojë që pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar të familjes së tij, nuk ka pengesë ligjore që i siguruari të përcaktojë që kjo shumë siguri pas vdekjes së tij, t'u paguhet edhe dy apo më shumë anëtarëve të familjes, duke i specifikuar konkretisht ato, si dhe pjesën që do të marrë secili.

Në rastet kur i siguruari ka përcaktuar në kontratën e sigurimit që pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet një personit tjetër jashtë familjes, në mënyrë që ky përcaktim të jetë i vlefshëm, duhet që në kontratë të tregohen me saktësi gjeneralitetet e plota të këtij personi, si dhe adresa e saktë e tij. Në mungesë të gjeneralitetëve të plota apo adresës së saktë të personit, i cili do të përfitojë shumën e sigurimit, ky përcaktim i të siguruarit konsiderohet i pavlefshëm dhe shuma e sigurimit do t'u paguhet trashëgimtarëve të të siguruarit, sipas rregullave mbi trashëgiminë.

Kur i sigurari përcakton që pas vdekjes së tij shuma e sigurimit t'i paguhet një personi tjetër, nuk kanë rëndësi për të drejtën, mardhëniet e gjinisë, të krushqisë apo të shoqërisë që i siguruari ka patur me këtë person, si dhe po ashtu nuk kanë rëndësi as motivet që e shtyjnë të siguruarin që shumën e sigurimit t'ia japë këtij personi. E rëndësishme është që i siguruari me vullnetin e tij të lirë dhe pa vese, të ketë përcaktuar që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij, t'i paguhet këtij personi dhe në këtë rast siguruari është i detyruar që të respektojë këtë vullnet të të siguruarit.

Në rastet kur i siguruari ka përcaktuar që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij t'i paguhet shtetit, është e mjaftueshme që i sigurari vetëm të shprehet që pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet shtetit, pa qenë nevoja që ai të përcaktojë organin konkret shtetëror. Në këtë rast siguruari do t'a paguajë shumën e sigurimit në Ministrinë e Financave, e cila është organi i cili përfaqëson shtetin, në mardhëniet financiare me të tretët.

Kur i siguruari ka përcaktuar që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij t'i paguhet një personi juridik publik, është e nevojshme që i siguruari të përcaktojë edhe personin publik konkret, të cilit do t'i paguhet shuma e sigurimit. Ky person juridik publik mund të jetë person juridik publik që i përket administratës qendrore shtetërore apo organeve të pushtetit vendor, si dhe çdo organi që ushtron funksione publike.

Për shembull, i siguruari mund të përcaktojë që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij, t'i paguhet ministrisë së Arsimit ose Bashkisë Tiranë ose Avokatit të Poullit. Në rast se i siguruari përcakton që shuma e sigurimit pas vdekjes së tij, t'i paguhet një personi juridik publik, por i siguruari nuk ka përcaktuar personin konkret, atëherë ky përcaktim është i pavlefshëm dhe shuma e sigurimit në këtë rast mendoj se duhet t'i kalojë shtetit dhe jo trashëgimtarëve të të siguruarit, sepse vullneti i të siguruarit ka qenë i shprehur qartë, që kjo shumë të mos u kalojë trashëgimtarëve të tij, përserisa ka përcaktuar se ajo duhet t'i kalojë një personi juridik publik. Por, meqënëse i sigurari nuk ka përcaktuar personin konkret juridik publik, është më e pranueshme që kjo shumë t'i kalojë shtetit, sepse në këtë mënyrë realizohet në mënyrë më të arsyeshme vullneti i të siguruarit.

Nga mënyra se si është formuluar neni 1153 i Kodit Civil, rezulton se i siguruari nuk ka të drejtë që pas vdekjes së tij të përcaktojë që shuma e sigurimit t'i paguhet një personi juridik privat. Në këtë përfundim arrihet nga interpretimi që i bëhet kësaj dispozitë, sepse me termin "një personi tjetër" jashtë anëtarit të familjes, duhet të kuptojmë kurdoherë një person fizik dhe jo edhe personin juridik publik apo privat qoftë ai.

Më bindës bëhet ky interpretim po t'i referohemi pjesës së fundit të kësaj dispozitë që përcakton "*... ose një personi tjetër juridik publik*", pa përmendur fare personin juridik privat, sepse në rast se ligjvënësi do të kishte dashur që të përcaktonte që përfitues në këtë rast të ishte edhe personi juridik privat, e kishte shumë të lehtë që pas fjalëve "*person juridik publik*" të shtonte dhe fjalët "*ose person juridik privat*". Duke menduar se kjo nuk është një harresë e ligjvënësit por, një zgjedhje e tij, do të konkludoja se i sigurari nuk ka të drejtë që të parashikojë që pas vdekjes së tij shuma e sigurimit t'i paguhet një personi juridik privat. Megjithatë, në alternativën se jemi para një harrese të ligjvënësit dhe se qëllimi i ligjvënësit, pavarësisht harresës së tij, ka qenë që t'i japë të drejtë të siguruarit që të përcaktojë që pas vdekjes së tij, shuma e sigurimit t'i paguhet edhe një personi juridik privat, zgjidhja gjendet me anë të interpretimit të zgjeruar të shprehjes "...një personi tjetër..." ku me termin person, duhet të kuptojmë si personin fizik, ashtu dhe personin juridik publik apo privat.

Në Kodin Civil është përcaktuar se kur në kontratën e sigurimit nuk është përcaktuar personi i cili mund të marrë shpërblimin e sigurimit, si dhe në rastet kur personi i përcaktuar në kontratë, ka vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar me një person tjetër, ose kur personi i caktuar si përfitues në kontratë, me dashje ka vrarë ose tentuar të vrasë të siguruarin, shpërblimi i sigurimit i paguhet të siguruarit. Ligji më pas ka përcaktuar se në qoftë së i siguruari ka vdekur, shpërblimi i sigurimit u paguhet trashëgimtarëve të tij ligjore ose testamentarë nga ana e siguresit.⁶⁶ Nga sa sipër rezulton që në mënyrë që shuma e sigurimit t'i paguhet të siguruarit ose trashëgimtarëve të tij ligjore apo testamentarë, duhet që të ekzistojnë një nga këto kushte:

a) I siguruari të mos ketë caktuar në kontratën e sigurimit personin që do të përfitojë shpërblimin e sigurimit me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit;

b) I siguruari ka caktuar një ose disa persona konkretë për të përfituar shumën e sigurimit pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, por këta persona kanë vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar më një person tjetër;

c) Personi i caktuar për të përfituar shumën e sigurimit me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë të siguruarin.

Në të gjitha këto raste, shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit i paguhet të siguruarit dhe kur ky ka vdekur i paguhet trashëgimtarëve ligjore ose testamentarë të të siguruarit. Në rastet kur i siguruari nuk ka lënë testament dhe në rastet kur ai nuk ka trashëgimtarë të gjinisë ose krushqisë së afërt të tij, nga ato të cilët parashikohen nga ligji si trashëgimtarë ligjorë, kjo shumë siguri i kalon shtetit, sepse shteti është sipas ligjit, kurdoherë trashëgimatri i radhës së fundit ligjor, për çdo person që vdes dhe për pasurinë e tij nuk ka lënë testament.⁶⁷

Siç u përmend edhe më lart, i siguruari ka të drejtë që të përcaktojë që shumën e sigurimit pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, ta përfitojë një person ose disa persona. Shtrohet pyetja: Çfarë

⁶⁶ Neni 1157 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "*Kur në dëshminë e sigurimit nuk është treguar personi që mund të marrë shumën e sigurimit, si dhe kur personi i treguar ka vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar me një person tjetër, ose kur ai me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë të siguruarin, shuma e sigurimit i paguhet të siguruarit, dhe në qoftë se ky ka vdekur, trashëgimtarëve të tij ligjor ose me testament*".

⁶⁷ Sipas nenit 366 të Kodit Civil kur trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtarë deri në shkalën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

ndodh kur i siguruari ka përcaktuar që shumën e sigurimit pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, ta përfitojnë shumë persona dhe një ose disa nga këta persona vdes para të siguarit, ose me dashje vret apo tenton të vrasë të siguarin? Në lidhje me këtë çështje në Kodin Civil përcaktohet se në rastet kur i siguruari ka caktuar shumë persona për të përfitur shumën e sigurimit dhe një ose disa për tyre ka vdekur para të siguarit, ose me dashje ka vrarë ose tentuar të vrasë të siguarin, pjesët që i takojnë këtij ose këtyre personave, ndahen midis personave të tjerë të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, në përpjestim me pjesën që i është caktuar secilit prej tyre.

Në rast se në kontratë nuk përmenden pjesët e personave të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, prezumohet se ato janë të barabarta. Pra, në këtë rast, në qoftë se një ose disa persona vdesin para të siguarit ose vrasin me dashje apo tentojnë të vrasin të siguarin, shuma e sigurimit nuk i kalon të siguarit ose trashëgimtarëve të tij ligjore apo testamentarë, por, u kalon personave të tjerë që janë caktuar për të marrë shumën e sigurimit, sipas pjesës së përcaktuar dhe në rast se nuk është përcaktuar pjesa e tyre, pjesa e personit të përjashtuar ndahet në mënyrë të barabartë midis këtyre personave.

Për ta kuptuar më mirë këtë situatë ligjore le ta sqarojmë atë me nga një shembull, konkret në të dy rastet, si në rastin kur i siguruari duke caktuar që shumën e sigurimit ta marrin shumë persona, ka përcaktuar edhe pjesën konkrete të secilit, ashtu edhe në rastin kur ai nuk ka bërë përcaktimin e pjesëve që do të marrë secili person. Le të fillojmë me rastin e parë. Ta zëmë se i siguruari M.G lidh një kontratë sigurimi personal në të cilën përcakton se shuma e sigurimit me vlerë 8.000.000 lekë, pas ndodhjes së rastit të sigurimit, do të përfitohet nga personat A.T B.S, C.R, D.V, dhe E.L duke përcaktuar që personi A.T dhe B.S do të marrin nga 2.000.000 lekë, personat C.R dhe D.V nga 1.000.000 lekë dhe personi E.L 2.000.000 lekë. Ta zëmë se personi A.T vdes para të siguarit. Në këtë rast pjesa e tij prej 2.000.000 lekësh, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit do të ndahet midis personave B.S, C.R, D.V, dhe E.L sipas pjesëve të përcaktuara në kontratë nga i siguruari. Kështu personat B.S dhe E.L do të përfitojnë nga shuma prej 2.000.000 lekësh që i përkiste personit A.T, dyfishin e shumës që do të përfitojnë personat C.R dhe D.V. Konkretisht personat B.S dhe E.L do të përfitojnë nga 75.000 lekë prej shumës prej 2.000.000 lekëve që i takonte personit A.T, ndërsa personat C.R dhe D.V do të përfitojnë nga 250.000 lekë prej kësaj shume. ($2 \times 75.000 = 1.500.000 + 2 \times 25.000 = 500.000$; $1.500.000 + 500.000 = 2.000.000$).

Në rastin e dytë, ta zëmë se i siguruari M.Z, lidh një kontratë sigurimi personal në të cilën përcakton që shuma e sigurimit me vlerë prej 5.000.000 lekësh pas ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, do të përfitohet nga personat A.V, B.G, C.E, D.H dhe E.X dhe i siguruari nuk përcakton pjesët që do të marrë secili. Ta zëmë se personat A.V dhe B.G me dashje vrasin të siguarin M.Z. Në këtë rast pjesa e tyre prej 2.000.000 lekësh do të përfitohet në mënyrë të barabartë nga personat C.E, D.H dhe E.X, duke marrë secili përveç pjesës së tyre nga 1.000.000 lekë, e cila prezumohet e barabartë, edhe nga $1/3$ e 2.000.000 lekëve që është shuma që duhej të merrnin personat A dhe B.

Pavarsisht, se si rregull, në rastet kur i siguruari ka caktuar shumë persona për të përfitur shumën e sigurimit dhe kur një nga këta persona vdes ose vret me dashje apo tenton të vrasë të siguarin, shuma e sigurimit nuk i kalon të siguarit e as trashëgimtarëve të tij, por i kalon personave të tjerë, në përputhje me pjesët e tyre të përcaktuara nga i siguruari dhe, kur nuk u janë përcaktuar pjesët, kjo shumë u kalon në mënyrë të barabartë, mund të ndodhë që edhe në këtë rast shuma e sigurimit t'i kalojë të siguarit ose trashëgimtarëve të tij ligjorë apo testamentarë. Mendoj se do të ndodhemi para një rasti të tillë, kur të gjithë personat e caktuar për të përfitur trashëgimin kanë vdekur para të siguarit ose me dashje kanë vrarë ose tentuar të vrasin të siguarin. Për shembull, në rast se i siguruari M.Z përcakton në kontratën e sigurimit personal që shuma e sigurimit me vlerë 5.000.000 lekë të përfitohet nga personat A.L, B.N dhe C.K dhe të tre

personat kanë vdekur para të siguararit ose të tre kanë vrarë me dashje ose kanë tentuar të vrasin të siguararin, në këtë rast shumica e sigurimit do të përfitohet nga i siguruari dhe në rast se edhe ky ka vdekur, kjo shumë do të përfitohet nga trashëgimatrët ligjore apo testamentarë të tij.

b) E drejta e të siguararit për të zëvendësuar personin që ka caktuar për të përfituar shumën e sigurimit pas vdekjes së tij, me një person tjetër.

I siguruari ka të drejtë që në kontratën e sigurimit të përcaktojë jo vetëm, personin që do përfitojë shumën e sigurimit pas vdekjes së tij, por edhe të drejtën për ta zëvendësuar këtë person me një person tjetër. Kjo e drejtë i njihet të siguararit shprehimisht nga ligji sipas të cilit i siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit vazhdon të jetë në fuqi, ka të drejtë që të zëvendësojë me një person tjetër personin që ka caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Për të bërë një gjë të tillë i siguruari detyrohet që të njoftojë me shkrim siguruesin, si dhe të paraqesë kontratën e sigurimit, për të bërë shënimet e nevojshme dhe nuk është e nevojshme që të njoftojë personin e mëparshëm të cilin e kishte caktuar si përfitues të shumës së sigurimit, por, që po bën zëvendësimin e tij në kontratë.⁶⁸

Në mënyrë që i siguruari të bëjë zëvendësimin e personit me një person tjetër, është e domosdoshme që kontrata e sigurimit të jetë akoma në fuqi. Në rast se kontrata e sigurimit ka mbaruar në një nga mënyrat e ligjshme të saj, ose është konstatuar apo është shpallur e pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë, i siguruari nuk ka të drejtë që të bëjë zëvendësimin e personit që është caktuar për të marrë shpërblimin e sigurimit, me një person tjetër.

Ligji i ka njohur të drejtën të siguararit që gjatë gjithë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, ai ka të drejtë që të bëjë zëvendësimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit pas vdekjes së tij, me një person tjetër, sepse i siguruari ashtu siç ka të drejtë të caktojë personin për të përfituar shumën e sigurimit, ashtu ka edhe të drejtë që ta zëvendësojë atë. Në këtë rast për të drejtën (ligjin) nuk kanë rëndësi motivet që e shtynë të siguararin që të zëvendësojë personin e caktuar për të marrë shumën e sigurimit, me një person tjetër, e rëndësishme është që i siguruari të shpreh vullnetin e tij të lirë dhe të plotë për të bërë këtë zëvendësim.

I siguruari mund të vendosë që të bëjë zëvendësimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit që mund të ketë qenë një anëtar i familjes së tij, me një person fizik tjetër, me një person juridik publik apo me shtetin dhe anasjelltas. Në të gjitha rastet që i siguruari bën zëvendësimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, me një person tjetër, duhet të përcaktojë me saktësi gjeneralitet dhe adresën e saktë të personit që bën zëvendësimin, në të kundërt zëvendësimi është i pavlefshëm.

Në këto raste, në qoftë se i siguruari nuk e bën në mënyrë të vlefshme zëvendësimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit me një person tjetër, jam i mendimit se shumica e sigurimit duhet që t'i paguhet personit të parë, që ishte caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Kjo për faktin se në qoftë se jemi para një zëvendësimi të pavlefshëm, i cili nuk sjellë pasojë juridike, si dhe jemi para caktimit të një personi për të marrë shumën e sigurimit, këtë shumë sigurimi do ta përfitojë ky person, përderisa zëvendësimi i tij ka qenë i pavlefshëm, domethënë, nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike në lidhje me personin e caktuar për të marrë shumën e sigurimit.

Në mënyrë që i siguruari të bëjë zëvendësimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, me një person tjetër, duhet që ai të njoftojë me shkresë siguruesin, si dhe të paraqesë kontratën e sigurimit në mënyrë që të bëhen shënimet e nevojshme. Në qoftë se i siguruari nuk e

⁶⁸ Neni 1154 i Kodit Civil në fuqi përcakton: “I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, ka të drejtë të zëvendësojë me një person tjetër personin që e ka caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Për këtë i siguruari detyrohet që të njoftojë me shkresë siguruesin dhe të paraqesë dëshminë e sigurimit për të bërë në të shënimet e nevojshme”.

përmbush këtë detyrim, pra, nuk njofton me shkrim siguruesin, si dhe nuk paraqet kontratën e sigurimit për të bërë shënimet përkatëse, zëvendësimi personit është i pavlefshëm, dhe shuma e sigurimit për arsyet e dhëna më lart, do t'i paguhet personit të mëparshëm që ishte caktuar për të marrë atë.

c) E drejta e të sigurvearit për të revokuar personin që është caktuar për të marrë shumën e sigurimit.

I sigurveari siç ka të drejtë që të caktojë personin për të përfituar shumën e sigurimit pas vdekjes së tij, ka edhe të drejtën që ta revokojë këtë person, domethënë, i sigurveari ka të drejtë që të revokojë të drejtën e këtij personi për të marrë shumën e sigurimit pas vdekjes së të sigurvearit. Kjo e drejtë e të sigurvearit përcaktohet në nenin 1155 të Kodit Civil sipas të cilit caktimi i personit që përfiton nga sigurimi, mund të revokohet nga i sigurveari në formën dhe mënyrën që është përdorur për caktimin e tij.

E drejta e të sigurvearit për të revokuar personin që është caktuar për të marrë shumën e sigurimit, është një e drejtë që mund të ushtrohet në çdo kohë nga ana e të sigurvearit, mjafton që kontrata e sigurimit të personit të jetë në fuqi. Po ashtu, në aktin e revokimit i sigurveari nuk është i detyruar që të japë ndonjë arsye apo të tregojë ndonjë shkak të ligjshëm se pse e bën revokimin e këtij personi.

Kjo e drejtë është një diskrecion i lirë i të sigurvearit dhe është thjesht në dëshirën dhe vullnetin e tij që të bëjë apo jo revokimin e personit, që është caktuar për të marrë shumën e sigurimit, pa qenë i detyruar për të treguar shkaqet apo arsyet. Po ashtu, edhe motivet që e shtyjnë të sigurvearin për të revokuar këtë person, nuk kanë asnjë rëndësi për të drejtën, e rëndësishme është që të ekzistojë vullneti i lirë dhe i plotë i të sigurvearit për të bërë revokimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit pas vdekjes së tij.

Në lidhje me formën sipas të cilës i sigurveari duhet të bëjë revokimin e personit të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, dispozita përcakton se revokimi duhet bërë në atë formë siç është bërë edhe caktimi i këtij personi. Kështu në rast se caktimi i personit është bërë më anë të shënimit të tij direkt në kontratën e sigurimit edhe revokimi i tij do të bëhet në këtë mënyrë, pra, duke u hequr emri i tij si përfitues nga kontrata e sigurimit, në rast se caktimi i këtij personi është bërë me anë të një deklaratë me shkrim të të sigurvearit, që i është njoftuar siguruesit edhe revokimi do të bëhet me anë të tërheqjes së kësaj deklaratë me shkrim, nga ana e të sigurvearit.

Në Kodin Civil është përcaktuar se revokimi i personit që është caktuar për të marrë shumën e sigurimit, nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët pas vdekjes së të sigurvearit, ose pasi të jetë të jetë vertetur ngjarja e sigurimit dhe personi ka deklaruar se dëshiron të përfitojë nga ky përcaktim i bërë nga i sigurveari.⁶⁹ Kjo do të thotë se e drejta e të sigurvearit për të revokuar personin e caktuar për të marrë shumën e sigurimit, është një e drejtë ngushtësisht personale dhe nuk mund t'u kalojë trashëgimtarëve të tij. Kjo e drejtë duhet që të ushtrohet vetëm nga ana e të sigurvearit dhe vetëm gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, në të kundërt, i sigurveari humbet të drejtën që të revokojë personin që është caktuar për të marrë shumën e sigurimit dhe kjo e drejtë bëhet e përvokueshme, domethënë, personi i caktuar për të marrë shumën e sigurimit, do ta përfitojë kurdoherë atë.

Në Kodin Civil, pavarësisht nga kjo, është parashikuar se caktimi i personit që përfiton nga sigurimi edhe pse mund të jetë i përvokueshëm nuk ka efekt, kur është rasti i parashikuar nga

⁶⁹ Paragrafi i dytë i nenit 1155 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Revokimi nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët pas vdekjes së kontraktuesit, pasi të jetë vertetur ngjarja e sigurimit e personi ka deklaruar se e dëshiron këtë përfitim".

gërma “a” e nenit 771 të Kodit Civil, domethënë, kur personi i caktuar për të marrë shumën e sigurimit, me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë të siguruarin, bashkëshortin, fëmijët ose prindërit e tij. Pra, në rastet kur personi i caktuar për të përfituar nga sigurimi, me dashje ka vrarë ose tentuar të vrasë të siguruarin, bashkëshortin, fëmijët apo prindërit e tij, nuk mund të përfitojë nga sigurimi edhe në rastet kur e drejta e tij për të përfituar nga sigurimi është bërë e pavorokueshme. Ky parashikim është bërë nga ligjvënësi pasi është e pamoralshme dhe antiligjore që një person të përfitojë nga keqbërjet e veta, dhe aq më tepër të përfitojë nga një krim i kryer prej tij.

Duke bërë një krahasim midis të drejtës së të siguruarit për të zëvendësuar personin që do të përfitojë nga sigurimi më një person tjetër, me të drejtën e të siguruarit për të revokuar personin që do të përfitojë nga sigurimi, shikojmë që ka shumë të përbashkëta midis tyre dhe dallimi kryesor midis tyre qëndron në faktin se në rastin e zëvendësimit të personit që përfiton nga sigurimi, kemi të bëjmë me zëvendësimin e këtij personi me një person tjetër, ndërsa në rastin e revokimit kemi të bëjmë me heqjen e të drejtës së këtij personi që të përfitojë nga sigurimi dhe në këtë rast nuk kemi zëvendësimin e tij me një person tjetër, por, shuma e sigurimit kalon në favor të të siguruarit ose të trashëgimatrëve të tij. Pra, dallimi kryesor qëndron në faktin se në rastin e zëvendësimit të personit shuma e sigurimit nuk përfitohet nga i siguruari, por, nga një person tjetër i cili zëvendëson personin e parë, ndërsa në rastin e revokimit të personit, shuma e sigurimit përfitohet nga vetë i siguruari ose trashëgimtarët e tij, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit.

Në lidhje me **detyrimet e të siguruarit në këtë kontratë**, ato janë të njëta me detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të pasurisë, me përjashtim të një detyrimi të specifik që ka i siguruari në kontratën e sigurimit të personit dhe ky detyrim ka të bëjë me **detyrimin që ka ai që të njoftojë sigruuesin për ndryshimet e profesionit të tij**.

Ky detyrim i të siguruarit buron nga neni 1159 i Kodit Civil, i cili është një dispozitë e përbërë nga pesë paragrafe, ku paragrafi i parë i saj nga mënyra se si është formuluar është i pakuptueshëm dhe tregon ose për një gabim material të ligjvënësit ose për një përkthim jo të saktë. Le të shohim konkretisht se si është formuluar paragrafi i parë i këtij neni. Ky paragraf ka këtë përmbajtje:

“Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit kur sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato nuk rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, sigruuesi nuk do ta kishte lidhur atë.”

Nga mënyra se si është formuluar ky paragraf ai është fare i pakuptueshëm dhe, nuk mund të nxirret asnjë kuptim logjik prej tij që të ketë të bëjë me anën juridike të asaj që ka dashur të thotë. Megjithatë, duke iu referuar dispozitave të tjera të Kodit Civil që trajtojnë kontratën e sigurimit, si dhe sidomos duke iu referuar paragrafëve të tjerë të po këtij neni, shohim se ky paragraf në mënyrë që të ketë kuptim duhet që të korigjohet nga ana gramatikore e gjuhësore. Konkretisht në pjesën e parë të fjalisë të këtij paragrafi pas fjalëve “Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit...” duhet të hiqet pjesëza “kur” si dhe në pjesën e dytë të fjalisë së këtij paragrafi pas fjalëve “...sjellin pushimin e efekteve të sigurimit në rast se ato...” duhet hequr pjesëza “nuk”. Pas bërjes së këtyre korigjimëve gjuhësore shohim se ky paragraf ka kuptim të saktë dhe të plotë dhe merr këtë përmbajtje:

“Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, sigruuesi nuk do ta kishte lidhur atë. ...”

I formuluar në këtë mënyrë ky paragraf i këtij neni, merr kuptimin e duhur juridik dhe kjo është mënyra e vetme se si duhet kuptuar ai, nga çdo jurist që e lexon dhe që mund ta zbatojë atë në zgjidhjen e ndonjë çështjeje të caktuar që i referohet këtij paragrafi. Duke lënë mënjanë problemet

në lidhje me kuptimin e paragrafit të parë të këtij neni, pasi ramë dakort që i vetmi kuptim juridik i tij është ai që u sqarua më lart, le të kthehemi tek përmbatja konkrete e nenit 1159 në tërësinë e tij.

Nga përmbatja e këtij neni konstatojmë që i siguruari është i detyruar që të njoftojë siguruesin për ndryshimin e profesionit apo veprimtarisë, gjatë kohës që kontrata e sigurimit personal është në fuqi. Në rast se i siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit personal është në fuqi, bën ndryshimin e profesionit apo të veprimtarisë së tij dhe nuk njofton për këtë siguruesin, atëherë zgjidhjet do të ishin të ndryshme në varësi të faktit nëse ky ndryshim i profesionit apo veprimtarisë së të siguarit e rrit rrezikun në mënyrë të atillë, që në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur kontratën. Zgjidhja tjetër do të ishte në rastet kur ndryshimi i mësipërm është i atillë, që gjendja e re edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën, por, do ta kishte lidhur atë, për një çmim më të lartë.

Rasti i parë parashikohet nga paragrafi i parë i nenit të mësipërm dhe sipas tij në rast se i siguruari bën ndryshimin e profesionit apo të veprimtarisë në mënyrë të atillë që këto ndryshime rritin rrezikun e sigurimit, duke krijuar një gjendje të re e cila po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do të kishte lidhur fare kontratën, atëherë ky ndryshim i profesionit apo veprimtarisë së të siguarit do të sjellë zgjidhjen e kontratës. Në këtë rast ndryshimi i profesionit apo veprimtarisë nga i siguruari sjell rrethana krejt të reja dhe e rrit rrezikun e sigurimit, në mënyrë të atillë që siguruesi po t'i kishte ditur këto rrethana, nuk do ta kishte lidhur fare kontratën e sigurimit personal.

Për shembull, në rast se i siguruari T.V, lidh një kontratë sigurimi personal me afat një vit dhe në kohën e lidhjes së kontratës ishte me profesionin e infermieres dhe gjatë kohës së lidhjes së kontratës ndryshon profesionin nga infermiere, në stjuardesë, ky ndryshim i profesionit sjell rrethana të reja dhe e rrit rrezikun në mënyrë të atillë, aq sa siguruesi po të ishte në dijeni të këtyre rrethanave në kohën e lidhjes së kontratës, nuk do ta kishte lidhur fare atë. Në këtë rast ndryshimi i profesionit të personit T.V, sjell zgjidhjen e kontratës së sigurimit sipas paragrafit të parë të nenit 1159 të Kodit Civil.

Rasti i dytë parashikohet nga paragrafi i dytë i këtij neni, sipas të cilit në rast se i siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, bën ndryshimin e profesionit apo veprimtarisë e cila është e një natyre të tillë, që gjendja e re e krijuar edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën, por, për një çmim më të lartë, atëherë, ky ndryshim sjell pakësimin e shumës së sigurimit që do t'i paguhet të siguarit, në përpjestim me çmimin më të ulët të caktuar në raport me atë çmim që ka qenë përcaktuar në fillim. Si shembull të këtij rasti mund të përmendim rastin kur i siguruari S.M, lidh një kontratë sigurimi personal, ku në kohën e lidhjes së kontratës ishte me profesionin e bujkut dhe gjatë kohës që kontrata është në fuqi ndryshon profesionin duke bërë profesionin e shoferit. Në këtë rast ndryshimi i rrethanave sjellë një gjendje të re e cila po të dihej nga siguruesi, do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë dhe në këtë rast me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, shuma e sigurimit do të pakësohet në përpjestim me çmimin më të ulët të caktuar, në raport me atë çmim që ka qenë caktuar në fillim.

Duhet të mbajmë parasysh se fakti nëse ndodhemi para rastit të parë apo të dytë, domethënë, para paragrafit të parë apo të dytë të nenit 1159 të Kodit Civil, përcaktohet rast pas rasti nga ana e gjykatës pasi shqyrton rrethanat e çështjes dhe, shembujt e dhënë nga ana ime mund të mos jenë plotësisht të përshtatshëm, por janë dhënë nga ana hipotetike për të bërë më të qartë dalimin midis këtyre dy paragrafëve. Ajo çfarë është e rëndësishme për t'u kuptuar është fakti që ndryshimet e profesionit të të siguarit gjatë kohës që kontrata e sigurimit personal është në fuqi, pa e njoftuar

siguruesin sjellin zgjidhjen e kontratës kur këto ndryshime krijonë një gjendje krejt të re, të cilën po ta kishte ditur siguruesi në kohën e lidhjes së kontratës, nuk do ta kishte lidhur atë dhe sjellin pakësim të shumës së sigurimit që do t'i paguhet të siguruarit, në rast se këto ndryshime të profesionit të të siguruarit, sjellin një gjendje të tillë që po të diheshin nga siguruesi, ai do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë.

Në Kodin Civil është përcaktuar se në qoftë se i siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit personal është në fuqi bën ndryshime të veprimtarisë apo të profesionit dhe e njofton siguruesin për ndryshimet e mësipërme, siguruesi ka të drejtë që brenda 15 ditëve të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën e sigurimit apo do të pakësojë shumën e sigurimit, ose do të ngrejë çmimin, domethënë, do të rrisë vlerën e primit të sigurimit.⁷⁰ Në këtë rast siguruesi ka të drejtë që të ushtrojë njërën nga dy të drejtat e mësipërme; ose të deklarojë zgjidhjen e kontratës dhe një të drejtë të tillë ai e ushtron kur ndryshimi i profesionit të të siguruarit ka sjellë një gjendje të re dhe ka rritur rrezikun në mënyrë të atillë, që po të dihej nga siguruesi në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur fare kontratën, ose të deklarojë pakësimin e shumës së sigurimit apo të kërkojë rritjen e vlerës së primit të sigurimit që do ta paguajë i siguruari, në qoftë se ndryshimi i profesionit nga ana e të siguruarit, ka sjellë një gjendje të tillë që po të dihej nga siguruesi në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë.

I siguruari nga ana e tij ka të drejtë që brenda 15 ditëve nga deklarimi i mësipërm që i bën siguruesi, të deklarojë nëse pranon apo jo ndryshimet e mësipërme në kontratë. Në rast se i siguruari nuk përgjigjet brenda 15 ditëve nga njoftimi që i bën siguruesi apo në rast se i siguruari deklaron se nuk i pranon ndryshimet e kërkuara nga siguruesi, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.

Pavarsisht se **detyrimi i të siguruarit në kontratën e sigurimit të personit për të njoftuar për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, është në thelb i njëjtë me detyrimin që ka ai në kontratën e sigurimit të pasurisë**, midis tyre ka ndryshime formale që kanë të bëjnë me periudhën e njoftimit, si dhe akteve që duhet të plotësojë për vertetimin e ngjarjes së sigurimit. Kështu me akte nënligjore është përcaktuar se me ndodhjen e rastit të sigurimit, i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit të personit, **duhet t'i dërgojnë njoftim me shkrim siguruesit, brenda tre ditëve nga ndodhja e rastit të sigurimit** ose brenda tre ditëve duke filluar ky afat, nga momenti kur ka patur mundësi të dërgojë njoftimin me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, ditën orën dhe shkakun e aksidentit, si dhe i siguruari është i detyruar që të paraqesë një certifikatë mjekësore të lëshuar nga mjeku. Në mënyrë që i siguruari të marrë shpërblimin e sigurimit, përveç njoftimit me shkrim të përmendur më lart dhe provimit të ngjarjes së sigurimit, ai duhet t'i paraqesë siguruesit **një kërkesë më shkrim**.

Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me disa akte të cilat në fushën e sigurimeve njihen me emrin **Dokumente të Reklamimit**. Këto akte janë të ndryshme në rastet kur nga ngjarja e sigurimit shkatohet paaftësia e perhershme apo e përkohshme për punë dhe kur shkatohet vdekja e të siguruarit. **Dokumentet e Reklamimit kur shkatohet paaftësia e perhershme apo e përkohshme për punë e të siguruarit janë:**

- a) Kontrata e sigurimit ose dëshmia e sigurimit
- b) Vendimi i Komisionit Mjeko-Ligjor që përcakton shkallën e humbjes së aftësisë për punë;

⁷⁰ Paragrafi i tretë i nenit 1159 të Kodit Civil në fuqi përcakton: "Në qoftë se i siguruari njofton për ndryshimet e mësipërme siguruesin, ky, brenda 15 ditëve duhet të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën apo do të pakësojë shumën e sigurimit ose të ngrejë çmimin".

c) Dokumentet që provojnë shpenzimet e mjekimit të bëra nga i siguruari në institucionet shëndetësore;

ç) Çertifikatë mjekësore përfundimtare që verteton gjendjen shëndetësore të të siguarit dhe ecurinë e saj të mëvonshme.

Në rastet **kur ngjarja e sigurimit shkakton vdekjen e të siguarit, Dokumentet e Reklamimit janë:**

a) Kontrata e sigurimit;

b) Çertifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile;

c) Dëshmia e trashëgimisë.

Të gjitha shpenzimet për marrjen dhe dërgimin e dokumenteve të mësipërme tek siguruesi, janë në ngarkim të të siguarit. **Pas plotësimit dhe dorëzimit të Dokumentëve të Reklamimit tek siguruesi, ai është i detyruar që brenda 60 ditëve, të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguarit ose personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata.** Në rast se siguruesi brenda këtij afati nuk i përgjigjet të siguarit ose nuk bën pagimin e shumës së sigurimit, i siguruari ka të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila është ajo që vendos përfundimisht për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

I siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nga ana e tij mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar dëmshpërblim **brenda tre vjetëve, duke filluar ky afat nga dita e ndodhjes së aksidentit ose nga momenti kur ata kanë patur mundësi objektive për të ushtruar vullnetin e tyre për paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim,** në të kundërt ata e humbasin përfundimisht të drejtën për të kërkuar nga siguruesi pagimin e shumës së sigurimit. **Ky afat është afat prekluziv,** domethënë, që shuan përfundimisht të drejtën për të kërkuar pagimin e shumës së sigurimit dhe si afat prekluziv nuk mund të rivendoset nga gjykata për asnjë arsye.

Në lidhje **me detyrimin siguruesit për të paguar shumën e sigurimit tek kontrata e sigurimit të personit,** vlen e njëta gjë që u tha edhe për detyrimin e që siguruesi ka tek kontrata e sigurimit të pasurisë për pagimin e shumës së sigurimit. Megjithatë, edhe në këtë rast ekzistojnë disa rregulla specifike që është e rëndësishme të trajtohen, pasi ato janë të ndryshme me ato që janë trajtuar në kontratën e sigurimit të pasurisë.

Kështu në rast vdekjeje të të siguarit si pasojë e risqeve (rreziqeve) të parashikuar në kontratë, i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, shpërblehet në vlerën e shumës së sigurimit. **Ky shpërblim jepet të siguarit edhe kur i siguruari vdes pas dy vitesh nga dita e ndodhjes së aksidentit,** duke zbritur shumën që i është paguar të siguarit për humbjen e aftësisë për punë, për shpenzimet e mjekimit dhe dëmshpërblimin ditor.

Në rast se **një aksident shkakton vdekjen e menjëhershme të të siguarit dhe të bashkëshortes së tij të pasiguarit ose e shkakton këtë vdekje brenda vitit të sigurimit,** si dhe në qoftë se **fëmijët e mitur të tyre rezultojnë përfitues sipas trashëgimisë ligjore ose testamentare,** siguruesi është i detyruar që tu paguajë fëmijëve të të siguarit dyfishin e shumës së sigurimit. Në qoftë se siguruesi ka paguar një pjesë së shumës së sigurimit për humbje të aftësisë për punë, për shpenzime mjekimi etj, fëmijëve të mitur, do t'u paguhet dyfishi i shumës së sigurimit që mbetet pasi zbritet shuma e paguar nga siguruesi.

Në rast vdekjeje të të siguarit, shuma e sigurimit u paguhet:

a) Personit ose personave të caktuar nga i siguruari në kontratën e sigurimit;

b) Trashëgimtarëve ligjorë apo testamentarë të të siguarit, por, gjithmonë nëse i siguruari nuk e ka përcatuar vetë në kontratë, trashëgimtarin që do të përfitojë këtë shumë.

Në rast humbje të aftësisë së përhershme për punë të të siguarit në mënyrë të plotë ose 100%, siguruesi i paguan të siguarit një shpërblim të barabartë më shumën e sigurimit. Siguruesi është i

detyruar që të paguajë dëmshpërblim vetëm për pasojat e drejtëpërdrejta dhe ekskluzive të ardhura nga ndodhja e aksidentit. Në qoftë se në momentin e ndodhjes së aksidentit, i siguruari nuk është fizikisht, plotësisht i shëndetshëm, siguruasi detyrohet të dëmshpërblejë vetëm pasojat që do të vinin patjetër në qoftë se aksidenti do t'i ndodhte një personi me shëndet të plotë. Në rast se shkaktohet humbja e plotë anatomike ose dëmtimi funksional i një organi, i siguruari shpërblehet përpjestimisht sipas përqindjes së llogaritur kundrejt shumës së siguar. Vlera konkrete e shpërblimit të sigurimit në këtë rast përcaktohet sipas tabelave përkatëse të hartuara nga Ministri i Financave.

Në rastet kur si pasojë e aksidentit i siguruari mjekohet në institucione mjekësore, spitale, klinika mjekësore shtetërore ose private, të siguarit i paguhen shpenzimet e mjekimit, deri në shumën e përcaktuar në kontratë. Kjo pagesë përfshin shpenzimet mjekësore, shpenzimet për kohëqëndrimin në spital, shpenzimet për trajtimin fizioterapik, si dhe të rraiaftësisimit të aplikuara nga këto institucione gjatë kohës së mjekimit. Në rastet e qëndrimit në spital ose institucion mjekësor si pasojë e aksidentit, të siguarit i paguhet një shpërblim ditor për çdo ditë qëndrimi, për një periudhë jo më shumë se 300 ditë qoftë dhe jo të vijueshme. Në qoftë se aksidenti vertetohet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale të ndryshme nga ajo e përcaktuara në kontratë, dëmshpërblimi do të bëhet i plotë, nëse veprimtari e re nuk e ka rritur riskun, dhe i reduktuar sipas përqindjeve të caktuara, në qoftë se vetetohet se veprimtaria e re e ka rritur riskun.

Në Kodin Civil është përcaktuar se shuma e sigurimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të personit, paguhet pavarësisht nga shuma që mund t'i paguhet të siguarit nga sigurimet shoqërore. Kjo do të thotë se kontrata e sigurimit personal është një kontratë krejt e pavarur dhe që nuk ka asnjë lidhje me mardhënien që krijohet midis të siguarit si punëmarrës dhe sigurimeve shoqërore. Këto mardhënie rregullohen nga dispozita krejt të tjera ligjore që parashikohen nga ligji “Për sigurimet shoqërore”, si dhe nga Kodi i Punës, ndërsa kontrata e sigurimit personal rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil.

Për këto arsye mardhëniet që krijohen midis të siguarit dhe siguruasit, në kontratën e sigurimit personal, janë krejt te pavarura dhe nuk kanë asnjë lidhje me mardhëniet që krijohen midis të siguarit si punëmarrës dhe sigurimeve shoqërore, si organ që bën sigurimin e punëmarrësve për veprimtarinë e punës. Është kjo arsyeja pse ligjvënësi ka parashikuar që shuma e sigurimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit, paguhet pavarësisht faktit nga shuma që mund t'i jetë paguar të siguarit nga sigurimet shoqërore.

Për shembull, ta zëmë se personi S.R është në mardhënie pune si mjek dhe për këtë paguan sigurimet shoqërore, si dhe ky person ka lidhur një kontratë sigurimi personal në bazë të dispozitave të Kodit Civil. Në këtë rast në qoftë se ndodh ngjarja e sigurimit apo aksidenti gjatë kohës që personi S.R është në punë, si dhe gjatë kohës që kontrata e sigurimit personal është në fuqi, ai sipas nenit 1161 të Kodit Civil do të përfitojë dy shuma si shpërblim sigurimi, njëren shumë nga sigurimet shoqërore sipas dispozitave të ligjit “Për sigurimet shoqërore” dhe shumën tjetër nga siguruasi, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Kapitulli 4. Disa veçori të kontratës së sigurimit sipas legjislacionit të shteteve të cammon-loë ose anglo-sakson.

4.1 Kuptimi dhe veçoritë e kontratës së sigurimit sipas sistemit anglo-sakson.

Në çështjet e deritanishme kemi trajtuar kuptimin, elementët dhe përmbajtjen e kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil Shqiptar, i cili siç dihet është marrë në një pjesë të madhe të dispozitave të tij, nga Kodi Civil italian, i cili është shtet që përta i përket legjislacionit përfaqëson sistemin e civil-loë ose romano-gjermanik. Në mënyrë që të bëhet kuptimi në mënyrë sa më të plotë i kontratës së sigurimit në të gjitha elementët e saj, mendoj se është me vend të paraqitet shkurtimisht edhe kuptimi i kësaj kontrate edhe sipas legjislacionit cammon-loë ose anglo-sakson. Një gjë e tillë do të bënte të mundur edhe krahasimin ndërmjet dy sistemeve kryesore ligjore të botës perendimore dhe do të nxirrshin në pah edhe veçoritë që ka çdo sistem në lidhje me trajtimin e kontratës së sigurimit.

Një veçori kryesore e sistemit cammon loë, në lidhje me kontratën e sigurimit është fakti se ky sistem ligjor e shikon kontratën e sigurimit në dy kuptime, në kuptimin juridik dhe ekonomik. Kështu po t'i referohemi sitemit ligjor të Sh.B.A, si një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të sisitemit cammon-loë, koncepti i kontratës së sigurimit është i lidhur më këto dy kuptime, kuptimin juridik dhe ekonomik. Sipas këtij sistemi ligjor **sigurimi është përkufizuar si transferim në mënyrë të barabartë i riskut dhe humbjeve, në këmbim të pagesës.** Edhe sipas legjislacionit cammon-loë, kontrata e sigurimit ka dy palë që janë siguruesi dhe i siguruari. Siguruesi është një kompani ose shoqëri aksionere që shet sigurime; i siguruari ose mbajtësi i policës së sigurimit, është një person fizik ose juridik i cili blen policën e sigurimit. **Rastet e sigurimit përbëjnë një tërësi faktorësh të cilët shërbëjnë për të përcaktuar shumën që duhet të paguajë i siguruari, me qëllim që të përfitojë nga sigurimi, shumë e cila quhet prim i sigurimit.** Managjimi

Sipas këtij sistemi sigurimi si aktivitet juridik dhe ekonomik, zhvillohet në bazë të disa parimeve. Sigurimi përfshin mbledhjen e parave me qëllim rishpërndarjen ndërmjet disa të siguruarve, të cilët konsiderohen si ente që i ekspozohen rrezikut, me qëllim pagimin relativ të humbjeve të jashtëzakonshme dhe fatale që mund t'u ndodhë këtyre të siguruarve. Personat fizikë ose juridikë të siguruar, janë në këtë mënyrë të mbrojtur nga risku i humbjeve, përkundrej pagimit të një çmimi, i cili varion në varësi të shpeshëtisë dhe madhësisë së dëmeve që shkakton ngjaraje e sigurimit. Sigurimi është një biznes tregtar, një pjesë e rëndësishme e shërbimeve të industrisë financiare, por të siguruarit mundet që edhe vetë të vetësigurohen me anë të të ruajtjes së parëve me qëllim eliminimin e humbjeve të mundshme në të ardhmen.

Në mënyrë që **risku i sigurimit të mund të jetë i siguroshëm** nga shoqëritë private të sigurimit, duhet të ketë shtatë karakteristika kryesore:

a. Një numër i madh i rasteve të ngjashme të sigurimit prej të cilave është i ekspozuar i siguruari. Nisur nga fakti se sigurimi operon me anë të mbledhjes së parave ndërmjet të siguruarve me qëllim rishpërndarjen, madhësia e policës së sigurimit është e lidhur me numrin individual të rasteve të sigurimit, e cila e lejon siguruesin të përfitojë nga ulja e madhësisë së rasteve të sigurimit, në të cilën parashikimi i humbjeve është i ngjashëm me humbjet aktuale.

b. Humbje duhet të jetë e përcaktuara saktë. Humbja që ka pësuar i siguruari duhet të jetë e përcaktuar në një datë të saktë, në një vend konkret dhe nga një shkak konkret, i cili përfshihet brenda rasteve të sigurimit të parashikuar në kontratë. Shembulli klasik është vdekja e një personi të

siguruar me ana të kontratës të sigurimit të jetës. Dëmtimet nga zjarri, nga aksidentet automobilistike dhe dëmtimet në punë, mund ta plotësojnë po ashtu këtë kriter, në rastet kur pasuria ose personi ka qenë i siguruar. Tipe të tjera të humbjeve që nuk i plotësojnë në mënyrë strikte këto kritere, mund të përcaktohen teorikisht. Për shembull, paaftësia në punë për shkak të sëmundjes, mund të përfshijë një periudhë të gjatë brenda të cilës personi i është ekspozuar rrezikut, në të cilën nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë, koha, vendi dhe shkak i ardhjes së kësaj paaftësie për punë. Megjithatë, zakonisht, dhe në kuptimin e përgjithshëm, koha, vendi dhe shkak i humbjes, duhet të jenë të qarta në mënyrë të mjaftueshme në mënyrë që personi me një njohori normale, dhe me një informacion të mjaftueshëm, të mund objektivisht të provojë të tre këto elementë.

c. Humbja duhet të jetë aksidentale ose rastësore. Ngjarja e cila shkakton humbjen e subjektit të siguruar duhet të jetë rastësore apo e shkakuar nga fati ose jashtë mundësisë për t'u kontrolluar nga i siguruari. Humbja duhet të jetë "e pastër", në kuptimin që duhet të jetë rezultat e një ngjarjeje në të cilën ekziston vetëm mundësia për për t'u paguar. Ngjarje të cilat përmbajnë elementë spekulativë, si risqet normale të biznesit, përgjithësisht nuk janë të sigurueshme.

ç. Humbja duhet të jetë e dukshme. Madhësia e humbjes duhet të shikohet nisur nga prespektiva dhe interesat e të siguruarit. Primi i sigurimit nevojitet që të mbulojë si koston e pritshme të humbjeve të pësuar, ashtu edhe shpenzimet e nevojshme gjyqësore që nevojiten për të provuar humbjet e pësuar, shpenzimet që nevojiten për të parandaluar ose pakësuar humbjet që vijnë nga ngjarja e sigurimit. Për humbjet e vogla të shkaktuara nga ngjarja e sigurimit, shpenzimet gjyqësore dhe ato që nevojiten për të parandaluar ose pakësuar humbjet që vijnë nga ngjarja e sigurimit, ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në përcaktimin e sasisë së dëmëve që ka pësuar i siguruari.

d. Çmimi i primit të sigurimit duhet të jetë i përbalueshëm. Nëse mundësia e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit është shumë e lartë, ose shpenzimet që duhen për të përbaluar ngjarjen e sigurimit, janë shumë të larta, duke bërë që çmimi i primit të sigurimit të jetë i lartë, përballë mbrojtjes së ofruar me anë të kontratës së sigurimit, asnjë subjekt nuk do të kishte dëshirë që të merrte pjesë në biznesin e sigurimeve, domethënë, të bënte kërkesë ose ofertë për të lidhur një kontratë sigurimi.

dh. Humbjet duhet të jenë të llogaritshme. Ekzistojnë të paktën dy elementë që duhet të merren në konsideratë dhe të cilët duhet të jenë fizikisht të llogaritshëm:

- a) Të ekzistojë mundësia e ndodhjes së dëmtimeve (humbjeve)
- b) Të jetë e mundur llogaritja e humbjeve të pësuar.

Mundësia e ndodhjes së dëmtimeve zakonisht është një shkak rastësor, i cili bën që të shkaktohen dëmtime ose humbje në objektin e siguruar, duke sjellë detyrimin e të siguruarit që të provojë ndodhjen e ngjarjes së sigurimit dhe të dëmit të pësuar.

e. Rastet/rreziqet e sigurimit duhet të jenë të kufizuara. Humbjet ose dëmtimet e siguruar nga kontrata e sigurimit, duhet të jenë në mënyrë ideale të pavarura nga vullneti i personave dhe nuk duhet të jenë katastrofike, domethënë, që humbjet nuk ndodhin në çdo rast dhe nuk janë aq të egra sa të falimentojnë plotësisht të siguruarin. I siguruari mund të preferojë të kufizojë ekspozimin e humbjeve mbi pasurinë, që i vijnë nga një rast i vetëm, në disa raste raste të humbjeve, që variojnë deri në 5% të pasurisë së tij të siguruar. Përfitimi nga e drejta e pronësisë (kapitali), e shtërngon të siguruarin që të lidhë kontrata të ndryshme sigurimi, siç është kontrata e sigurimit nga tërmeti, ose kontrata sigurimi nga fatëkeqësitë natyrore, në vende ku zakonisht ndodhin këto fatëkeqësi (hurricane zones). Në SH.B.A, për shembull, sigurimi i pasurisë nga përmbytjet bëhet nga Qeveria Qëndrore.

4.2. Kushtet ligjore për lidhjen e kontratës së sigurimit sipas sistemit cammon laë.

Kur një kompani siguri lidh një kontratë siguri për një objekt të caktuar, në rastet e sigurimit të pasurisë ose me një person të caktuar, në rastet të personit, kontrata duhet që të plotësojë disa kushte ligjore. Këto kushte ligjore njihen zakonisht, si parimet ligjore të kontratës së sigurimit, ndër të cilat mund të përmendim:

a. Pagimi i shpërblimit të sigurimit. Kompania e sigurimit ka detyrimin që të paguajë ose të kompensojë të siguruarin për humbjet e pësuar nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit.

b. Interesi i siguruarës. I siguruari duhet të vuajë direkt nga humbja ose dëmtimi i pasurisë së siguar, domethënë, i siguruari duhet të ketë interes të ligjshëm për lidhjen e kontratës së sigurimit, pra, ose duhet të jetë pronar i pasurisë ose të ketë një të drejtë të ligjshme gëzimi nga kjo pasuri.

c. Ekzistenca e mirëbesimit ndërmjet palëve. Siguruesi dhe i siguruari duhet të jenë lidhur në një marrëdhënie mirëbesimi dhe ndershmërie me njëri-tjetrin.

ç. Pagimit i kontributit/primit nga i siguruari. I siguruari në kontratën e sigurimit ka detyrimin që të bëjë pagimit e primit të sigurimit në favor të kompanisë së sigurimit.

d. Rasti i sigurimit duhet të jetë i përcaktuar qartë. Rasti i sigurimit, i cili njihet në gjuhën ekonomiko-financiare si **peril**, duhet të jetë i parashikuar në kontratën e sigurimit, në të cilën rastet më kryesore të humbjeve që mund të pësojë pasuria mund të mos jenë parashikuar në kontratë.

Kontrata e sigurimit mund të ndikojë në rritjen e humbjeve nëpërmjet të ashtëquajturit moral i riskut të sigurimit (moral hazard), nga aktivitetet kriminale dhe hapat parandalues që merren nga kompanitë e sigurimit për parandalimin ose pakësimin e dëmit të shkaktuar nga ngjarja e sigurimit. Studjuesit që merren me studimin e kontratës së sigurimit, përdorin në mënyrë tipike moralin mbi riskun e sigurimit, për të referuar në rritjen e humbjeve të pasurisë si pasojë e mungesës së kujdesit ose indiferencës së të siguruarit.

Pagimi i shpërblimit të sigurimit. Ky parim, i cili është përmendur nga ana jonë më lart, nënkupton “rikthimin në gjendjen e mëparshme”, ose “të vendosesh gjendjen në pozicionin e mëparshëm”, nga ndryshimi i ndodhur në objektin e siguar si pasojë e ndodhjes së rastit të sigurimit ose peril-it. Në kontratën e sigurimit të jetës së personit, përgjithësisht nuk pranohet rikthimi në gjendjen e mëparshme, por, pranohet pagimi i një shume të caktuar, si shpërblim për ndodhjen e rastit të sigurimit. Në përputhje me përcaktimin e mësipërm, ekzistojnë dy tipe kontratash siguri:

a) Kontrata siguri në të cilën siguruesi ka detyrimin për rikthimin e pasurisë së të siguruarit në gjendjen e mëparshme (indemnity policy) dhe

b) Kontrata siguri në të cilën siguruesi ka detyrimin për t'i paguar një shumë të caktuar të siguruarit, si shpërblim për ndodhjen e rastit të sigurimit.

Modeli i llogaritjes së fitimeve nga siguruesi, tek kontrata e sigurimit sipas sistemit anglo-sakson.

Ky model fitimi mund të reduktohet në një ekuacion të thjeshtë:

Fitimi = primi i fituar + të ardhura nga investimet – humbjet nga rasti i sigurimit – shpenzime të tjera që lidhen me kontratën e sigurimit.

Siguruesit mund të realizojnë fitime nga kontrata e sigurimit në dy mënyra:

a) Me anë të procesit të zgjedhjes së risqeve të sigurimit që ata vendosin që të mbulojnë, si dhe me anë të vendimeve që marrin në lidhje me madhësinë që duhet të ketë primi i sigurimit që do të paguhet nga si siguruari, me qëllim mbulimin e këtyre risqeve, i njohur në anglisht si “underwriting”;

b) Me anë të investimeve që bëjnë dhe primeve që mbledhin nga kontrata e sigurimit.

Aspekti më i vështirë i bisnezit të sigurimit është procesi i zgjedhjes së risqeve të sigurimit që siguresit vendosin të mbulojnë. Duke përdorur një bazë të gjerë të dhënash siguresit përpiqen që të parashikojnë raste sigurimi që kanë mundësi të ndodhin sa më pak ose sa më rrallë, në mënyrë që pagimi i primit të sigurimit nga të siguruarit, t'i përgjigjet risqeve të sigurimit që ata mbulojnë. Bazuar në këtë përfundim, siguresit përdorin shkencën e studimit të risqeve të sigurimit (actuarial science), për të përcaktuar risqet që do të mbulojnë dhe primet e sigurimit që ata do të vendosin që të paguhen nga të siguruarit, me qëllim mbulimin e këtyre risqeve.

Të dhënat analizohen me ndershmëri në bazë të një projekti të saktë dhe mënyra se si do të veprohet në të ardhmen, në lidhje me shkallën e mbulimit të risqeve të sigurimit, bazohet në gjendjen reale. Shkenca e studimit të risqeve të sigurimit, përdor statistikat dhe mundësinë për të analizuar shkallën e ndodhjes së risqeve të sigurimit që do të mbulohen dhe këto parime të kësaj shkence përdoren për të përcaktuar të gjitha kushtet në kontratën e sigurimit nga siguresi. Sigurisht, parë në këndvështrimin e siguresit, disa kontrata sigurimi janë "fituese", që do të thotë që shuma që siguresi paguan për mbulimin e risqeve të sigurimit është më e vogël, se primi i sigurimit që ai merr dhe të ardhurat që ai fiton nga investimet.

Nga ana tjetër, po sipas siguresit, disa kontrata të tjera janë "humbëse", kur shuma që siguresi paguan për mbulimin e risqeve të sigurimit, është më e madhe se primi i sigurimit që ai merr dhe të ardhurat që ai fiton nga investimet. Shkenca që merret me studimin e risqeve të sigurimit, ka si qëllim themelor që të bëjë të mundur që siguresi të lidhë sa më shumë kontrata sigurimi "fituese" dhe të përjashtojë sa të jetë e mundur lidhjen e kontratave të sigurimit "humbëse".

Aftësia e siguresit në lidhjen e kontratës së sigurimit, matet nga shkalla e kombinimit të humbjeve dhe shpenzimeve, përballë primit të sigurimit. Një shkallë kombinimi e tyre më pak se 100%, do të thotë lidhje e kontratës së sigurimit me përfitim, nga ana tjetër çdo vlerë që kalon 100%, do të thotë humbje për siguresin. Një kompani sigurimi, e cila ka një kombinim të humbjeve dhe shpenzimeve, përballë primit të sigurimit, mbi 100%, domethënë, që humbjet dhe shpenzimet e siguresit në kontratën e sigurimit janë më të mëdha se primi i sigurimit i paguar nga i siguruari, asnjëherë nuk mund të nxjerrë përfitime nga lidhja e kësaj kontrata sigurimi.

Kompania e sigurimit nxjerr përfitime nga investimet që ajo mund të bëjë me rezervën e kursyer nga aktiviteti i sigurimit (float). Rezerva e kursyer përfaqëson shumën e parave që kompania zotëron nga paratë që ajo ka mbledhur më parë, prej primeve të sigurimit, që nuk janë shpenzuar në mbulimin e risqeve të sigurimit. Kompania e sigurimit fillon që të investojë këtë rezervë të rrjedhur nga aktiviteti i sigurimit, në momentin më të parë që ajo e ka mbledhur atë, dhe vazhdon të përfitojë interesa (kamata) mbi këtë shumë ose të ardhura të tjera, deri në momentin që asaj i nevojiten për të paguar risqet e sigurimit që kanë ndodhur. Duke investuar paratë që rrjedhin nga rezerva e sigurimit, kompanitë e sigurimit arrijnë që të nxjerrin përfitime të mëdha. Për shembull, Shoqata Britanike e Siguresve, e cila përfshin 94% të kompanive të Britaninë e Madhe, zotëron afërsisht 20% të investimeve, në Tregun e Letrave me Vlerë, të Londrës.

Në SH.B.A, përfitimi i kompanive të sigurimit nga kontrata e sigurimit llogaritet rreth 122 miliardë dollarë, për pesë vitet e fundit, deri në vitin 2003. Nga kjo shumë e përgjithshme e fitimeve, rreth 68 miliardë dollarë, sigurohet prej tyre në mënyrë ekskluzive nga investimet e bëra prej tyre në rezervën që rrjedh nga aktiviteti i sigurimit. Disa studjues të industrisë së sigurimit, janë të mendimit se nuk është e mundur që kompanitë e sigurimit të arrijnë të sigurojnë përfitime të tilla nga rezerva e sigurimit, në mënyrë të përhershme, por ky nuk është një mendim i pranuar nga të gjithë.

4.3. Llojet kryesore të sigurimit sipas sistemit cammon laë.

Çdo lloj risku ose rasti sigurimi është e mundur teorikisht që të sigurohet. Rastet konkrete të ndodhjes së risqeve të sigurimit, siç është thënë më lart, njihen me emrin peril. Një kontratë sigurimi, e quajtur edhe në sistemin cammon laë, ashtu si edhe legjislacioni ynë, si policë sigurimi, duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë, cilët risqe sigurimi mbulon dhe cilat risqe janë të përjashtuara nga sigurimi. Një policë sigurimi mund të mbulojë një ose disa kategori risqesh sigurimi. Për shembull, një policë sigurimi e automjeteve, mund të mbulojë riqet e sigurimit që kanë të bëjnë me pronësinë e këtij automjeti, gjë që ndodh më zakonisht, ku përfshihen mbulimi i riqeve të vjedhjes ose dëmtimit të automjetit, por mund të mbullojë edhe risqet e përgjegjësisë, ku përfshihen mbulimi i pretendimeve ligjore nga shkaktimi i aksidentit.

Një policë e sigurimit e banesës në SH.B.A, zakonisht mbulon risqet që shkaktojnë dëmtimin e banesës, shpenzimet që kanë të bëjnë me pretendimet ligjore kundër pronarit, si dhe një një shumë të vogël edhe risqet që kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve mjekësore të pronarit dhe familjarëve të tij, si dhe të personave të tjerë që kanë qenë në banesë dhe që janë dëmtuar nga ndodhja e rastit të sigurimit. Bisnezi i sigurimeve mund të shfaqet në forma të ndryshme, në aq forma ose lloje sa janë risqet mund të të dëmtojnë këtë biznes. Por, pavarësisht nga llojet e ndryshme të shfaqjes së saj, ekzistojnë dy tipe kryesore të biznesit të sigurimeve të cilat janë:

a) Llojet e ndryshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale;

b) Polica e sigurimit të pronësive, e cila mund të ndahet në aq lloje sa janë nevojat e pronarëve për mbrojtjen e pronësisë së sendeve të tyre.

Shkurtimisht llojet kryesore të sigurimeve sipas sistemit cammon laë janë:

a. Sigurimi i automjeteve.

Sigurimi i automjeteve ka për qëllim që të mbrojë pronarin ose përdoruesin e automjetit nga dëmet financiare që mund të pësojë me ndodhjen e aksidentit. Ajo është një kontratë ndërmjet pronarit ose përdoruesit të mjetit dhe kompanisë së sigurimit, në bazë të të cilës i siguruarit bie dakort që të paguajë primin e sigurimit, ndërsa kompania e sigurimit bie dakort që të paguajë humbjet e shkaktuar nga ndodhja e aksidentit, ashtu siç është përcaktuar në policën e sigurimit. Sipas sistemit cammon laë, sigurimi i automjeteve mbulon sigurimin e automjetit nga dëmtimet, sigurimin nga përgjegjësitë dhe sigurimin e shpenzimeve mjekësore.

a) Sigurimi i mjetit nga dëmtimet, nënkupton që kompania e sigurimit i paguan të siguruarit dëmtimet që i janë shkaktuar mjetit të tij nga ndodhja e aksidentit.

b) Sigurimi i përgjegjësisë, nënkupton që kompania e sigurimit paguan në favor të të siguruarit shpenzimet që kanë të bëjnë me pretendimet që kanë personat e tretë në lidhje me dëmtimin e shëndetit të tyre ose dëmtimit të pasurisë, nga ndodhja e aksidentit.

c) Sigurimi i shpenzimeve mjekësore, do të thotë që kompania e sigurimeve i paguan të siguruarit shpenzimet spitalore, shpenzimet që kanë të bëjnë me rehabilitimin e tij, si dhe në disa raste edhe diferencën e uljes së pagës që ka pësuar i siguruarit dhe shpenzimet e varrimit të të siguruarit, kur nga aksidenti ka ardhur vdekja e të siguruarit.

b. Sigurimi i banesës.

Sigurimi i banesës ka si qëllim shpërblimin e dëmeve që ka pësuar banesa si pasojë e dëmtimit ose shkatërrimit të saj, nga fatkeqësitë natyrore. Në disa zona gjeografike, një policë sigurimi standarte e sigurimit të banesës, përjashton disa lloje të sigurta fatkeqësish natyrore, siç janë përmbytjet dhe termetet, për të cilat kërkohet një sigurim shtesë. Një problem i qëndrueshëm në këto lloje sigurimesh, është çështja e përgjegjësisë së pronarëve të banesave. Polica e sigurimit mund të përfshijë edhe sendet e luajtshme dhe orenditë e banesës, por këto sende mund të jenë edhe

objekt i një kontrate të veçantë, veçanërisht në rastet kur banesa është marrë me qira. Në disa shtete kompania e sigurimit ofron në një paketë siguruese, përgjegjësinë ligjore për plagosjen e personave që banojnë në banesë, për dëmtimet që mund të ketë banesa, si dhe për plagosjen ose ngordhjen e kafshëve shtëpiake.

c. Sigurimi i shëndetit të personit.

Polica e sigurimit të shëndetit mbulon shpenzimet që bën i siguruari për trajtimin e tij mjekësor, si pasojë e ndodhjes së riskut të sigurimit. Në disa shtete për shembull, në Britaninë e Madhe, kjo policë nuk përfshin edhe sigurimin mjekësor për dhëmbët, për të cilën kërkohet një policë sigurimi e posaçme. Në vendet e tjera, si për shembull, në SH.B.A, polica e sigurimit të shëndetit, mbulon edhe shpenzimet që bën i siguruari në lidhje me dhëmbët, shpenzime që ofrohen në një paketë të vetme për sigurimin e shëndetit.

ç. Sigurimi nga aksidentet, sëmundjet dhe papunësia.

Polica e sigurimit nga paaftësia për punë, siguron mbështetje financiare, në qoftë se i siguruari, ose mbajtësi i policës së sigurimit, është i pamundur për punë për shkak të sëmundjes ose dëmtimeve të shëndetit. Kjo mbështetje financiare i siguron të siguarit ndihmë financiare për disa muaj për pagimin e taksave të ndryshme, si kreditë dhe qiratë.

Sigurimi i paaftësisë së përkohshme për punë, lejon pronarët e bizneseve që të sigurojnë rastet kur ato për një periudhë të caktuar kohe, e kanë të pamundur që të punojnë.

Sigurimi i paaftësisë së përhershme për punë, i siguron të siguarit marrjen e përfitimeve në rastet kur ai është i paaftë për të punuar në profesionin që ka patur gjatë gjithë jetës së tij, sigurimi i cili mund të barazohet me sigurimin e jetës.

Sigurimi i punonjësve, i garanton punonjësve të siguar të gjitha kompensimet e nevojshme që kanë të bëjnë me uljen e pagës së tyre, si pasojë e ndodhjes së aksidentit në punë, si dhe pagimin e të gjitha shpenzimeve mjeksësore që ka bërë punonjësi si pasojë e dëmtimeve të pësuar nga aksidenti.

d. Sigurimi i jetës dhe shëndetit nga veprimet e personave të tretë (Casualty).

Sigurimi i jetës dhe shëndetit nga veprimet kriminale, është një nga format e këtij lloj sigurimi, e cila e siguron mbajtësinë e policës së sigurimit nga dëmtimet e pësuar prej veprimeve kriminale të një pale të tretë. Për shembull, kompanitë e sigurimit mund të lidhin kontrata sigurimi kundër krimeve për të mbuluar humbjet që vijnë nga vjedhja e pasurisë prej personave të tretë, ose nga vjedhja e sendeve që bëjnë personat të cilët kishin për detyrë për t'i ruajtur ato.

Sigurimi nga risqet politike, është një tjetër formë e sigurimit të jetës dhe shëndetit prej veprimeve të personave të tretë, e cila mund të lidhet nga bizneset në ato vende ku ekziston një rrezik për revolucion ose ekzistojnë kushte të tjera politike, të cilat mund t'i shkaktojnë humbje biznesit.

dh. Sigurimi i jetës.

Sigurimi i jetës garanton përfitimin e një shume financiare tek anëtarët e familjes të të siguarit ose tek një tjetër person përfituesi i shënuar nga i siguruari në kontratën e sigurimit dhe mundet më konkretisht që të sigurojë mjetet e jetesës për personat e tjerë të familjes së të siguarit, shpenzimet që janë të nevojshme për cermoninë mortore, ato që kanë të bëjnë me varrimin, si dhe shpenzimet e tjera financiare që kanë të bëjnë me respektimin e të vdekurit të siguar. Polica e sigurimit të jetës zakonisht lejon mundësinë e pagimit të vazhdueshëm të një shume të caktuar në favor të familjarëve të të siguarit të vdekur nga risku i sigurimit ose pagimin e një rente jetësore.

Renta jetësore siguron pagimin e vazhdueshëm të një sasive të hollash të favor të familjarëve të të siguarit të vdekur, dhe klasifikohet zakonisht si sigurim, sepse ajo jepet nga kompanitë e sigurimit dhe rregullohet si sigurim dhe kërkon të njëjtat rregulla të përcaktimit të riskut dhe të njëjtat rregulla

të managjimit, ashtu edhe si sigurimi i jetës. Rentat jetësore dhe pensionet, konsiderohen disa herë si sigurime, duke marrë parasysh faktin se disa pensionistë mund të jetojnë, duke mos u mjaftuar burimet financiare që ata kanë për të jetuar. Në këtë kuptim, ato janë plotësisht sigurime jete, dhe në një ardhme të afërt, do të përbëjnë drejtimin (trend-in) kryesor të kontratës së sigurimit të jetës.

Sigurisht kontrata e sigurimit të jetës mbledh para kesh, të cilat mund të përdoren nga i siguruari nëse ai nuk do ta kishte lidhur këtë kontratë, ose mund t'i huazonte këto para, duke përfituar interesat e tyre. Disa polica të sigurimit të jetës, si renta jetësore ose kontrata e dhënies së parave institucioneve shkollore apo kolegjeve, janë mjete financiare të akumuluar për të bërë shpenzime në lidhje me shëndetin, kur të jetë e nevojshme.

Në disa vende si në SH.B.A dhe në Mbretërinë e Bashkuar, ligjet e taksave garantojnë që dhënia e këtyre shumave për këtë qëllim, në rrethana të caktuar, nuk taksohet. Një gjë e tillë çon në përhapjen gjithnjë e më të madhe të kontratës së sigurimit të jetës si “një taksë efiçente”, e cila i shërben individit për të ruajtur para dhe për të siguruar jetesën e tij, në vitet e fundit të jetës.

Në SH.B.A, interesi i të ardhurave nga shuma e derdhur për sigurimin e jetës dhe të ardhurat që personi merr si rentë jetësore, shtyhen për t'u paguar më vonë. Megjithatë, në disa raste përfitimi i ardhur nga shtyrja e pagimit të taksave, mund të rikompensohet me kthimin e një shume të vogël nga i siguruari. Kjo varet nga kompania e sigurimit, tipi i kontratës së sigurimit të jetës dhe rrethana të tjera.

e. Sigurimi i pasurisë.

Sigurimi i pasurisë siguron mbrojtje kundër risqeve që mund t'i kanosen pronës, si zjarri, vjedhja, ose dëmtime të tjera. Kjo kontratë sigurimi përfshin forma të ndryshme të saj, si kontrata e sigurimit nga zjarri, nga përmbytjet, nga tërmetet, sigurimi i banesave, sigurimi i marinës, etj. Për disa nga këto forma sigurimi ne kemi folur më lart, si sigurimi i automjeteve dhe i banesës, të cilat përfshihen në sigurimin e pasurisë, ndërsa tani do të përmendim disa nga llojet e tjera të sigurimit të pasurisë sipas legjislacionit cammon laë, të cilat janë:

- Kontrata e sigurimit të avionëve, me anë të të cilës bëhet sigurimi i avionëve nga dëmtimet, shkatërrimi dhe risqet e përgjegjësive;
- Kontrata e sigurimit të makinerive, e cila siguron makineritë nga dëmtimet fizike që mund të kenë gjatë procesit të punës;
- Kontrata e sigurimit të ndërtimeve, e cila siguron dëmtimet fizike ose humbjet që mund të kenë objektet gjatë procesit të ndërtimit, sigurimi i cili përfshin çdo lloj risku sigurimi;
- Kontrata e sigurimit në grup, që përdoret nga fermerët me qëllim për të reduktuar ose managjuar risqet që janë të lidhura me kultivimin e kulturave bujqësore, të cilat (kulturat bujqësore) mund të sigurohen nga breshëri, ngricat, sëmundjet, insektet etj;
- Kontrata e sigurimit nga tërmetet, e cila siguron pasurinë nga çdo dëmtim që mund t'i shkaktohet asaj si pasojë e tërmetit;
- Kontrata e besnikërisë, e cila është një nga format e kontratës së sigurimit ndaj veprimeve të të tjerëve, që i mbulon mbajtësit të policës së sigurimit dëmet e shkaktuara nga persona konkretë, si pasojë e shkeljes së besnikërisë në punë;
- Kontrata e sigurimit nga përmbytjet e cila siguron çdo humbje ose dëmtim të pasurisë që është shkaktuar prej përmbytjeve;
- Kontrata e sigurimit të qiradhënësve të pronave (landlord insurance), e cila është një kontratë specifike vetëm për pronarët që japin pronat me qira dhe që siguron pronat nga dëmtimet ose shkatërrimet e mundshme;
- Kontrata e sigurimit të marinës dhe transportimit të mallrave, e cila mbulon të gjitha humbjet që një anije ose aeroplan pëson gjatë udhëtimit;

- Kontrata e sigurimit të kthimit të huasë, që njihet ndryshe edhe si kontrata e dorëzarisë, e cila garanton kthimin e huasë nga humamarrësi;
- Kontrata e sigurimit nga aktet terroriste, e cila siguron pasurinë nga çdo humbje ose dëmtim i shkaktuar nga aktet terroriste;
- Kontrata e sigurimit nga vullkani, e cila mbulon humbjet që mund të pësojë pasuria nga shpërthimi vullkanik;
- Kontrata e sigurimit nga stuhitë, e cila siguron pasurinë nga çdo humbje që mund të pësojë ajo si pasojë e uraganeve dhe cikloneve tropikale.

Kapitulli 5.

Kontrata e sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil italian.

5.1. Kuptimi i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian.

Trajtimi në mënyrë të përmbledhur i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian mendoj se është i domosdoshëm, kjo për faktin se një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit tonë Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit, janë marrë pikërisht nga Kodi Civil italian. Në këtë mënyrë do të kishim mundësi që të konstatojmë disa nga problemet që paraqesin formulimet e dispozitave të Kodit tonë Civil, duke konkluduar nëse këto paqartësi në formulim, kanë të bëjnë me gabime në shtyp, me përkthimin jo të përshtatshme apo me një zgjedhje të ligjvënësit tonë. Po ashtu, duke trajtuar kontratën e sigurimit sipas ligjit italian, mund të bëjmë edhe një studim krahasues, ndërmjet mënyrës së rregullimit të kësaj kontrate sipas ligjit shqiptar dhe atij italian, duke nxjerrë në pah edhe të përbashkutat dhe dallimet që kanë këto dy legjislatore në lidhje me kontratën e sigurimit.

Kodi Civil italian, po ashtu, si Kodi Civil shqiptar, në dispozitat e tij e jep në mënyrë të shprehur kuptimin e kontratës së sigurimit duke e përcaktuar atë si një kontratë të lidhur ndërmjet dy palëve; siguruesit dhe të siguruarit, mbi bazën e të cilës njëra palë, siguruesi kundrejt pagimit të një çmimi të caktuar në favor të tij, të quajtur prim i sigurimit, ka detyrimin që të zhdëmtojë palën tjetër, të siguruarin, brenda kufijve të përcaktuar në kontratë, për dëmet e pësuar nga rasti i sigurimit, ose të pagujë një shumë të hollash apo një rentë jetësore në favor të të siguruarit, kur rasti i sigurimit i shkakton dëme në jetën apo shëndetin e tij.⁷¹ Nga përkufizimi që Kodi Civil italian i bën kontratës së sigurimit konstatohet se ky përkufizim është i njëjtë me përkufizimin që Kodi Civil i yni i bën kësaj kontrate në nenin 1113 të tij, duke u bërë nga ana e ligjvënësit tonë vetëm disa rregullime në pikëpamje të teknikës legjislative, duke e ndarë dispozitën në paragrafe, si dhe duke përmendur shprehimisht dy llojet kryesore të kontratës së sigurimit, sigurimin e pasurisë dhe sigurimin e personit, gjë që ligjvënësi italian nuk e ka bërë.

Por, në thelb duhet të pranojmë se, konceptet mbi kuptimin e kontratës së sigurimit si në ligjin italian dhe në ligjin shqiptar janë të njëta dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, përderisa Kodi Civil shqiptar këtë rregullim ligjor e ka marrë tek Kodi civil italian. Kështu tek të dy ligjet bëhet dallimi ndërmjet kontratës së sigurimit të personit dhe kontratës së sigurimit të pasurisë (edhe pse në Kodin Civil shqiptar në mënyrë të shprehur dhe në atë italian në mënyrë të heshtur dhe të nënkuptuar), ku tek sigurimi i pasurisë siguruesi duhet të shpërblejë dëmin e pësuar mbi pasurinë të siguruarit, brenda kufijve të caktuar në kontratë, ndërsa tek sigurimi i personit, siguruesi duhet të pagujë një shumë të hollash në favor të të siguruarit, për dëmet e pësuar në jetën ose shëndetin e tij. I vetmi dallim ndërmjet ligjit italian dhe ligjit shqiptar në lidhje me kuptimin e kontratës së sigurimit të personit, është fakti se në ligjin italian është parashikuar në mënyrë të shprehur se siguruesi në këtë rast mund të pagujë edhe një rentë jetësore në favor të të siguruarit me ndodhjen e rastit të

⁷¹ Neni 1882 i Kodit Civil italian përcakton: “*Sigurimi është një kontratë në të cilën siguruesi, kundrejt pagimit të primt të sigurimit në favor të tij, është i detyruar që t’i zhdëmtojë të siguruarit, brenda kufijve të caktuar në kontratë, dëmet e shkaktuara nga rasti i sigurimit ose të pagujë në favor të të siguruarit një shumë të hollash apo një rentë jetësore me verifikimin e një ngjarje që shkakton dëme në shëndetin ose jetën e të siguruarit*”.

sigurimit që shkakton dëme në jetën ose shëndetin e tij, gjë që nuk është parashikuar në ligjin shqiptar.⁷²

Në Kodin Civil italian është parashikuar se në mënyrë që një subjekt të dalë me cilësinë e siguresit duhet të plotësojë disa cilësi të caktuara, konkretisht vetëm personat juridikë mund të dalin me cilësinë e siguresit. Po ashtu, ky Kod ka parashikuar se një kategori e caktuar personash juridikë nuk mund të ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimeve, siç janë institucionet publike apo edhe shoqëritë aksionare të cilat rregullohen me anë të ligjeve të veçanta.

Një rregullim të veçantë është parashikuar në ligjin civil italian në lidhje me sigurimin e kredive dhe për sigurimin kundër rreziqeve të transportit detar. Në lidhje me sigurimin e kredive është përcaktuar se sigurimi i tyre bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil, por duke mbajtur parasysh veçoritë që paraqet kjo mardhënie juridiko-civile. Për sa i përket sigurimit të rreziqeve të transportit detar, është parashikuar se sigurimi i këtyre rreziqeve bëhet sipas dispozitave të Kodit Detar dhe vetëm për çështjet që nuk janë rregulluar nga ai Kod, zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Në ligj është përcaktuar po ashtu se rregullimi i sigurimeve shoqërore bëhet me anë të ligjeve të veçanta dhe në mungesë të këtyre ligjeve ose për çështje që nuk janë rregulluar nga ligjet e veçanta, zbatohen dispozitat e Kodit Civil italian.

Një veçori tjetër e ligjit civil italian në lidhje me kontratën e sigurimit, e cila nuk është e parashikuar në ligjin shqiptar, është fakti se ligji italian ka bërë përcaktime konkrete në lidhje me ofertën ose propozimit që bën i siguruari për lidhjen e kontratës së sigurimit. Kështu konkretisht ligji ka parashikuar se në rastet kur i siguruari i paraqet me shkrim ofertë siguresit për lidhjen e kontratës së sigurimit, ai qëndron i lidhur me propozimin e tij, domethënë, duhet që të presë përgjigjen e siguresit për lidhjen ose jo të kontratës, për një periudhë prej 15 ditësh dhe për një afat prej 30 ditësh, kur është e nevojshme që të bëhet paraprakisht një vizitë mjekësore të të siguruarit. Ligji ka përcaktuar se ky afat fillon nga dita e dorëzimit të propozimit tek siguresi ose nga dita e dërgimit të këtij propozimi.⁷³

5.2. Forma e lidhjes së kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian.

Përsa i përket formës së lidhjes së kontratës së sigurimit, ligji civil italian po ashtu si ai shqiptar, përcaktojnë se kontrata e sigurimit duhet lidhet me shkrim dhe konkretisht në formën e policës së sigurimit e cila i lëshohet të siguruarit nga siguresi në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Në ligjin italian dispozita që parashikon formën e lidhjes të kësaj kontrate, në ndryshim nga ligji shqiptar, nuk është shprehur që mosrespektimi i formës së përcaktuar në ligj, pra, i formës shkresore, e bën kontratën të pavlefshme. Përkundrazi, po t'i referohemi dispozitës konkrete të

⁷² Renta jetësore është një kontratë e cila rregullohet në Kodin Civil shqiptar nga neni 1065 deri në nenin 1073, por fatëkeqsisht nga rregullimi që i është bërë kësaj kontrate nga Kodi Civil i yni, nuk jepet kuptimi i kësaj kontrate në asnjë prej këtyre dispozitave dhe në këto kushte për të konkluduar se çfarë përfaqëson kjo kontratë do të duhet t'i referohemi të gjithë neneve të Kodit Civil që rregullojnë këtë kontratë si dhe shkencës së të drejtës civile. Duke u referuar sa më sipër mund të konkludojmë se renta jetësore është një kontratë e cila përfaqëson sigurimin e mjeteve të mjaftueshme për jetesë për një ose disa persona, e cila mund të bëhet me anë të kalimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm ose të një shume të hollash me ose pa shpërblim, këtij personi, zakonisht për gjithë jetën e tij. Veçoria tipike e rentës jetësore është fakti se kjo kontratë siguron mjetet e nevojshme për jetesë për një ose disa persona, e cila është e shfaqur zakonisht me anë të përfitimit të një shume të hollash nga personi që përfiton rentën jetësore, çdo muaj ose çdo vit dhe që është e lidhur ngushtë me cilësitë e personit, pra, është një e drejtë që nuk mund të trashëgohet.

⁷³ Neni 1887 i Kodit Civil italian përcakton: *“Pala që i bën propozimin për lidhjen e kontratës së sigurimit, në mënyrë shkresore, duke ia drejtuar direkt siguresit, qëndron e lidhur me këtë propozim për një periudhë prej 15 ditësh, ose prej 30 ditësh kur duhet bërë një vizitë mjekësore. Ky afat fillon nga data e dorëzimit ose dërgimit të propozimit tek siguresi”*

Kodit Civil italian që bën fjalë për formën e lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që është konkretisht paragrafi i parë i nenit 1888 të këtij Kodi, do të konstatojmë se ky paragraf mund të përkthehet, fjalë për fjalë, në këtë mënyrë: “*Kontrata e sigurimit duhet të provohet se është lidhur me shkrim*”, paragraf i cili mund të përkthehet sipas gjuhës juridike, në shqip, në këtë mënyrë: “*Kontrata e sigurimit duhet të lidhet me shkrim në mënyrë që të provohet përballë të tretëve*”.

Nga sa sipër konstatohet se kemi ndryshime ndërmjet ligjit civil italian dhe atij shqiptar, ku ligji italian formën me shkrim të kontratës së sigurimit e kërkon për efekte provueshmërie, përballë të tretëve, pra, kjo kontratë është e vlefshme edhe në qoftë se nuk lidhet nga palët në formë shkresore, por nuk mund të provohet me dëshmitarë, ndërsa sipas ligjit shqiptar forma e kontratës së sigurimit kërkohet për efekte vlefshmërie dhe mos respektimi i formës së kërkuar nga ligji, e bën kontratën e sigurimit të pavlefshme. Një tjetër ndryshim ndërmjet legjislacionin italian dhe atij shqiptar, në lidhje me formën e kontratës së sigurimit, edhe pse më pak i rëndësishëm se i pari, ka të bëjë me faktin se ndërsa ligji italian pranon që kontrata e sigurimit lidhet zakonisht me anë të policës së sigurimit që siguruari i lëshon të siguruarit, por, është më i hapur duke parashikuar se kjo kontratë mund të lidhet edhe me anë të një dokumenti tjetër të ndryshëm nga policia e sigurimit, por, që është i barazvlefshëm me të, ligji shqiptar është i ngurtë në këtë drejtim, nuk lejon asnjë formë tjetër të lidhjes së kontratës së sigurimit, përveç asaj të policës së sigurimit të cilën e lëshon në çdo rast siguruari, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Legjislacioni civil italian në ndryshim nga ai shqiptar, kjo nisur edhe nga fakti se niveli i zhvillimit ekonomik, financiar dhe shoqëror, ndërmjet dy vendeve është i ndryshëm, ka parashikuar edhe një formë të veçantë të kontratës së sigurimit, e cila mund të lidhet edhe në formën e një letre me vlerë me urdhër ose me titull tek prurësi.⁷⁴ Në ligj është përcaktuar se në qoftë se kontrata e sigurimit është lidhur në formën e një letre me vlerë me urdhër ose tek prurësi, transferimi i policës së sigurimit sjell edhe transferimin e të drejtës së kredisë përballë siguruarit, me të njëjtat efekte si cedimi i kredisë. Kjo do të thotë se personi i cili është mbajtës i policës së sigurimit të lëshuar në formën e letrës me vlerë me urdhër ose tek prurësi, ka të njëjtat të drejta përballë siguruarit, si personi që ka lidhur kontratën e sigurimit me siguruarin.

Duke qenë se policia e sigurimit e lëshuar në formën e letrës me vlerë me urdhër ose tek prurësi, është lirisht e transferueshme nga një subjekt tek tjetri, pa iu nënshtruar ndonjë formaliteti të caktuar, ligji italian ka parashikuar se në rastet kur siguruari pa dashje ose pa pakujdesi të rëndë bën pagimin e shumës së sigurimit në favor të xhiruesit, në rastin e policës së sigurimit në formën e letrës me vlerë me urdhër ose në favor të prurësit të kësaj letre me vlerë, siguruari nuk mban përgjegjësi edhe në rastet kur xhiruesi ose përfituesi i letrës me vlerë, nuk ka qenë i siguruari i vertetë. Një parashikim i tillë është më se logjik, sepse përderisa policia e sigurimit në formën e letrës me vlerë, transferohet lirisht nga një subjekt tek tjetri, siguruari është i detyruar që të bëjë

⁷⁴ Letrat me vlerë përfaqësojnë të drejta të caktuara për mbajtësit e tyre, të cilat kanë si veçori kryesore se janë të transferueshme lirisht nga një subjekt tek tjetri. Njihen disa lloje letrash me vlerë si aksionet, obligacionet, etj, si dhe njihen disa klasifikime të letrave me vlerë. Një nga klasifikimet më të njohura të letrave me vlerë është ndarja në letra me vlerë me urdhër dhe letra me vlerë tek prurësi. E përbashkëta e këtyre dy llojeve të klasifikimeve është fakti se transferimi i letrës me vlerë, qoftë me urdhër ose qoftë letër me vlerë tek prurësi, nga një subjekt tek tjetri, sjell automatikisht edhe kalimin e të drejtës që përfaqëson ose bart kjo letër me vlerë. Letrat me vlerë tek prurësi kalojnë automatikisht nga një subjekt tek tjetri dhe prurësi ose mbajtësi i kësaj letre me vlerë prezumohet edhe pronari i tyre dhe në fakt edhe të hollat ose paratë, nuk janë gjë tjetër vetëm letra me vlerë tek prurësi, që i paguhen prurësit më të parë. Letrat me vlerë me urdhër kalojnë nga një subjekt tek tjetri, lirisht, por, për këtë është e nevojshme që të ekzistojë në letrën me vlerë, **një urdhër i mbajtësit të tyre**, ku të përcaktohet se kjo letër me vlerë të kalojë tek një subjekt tjetër, urdhër nga i cili ata kanë marrë emrin.

pagimin e shumës së sigurimit mbatjesit ose prurësit të policës së sigurimit, pavarësisht se ai mund të mos jetë i siguruari i vertetë.

Në qoftë se ndodh një veprimi i tillë, i siguruari i vertetë, duhet të ngrejë padinë e begatimit pa shkak ndaj personit që ka e përfituar pa të drejtë shumën e sigurimit. Polica e sigurimit e lëshuar në formën e letrës me vlerë me urdhër ose tek prurësi, ashtu si të gjitha letrat me vlerë ka rrezik që të humbë, të vidhet apo të asgjësohet, dhe në këto raste ligji italian ka parashikuar se zbatohen të njëjtat dispozita për zhvlerësimin dhe amortizimin e letrave me vlerë me urdhër.

Në Kodin Civil italian janë parashikuar edhe rastet kur kontrata e sigurimit lidhet nga një person në emër të një personi tjetër, pa patur të drejtë personi që lidh kontratën, në emër të tjetrit, për ta bërë një gjë të tillë ose pa qenë i autorizuar për lidhjen e kontratës nga personi tjetër. Në lidhje me këtë situatë juridike në ligj është përcaktuar se në rastet kur ndodh një gjë e tillë, personi në favor të të cilit është lidhur kontrata, mund të mos e miratojë lidhjen e kontratës dhe në këtë rast të gjitha pasojat e kontratës bien mbi kontraktuesin e pautorizuar, ose mund ta miratojë lidhjen e kontratës, madje, edhe pas mbarimit të afatit të saj ose pas verifikimit të rastit të sigurimit.

Kur kontraktuesi lidh një kontratë sigurimi në emër të një personi tjetër, pa e patur një të drejtë të tillë, kontraktuesi është i detyruar që personalisht të përmbushë detyrimet që rrejdhin nga kontrata, deri në momentin që i siguruari është shprehur me shkrim për miratimin ose refuzimin e kontratës. Po ashtu, ky kontraktues, detyrohet përballë siguresit që të paguajë primet e sigurimit për gjatë gjithë periudhës, deri sa personi në favor të të cilit është lidhur kontrata, bën miratimin ose refuzimin e saj.

Një tjetër situatë juridike është parashikuar nga ana e ligjit italian, e cila ka të bëjë me rastet kur kontrata e sigurimit lidhet nga kontraktuesi, për llogari të një personi tjetër. Në këto raste kontrata e sigurimit lidhet ose me anë të prokurës ose me anë të kontratës së porosisë mbi bazën e të cilës kontraktuesi vepron vetë në emër të tij, por, për llogari të të siguarit. Kur kontraktuesi vepron për llogari të një personi tjetër për lidhjen e kontratës së sigurimit, ai është i detyruar që të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata, me përjashtim të atyre që janë të lidhur ngushtë me cilësitë personale të të siguarit.

Pavarësisht nga fakti se kontrata e sigurimit në këtë rast lidhet nga ana e kontraktuesit dhe detyrimet që burojnë prej saj përmbushen nga ana e kontraktuesit, të drejtat që rrjedhin nga kontrata i takojnë të siguarit, dhe personi që ka lidhur kontratën, edhe nëse është posedues i policës së sigurimit, nuk mund t'i bëjë të vlefshme këto të drejta, pa pëlqimin me shkrim të të siguarit, në të cilën ai shprehet nëse është dakort për lidhjen e kontratës për llogari të tij. Siguruesi, në llogari të të cilit është lidhur kontrata, ka të drejtë të bëjë të gjitha prapsimet që i takojnë personit që ka lidhur kontratën për llogari të tij, kundrej siguresit, në varësi të llojit të kontratës së sigurimit të lidhur.

Nga ana tjetër, personi që ka lidhur kontratën për llogari të të tjerëve, ka të njëjtat të drejta mbi shumën e sigurimit që paguhet nga siguruesi, me ndodhjen e rastit të sigurimit, ashtu si ruajtësi i kredisë për shpenzimet e bëra për ruajtjen e kredisë, për rikthimin e primeve të paguara siguresit dhe për rikthimin e shpenzimeve të lidhjes së kontratës. Një nga detyrimet me të rëndësishme të të siguarit në kontratën e sigurimit sipas ligjit civil italian dhe shqiptar, është detyrimi për të dhënë informata të sakta në lidhje dhe çdo rrethanë që ka të bëjë me ndodhjen dhe përcaktimin e sasisë së rrezikut të sigurimit, ku nga ana e të dy ligjeve dallohen qartë dy situata juridike.

Situata e parë juridike i referohet rasteve kur i siguruari me dashje ose pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për ekzistencën e rrethanave që kanë të bëjnë me ndodhjen dhe ekzistencën e rrezikut të sigurimit dhe situata e dytë ka të bëjë me rastet kur i siguruari nga pakujdesia e lehtë ose neglizhenca jep informata të pasakta, ose hesht për ekzistencën e këtyre rrethanave. Zgjdhja e dhënë nga ana e të dy ligjeve për situatën e parë, kur i siguruari me dashje

ose pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për ekzistencën e rrethanave që kanë të bëjnë me ndodhjen dhe ekzistencën e rrezikut të sigurimit, është pothuajse e njëjtë, megjithatë, në ligjin shqiptar është pranuar edhe një alternativë shtesë për siguruesin, e cila nuk gjendet në ligjin italian. Konkretisht sipas ligjit italian në qoftë se i sigururi me dashje ose pakujdesi të rëndë, jep informata të pasakta ose hesht për ekzistencën e rrethanave që kanë të bëjnë me ndodhjen dhe ekzistencën e rrezikut të sigurimit, informata të cilat janë të atilla që po të ishin ditur nga siguruesi në momentin e lidhjes së kontratës, ai nuk do ta kishte lidhur kontratën ose nuk do ta kishte lidhur kontratën në ato kushte, siguruesi ka vetëm një të drejtë, të kërkojë anulimin e kontratës, duke përfituar me këtë rast primet e sigurimit të paguara deri në momentin e anulimit të kontratës dhe në çdo rast primet e sigurimit për vitin e parë të vazhdimin të kontratës.

Sipas ligjit civil shqiptar siguruesi në qoftë se i siguruari me dashje ose pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për rrethana që po të ishin ditur nga siguruesi ai nuk do ta kishte lidhur fare kontratën ose nuk do ta kishte lidhur në ato kushte, ka përveç të drejtës për të kërkuar anulimin e kontratës, edhe të drejtën për të kërkuar ndryshimin e primit të sigurimit, ndryshimin e shumës së sigurimit ose ndryshimin e afatit të sigurimit. Dhënia e një mundësie të tillë shtesë siguruesit në këto raste, mendoj se është një zgjedhje e duhur nga ana e ligjvënësit shqiptar, kjo për faktin se në varësi të llojit të kontratës së sigurimit të lidhur, siguruesi mund të jetë i interesuar jo për anulimin e kontratës, por, për ndryshimin e primit të sigurimit ose të shumës së sigurimit apo të afatit të sigurimit, në rastet kur i siguruari me dashje ose pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për ekzistencën e rrethanave që përcaktojnë ndodhjen dhe sasinë e rrezikut të sigurimit.

Në një situatë të tillë, siguruesi sipas ligjit civil shqiptar, ashtu si dhe atij italian, ka të drejtë që në rastet kur zgjedh të kërkojë anulimin e kontratës, të përfitojë primet e sigurimit deri në momentin e anulimit të kontratës dhe në çdo rast primet e sigurimit për vitin e parë të ekzistencës së kontratës. Po ashtu, sipas këtyre dy ligjeve, e drejta e siguruesit për të kërkuar anulimin e kontratës duhet të ushtrohet **brenda tre muajve**, duke filluar ky afat nga dita që siguruesi ka marrë dijeni për ekzistencën e deklarimeve të pasakta ose heshtjen të bëra me dashje ose pakujdesi të rëndë nga ana e të siguruarit. Në këto raste në qoftë se ndodh ngjarje e sigurimit pa kaluar afati tre mujor i mësipërm, brenda të cilit siguruesi ka të drejtë që të kërkojë anulimin e kontratës, **siguruesi nuk detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit**.

Zgjidhja juridike e dhënë nga legjislacioni italian dhe shqiptar në lidhje me situatën e dytë, kur i siguruari pa dashje dhe jo me pakujdesi të rëndë, ka bërë deklarime të pasakta ose ka heshtur për rrethana për të cilat po të ishin ditur nga siguruesi në kohën e lidhjes së kontratës, ai (siguruesi) nuk do ta kishte lidhur kontratën ose nuk do ta kishte lidhur me ato kushte, është e njëjtë. Të dy legjislacionet pranojnë se siguruesi nuk ka të drejtë që të kërkojë anulimin e kontratës në këtë rast, por, ai ka të drejtë që brenda tre muajve të heqë dorë nga kontrata, me anë të një njoftimi me shkrim që i bën të siguruarit.

Në raste të tilla, në qoftë se rasti i sigurimit vertetohet para se deklarimet e rreme ose heshtja e të siguruarit, pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë, të jenë njohur nga ana e siguruesit, ose para se ky i fundit të ketë deklaruar për heqjen dorë nga kontrata, shumën e sigurimit që duhet të paguajë siguruesi për ndodhjen e rastit të sigurimit, reduktohet në përpjestim me diferencën ndërmjet primit të paguar, dhe primit që do të ishte paguar nëse do të ishte njohur gjendja reale e rrethanave në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit. Pra, konstatojmë se ka ndryshime thelbësore në lidhje me pagimin e shumës së sigurimit nga siguruesi, në rastet kur i siguruari jep informata të pasakta ose hesht me dashje ose pakujdesi të rëndë, me rastet kur ai këto informata ose heshtjen e bën pa dashje dhe pa pakujdesi të rëndë. Kur i siguruari me dashje ose pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për rrethanat që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e rrezikut të sigurimit, në

qoftë se ndodh rasti i sigurimit, brenda afatit tre mujor kur siguruesi ka të drejtë që të anullojë kontratën, siguruesi nuk është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit. Nga ana tjetër, në qoftë se i siguruari pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë, jep informata të pasakta ose hesht për rrethanat që kanë rëndësi thelbësore për rrezikun e sigurimit, në qoftë se ndodh rasti i sigurimit, brenda afatit tre mujor brenda të cilit siguruesi ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, siguruesi në këto raste detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit, por kjo shumë reduktohet në përpjestim me diferencën ndërmjet primit të paguar, dhe primit që do të ishte paguar nëse do të ishte njohur gjendja reale e rrethanave në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit.

5.3. Ekzistenca e rrezikut të sigurimit, si kusht për lidhjen e kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil italian.

Një tjetër çështje e trajtuar nga ana e ligjit civil italian, ashtu si edhe atij shqiptar, është çështja e ekzistencës së rrezikut të sigurimit, në kohën e lidhjes së kontratës, si dhe gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj. Konkretisht të dy legjislationet parashikojnë se kontrata e e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar asnjëherë, ose pushon se ekzistuari para se të lidhet kontrata. Ekzistenca e rrezikut të sigurimit të kontrata e sigurimit është i lidhur me atë që njihet nga shkenca e të drejtës civile dhe ligji civil, **si shkak i ligjshëm për lidhjen e kontratës.**

Ashtu siç dihet nga teoria e të drejtës civile, në mënyrë që një kontratë e çdo lloji, të jetë e vlefshme, ajo duhet të plotësojë disa kushte thelbësore për lidhjen e saj, një prej të cilëve është ekzistenca e shkakut të ligjshëm për lidhjen e kontratës. Shkak i ligjshëm përfaqëson qëllimin tipik ose arsyen bazë që i shtyn palët të lidhin një kontratë, e cila për çdo kontratë është një dhe i vetëm dhe ky shkak i ligjshëm nuk duhet të ngatërrohet me motivet e lidhjes së kontratës, të cilat janë nga më të ndryshme dhe zakonisht nuk kanë rëndësi për të drejtën ose ligjin. Shkak i ligjshëm tek kontrata e sigurimit është i lidhur me ekzistencën e rrezikut të sigurimit, sepse në qoftë se nuk ekziston ky rrezik, i cili me ndodhjen e tij do t'i shkaktojë dëme të siguruarit në jetën, shëndetin ose pasurinë e tij, atëherë nuk ekziston as qëllimi bazë dhe arsyeja juridike pse palët do të lidhin kontratën e sigurimit, për pasojë nuk ekziston as shkak i ligjshëm, për lidhjen e saj, duke e bërë kontratën të pavlefshëm.

Nisur nga fakti se ekzistenca e rrezikut të sigurimit është një kusht “sine qua non” ose një kusht pa të cilin nuk mund të ekzistojë kontrata e sigurimit, kjo kontratë do të zgjidhet ose do të pushojë edhe në rastet kur rreziku i sigurimit pushon pas lidhjes së kontratës së sigurimit. Në raste të tilla siguruesi ka të drejtë të kërkojë pagimin e primeve të sigurimit, derisa pushimi i rrezikut të sigurimit t'i jetë komunikuar ose ai të ketë marrë dijeni nga rrethana të qarta për pushimin e tij.

Po ashtu, primet e sigurimit për periudhën e sigurimit nga momenti i lidhjes së kontratës, deri në momentin e njoftimit të pushimit të rrezikut të sigurimit, ose deri në momentin që siguruesi ka marrë dijeni nga rrethana të qarta për pushimin e tij, duhet të paguhen plotësisht nga i siguruari. Në qoftë se kontrata e sigurimit është lidhur me kusht pezullues, domethënë, që efektet e saj do të fillojnë në një moment të mëvonshëm, pas lidhjes së kontratës së sigurimit, dhe rreziku i sigurimit pushon para se të jetë vertetur kushti pezullues i kontratës, pas të cilat ajo do të fillonte efektet e saj, siguruesi nuk ka të drejtë që të kërkojë pagimin e primeve si më sipër, por, ka të drejtë të kërkojë nga i siguruari vetëm pagimin e shpenzimeve që ka bërë për lidhjen e kontratës.

Në lidhje me rregullimin ligjor të kontratës së sigurimit, Kodi Civil italian, në ndryshim nga Kodi Civil i yni, ka parashikuar edhe një situatë tjetër juridike që ka të bëjë me zvogëlimin e rrezikut të sigurimit, për shkak të rrethanave që kanë ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, por që nuk i janë njoftuar siguruesit nga i siguruari. Konkretisht, në rast se i siguruari i njofton

siguruesit ndryshime në rrezikun e sigurimit, të cilat po të ishin ditur në momentin e lidhjes së kontratës, do të kishin sjellë përcaktimin e pagimit të një primi më të vogël nga i siguruari, siguruesit, nuk mund t'i kërkohej pagimi në të ardhmen i një primi me të vogël prej të siguruarit, por, siguruesit i njihet e drejta që të heqë dorë nga kontrata, brenda dy muajve nga dita që i është bërë ky njoftim.⁷⁵

Një zgjidhje e tillë është bërë nga ana e ligjvënsit duke u nisur nga fakti se siguruesi nuk mund të detyrohet që të ndryshojë kushtet e kontratës jashtë vullnetit të tij dhe në dëm të tij, duke iu kërkuar që të pranojë pagimin e një primi sigurimi më të vogël në të ardhmen, për rrethana që ai nuk i dinte, por, ligji i ka njohur të drejtën siguruesit që brenda dy muajve të heqë dorë nga kontrata. Natyrisht, në qoftë se siguruesi është dakort që me njoftimin e rrethanave që tregojnë uljen e rrezikut të sigurimit, të pranojë në të ardhmen pagimin e primeve më të vogla në favor të tij, ai e ka plotësisht një të drejtë të tillë, dhe në këto raste ai nuk është i detyruar që të heqë dorë nga kontrata, por, ligji ka parashikuar se, kundër vullnetit të tij, siguruesi nuk është i detyruar që të pranojë pagimin e primeve më të ulta nga i siguruari, në këtë rast, duke i njohur të drejtën siguruesit që të heqë dorë nga kontrata në rrethana të tilla.

Nga ana e ligjit italian është parashikuar një klauzolë e tillë e cila mendoj se ka nevojë për interpretim, sipas të cilës heqja dorë nga kontrata nga ana e siguruesit ka efekte pas një muaji. Në këtë rast lind pyetja: Si duhet kuptuar shprehja që heqja dorë e siguruesit nga kontrata sjell efekte pas një muaji? Në lidhje me këtë pyetje kam mendimin se përgjigja e saj ka të bëjë me faktin se në qoftë se ngjarja e sigurimit ndodh brenda një muaji nga koha që siguruesi ka hequr dorë nga kontrata, kjo heqje dorë nuk ka efekte dhe siguruesi është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë. Nga ana tjetër në qoftë se rasti i sigurimit ndodh pas kalimit të afatit një muaj kur siguruesi ka hequr dorë nga kontrata, kjo heqje dorë sjell efektet e saj, kontrata quhet e zgjidhur dhe siguruesi nuk detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit në favor të të siguruarit.

5.4. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën e sigurimit të pasurisë sipas Kodit Civil italian.

Legjisllacioni civil italian, ashtu si dhe ai shqiptar si një nga detyrimet kryesore të të siguruarit në kontratën e sigurimit parashikojnë edhe detyrimin që ka i siguruari që të njoftojë menjëherë siguruesin për çdo ndryshim i cili rrit rrezikun e sigurimit, në mënyrë të atillë që, gjendja e re e krijuar po të kishte ekzistuar ose të ishte e njohur në momentin e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur kontratën ose do ta kishte lidhur për një prim më të lartë. Zgjidhjet që jep legjisllacioni italian dhe ai shqiptar në rast se i siguruari nuk e përmbush këtë detyrim janë të ndryshme. Kështu sipas ligjit italian në qoftë se i siguruari nuk njofton menjëherë siguruesin për çdo ndryshim të rrethanave që shtojnë rrezikun e sigurimit, siguruesi ka vetëm një të drejtë kryesore në lidhje me fatin e kontratës, të heqë dorë nga kontrata, brenda një muaji nga marrja dijeni për ekzistencën e këtyre rrethanave, duke njoftuar për këtë me shkrim të siguruarin.

Nga ana tjetër, sipas ligjit civil shqiptar, në qoftë se i siguruari nuk njofton menjëherë siguruesin për ndryshimin e rrethanave që shtojnë rrezikun e sigurimit, gjatë kohës së vazhdimit të kontratës, siguruesi mund të ushtrojë një nga këto të drejta:

- a) të ndryshojë masën e primit të sigurimit;

⁷⁵ Paragrafi i parë i nenit 1897 i Kodit Civil italian përcakton: "Në qoftë se i siguruari i njofton siguruesit ndryshime në rrezikun e sigurimit, të cilat po të ishin ditur në momentin e lidhjes së kontratës, do të kishin sjellë përcaktimin e pagimit të një primi më të vogël nga i siguruari, siguruesi duke filluar nga momenti i mbarimit të afatit të pagimit të primit ose të kësteve të tij, nuk mund t'i kërkohej pagimi në të ardhmen i një primi me të vogël prej të siguruarit, por, siguruesi ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, brenda dy muajve nga dita që i është bërë ky njoftim".

- b) të ndryshojë shumën e sigurimit;
- c) të ndryshojë afatin e kontratës së sigurimit;
- d) të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Në ligjin italian, në ndryshim nga ligji shqiptar, (për të cilin mendoj se duhej t'i kishte parashikuar), janë përcaktuar edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me efektet e heqjes dorë nga kontrata prej siguresit, si dhe me të drejtën që ka siguresi në lidhje me primet e sigurimit dhe me ndodhjen e rastit të sigurimit. Konkretisht sipas Kodit Civil italian heqja dorë e siguresit nga kontrata ka efekt të menjëhershëm, nëse zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që siguresi nuk do ta kishte lidhur kontratën dhe ka efekt pas pesëmbëdhjetë ditësh, nëse zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që siguresi do ta kishte lidhur kontratën, kundrejt pagimit të një primi më të lartë nga i siguruari.

Rëndësia që ka përcaktimi i afatit se kur fillon që të ketë efekt heqja dorë nga kontrata nga ana e siguresit, u sqarua nga ana jonë më lart, kur u trajtuan rrethanat që zvogëlojnë rrezikun e sigurimit, kjo do të thotë se në rastin konkret në qoftë se heqja dorë ka efekt të menjëhershëm (nëse zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që siguresi nuk do ta kishte lidhur kontratën), siguresi nuk detyrohet asnjëherë për pagimin e shumës së sigurimit. Nga ana tjetër, në qoftë se heqja dorë ka efekt pas pesëmbëdhjetë ditësh (nëse zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që siguresi do ta kishte lidhur kontratën, kundrejt pagimit të një primi më të lartë nga i siguruari), në rast se ndodh ngjarja e sigurimit në periudhën brenda 15 ditëve nga heqja dorë nga kontrata, siguresi detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit ndaj të siguarit, por, kjo shumë zvogëlohet në përpjestim me raportin e primit të përcaktuar në kontratë, dhe primit që duhet të ishte përcaktuar nëse zmadhimi i rrezikut do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës.

Në ligjin italian po ashtu është përcaktuar se në qoftë se rasti i sigurimit vertetohet para se të kenë kaluar afatet për njoftimin e heqjes dorë nga kontrata (afat i cili është një muaj), siguresi nuk ka përgjegjësi për pagimin e shumës së sigurimit, në rast se zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që ai nuk do ta kishte lidhur kontratën, nëse gjendja e re e krijuar do të ekzistonte në momentin e lidhjes së kontratës. Nga ana tjetër, në qoftë se rasti i sigurimit vertetohet para se të kenë kaluar afatet për njoftimin e heqjes dorë nga kontrata, siguresi do të bëjë pagimin e shumës së sigurimit, në rast se zmadhimi i rrezikut të sigurimit është i atillë që ai do ta kishte lidhur kontratën me një çmim më të lartë, nëse gjendja e re e krijuar do të ekzistonte në momentin e lidhjes së kontratës, por vlera e shumës së sigurimit zvogëlohet në përpjestim me raportin e primit të përcaktuar në kontratë, dhe primit që duhet të ishte përcaktuar nëse zmadhimi i rrezikut do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës. Kur siguresi heq dorë nga kontrata e sigurimit për shkak të mosnjoftimit të rrethanave që rëndojnë rrezikun e sigurimit në mënyrë të atillë që po të ishin ditur në kohën e lidhjes së kontratës, siguresi nuk do ta kishte lidhur kontratën, ligji italian i ka njohur siguresit të drejtën për të përfutur primet e sigurimit të paguara nga i siguruari, në periudhën nga momenti i lidhjes së kontratës së sigurimit, deri në momentin e heqjes dorë prej tij nga kontrata.

Kur kemi folur për veçoritë e kontratës së sigurimit në fillim të këtij punimi, kemi thënë se një nga veçoritë kryesore të kësaj kontrate, është se kjo kontratë është kontratë me afat të përcaktuar dhe afati tek kontrata e sigurimit ka një rëndësi thelbësore, jo vetëm për faktin se ky afat, në ndryshim nga të gjitha kontratat e tjera, llogaritet jo vetëm me ditë, por edhe me orë dhe minuta, por, edhe për faktin tjetër se **mospërcaktimi i afatit të fillimit dhe mbarimit të kontratës së sigurimit e bën këtë kontratë të pavlefshme**. Të njëtin qëndrim me ligjin shqiptar mban edhe legjislacioni italian në të cilin është përcaktuar se kontrata e sigurimit i fillon efektet nga ora njëzetë

e katër të ditës së lidhjes së kontratës, deri në orën njëzetë e katër të ditës së fundit të afatit të kontratës.

Po ashtu, në ligji italian në mënyrë identike si ligji shqiptar, është parashikuar se në qoftë se kontrata e sigurimit është lidhur për një afat mbi dhjetë vjet, çdo palë ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pas plotësimit të këtij afati, me anë të një njoftimi me shkrim të bërë palës tjetër për një periudhë të paktën gjashtëmujore, si dhe fakti që kjo kontratë mund të ripërtrihet në heshtje një ose disa herë, por, çdo ripërtritje nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet. Në fakt dispozita e nenit 1124 të Kodit Civil shqiptar që rregullon afatin e kontratës së sigurimit, është marrë në mënyrë identike nga neni 1899 i Kodit Civil italian, çka tregon edhe njëherë konstatimin e bërë nga ana ime se, një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit tonë Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit, por edhe kontrata të tjera të të drejtës civile, janë marrë nga Kodi Civil italian.

Një nga detyrimet që ka siguruasi në kontratën e sigurimit është pagimi i shumës së sigurimit ose shpërblimit të sigurimit, në qoftë se ndodh rasti i sigurimit i parashikuar nga palët në kontratë. Megjithatë, si ligji civil italian, ashtu edhe ai shqiptar, parashikojnë disa rrethana kur siguruasi përjashtohet nga detyrimi për të paguar shumën e sigurimit edhe pse ka ndodhur rasti i sigurimit, rrethana që i referohen rasteve kur dëmi është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të kontraktuesit, të siguruasit ose të përfituesit të sigurimit.

Por, ajo ku dallojnë këto dy ligje në lidhje me përgjegjësinë e siguruasit në këtë rast, ka të bëjë me faktin se ndërsa dispozita ligjore e parashikuar nga ligji shqiptar, është një dispozitë urdhëruese, pra, duhet të zbatohet detyrimisht nga palët dhe palët nuk mund të shmangin as me marrëveshje të tyre zbatimin e kësaj dispozite, sipas ligjit italian kjo dispozitë është në mënyrë të pjesshme lejuese, pra, palët mund të parashikojnë ndryshe me marrëveshje, por, vetëm përsa i përket pakujdesisë së rëndë. Kjo do të thotë se sipas ligjit italian palët mund të parashikojnë me marrëveshje që siguruasi të detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit edhe në rastet kur rasti i sigurimit është shkaktuar me pakujdesi të rëndë të kontraktuesit, të të siguruarit apo të përfituesit të dhurimit. Ndërsa përsa i përket rasteve të shkaktimit të dëmit me dashje nga këto persona, dispozita ligjore e Kodit Civil italian është me natyrë urdhëruese, njësoj si Kodi ynë Civil, dhe palët nuk mundet që më marrëveshje të parashikojnë që siguruasi të detyrohet që të paguajë shumën e sigurimit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje nga ana e kontraktuesit, ose nga ana e të siguruarit apo përfituesit të dhurimit.

Në lidhje me përgjegjësinë e siguruasit për pagimin e shumës së sigurimit, legjislacioni italian, në ndryshim nga ai shqiptar, parashikon se siguruasi është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit edhe në rastet kur rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë nga persona për veprimet e të cilëve i siguruari është i detyruar që të përgjigjet. Po ashtu, ky legjislacion parashikon se siguruasi është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit edhe në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar nga veprimet e kontraktuesit, të të siguruarit ose të përfituesit, kur këto veprime janë kryer për shkak të detyrimeve të solidaritetit njerëzor ose mbrojtjen e interesave të zakonshme të siguruasit, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.

Një nga detyrimet më të rëndësishme që ka i siguruari në kontratën e sigurimit, sipas legjislacionit italian dhe atij shqiptar, është detyrimi për pagimin e primit të sigurimit, prim i cili mund të paguhet me një veprim të vetëm ose me këste, në varësi të kushteve të përcaktuara në kontratë nga palët. Sipas legjislacionit italian dhe po ashtu edhe sipas legjislacionit shqiptar, i cili në rregullimin e kësaj çështjeje është bazuar tek ligji italian dhe neni 1125 i Kodit Civil shqiptar, përfaqëson në vetëvete dy paragrafët e parë të nenit 1901 të Kodit Civil italian, mospagimi i primit të sigurimit nga ana e të siguruarit, sjellë si pasojë pezullimin e kontratës së sigurimit, deri në momentin që ky prim të paguhet nga ana e të siguruarit.

Konkretisht është parashikuar se në qoftë se kontraktuesi ose i siguruari nuk paguan primin e sigurimit ose këstin e parë të tij, brenda afatit të përcaktuar në kontratë, kontrata e sigurimit pezullohet deri në orën njëzetë e katër të ditës kur i siguruari të përmbushë këtë detyrim. Në rastet kur në kontratën e sigurimit është përcaktuar që primi i sigurimit të paguhet me këste dhe i siguruari paguan këstin e parë të primit të sigurimit, por, nuk paguan këstet e tjera në vazhdim, të parashikuara në kontratë, kontrata e sigurimit pezullohet deri në orën njëzetë e katër të ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit të këtij primi.

Ligji civil italian në ndryshim nga ai shqiptar, ka përcaktuar se gjendja e pezullimit të kontratës së sigurimit nuk mund të vazhdojë pa afat, dhe në qoftë se i siguruari nuk paguan primin e sigurimit ose këstet e tij, brenda gjashtë muajve nga data që është bërë pezullimi i kontratës, kontrata e sigurimit zgjidhet në mënyrë automatike. Në rastet që kontrata e sigurimit zgjidhet për një shkak të tillë, siguruasi ka të drejtë që të përfitojë primet e sigurimit të paguar deri në periudhën që kontrata e sigurimit zgjidhet, si dhe ka të drejtë të kërkojë shpenzimet që ka bërë për lidhjen e kësaj kontrate.⁷⁶ Mosparashikimi nga ana e Kodit tonë Civil i një afati brenda të cilit mund të qëndrojë e pezulluar kontrata e sigurimit për shkak të mos pagimit të primit ose këstit të sigurimit nga i siguruari, si dhe mosparashikimi i pasojave që sjell ky pezullim dhe të drejtave që i takojnë siguruasit kjo kontratë zgjidhet për këtë shkak, mendoj se përbën një mangësi të Kodit tonë Civil, e cila duhet të rregullohet sa më shpejt nga ana e ligjvënësit.

Në ligjin civil italian është parashikuar edhe se çfarë ndodh me kontratën e sigurimit në rastet kur shoqëria siguruase i nënshtrohet procedurave ligjore të bashkimit ose ndarjes si dhe rastet kur kjo shoqëri i nënshtrohet procedurave të falimentimit të detyruar administrativ. Në rastet kur shoqëria siguruase bashkohet me dy ose më shumë shoqëri të tjera siguruase, ose ndahet në dy ose më shumë shoqëri të tjera, kontrata e sigurimit nuk zgjidhet në këtë rast, por, vazhdon si më parë, ku të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së bashkuar ose të ndarë, kalojnë tek shoqëria e bashkuar ose tek shoqëritë e ndara, në përputhje me marrëveshjen e bashkimit ose ndarjes së kësaj shoqërie. Në qoftë se shoqëria siguruase i nënshtrohet procedurave të detyrueshme të falimentimit, ky fakt përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, dhe kjo kontratë zgjidhet sipas procedurës dhe efekteve të parashikuara në ligje të veçanta për këtë qëllim, të cilat duhet të mbajnë parasysh në çdo rast të drejtat dhe privilegjet që ka i siguruari nga kontrata e sigurimit.

Duke u nisur nga zhvillimi ekonomik dhe social që ka shteti italian, i cili sigurisht është i ndryshëm nga ai i shtetit shqiptar, në Kodin Civil italian është parashikuar në mënyrë të shprehur edhe pozita që ka agjenti i sigurimeve në këtë kontratë. Kuptohet se agjenti i sigurimeve për lidhjen e kontratës së sigurimit vepron sipas dispozitave ligjore që rregullojnë kontratën e agjensisë, e cila është një kontratë tipike për një ekonomi të zhvilluar tregu, dhe ku detyrimi bazë i agjentit është që të kryejë veprimet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e kontratës në emër të tij, por, për llogari dhe interes të palës që vepron, e cila në kontratën e sigurimit mund të jetë zakonisht siguruasi, por edhe i siguruari.

Ligji italian shprehet se agjenti i sigurimeve gjatë lidhjes së kontratës së sigurimit është i detyruar që t'i kryejë veprimet e tij në përputhje me përcaktimet e bëra në kontratë, si dhe mund të kryejë edhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me lidhjen e kontratës së sigurimit, brenda kufijve të caktuar në kontratën e agjensisë, e cila në ligjin italian njihet me termin e përgjithshëm **prokurë**.

⁷⁶ Paragrafi i tretë i nenit 1901 të Kodit Civil italian përcakton: “Në hipotezat e parashikuara në dy paragrafët e mësipërm, kontrata e sigurimit zgjidhet automatikisht nëse siguruasi brenda një afati gjashtë mujor, duke filluar nga dita që primi ose këstet e tij duhej të ishin paguar, nuk arrin që të nxjerrë primin e sigurimit; siguruasi ka të drejtë vetëm të përfitojë pagimin e primeve respektive për periudhën e sigurimit në vazhdim, si dhe kthimin e shpenzimeve që ka bërë. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim për kontratën e sigurimit të jetës”.

Ky ligj po ashtu, i njeh të drejtën agjentit të sigurimeve që të nxisë kryetjen e veprimeve në favor të siguruesit, në përmbushje të detyrimeve të tij për lidhjen e sa më shumë kontratave të sigurimit, në favor të siguruesit për llogarinë e të cilit ai vepron.

Në Kodin Civil italian, po ashtu si edhe në Kodin tonë Civil në disa dispozita është rregulluar në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra, kontrata e sigurimit të pasurisë dhe kontrata e sigurimit të personit. Në lidhje me kontratën e sigurimit të pasurisë një nga çështjet më të rëndësishme të rregulluar nga të dy Kodet është çështja e **ekzistencës së interesit të sigurueshëm të të siguruarit** mbi pasurinë që siguron, i cili duhet të ekzistojë jo vetëm në momentin e lidhjes së kontratës, por edhe gjatë gjithë kohës së vazhdimit të saj.

Koncepti i “interesit të sigurueshëm” nuk jepet në ligj, por bëhet nga shkenca e të drejtës civile, sipas të cilit një subjekt ka interes të sigurueshëm për të siguruar një pasuri, në qoftë se ai nga dëmtimi ose shkatërrimi i pasurisë çenohet në mënyrë direkte ose indirekte në të drejtat e tij pasurore. Duke iu referuar këtij koncepti kanë interes të sigurueshëm për të siguruar një pasuri, jo vetëm pronari i pasurisë, por, edhe poseduesi, uzufuktari, si dhe çdo person që gëzon një të drejtë reale të paluajtshme mbi këtë pasuri. Koncepti i pasurisë në këtë rast përfshin çdo send që është objekt i botës materiale, që sjell dobi ekonomike dhe vihet në sundim të njeriut, ku përfshihen si sendet e luajtshme dhe ato të paluajtshme dhe në përgjithësi çdo send që është i ligjshëm në qarkullimin civil.

Interesi i sigurueshëm përbën në vetevete një nga elementët thelbësore ose esenciale të kontratës së sigurimit të pasurisë, mungesa e të cilit bën që kjo kontratë të jetë absolutisht e pavlefshme. Një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë të shprehur në ligjin italian në të cilin thuhet se kontrata e sigurimit të pasurisë është e pavlefshme në qoftë se në momentin e lidhjes së saj, nuk ekziston një interes i të siguruarit për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Jo vetëm aq, por interesi i sigurueshëm i të siguruarit duhet të ekzistojë gjatë gjithë kohës së vazhdimit të kontratës së sigurimit të pasurisë, sepse në qoftë se ai pushon gjatë kohës së kontratës është në fuqi, kontrata zgjidhet në mënyrë automatike dhe bëhet kthimi i palëve në gjendjen e mëparashme.

Një nga detyrimet e siguruesit në kontratën e sigurimit të pasurisë është detyrimi për të shpërlyer të siguruarin për dëmin që ka pësuar në pasurinë e tij, si pasojë e ndodhjes së rastit të sigurimit. Shpërblimi i dëmit nga ana e siguruesit në favor të të siguruarit, bëhet brenda kufijve të përcaktuar në kontratë dhe sipas procedurës së caktuar nga dispozitat ligjore ose nga vullneti i palëve. Legjislati i italian dhe ai shqiptar parashikojnë me dispozita lejuese se si rregull siguruari është i detyruar që të shpërblejë vetëm dëmin efektiv që i shkaktohet pasurisë së siguruar dhe jo edhe fitimin e munguar, përveç kur palët me marrëveshje kanë parashikuar ndryshe. Kjo do të thotë se kur palët me marrëveshje në mënyrë të shprehur përcaktojnë se siguruari është i detyruar që të shpërblejë jo vetëm dëmin efektiv që i është shkaktuar pasurisë së siguruar, por edhe fitimin e munguar, kjo marrëveshje është plotësisht e vlefshme dhe siguruari është i detyruar që ta përmbushë këtë detyrim që ka marrë përsipër me vullnetin e tij.

Në Kodin Civil italian ndryshe nga ai shqiptar, është parashikuar se siguruari nuk përgjigjet ose përgjigjet në mënyrë të kufizuar, për shpërblimin e dëmeve që i janë shkaktuar pasurisë së siguruar, në qoftë se këto dëme janë shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit. Me këtë rast lind nevoja që të bëhet sqarimi shkurtimisht i konceptit “e metë e fshehtë e sendit”, një koncept i cili është shumë i rëndësishëm tek kontrata e shitjes, sipas ligjit shqiptar, por, që sipas ligjit italian, ka të njëjtën rëndësi edhe për kontratën e sigurimit. Sipas shkencës së të drejtës civile me të meta të fshehta të sendit do të kuptojmë ato të meta që kanë ekzistuar tek sendi që para se të lidhej kontrata dhe që dihen nga pronari i sendit dhe që janë të atilla që nuk duken në pamjen e jashtme pas një kontrolli normal të sendit, por, shfaqen me kalimin e një kohë të caktuar gjatë përdorimit të sendit.

Nisur nga kuptimi që shkenca e të drejtës civile i jep konceptit të të metës së fshehtë të sendit, rezulton që në mënyrë që të jemi para këtij koncepti duhet të plotësohen në të njëjtën kohë këto kushte:

- a) Duhet që sendi të paraqesë të meta, domethënë, te ketë mangësi që e pengojnë atë që të funksionojë normalisht;
- b) Duhet që këto të meta të kenë ekzistuar para lidhjes së kontratës;
- c) Duhet që këto të meta të dihen nga pronari i sendit ose personi që gëzon një të drejtë reale apo kontraktuesi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë;
- ç) Duhet që këto të meta të mos konstatohen nga një kontroll normal i pamjes së jashtme që i bëhet sendit;
- d) Duhet që këto të meta të shfaqen pas lidhjes së kontratës së sigurimit, nga përdorimi normal që i bëhet sendit.

Në qoftë se rasti i sigurimit duke i sjellë dëme ose duke e shkatërruar pasurinë e siguruar, shkaktohet nga të metat e fshehta të sendit, sipas ligjit italian siguroesi shkarkohet plotësisht nga detyrimi për shpërblimin e dëmit në qoftë se e meta është e atillë që po të ishte ditur nga siguroesi ai nuk do ta kishte lidhur fare kontratën. Nga ana tjetër, në qoftë se e meta e fshehtë e sendit që shkaktonte rastin e sigurimit, është e atillë që ka zmadhuar sasinë e dëmit që i është shkaktuar sendit të siguruar, përgjegjësia e siguroesit do të kufizohet dhe siguroesi do të përgjigjet der në atë masë, që do të ishte përgjigjur, nëse nuk do të kishte ekzistuar e meta e fshehtë e sendit.⁷⁷

Elementi i fundit që duhet thënë në lidhje me dëmin e shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit, është fakti se ligji italian këtë rregullim ligjor e bën me norma lejuese, çka do të thotë se në qoftë se palët me marrëveshje në mënyrë të shprehur përcaktojnë se siguroesi do të përgjigjet për dëmet që mund të pësojë pasuria e siguruar, edhe në rastet kur këto dëme shkaktohen nga të metat e fshehta të sendit të siguruar, një përcaktim i tillë është plotësisht i vlefshëm dhe siguroesi do të përgjigjet sipas kushteve të përcaktuara prej tij në kontratë. Po ashtu, më duhet të shtoj që mosparashikimi nga ana e Kodit tonë Civil i përjashtimit ose kufizimit të përgjegjësive së siguroesit kur rasti i sigurimit shkaktohet nga të metat e fshehta të sendit, mendoj se përbën një të metë ose mangësi të këtij Kodi, e cila duhet plotësuar.

Ligji italian dhe ai shqiptar parashikojnë se sigurimi i pasurisë mund të bëhet në mënyrë të plotë ose të pjesshme, domethënë, mund të sigurohet e gjithë sendi, duke përfshirë të gjithë vlerën e tij, apo vetëm një pjesë e tij, kjo në varësi të vullnetit të të siguarit. Në qoftë se i siguarit zgjedh që të bëjë sigurimin e sendit ose të pasurisë së tij, vetëm për një pjesë të saj dhe ndodh rasti i sigurimit, duke u shkatërruar ose asgjësuar plotësisht sendi i siguruar, siguroesi përgjigjet për dëmet e shkaktuara në pasurinë e siguruar, në përpjestim me vlerën që është siguruar sendi, me përjashtim të rasteve kur palët kanë parashikuar ndryshe.

Në qoftë se i siguarit e ka siguruar në vlerë të plotë sendin, për përcaktimin e shpërblimit të dëmit që duhet të bëjë siguroesi në favor të të siguarit, rëndësi ka përcaktimi i vlerës së dëmit që duhet të paguajë siguroesi. Kjo vlerë dëmi siguroesit që do të llogaritet sipas kritereve të përcaktuara në kontratë, por, nga ana e ligjit janë vendosur disa rregulla të detyrueshme të cilat duhet të mbahen parasysh nga palët në përcaktimin e vlerës së dëmit. Kështu vlera e dëmit nuk mund të jetë

⁷⁷ Neni 1906 i Kodit Civil italian përcakton: “Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë, i siguarit nuk përgjigjet për për dëmin e ardhur nga të metat e fshehta të sendit të siguruar, të cilat nuk kanë qenë bërë të njohura në momentin e lidhjes së kontratës.

Në qoftë se e meta e fshehtë e sendit ka zmadhuar sasinë e dëmit të shkaktuar sendit të siguruar, i siguarit, me përjashtim të rasteve kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë, përgjigjet në masën që do të ishte përgjigjur, nëse nuk do të kishte ekzistuar e meta e fshehtë e sendit”.

asnjëherë më e madhe se vlera që kishte sendi i siguruar në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit.

Përcaktimi i vlerës së sendit të siguruar, sipas ligjit italian, mund të bëhet në kohën e lidhjes së kontratës, me marrëveshje të veçantë nga palët, ndërkohë që është e vlefshme vlera e sendit që shënohet në policën e sigurimit të pasurisë. Në rastet kur sendi i siguruar janë prodhimet bujqësore dhe këto prodhime janë dëmtuar si pasojë e ndodhjes së rastit të sigurimit, për përcaktimin e dëmit mbahet parasysh vlera që do të kenë këto produkte në kohën e pjekjes së tyre ose në kohën kur ato zakonisht mblidhen.

Kodi Civil italian në ndryshim nga ai shqiptar, ka parashikuar edhe rastet kur nga ana e të siguruarit bëhet sigurimi i pasurisë për një vlerë më të madhe se vlera e pasurisë së siguruar. Zgjidhja e dhënë nga ana e ligjit italian në lidhje me fatin e kontratës së sigurimit të pasurisë të lidhur në këtë mënyrë, është e ndryshme në varësi të faktit nëse i siguruari ka vepruar me dashje ose me pakujdesi.

Në rastet kur i siguruari nga vepruar me dashje dhe ka bërë sigurimin e pasurisë për një vlerë më të madhe se vlera që ka sendi i siguruar, kontrata e sigurimit është e pavlefshme dhe në këto raste, siguresi, në qoftë se ka qenë me mirëbesim, ka të drejtë të përfitojë primet e sigurimit deri në momentin që do të konstohet kjo pavlefshmëri. Nga ana tjetër, në qoftë se i siguruari me pakujdesi ka bërë sigurimin e pasurisë për një vlerë më të madhe se vlera e pasurisë së siguruar, kontrata e sigurimit e lidhur në këto kushte, është e vlefshme, por, vetëm deri në vlerën që ka pasuria e siguruar, ndërkohë që i siguruari ka të drejtë që të përfitojë, në mënyrë përpjestimore, një ulje të primeve të sigurimit në të ardhmen.⁷⁸

I siguruari mund ta sigurojë pasurinë e tij, për të njëjtat rreziqe sigurimi, në një sigures ose në dy ose më shumë sigures, në të njëjtën kohë, situatë juridike e cila është parashikuar dhe zgjidhur në mënyrë të njëjtë, si nga ligji italian, ashtu edhe nga ai shqiptar. Kështu në rastet kur për të njëjtat rreziqe sigurimi dhe për të njëjtën pasuri, janë lidhur në mënyrë të pavarur dy ose më shumë kontrata sigurimi në sigures të ndryshëm, i siguruari ka detyrimin që t'i njoftojë të gjithë siguresit për ekzistencën e këtyre kontratave. Detyrimi i mësipërm i të siguruarit është një detyrim i cili duhet që të përmbushet në çdo rast prej tij, sepse në të kundërt, në qoftë se i siguruari nuk i njofton të gjithë siguresit se për të njëjtën pasuri dhe rreziqe sigurimi, ka lidhur disa kontrata sigurimi, siguresit kanë të drejtë që të mos paguajnë shpërblimin e sigurimit.

I siguruari ka detyrimin jo vetëm që të njoftojë të gjithë siguresit për kontratat e sigurimit që ai ka lidhur për të njëjtën pasuri, në momentin e lidhjes së kontratës, por, ai ka po ashtu detyrimin që të njoftojë të gjithë siguresit, në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj, për ndodhjen e rastit të sigurimit, brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Në këto raste, i siguruari mund të kërkojë pagimin e të gjithë shumës së sigurimit tek një ose disa sigures, por, kjo shumë nuk mund të kalojë në asnjë rast, vlerën e dëmit të pësuar.

Siç mund të konsatohet kur i siguruari ka lidhur disa kontrata sigurimi në sigures të ndryshëm, për të njëjtën pasuri, siguresit qëndrojnë si debitorë solidarë përballë të siguruarit, në lidhje me pagimin e shpërblimit të sigurimit, në qoftë se ndodh rasti i sigurimit. Është kjo arsyeja pse ligji italian, ashtu si edhe ligji shqiptar, kanë parashikuar që siguresi i cili ka paguar shumën e dëmit

⁷⁸ Neni 1909 i Kodit Civil italian përcakton: “*Sigurimi për një shumë që e tejkalon vlerën e sendit të siguruar nuk është i vlefshëm nëse kjo është bërë me dashje nga ana e të siguruarit; siguresi në qoftë se ka qenë me mirëbesim ka të drejtë të primeve të paguar për periudhën deri sa të konstatohet kjo pavlefshmëri. Nëse sigurimi për një shumë më të madhe se vlera e sendit të siguruar nuk është bërë me dashje nga i siguruari, kontrata ka efekt deri në vlerën reale të sendit të siguruar, dhe i siguruari ka të drejtë që të përfitojë në të ardhmen një ulje në mënyrë përpjestimore të primit të sigurimit*”.

për llogari të një ose disa siguruesve të tjerë, ka të drejtën e regresit ndaj siguruesve të tjerë, të cilët nuk kanë paguar, për ndarjen e shumës së sigurimit sipas kontratave përkatëse. Kur e njëta pasuri është e siguruar nga dy ose më shumë sigurues, mund të ndodhë që pas vertetimit të rastit të sigurimit, një ose disa prej tyre të jenë në paaftësi pagueuse ose insolvabël. Në një rast të tillë pjesa e siguresit ose siguruesve që janë insolvabël, ndahet mes siguruesve të tjerë, në përpjestim me detyrimet respektive të ndërmarra në kontratat përkatëse.

Në ligjin italian është parashikuar edhe rasti kur i siguruari e siguron pasurinë e tij në dy ose më shumë sigurues, por, detyrimet e siguruesve përballë të siguarit janë të ndara dhe ekzaktësisht të përcaktuara, raste që njihen edhe si **bashkësigurimi i pasurisë**. Kur ndodhemi para rasteve të tilla, secili sigurues është i detyruar që të paguajë shpërblimin e dëmit në përpjestim me pjesën e tij përkatëse, edhe në rastet kur siguresit kanë nënshkruar një kontratë të vetme me të siguarin.

Kur kemi folur për kontratën e sigurimit në pjesën e parë të kësaj teme, kemi theksuar se në bazë të kësaj kontrate, pasuria nuk sigurohet nga çdo rrezik sigurimi apo ngjarje sigurimi, por vetëm për ato rreziqe sigurimi që palët kanë parashikuar shprehimisht në kontratë. Në përputhje me këtë koncept, legjislacioni italian ka parashikuar se siguresi nuk është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit, në rastet kur rreziku i sigurimit është shkaktuar nga lëkundjet e tokës, lufta, kryengritjet ose trazirat civile. Vlen të theksohet fakti se ligjvënësi italian e ka bërë një përcaktim të tillë me anë të një dispozite lejuese, çka do të thotë se, në qoftë se palët me vullnetin e tyre, parashikojnë shprehimisht në kontratë se, siguresi do të përgjigjet edhe për rreziqet e shkaktuar nga tërmeti, lufta, kryengritja, etj, një përcaktim i tillë është plotësisht i vlefshëm dhe në këtë rast do të zbatohet vullneti i palëve.

Sipas legjislacionit italian një nga detyrimet më të rëndësishme të të siguarit në kontratën e sigurimit të pasurisë është detyrimi i tij **që të njoftojë për ndodhjen e rastit të sigurimit siguresin ose personin e autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës, brenda tre ditëve nga ndodhja e rastit të sigurimit ose nga dita e marrjes dijeni nga i siguruari për ndodhjen e rastit të sigurimit**. I siguruari nuk është i detyruar që ta përmbushë këtë detyrim, në rastet kur siguresi ose personi i autorizuar prej tij, ka ndërhyrë në veprimet për pakësimin e dëmit të ardhur nga rasti i sigurimit ose ka qenë i pranishëm në konstatimin e rastit të sigurimit. Në qoftë se pasuria e siguruar është bagëti ose gjë e gjallë, i siguruari ka detyrimin që të njoftojë siguresin për ndodhjen e rastit të sigurimit, brenda njëzetë e katër orëve nga ndodhja e rastit të sigurimit, përveç rasteve kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.

Detyrimi ligjor që ka i siguruari për të njoftuar siguresin, për ndodhjen e rastit të sigurimit, është një detyrim që duhet të përmbushet në çdo rast nga i siguruari, sepse mospërmbushja e këtij detyrimi prej tij, sjell pasoja direkte për të siguarin. Këto pasoja janë të ndryshme në varësi të faktit nëse i siguruari nuk e njofton siguresin për ndodhjen e rastit të sigurimit me dashje ose nga pakujdesia. Në qoftë se i siguruari me dashje nuk e njofton siguresin për ndodhjen e rastit të sigurimit, ai humbet të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga rasti i sigurimit. Nëse i siguruari nga pakujdesia nuk e përmbush detyrimin e mësipërm, siguresi ka të drejtë që të kërkojë zvogëlimin e shpërblimit të dëmit, në përpjestim me dëmin e pësuar nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve.

Në kontratën e sigurimit të pasurisë i siguruari, sipas ligjit italian, por, edhe atij shqiptar, përveç detyrimit për të njoftuar siguresin për ndodhjen e rastit të sigurimit, brenda afateve ligjore, ka edhe detyrimin që të marrë të gjitha masat për të shmangur ndodhjen e rastit të sigurimit, si dhe për të pakësuar dëmet e shkaktuara nga rasti i sigurimit. Të gjitha shpenzimet e bëra për këtë qëllim nga i siguruari, janë në ngarkim të siguresit, në përpjestim me vlerën e siguruar, duke marrë në konsideratë vlerën që ka patur pasuria në kohën e ndodhjes së rastit të sigurimit edhe pse këto

shpenzime arrijnë së bashku me shumën për shpërblimin e dëmit, një vlerë më të madhe se shuma e sigurimit, edhe në rastet kur këto shpenzime nuk e kanë arritur qëllimin për të cilën janë kryer, përveç rasteve, kur siguruasi provon se këto shpenzime janë bërë pa kujdesin e duhur, nga i siguruari.

Jo vetëm aq, por në ligj është përcaktuar se siguruasi përgjigjet për dëmet materiale të shkaktuara mbi sendet e siguruar, nga mjetet e përdorura nga i siguruari me qëllim shmangjen ose zvogëlimin e dëmeve të ndodhura nga rasti i sigurimit, me përjashtim të rasteve kur siguruasi provon se këto mjete janë përdorur pa kujdesin e duhur nga i siguruari. Siguruasi i cili ndërhyr për pakësimin e dëmit, duhet, në qoftë se një gjë e tillë i kërkohet nga i siguruari, të parapaguajë shpenzimet e bërë për këtë qëllim ose të marrë pjesë në pagimin e tyre së bashku me të siguruarin në përpjestim me vlerën e sigurimit.

Rasti i sigurimit i cili shkakton dëme në pasurinë e siguruar, mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme të parashikuar nga palët në kontratë, **shkaqe që si rregull nuk varen nga vullneti i palëve**, por, mund të ndodhë që rasti i sigurimit të shkaktohet edhe nga veprimet e kryera me faj nga ana e personave të tretë. Si ligji italian edhe ai shqiptar ka përcaktuar se siguruasi është i detyruar që t'i shpërblejë dëmin e shkaktuar në pasurinë e siguruar të siguruarit, pavarësisht nga fakti nëse dëmi është shkaktuar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i njerëzve, apo është shkaktuar nga veprimet e kryera me faj të personave të tretë. **Kur rasti i sigurimit është shkaktuar për faj të personave të tretë, ligji ka përcaktuar se siguruasi i cili paguan shpërblimin e dëmit në favor të të siguruarit, ka të drejtën e regresit ndaj personit i cili e ka shkaktuar dëmin nga veprimet e kryera me faj të tij.**

Ligji italian, në ndryshim nga ai shqiptar, ka parashikuar se e drejta e regresit nuk zbatohet në rastet kur dëmi është shkaktuar nga fëmijët, nga të birësuarit, nga pasardhësit, nga prindërit ose të afërmit e tjerë të të siguruarit të cilët janë bashkëjetues ose kanë jetuar në një banesë më të, me përjashtim të rasteve kur këta kanë vepruar me dashje. Po ashtu, ky ligj ka përcaktuar se i siguruari përgjigjet ndaj siguresit në qoftë se ai me qëllim cënon të drejtën e tij të regresit, si dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e regresit zbatohen edhe për sigurimet kundër aksidenteve në punë dhe kundër fatëkeqësive rastësore.

Në ligjin civil italian, është trajtuar si një lloj i veçantë i kontratës së sigurimit të pasurisë, sigurimi i përgjegjësisë civile, duke përcaktuar se në këtë kontratë siguruasi detyrohet që t'i paguajë të siguruarit shpërblimin e dëmit, për pasojat e ardhura gjatë periudhës së sigurimit. Po ashtu, në këtë ligj është përcaktuar se në kontratën për sigurimin e përgjegjësisë civile, mund të parashikohet që shpërblimi i dëmit të bëhet edhe në favor të një personi të tretë të përcaktuar në marrëveshje nga palët, por, në të dy rastet siguruasi përjashtohet nga detyrimi për të shpërblyer dëmin, në qoftë se veprimi është kryer me dashje nga i siguruari ose personi i tretë.

Në këtë kontratë siguruasi ka të drejtë që të njoftojë paraprakisht të siguruarin, për pagimin e dëmit personit të tretë që ai i detyrohet, dhe është i detyruar që të paguajë direkt dëmin personit të tretë, në qoftë se një gjë e tillë i kërkohet nga i siguruari. Shpenzimet e bëra për të shmangur veprimin që do t'i shkaktonte dëm të siguruarit, janë në ngarkim të siguresit, brenda kufijve të shumës së sigurimit. Megjithatë, në rastet kur duhet të shpërblehet një dëm që e kalon shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë, shpenzimet gjyqësore ndahen ndërmjet siguresit dhe të siguruarit, në përpjestim me interesat e tyre përkatëse.

Në ndryshim nga ligji shqiptar, legjislacioni italian parashikon se shitja apo kalimi i të drejtës së pronësisë mbi sendin e siguruar nga një subjekt tek tjetri, nuk është shak për zgjidhjen e kontratës

së sigurimit të pasurisë.⁷⁹ Kodi Civil shqiptar nga ana e tij parashikon se në rastet kur pasuria e siguruar kalon nga një subjekt tek një tjetër, kontrata e sigurimit të pasurisë quhet e zgjidhur dhe në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjestim me kohën që mbetet deri në përfundimin e afatit të sigurimit. I vetmi përjashtim që bën legjilacioni ynë është në rastin e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, sigurimi i cili rregullohet me ligj të veçantë dhe nuk është objekt trajtimi i temës tonë, ku kalimi i pronësisë mbi mjetin nga një person tek tjetri, nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, por, kjo kontratë vazhdon deri në fund të saj me pronarin e ri të mjetit.

Qëndrimi i mbajtur nga ana e Kodit tonë Civil në lidhje me sigurimin vullnetar të pasurisë, i ndryshëm nga ligji italian për rastet kur pasuria e siguruar kalon nga një person tek tjetri, ku sipas ligjit tonë kjo përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, ndërsa sipas ligjit italian kontrata vazhdon normalisht, mendoj se nuk është i drejtë dhe duhet të rregullohet nga ana e ligjvënësit tonë. Kjo për faktin se nuk do të ishte e arsyeshme dhe në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut që thjesht ndryshimi i pronarit mbi sendin e siguruar, të përbente shkak ligjor dhe automatik për zgjidhjen e kontratës, çka mendoj se është një zgjidhje në kundërshtim me interesat e sigurvearit dhe të të siguruarit. Këtij arsytimi i shtohet edhe fakti se në një çështje analoge të rregulluar po nga ligjvënësi shqiptar me ligj të veçantë, dhe që ka të bëjë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, është pranuar se kalimi i pronësisë mbi mjetin, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit të mjetit, prandaj të njëtin qëndrim duhet të kishte mbajtur ligjvënësi shqiptar edhe në rastet e sigurimit vullnetar të pasurisë.

Ligji civil italian i cili ka parashikuar se kalimi i pronësisë mbi sendin e siguruar nga një person tek tjetri nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, si dhe ka përcaktuar edhe të drejtat dhe detyrimet që kanë palët në këtë rast, kur pasuria e siguruar kalon tek një person tjetër. Një nga detyrimet e të siguruarit në këto raste është, të njoftoj menjëherë sigurvearit për shitjen e sendit të siguruar, si dhe të bëjë njoftimin e blerësit të sendit për ekzistencën e kontratës së sigurimit. Në qoftë se i siguruari nuk e përmbushë këtë detyrim, ai është i detyruar që të paguajë primet që duhen paguar pas datës së shitjes së sendit, pavarësisht se sendi i siguruar është shitur prej tij dhe me ndodhjen e rastit të sigurimit shuma e sigurimit përfitohet nga blerësi i sendit dhe jo nga i siguruari.

Në rast se i siguruari ka njoftuar blerësin e sendit të siguruar për ekzistencën e kontratës së sigurimit, të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, i kalojnë blerësit të sendit të siguruar, nëse ky i fundit ka patur dijeni për ekzistencën e kontratës së sigurimit dhe brenda dhjetë ditëve nga mbarimi i afatit për pagimin e ardhshëm të primit të sigurimit, nuk kanë njoftuar sigurvearin se nuk dëshiron që të vazhdojnë kontratën e sigurimit. Sigurveari ka të drejtë që të përfitojë primet e sigurimit për periudhën deri në momentin që blerësi bëjë një njoftim të tillë. Sigurveari po ashtu, ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i mësipërm i marrë nga blerësi i sendit të siguruar, të heqë dorë nga kontrata, me anë të një njoftimi paraprak prej pesëmbëdhjetë ditësh, njoftim i cili mund të bëhet edhe me anë të letër rekomandesë.

Si përjashtim nga rregullat e trajtuara më lart, në qoftë se është lidhur një kontratë sigurimi e pasurisë me titull me urdhër ose me titull tek prurësi, blerësi nuk ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar sigurvearin për këtë qëllim, dhe as sigurveari nuk ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata. Një përjashtim i tillë është bërë nga ligjvënësi italian duke u nisur nga vetë veçoritë që

⁷⁹ Paragrafi i parë i nenit 1918 i Kodit Civil italian përcakton: “Shitja e sendit të siguruar nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit.”

paraqet kontrata e sigurimit të pasurisë e lidhur në formën e një titulli me urdhër ose tek prurësi, e cila ka formën e një letre me vlerë, që qarkullon lirisht dhe pronar i saj është në çdo rast personi që ka sundimin efektiv mbi të, dhe për këtë arsye është e pamundur që të hiqet dorë nga kontrata në një rast të tillë.

5.5. Disa veçori të kontratës së sigurimit të personit sipas Kodit Civil italian.

Në Kodin Civil italian në disa dispozita është trajtuar edhe kontrata e sigurimit të personit, i cili mund të haset në dy forma; në formën e sigurimit të jetës dhe të sigurimit të shendetit të një personi. Kur flasim për person në këtë rast kemi parasysh vetëm personin fizik, në kuptimin që atij i jep ligji, dhe jo personin juridik dhe në këtë rast kemi parasysh personin fizik si qenie biologjike dhe shoqërore, i cili sipas ligjeve të natyrës dhe të biologjisë i nënshtrohet lindjes, mundësisë së dëmtimit të shëndetit gjatë kohës së qenies gjallë të tij dhe së fundi vdekjes.

Ligji italian, ashtu siç e kemi përmendur në fillim të kësaj çështjeje, përcakton se tek kontrata e sigurimit të personit, njëra palë, i siguruari detyrohet që të paguajë një prim të caktuar kundrejt palës tjetër, siguruesit, e cila me ndodhjen e rastit të sigurimit të parashikuar në kontratë, detyrohet që të paguajë në favor të të siguarit, ose një personi të tretë në favor të të cilit është lidhur kontrata, një shumë të caktuar të hollash. Në ligj është përcaktuar se sigurimi i jetës mund të bëhet jo vetëm në favor të të siguarit, por edhe në favor të një personi të tretë. Në rastet kur sigurimi i jetës bëhet në favor të personit të tretë, në mënyrë që kontrata e sigurimit të jetës e vlefshme, është e domosdoshme që personi i tretë të japë pëlqimin me shkrim për lidhjen e kontratës në favor të tij.⁸⁰

Parashikimi i bërë nga ligji italian sipas të cilit kur kontrata lidhet në favor të një personi të tretë, në mënyrë që ajo të jetë e vlefshme, duhet që edhe personi i tretë në favor të të cilit është lidhur kontrata, të japë pëlqimin me shkrim për lidhjen e saj, është një parashikim të cilin nuk e gjejmë në ligjin shqiptar, dhe mendoj se një parashikim i tillë nuk është i nevojshëm dhe për pasojë qëndrimi që ka mbajtur ligjvënësi shqiptar më duket më i drejtë. Kjo për faktin se në këtë rast personi i tretë në favor të të cilit lidhet kontrata e sigurimit të jetës, përfiton vetëm të drejta nga kjo kontratë dhe jo detyrime dhe në përgjithësi ligji njih edhe raste të tjera ku një person mund të përfitojë të drejta edhe pa pëlqimin e tij, madje edhe pa dijeninë e tij, gjë që duhet pranuar edhe për kontratën e sigurimit të personit.

Përveç sa më sipër përcaktimi i bërë nga ligji italian sipas të cilit personi i tretë në favor të të cilit është lidhur kontrata e sigurimit të jetës ose shendetit, duhet të japë paraprakisht pëlqimin në mënyrë që kjo kontratë të jetë e vlefshme, paraqet probleme edhe në vetë ligjin italian, duke e bërë të vështirë zbatimin e kësaj kontrate në praktikë. Kështu vetë ligji italian parashikon se emërimi i personit të tretë, në favor të të cilit lidhet kontrata e sigurimit të jetës, mund të bëhet me anë të një deklaratë me shkrim të mëvonshme, e cila i njoftohet siguruesit, ose me anë të testamentit ose me anë të përcaktimit me testament të një shume sigurimi, në favor të një personi konkret. Në këtë rast shtrohet pyetja: Në qoftë se emërimi i personit të tretë në favor të të cilit lidhet kontrata e sigurimit, bëhet me anë të testamentit ose me anë të të përcaktimit me testament të një shume sigurimi, në favor të një personi konkret, në çfarë mënyre duhet ta japë pëlqimin personi i tretë, dhe në çkohë duhet ta japë ai këtë pëlqim?

Në lidhje me këtë pyetje, duke u nisur nga fakti se testamenti është një veprim juridik “mortis causa” dhe fillon që t’i sjellë efektet e tij vetëm pas vdekjes së trashëgimlënësit, momenti i vetëm kur personi i tretë në favor të të cilit është lidhur kontrata e sigurimit të jetës kur ai mund të japë

⁸⁰ Paragrafi i dytë i nenit 1919 të Kodit Civil italian përcakton: “Sigurimi i jetës i bërë në favor të një personi të tretë, nuk është i vlefshëm nëse personi i tretë ose përfaqësuesit e tij ligjor nuk japin pëlqimin për lidhjen e kontratës, pëlqim i cili duhet të jepet në formë shkresore”.

pëlqimin për kontratën e lidhur në emër të tij, në këtë rast, është pas çeljes së trashëimisë së trashëgimlënësit. Ky pëlqim duhet të jepet nga ana e personit të tretë në formë të shkruar, pra, me anë të një deklaratë me shkrim, me anë të cilës deklarohet nëse dëshiron ose jo të përfitojë nga kontrata e sigurimit të jetës të lidhur në favor të tij.

Në ligjin italian, po ashtu si edhe në ligjin shqiptar, është parashikuar se personi i cili ka lidhur kontratën e sigurimit të jetës, në favor të një personi të tretë, ka të drejtë që të bëjë revokimin e kësaj kontrate, në të njëjtat mënyra dhe forma që është bërë caktimi i personit të tretë, pa qenë i detyruar të tregojë shkaqet apo motivet pse e bën një gjë të tillë. Revokimi i përfituesit nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët e personit që ka caktuar përfituesin pas vdekjes së tij, dhe as në rastet kur pas verifikimit të rastit të sigurimit, përfituesi ka deklaruar se don të përfitojë nga kontrata e sigurimit e lidhur në favor të tij.

Në qoftë se kontraktuesi ka hequr dorë me shkrim nga e drejta për të revokuar përfituesin e sigurimit, ky deklarim nuk ka efekte kur përfituesi i ka deklaruar kontraktuesit se don të përfitojë nga kontrata e sigurimit. Heqja dorë e kontraktuesit nga drejta për të revokuar përfituesin e sigurimit dhe deklarimi i përfituesit të sigurimit, duhet t'i njoftohen me shkrim siguruesit.

Personi në favor të të cilit është lidhur kontrata e sigurimit të jetës, përfiton si rregull, shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë, me ndodhjen e rastit të sigurimit, kur kontrata e sigurimit e lidhur në favor të tij, ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së rastit të sigurimit. Megjithatë, ky person nuk përfiton shumën e sigurimit të parashikuar në kontratë, në rastet kur provohet se ai ka vrarë ose tentuar të vrasë personin i cili ka lidhur kontratën në favor të tij, bashkëshortin, fëmijët ose prindërit e tij.

Në ligjin italian, duke u nisur nga veçoritë që paraqet shuma e sigurimit tek kontrata e sigurimit të personit, është përcaktuar se kjo shumë nuk mund t'i nënshtrohet ekzekutimit të detyrueshëm ose sekuestrës parandaluese. Në lidhje me primet e paguara, ligji parashikon se janë të zbatueshme dispozitat konkrete për revokimin e veprimeve të kryera me dashje në dëm të kreditorit, dhe ato që kanë të bëjnë me pakësimin e dhurimit.

Tek kontrata e sigurimit të personit, ky ligj përcakton se në qoftë se kontraktuesi nuk paguan primin përkatës të sigurimit gjatë vitit të parë, siguruesi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës brenda gjashtë muajve nga dita që afati për pagimin e primit ka mbaruar. Kjo dispozitë zbatohet edhe në rastet kur primi i sigurimit është i ndarë në këste, në rastet kur kalon afati i pagimit të një kësti të vetëm të primit të sigurimit. Nëse kontraktuesi nuk paguan primet vijuese brenda afatit të parashikuar në policën e sigurimit, ose në mungesë të një parashikimi të tillë, brenda njëzetë ditëve nga mbarimi i afatit për pagimin e tyre, kontrata zgjidhet, dhe primet e paguara deri në këtë periudhë i takojnë siguruesit, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë kushtet për shpërblimin e sigurimit ose për zvogëlimin e shumës së sigurimit.

Kodi Civil italian, po ashtu si edhe ai shqiptar, kanë parashikuar zgjidhje të njëta juridike për rastet kur i siguruari tek kontrata e sigurimit të personit, gjatë kohës së vazhdimit të kontratës, bën ndryshimin e veprimtarisë së tij ose të profesionit. Kështu konkretisht ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit nuk sjellin zgjidhjen e kontratës së sigurimit, në rast se nuk e rëndojnë rrezikun e sigurimit në mënyrë të atillë që, po të ishte njohur kjo gjendje në momentin e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën. Në rast se ndryshimet janë të një natyre të tillë që, gjendja e re edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë, pagimi i shumës së sigurimit pakësohet në përpjestim me shumën me të ulët të caktuar, në raport me çmimin që ishte përcaktuar në fillim.

Në qoftë se i siguruari njofton për ndryshimet e mësipërme siguruesin, ky i fundit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve, duhet të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën ose do të pakësojë shumën e

sigurimit apo do të rrisë primin e sigurimit. Nëse siguruasi deklaron se kërkon të ndryshojë kontratën në një nga dy mënyrat e treguara më lart, i siguruari brenda pesëmbëdhjetë ditëve të ardhshme, duhet të deklarojë nëse e pranon propozimin e mësipërm të siguresit.

Në qoftë se i siguruari deklaron se nuk i pranon këto ndryshime, kontrata e sigurimit zgjidhet, duke u shuar e drejta e të siguarit për të kërkuar primet e sigurimit për periudhën në vazhdim, si dhe duke u shuar e drejta e të siguarit për të kërkuar shpërblimin e sigurimit. Heshtja e të siguarit vlen si pranim i propozimit të siguresit. Njoftimet dhe deklaratimet e parashikuara në paragrafet e mësipërme mund të bëhen edhe me anë të letër rekomandesë.

Ligji italian, në ndryshim nga ai shqiptar, parashikon edhe situatën juridike të vetëvrasjes së të siguarit duke përcaktuar se në rast të vetëvrasjes së të siguarit, kur ajo ka ndodhur para se të kenë kaluar dy vjet nga lidhja e kontratës, siguruasi nuk është i detyruar që të paguajë shumën e sigurimit, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë. Siguruasi nuk është i detyruar të paguaj shumën e sigurimit edhe në rastet kur kontrata e sigurimit ka qenë e pezulluar për shkak të mospagimit të primit të sigurimit, në kushtet kur nuk kanë kaluar dy vjet nga dita kur pezullimi i kontratës ka pushuar.

Kodi Civil italian ka rregulluar edhe çështjen e risigurimeve të pasurisë dhe personit, çështje të cilat sipas legjislacionit shqiptar nuk rregullohen në Kodin Civil, por rregullohen me anë të ligjit të veçantë, ligji i cituar nga ana jonë më lart. Në lidhje me çështjen e risigurimeve, ligji italian përcakton se kontratat e përgjithshme mbi risigurimet, të lidhura më një numër mardhëniesh risigurimi, duhet të lidhen në formë shkresore. Mardhëniet e risigurimeve në ekzekutim të kontratave të përgjithshme dhe të kontratave të risigurimit për rreziqe të veçanta, mund të provohen sipas rregullave të përgjithshme.

Në ligj po ashtu është përcaktuar se kontrata e risigurimit nuk krijon mardhënie ndërmejt të siguarit dhe risiguresit, përveç dispozitave të veçanta që parashikojnë privilegjet dhe të drejtat e të siguarit. Në rast të likuidimit të detyruar administrativ të të siguarit, risiguruasi duhet të paguajë në mënyrë tërësore dëmin e pësuar nga i siguruari, përveç shumave që kanë të bëjnë me primin dhe kreditë që ka risiguruasi ndaj të risiguarit. Në rast të likuidimit të detyruar administrativ të ndërmarrjes risiguresese ose të risiguarit, të drejtat dhe detyrimet që ngelin pas likuidimit, rezultojnë të mbyllura në llogaritë që lidhen me kontratat e risigurimit, dhe kompensohen në përputhje me dispozitat ligjore.

Kapitulli 6.

Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare, në lidhje me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë.

Për të arritur në konkluzione përsa i përket mënyrës se si janë zbatuar nga ana e gjykatave shqiptare dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e sigurimit të personit dhe pasurisë, unë kam studiuar vendimet gjyqësore që i përkasin periudhës 2005-2010 në gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, në gjykatën e apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë. Veçoria e parë dhe më e rëndësishme që vihet re në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit të rregulluar sipas dispozitave të Kodit Civil, në gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë dhe në gjykatën e apelit Tiranë, është fakti se këto gjykata në vendimet e tyre bëjnë një konfondim ose ngatërrim të kësaj kontrate me kontratën e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, e cila rregullohet jo nga Kodi Civil, por nga një ligj i veçantë, i cili është konkretisht Dekreti nr.295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshmë të mbajtësve të mjeteve motorike dhe përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, mirtuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992, ligj i cili nuk është objekt trajtimi i temës time.

Kështu në shumicën e vendimeve të gjyktaës së rrethit gjyqësor, Tiranë dhe të apelit Tiranë, edhe pse konflikti ligjor ka të bëjë me zbatimin e dekretit nr.295, datë 15.09.1992, si bazë ligjore është caktuar, si neni 1113 i Kodit Civil, ashtu edhe Dekreti në fjalë, edhe pse këto dy ligje rregullojnë totalisht lëndë të ndryshme, dekreti në fjalë rregullon çështjet e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, ndërsa Kodi Civil rregullon vetëm kontratën vullnetare të sigurimit të personit ose të pasurisë. Në disa vendime të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, konstatohet më tej akoma, që edhe pse konflikti gjyqësor ka të bëjë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, si bazë ligjore vendoset vetëm neni 1113 i Kodit Civil, i cili nuk e rregullon fare këtë çështje dhe për më tepër zgjidhja e çështjes nga ana e gjykatës është bërë duke iu referuar vetëm Kodit Civil.

Një veçori tjetër që mund të konstatohet nga praktika gjyqësore për periudhën 2005-2010 në këto gjykata, është fakti se pjesa më e madhe e konflikteve gjyqësore, kanë të bëjnë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, i cili rregullohet me anë të Dekretit të përmendur më lart, i cili siç është thënë, nuk është objekt i temës time, dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre, i referohet sigurimit vullnetar të personit ose pasurisë, të rregulluar nga Kodi Civil. Fakti që praktika gjyqësore e gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë dhe e gjykatës së apelit Tiranë, është e varfër për çështjet që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit vullnetar, të rregulluar nga Kodi Civil, tregon edhe njëherë për atë që kemi thënë që në fillim, që në vendin tonë mungon kultura juridike që lidhet me sigurimin vullnetar të jetës dhe pasurisë.

Megjithatë, pavarisht nga sa u tha më lart, qoftë edhe për efekte statistikore, ia vlen të përmendet se në gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, për vitet 2005-2010, numri i konflikteve gjyqësore që kanë të bëjnë me sigurimet, ku përfshihen edhe sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike, i cili përbën pjesën më të madhe të rasteve dhe është e pamundur që të ndahet nga sigurimi vullnetar i personit dhe pasurisë, për shkak të konfondimit të bërë nga kjo gjykatë, paraqitet si më poshtë:

- Viti 2005 – 12 çështje;
- Viti 2006 – 20 çështje;
- Viti 2007 – 31 çështje;
- Viti 2008 – 60 çështje;
- Viti 2009 – 20 çështje;

Viti 2010 – 20 çështje.

Totali – 163 çështje.

Në lidhje me këto të dhëna statistikore më duhet të them se mund ketë ndonjë pasaktësi në pasqyrimin e tyre, pasi këto të dhëna janë marrë nga shërbimi i IT (i teknologjisë së informacionit), pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë dhe nga ana ime është ndjekur, për aq sa ka qenë e mundur ecuria e këtyre çështjeve, në gjykatën e apelit Tiranë dhe më pas në Gjykatën e Lartë.

Përsa i përket çështjeve të shqyrtuara në gjykatën e apelit Tiranë, më duhet të them se, një pjesë e konsiderueshme e tyre, sidomos ato që i përkasin viteve 2009 dhe 2010, nuk janë pasqyruar në këtë punim, sepse ende nuk janë shqyrtuar nga kjo gjykatë. Për çështjet e gjykuara nga Gjykata e Lartë, duke qenë se çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin vullnetar të personit dhe pasurisë të gjykuara nga kjo Gjykatë, janë shumë të pakta, nga ana ime, nuk është ndjekur kriteri kohor, pra, periudha 2005-2010, dhe as kriteri i lokalizimit të gjykatave të rrethit gjyqësor, Tiranë dhe të apelit Tiranë, por, do të pasqyrohen të gjitha vendimet e Gjykatës së Lartë, që unë kam mundur të gjej, në lidhje me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë.

Në lidhje me pasqyrimin e vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, për periudhën 2005-2010, që kanë të bëjnë me sigurimin vullnetar të pasurisë dhe personit, këto janë shumë të pakta dhe shumica e tyre kanë të bëjnë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, të cilat nuk do të citohen nga ana ime, sepse dalin jashtë objektit të punimit tim. Kjo varfëri në praktikën gjyqësore rrjedh edhe nga fakti se një pjesë e madhe e këtyre çështjeve i përkasin viteve 2008, 2009, dhe 2010, të cilat për shkak të ngarkesës së madhe të punës së kësaj gjykate, ende nuk janë përfunduar prej saj, dhe në këto kushte është e pamundur që të pasqyrohen në këtë punim.

Nga vendimet e marra prej **gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, vlen të përmendet **vendimi nr. 4120, datë 24.06.2005**, vendim i cili u takon palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria tregtare “*Albania Duty Free Distribution*”, me të paditur Instituti i Sigurimeve INSIG sh.a dhe Avakotura e Shtetit, me objekt detyrimin e të paditurit që të paguajë shpërblimin e dëmit të rrjedhur nga rasti i sigurimit dhe me bazë ligjore nenet 1113 e vijues të Kodit Civil. Ashtu siç mund të konstatohet lehtë nga përmbajtja e tij, ky vendim bën fjalë për një rast të sigurimit vullnetar të pasurisë nga ana e të siguruarit, sigurimi i cili është dokumentuar me anë të kontratës së sigurimit nr. 30, datë 02.06.2004.

Për të analizuar nga ana juridike mënyrën sesi janë zbatuar nga ana e gjykatës dispozitat e Kodit Civil që kanë të bëjnë me sigurimin vullnetar të pasurisë, mendoj se është e nevojshme të paraqiten rrethanat e faktit të pasqyruara në këtë vendim gjyqësor, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë: “...Pala paditëse përfaqëson një shoqëri tregtare, e cila ushtron një aktivitet “*Duty Free*”, në njësinë e saj të shërbimit tregtar, në një nga ambientet e aeroportit “*Nënë Tereza*”, në Rinas të Tiranës. Në këtë njësi të saj ajo tregton mallra e artikuj të ndryshëm si cigare, parfume, pije alkoolike, ëmbëlsira, aksesore, etj.

Me datë 02.06.2004, kjo shoqëri ka lidhur një kontratë sigurimi pasurie me anën e paditur INSIG sh.a për dëmet që mund t'i vinin nga rënia e zjarrit në njësinë e shërbimit të tregtimit të mallrave të saj si më lart; fakt ky që pranohet nga të dy palët ndërgjyqëse, por që konfirmohet gjithashtu nga Polica e Sigurimit (Dëshmia e Sigurimit) nr. 30, datë 02.06.2004, të cilës, kësaj të fundit, i janë bashkëngjitur edhe kushtet e përgjithshme të këtij sigurimi të miratuar nga ana e të paditurit me urdhërin e saj nr. 46, datë 24.04.2004. Kjo kontratë sigurimi rezulton se është lidhur me afat 1 vjeçar. Ndërkohë del që brenda këtij afati 1 vjeçar dhe konkretisht me datë 17.06.2004, rreth orës 24.00, në dyqanin si më lart të palës paditëse, ka rënë zjarr. Për këtë pala paditëse ka njoftuar menjëherë anën e paditur.

Kjo e fundit ka bërë menjëherë verifikimet në vend me specialistët e saj dhe në përfundim, rastin në fjalë, domethënë, rënien e zjarrit në dyqanin e siguruar të palës paditëse, si më lart, ajo e ka konstatuar dhe njohur si rast sigurimi, e madje menjëherë ka nisur procedurat e saj për trajtimin dhe vlerësimin e dëmit të ardhur nga zjarri. Në përfundim pas vlerësimeve përkatëse të bëra me ekspertët e saj, i padituri INSIG sh.a në rastin konkret ka njohur si dëm real shumën prej 58.974,58 euro, shumë të cilën rezulton se ja ka likuduar palës paditëse”.

Nga studimi i këtij konflikti gjyqësor rezulton se mosmarrëveshja e lindur ndërmjet palëve ka të bëjë me **vlerën e shumës së sigurimit që i padituri**, shoqëria siguruuese në këtë rast, i ka paguar paditësit, të siguruarit në rastin tonë, me të cilën i siguruari paditës nuk ka qenë dakort dhe kjo ka qenë edhe arsyeja e vetme pse ai ka ngritur padi në gjykatë. Për të përcaktuar vlerën konkrete që ka shuma e sigurimit në këtë rast, për të cilën duhet të detyrohet i padituri duhet të mbahen parasysh dy çështje të rëndësishme:

Së pari: Duhet të mbahet parasysh se sa ka qenë vlera e përgjithshme e sigurimit, domethënë, cila ka qenë shuma konkrete me anë të të cilës është siguruar pasuria objekt konflikti, e cila në rastin konkret rezulton se është 237.751 euro;

Së dyti: Për të përcaktuar dëmin e pësuar nga i siguruari nga ndodhja e rastit të sigurimit, është e domosdoshme që të caktohet një grup ekspertësh të fushës së vlerësimit të pasurisë.

Në lidhje me këto dy çështje, mendoj se nga ana e gjykatës janë zgjidhur drejt ato, sepse ajo në përcaktimin e shumës së sigurimit që siguruasi është i detyruar që t'i paguajë të siguruarit ka mbajtur parasysh që kjo shumë sigurimi të mos jetë më e lartë se vlera e përgjithshme e sigurimit për pasurinë e siguruar, pra, në rastin konkret shuma e sigurimit të mos e kalojë vlerën 237.751 euro. Po ashtu, nga ana e gjykatës është caktuar edhe një grup ekspertësh kompetentë dhe të pavarur, të cilët kanë bërë vlerësimin e dëmeve të pësuar nga paditësi për shkak të ndodhjes së rastit të sigurimit, dhe në aktin e tyre të ekspertimit kanë përcaktuar se vlera e dëmeve të pësuar është 208.728, 72 euro, një vlerë e cila është disa herë më e lartë se vlera e nxjerrë nga vetë ekspertët e të paditurit, e cila siç e thamë ishte 58.974,58 euro.

Nga analiza juridike që i bëhet këtij vendimi, konstatohet se ky vendim është i arsyetuar mirë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, ku nga ana e gjykatës u janë dhënë zgjidhje të gjitha çështjeve që kanë qënë objekt shqyrtimi para saj. Sidomos, mjaft interesant dhe për t'u vlerësuar më duket arsyetimi i gjykatës në lidhje me vlerësimin e aktit të ekspertimit si provë, i cili ka përbërë në fakt të gjithë thelbin e konfliktit ndërmjet palëve, ku kjo gjykatë, ndër të tjera arsyeton: “... Gjykata, nga ana e saj, i çmon të drejta kërkimet si më lart të palës paditëse, nisur ndër të tjera edhe nga konkluzionet si më sipër të ekspertëve gjyqësorë; konkluzione këto të fundit të cilat në harmoni e në lidhje me provat e tjera në këtë gjykim, çmohen nga gjykata si të drejta, objektive dhe të paanshme, në lidhje me vlerësimin e dëmit të ardhur nga rënia e zjarrit për rastin në fjalë. Në këtë konkluzion e bindje të saj si më lart, gjykata arrin gjithashtu nga fakti tjetër se edhe akti i ekspertimit vlerësues të organit të prokurorisë, datë 01.09.2004 (i kryer gjatë hetimit të kësaj çështje nga ky organ), ka nxjerr një dëm krejt ndryshe nga ai që ka vlerësuar ana e paditur me ekspertët e saj.

Më konkretisht, rezulton se akti i prokurorisë vlerëson një dëm prej 178.799, 35 euro dhe jo prej 58.974, 58 euro, sikurse padrejtësisht ka vlerësuar në rastin konkret ana e paditur me ekspertët e saj. Pra, siç shihet, vlerësimi nga ana e organit të prokurorisë përafrohet me atë të ekspertëve gjyqësorë dhe është krejt i ndryshëm dhe disa herë më i madh se ai që është vlerësuar nga ana e paditur. Ndërkaq duke patur parasysh se akti i organit të prokurorisë përfaqëson aktin e një organi të specialiazuar dhe të paanshëm, atëherë për gjykatën përforcohet edhe më shumë bindja e

brendshme juridike se, vlerësimi i bërë nga ana e paditur është një vlerësim krejtësisht subjektiv, dhe, se vlerësimi real është ai i bërë nga ekspertët gjyqësorë në këtë gjykim të sotëm.

Ndërkohë dihet nga pikëpamja ligjore shuma e sigurimit, prej siguruesit, caktohet duke patur parasysh pikërisht vlerën e pasurisë që kërkohet për t'u siguruar në momentin e lidhjes së kontratës. Më konkretisht, kjo shumë siguri sipas nenit 1136 të Kodit Civil nuk mund të jetë më e madhe se vlefja e pasurisë. Ndërkaq në këtë kuadër, konstatohet, se zjarri në rastin konkret ka rënë 15 ditë pas lidhjes së kontratës, pra, në një kohë tepër të shkurtër pas lidhjes së kontratës së sigurimit; çka tregon bindshëm se vlera e mallit të dëmtuar nga zjarri, me përafërsi, duhet të ketë qenë përafërsisht sa vlera e pasurisë në momentin e lidhjes së kontratës dhe për rrjedhojë në vlerën e caktuar nga ekspertët gjyqësorë në këtë gjykim, domethënë, jo në vlerën e nxjerrë nga ana e paditur me ekspertët e kësaj të fundit...⁸¹

Si konkluzion mund të themi se nga ana e gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, në këtë vendim gjyqësor janë zbatuar drejt edhe saktë të gjitha dispozitat e parashikuara në Kodin Civil që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit vullnetar të pasurisë, duke e zgjidhur sipas mendimit tim drejt çështjen.

Për vitin 2006 si objekt trajtimi në këtë punim, mendoj të paraqes **vendimin nr. 1120, datë 28.02.2006 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, i cili u përket palëve ndërgjyqëse: paditës K.G, i paditur shoqëria e sigurimeve "INSIG", sh.a, me objekt shpërblimi dëmi i rrjedhur nga kontrata e sigurimit dhe me bazë ligjore nenin 1113 e vijues të Kodit Civil. Ky vendim gjyqësor bën fjalë për një konflikt të lindur ndërmjet palëve në lidhje me zbatimin e një kontrate sigurimit të personit dhe rrethanat e faktit, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë: "...Midis paditëse K.G dhe të paditurit shoqëria e sigurimeve "INSIG", sh.a, është lidhur kontrata e sigurimit të personit nr. 0007990, datë 20.09.2004, për sigurimin e shëndetit për udhëtim jashtë shtetit. Gjatë kohës që ka qenë në Itali, paditësja ka bërë disa diagnostikime. Gjatë ekzaminimit të saj në skaner, paditësja sipas diagnozës së ardhur nga Departamenti i Mjekësisë Interne, Kardio Vaskulare dhe Geriatrike të Universitetit të Sienës, Itali, ka pësuar një kolaps kardio-qarkullues, rënie e shprehur e punës së zemrës, rënie e tensionit të gjakut, edemë të mushkërive, në një paciente që vuan nga miastenia e grave dhe hipotiroidizmi pas tiroidit, ulje e funksionit të gjendrës tiroide pas një inflamacioni të saj.

Për shkak të kësaj gjendjeje shëndetësore, paditësja K.G ka qëndruar e shtruar për dy javë në spital. Në muajin mars 2005 paditëses nga spitali i Sienës, i ka ardhur një faturë për të paguar shumë prej 8020, 62 euro, si rezultat i qëndrimit në spital. Paditësja duke qenë e siguruar pranë të paditurit, ka kërkuar nga i padituri, bazuar në policën e sigurimit, të paguantë këtë shumë. I padituri shoqëria e sigurimeve "INSIG" sh.a, ka refuzuar që të paguajë këtë shumë, sepse ajo sipas tij përjashtohet në mënyrë të shprehur në seksionin 3, pika 16 e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Sigurimit të Shëndetit...⁸²

Duke i bërë një analizë ligjore vendimit të vendimit të mësipërm konstatohet se ky vendim sipas mendimit tim duhet të ishte më i plotë në drejtim të arsytimit të bazës ligjore dhe të shkaqeve juridike pse gjykata pranon padinë e paditëses. Nga vendimi gjyqësor rezulton se edhe në këtë rast gjykata ka caktuar një ekspert për të përcaktuar nëse ngjarja e ndodhur përfshihet apo jo në rastet e sigurimit të mbuluara nga kontrata dhe mendimi i ekspertit ka qenë përcaktues në pranimin e padisë nga gjykata, kjo për faktin se eksperti në aktin e tij ka pranuar se problemet shëndetësore të shfaqura nga paditësja, nuk kanë lidhje me sëmundjet e mëparshme të saj dhe për pasojë shpenzimet mjekësore të bëra prej saj përfshihen në rastin e sigurimit.

⁸¹ Shih për më tepër vendimin nr. 4120, datë 24.06.2005 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

⁸² Shih për më tepër vendimin nr. 1120, datë 28.02.2006 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

Nga ana tjetër konstatohet se ndërsa gjykata e ka zgjidhur drejt çështjen, duke zbatuar me korrektësi dispozitat e Kodit Civil në lidhje me kontratën e sigurimit të personit, përsa i përket dhënies së arsyeve juridike dhe analizës juridike të konfliktit, mendoj se gjykata duhej të kishte arsyetuar me më hollësi, duke dhënë në mënyrë më të detajuar shkaqet e pranimin të padisë, fakt i cili mund të jetë deri në një farë mase i justifikuar, kjo për shkak të ngarkesës shumë të madhe që përballon një gjyqtar i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë. Megjithatë, përmbledhja e analizës juridike të një vendimi vetëm në një paragraf të vetëm të përbërë nga disa rreshta, mendoj se është i pamjaftueshëm në mënyrë që një vendim të konsiderohet i plotë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Kështu analiza juridike e zgjidhjes së çështjes nga ana e gjykatës është bërë vetëm një një paragraf duke u shprehur: “Duke analizuar provat e sipërcituara, se në rastin objekt shqyrtimi gjyqësor kemi të bëjmë me një sëmundje të mënjëhershme, e cila nuk përjashtohet nga seksioni 3, pika 16 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Sigurimit të Shëndetit. Kjo pikë përjashton nga mbulimi vetëm “dëmet e shkaktuara nga difekte fizike, dobësi, gjendje shëndetësore kronike ose sëmundje që kanë ekzistuar deri ose më parë se data e hyrjes së personit të siguruar në këtë mbrojtje. Në rastin objekt gjykimi nuk kemi të bëjmë me asnjë nga sëmundjet, që përjashtohen nga mbulimi në këtë pikë. Kështu që pretendimi i paditëses K.G për t’u dëmshpërblyer për shumën e parave që i kërkohen nga spitali i Sienës, është i bazuar në ligj...”; mendoj se nuk është e mjaftueshme për një vendim gjyqësor që plotëson të gjitha kërkesat e ligjit të parashikuara nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile.

Për vitin 2007 me interes për t’u paraqitur në këtë punim është vendimi **nr. 2388, datë 03.04.2007, i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, i cili ka si specifikë se bën fjalë për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktore nga palët, e cila mund të konsiderohet edhe si kontratë e sigurimit të përgjegjësisë, e cila nuk rregullohet në mënyrë të shprehur nga Kodi Civil, por, në rastin konkret rregullohet nga ana e ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995, “Për prokurimin publik”. Ky konflikt gjyqësor ka si palë paditëse Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH), si palë të paditur shoqërinë siguruese “Albsig”, sh.a, si person të tretë shoqërinë “Sam Co”, sh.p.k dhe me objekt: detyrimin e të paditurit që të paguajë shumën prej 1600 000 lekë që rrjedh nga ekzekutimi i “Çertifikatës për garantim kontrate”, nr. 66, datë 19.05.2005.

Rrethanat e faktit në lidhje me këtë konflikt gjyqësor, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë: “...Pala paditëse SHISH mbi bazën e urdhërit të prokurimit nr. 10-76, datë 30.03.2005, ka lidhur kontratën e shit-blerjes nr. 251, datë 20.05.2005 për blerje pjesë këmbimi për automjetet, me shoqërinë “Sam Co”, sh.p.k, si fituese e tenderit të zhvilluar për këto blerje. Në kontratë është përcaktuar çmimi i blerjes së pjesëve të këmbimit për automjetet në shumën prej 15 053 477 lekë, ku janë përfshirë çdo taksë apo tatim i aplikuar në Republikën e Shqipërisë.

Po sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, lëvrimi i mallit do të bëhej brenda 60 ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Në pikën 8 të kontratës është përcaktuar kushti i sigurimit të kontratës që do të ishte në formën e garancisë në masën 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës, e cila çlirohet nga blerësi pas përfundimit të mallit në kushtet e kësaj kontrate, në të kundërt, kur shkelen kushtet e kontratës ajo nuk i kthehet shitësit. Vlefshmëria e kontratës është parashikuar deri më 31.12.2005.

Në funksion të kësaj kontrate, personi i tretë, shoqëria “Sam Co”, sh.p.k, ka bërë sigurimin e kontratës pranë palës së paditur, shoqërisë së sigurimit “Albsig”, sh.a, në masën 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës, në shumën 1600 000 lekë. Kështu pala e paditur ka lëshuar çertifikatën për garantim kontrate, nr. 66, datë 19.05.2005, sipas të cilës me paraqitjen e kërkesës nga Enti Prokurues, SHISH, pala e paditur merrte përsipër të paguante në llogarinë e këtij Enti, shumën e

garantuar, me kusht që Enti fitues, nënshkrues i kontratës të ketë dështuar në realizimin e saj, në përputhje me detyrimet dhe specifikimet e parashikuara në të.

Në certifikatë është parashikuar e drejta e garantuesit, shoqërisë “Albsig”, sh.a për të fituar ndaj Entit Fitues, të drejtat e Entit Prokurues. Pra, pala e paditur do të përgjigjej ndaj palës paditëse duke patur të drejtën t’i kërkonte personit të tretë shumën e paguar për llogari të tij. Në gjykim ka rezultuar e provuar se personi i tretë nuk i ka përmbushur detyrimet kontraktore as brenda 60 ditëve dhe as më vonë...”⁸³

Duke i bërë një analizë juridike këtij vendimi, konstatohet se nga ana e gjykatës është zgjidhur drejt çështja, duke u detyruar pala e paditur “Albsig”, sh.a, që t’i paguajë paditësit SHISH, shumën prej 1600 000 lekë si garanci për ekzekutimin e kontratës. Në vendimin e saj gjykata ndër të tjera arsyeton: “...Detyrimi i palës së paditur përveçse nga certifikata për sigurim kontrate, rrjedh edhe nga neni 8.1 i kontratës, ku përveç të tjerash theksohet: “*...Në të kundërt kur shkelen kushtet e kontratës, ajo (garancia) nuk i kthehet më shitësit*”. Gjithashtu në nenin 32.1 “*Sigurimi i kontratës*” thuhet: “*Shuma e sigurimit të kontratës duhet t’i paguhet Entit Prokurues si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës*”.

Mospërmbushja e detyrimeve kontraktore nga personi i tretë i ka sjellë parregullsi palës paditëse duke i shkaktuar bllokimin e mjeteve të planifikuar për t’u riparuar e mosfunksionimin normal të veprimtarisë. ...”.

Për vitin 2007 çmoj me vend që të paraqes në këtë punim edhe vendimin me **nr. 115 akti, datë 17.02.2007 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, i cili ka si palë paditëse shtetasin A.B, si të paditur INSIG, sh.a, me objekt detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer dëmin e pësuar si rezultat i vjedhjes së automjetit tip “*Daimler Chrysler*”, dhe me bazë ligjore nenin 1113 të Kodit Civil. Në lidhje me këtë vendim gjyqësor më duhet të sqaroj se konflikti i zgjidhur me anë të tij, përfshihet brenda objektit të temës time, për faktin se edhe pse ka të bëjë me sigurimin e automjetit, **ky sigurim përbën sigurim vullnetar të pasurisë**, ku automjeti përbën një nga llojet e sendeve me rëndësi në qarkullimin civil dhe që mund të sigurohet si çdo send tjetër, dhe nuk ka të bëjë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, në bazë të dekretitnr.295, datë 15.09.1992 “*Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtesve të mjeteve mototike dhe përgjegjësinë ndaj palëve të treta*”, i cili, siç e kemi theksuar disa herë më lart, nuk është objekt i temës time.

Konflikti gjyqësor duke iu referuar vendimit të mësipërm rezulton se ka ndodhur mbi bazën e këtyre rrethanave të faktit: “Paditësi A.B ka patur në pronësi një automjet tip “*Daimler Chrysler*”, me targë TR 3230 F dhe rezulton se e ka patur të siguar pranë palës së paditur me kontratën e sigurimit (Kasko), me nr. 0002778, datë 18.03.2003, për një periudhë 1 vjeçare. Ndërkohë, brenda kësaj periudhe të sigurimit të automjetit si më sipër, rezulton që paditësit t’i jetë vjedhur ky automjet nën presionin e armëve të zjarrit nga tre persona, ngjarje e cila ka ndodhur me datë 04.03.2004, rreth orës 23.00, në afërsi të vendit të quajtur “*Liqeni artificial*”, Tiranë, pranë Gardës së Republikës. Për këtë ngjarje si më lart, nga paditësi është bërë menjëherë kallzim pranë Komisarariatit të Policisë nr. 2, e ndërkaq organi i prokurorisë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 971 të vitit 2004; hetimet për të cilin aktualisht janë pezulluar për zbulimin e autorëve të vjedhjes në fjalë.

Ndërkohë që rezulton gjithashtu e provuar se paditësi, brenda afatit ligjor, ka njoftuar për ngjarjen të paditurin, të cilës i ka dorëzuar ndër të tjera edhe vertetimin përkatës për fillimin e procedimit penal për këtë ngjarje nga organet kompetente”.

⁸³ Shih për më tepër vendimin nr. 2388, datë 03.04.2007, i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

Bazuar në rrethana të tilla të faktit, mendoj se gjykata e shkallës së parë, Tiranë, e ka zgjidhur drejt çështjen, duke e konsideruar ngjarjen e ndodhur, vjedhjen nën kërcënimin e armëve të mjetit të paditësit, si rast sigurimi dhe duke e detyruar të paditurin që të paguajë shpërblimin e sigurimit, brenda kufijve të përcaktuar në kontratë. Me interes është të citohet argumentimi i gjykatës në lidhje me rrëzimin e pretendimit të të paditurit, sipas të cilit vjedhja e mjetit të siguruar me anë të presionit të armëve, nuk përbën rast sigurimi, ku gjykata ndër të tjera arsyeton: "...Gjykata e rrëzon këtë pretendim, si më sipër, të palës së paditur për shkaqet që vijnë: së pari: Në kontratën e posaçme të sigurimit nr. 0002778, dt. 18.03.2003, palët kontraktore nuk kanë bërë e përcaktuar ndonjë diferencim të llojit të vjedhjes si "rast sigurimi", por e kanë parë atë, d.m.th "vjedhjen" si një koncept në tërësi si "rast sigurimi". Ndërkaq, gjykata vë në dukje se nga pikëpamja teorike dhe praktike, teoria e së drejtës penale pranon se "vjedhja" përsa i përket formës dhe llojit të saj, mund të jetë e "hapur" ose e "fshehtë"; me "dhunë psikike" apo me "dhunë fizike", etj. Në këto kushte gjykata konkludon e çmon se përsa kohë këto lloj vjedhjesh si më sipër nuk janë parashikuar shprehimisht në "rastet e përjashtimit" të mbulimit të sigurimit, atëherë, prezumohen se ato janë të mbuluara nga kontrata përkatëse e sigurimit e lidhur ndërmjet palëve. Së dyti: Gjykata çmon se vjedhja që i është bërë paditësit A.B nën presionit e armëve rë zjarrit nuk mund të përfshihet as në "rastin e përjashtimit të mbulimit të sigurimit" të parashikuar në pikën 6/b të "Kushteve të përgjithshme" të kontratës së sigurimit – sikurse padrejtësisht pretendon e interpreton pala e paditur. Në këtë konkluzion si më sipër gjykata arrin për faktin se ajo ka bindjen e plotë juridike se vjedhja në rrethanat si më lart e automjetit të paditësit A.B, si në përmbajtje dhe në formë, nuk përbën "veprime të armatosura", në kuptimin që sanksionon e citon pika 6/b e "Kushteve të përgjithshme" të kontratës së sigurimit, që i referohet gabimisht pala e paditur ...".

Për vitin 2007 e çmoj me vend që të paraqes në këtë punim edhe një vendim tjetër të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, dhe konkretisht **vendimin nr. 2606, datë 12.04.2007**, i cili i përket palës paditëse V.SH, me të paditur shoqërinë e sigurimeve INSIG sh.a, me person të tretë Bankën Amerikane të Shqipërisë dhe me objekt detyrimin e të paditurit që të paguajë shumën e sigurimit prej 17625,23 dollarë. Ky konflikt gjyqësor ka të bëjë me kontratën e sigurimit vullnetar të jetës dhe rrethanat e faktit rezultojnë të provuara si më poshtë: "...Paditësi është bashkëshort i të ndjerës Dh.Sh dhe me vendimin nr. 1350, datë 12.07.2006 të gjykatës së shkallës së parë, Vlorë është caktuar së bashku me fëmijët A e A.Sh trashëgimtar ligor i të ndjerës dhe si i tillë në kuptim të nenit 1157 të Kodit Civil legjitimohet që të ngrejë këtë padi.

Me datë 16.05.2003 e ndjera Dh.Sh, ka lidhur me palën e tretë një kontratë kredie bankare për shumën 22 000 dollarë për blerjen e një apartamenti banimi. Në pikën 3/1 të kontratës është parashikuar që kredimarrësi të sigurojë në favor të Bankës Amerikane (person i tretë në këtë gjykim) për shumën e huasë, i cili do të jetë i rinovueshëm çdo vit për shumën e papaguar të kredisë.

Pala e paditur me personin e tretë kanë patur një akt marrëveshje të datës 08.08.2001 për siguroimin e jetës së debitorëve për shumën e kredisë së dhënë nga kreditori, në rast vdekje të debitorit. Në nenin 3 të kësaj akt marrëveshjeje parashikohet se kreditori merr përsipër që të sigurojë lidhjen e kontratës së sigurimit të debitorit, me klientët që marrin kredi për një periudhë deri në 10 vjet. Ndërsa në nenin 8 të kësaj akt marrëveshjeje parashikohet se polica e sigurimit të jetës përgatitet dhe lëshohet nga siguruuesi pas plotësimit të pyetsorëve për siguroimin e jetës së debitorit dhe formularit të miratimit të kredisë nga kreditori.

Në zbatim të kësaj akt marrëveshjeje, po në ditën e lidhjes së kontratës së kredisë bankare është plotësuar pranë Bankës Amerikane nga e ndjera aplikimi për siguroimin e jetës së debitorit. Këtu e

ndjera ka deklaruar se nuk vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë dhe se ka bërë tek mjekët vetëm kontrolle rutinë.

Me marrjen e aplikimit me faks nga Banka Amerikane, pala e paditur ka lidhur me të ndjerën me datë 23.05.2003 policën e sigurimit të jetës dhe kjo e fundit ka paguar primin e sigurimit prej 83,21 dollarë. Me datë 29.12.2005 Dh.Sh ka vdekur dhe me datë 20.04.2006 paditësi ka kërkuar nga pala e paditur dëmshpërblimin e shumës së kredisë së mbetur, meqenëse e ndjera ka qenë e siguruar pranë të paditurit. Meqenëse ky pagim është refuzuar paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi. ...”.

Duke i bërë një analizë juridike vendimit të mësipërm, konstohet se drejt ka vepruar gjykata kur ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur si të pabazuar në prova e ligj, duke arsyetuar se nga ana e të ndjerës Dh.Sh janë shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë kontratën e sigurimit të personit, duke u shkelur prej saj konkretisht nenet 422 dhe 1117 të Kodit Civil, si dhe janë shkelur dispozitat konkrete të kontratës së lidhur nga palët. Në dhënien e arsyeve për rrëzimin e padisë së ngritur gjykata ndër të tjera arsyeton: “...Neni 420 i Kodit Civil parashikon se detyrimet lindin nga kontrata dhe nga ligji. Ndërsa neni 422 i Kodit Civil parashikon:

“Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të aqësuesit”.

Kontrata e sigurimit të palëve është lidhur në zbatim të neneve 1113-1161 të Kodit Civil. Neni 1117 i Kodit Civil parashikon:

“I siguruari duhet t’i njoftojë siguruiesit, me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut. Quhet se kanë rëndësi thelbësore të gjitha rrethanat për të cilat siguruiesi ka pyetur me shkresë të siguruarin. ...”.

Në zbatim të kësaj dispozite dhe të marrëveshjes së lidhur me bankat për aplikimet e sigurimit të jetës, pala e paditur ka përpiluar “Kushtet e përgjithshme të sigurimit të jetës” së debitorit. Në pikën 4/5 të kontratës pala e paditur ka parashikuar refuzimin e pagimit të dëmshpërblimit në rast fatkeqësie dhe të çdo rrethane tjetër, në qoftë se kreditori apo i siguruari kanë dhënë informata jo të sakta në kërkesën apo dokumentet e paraqitura dhe në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit.

Ndërsa në pikën 9/1 parashikohet se sigurimi nuk mbulon vdekjen për “...Çdo lloj defekti fizik apo mendor, sëmundjeve të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim ose të lidhura me to, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i siguruari dhe është pranuar nga siguruiesi. ...”.

Në rastin konkret pala e paditur me datë 15.05.2006 ka kërkuar verifikimin e sëmundjes së të ndjerës Dh.Sh. Komisioni mjekësor i përbërë nga mjekët ligjore F.H, BÇ dhe S.M, ka konkluduar se e ndjera Dh.Sh është diagnostikuar me diagnozën kancer i gjirit që në vitin 2001, dy muajt e fundit është rënduar nga metastazat dhe se ka vdekur nga Ca Mamma e “kancerit të gjirit”.

Këtë fakt e ndjera nuk e ka deklaruar në aplikimin e saj me rastin e marrjes së kredisë bankare dhe lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës. Gjykata vlerëson se deklarimi i sëmundjes së pashërueshme të kancerit është një rrethanë që ka rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut, detyrim që parashikohet edhe nga neni 422 i Kodit Civil. Në rast se e ndjera do të deklaronte sëmundjen e rëndë, pala e paditur mund të mos lidhte kontratën e sigurimit të jetës ose do të kërkonte pagimin e primeve në vlera shumë më të larta se ato që ka paguar e ndjera. ...”⁸⁴

Nga **vendimet e gjykatës së apelit Tiranë**, çmoj me vend që të pasqyroj në këtë punim, **vendimin nr. 1007, datë 17.10.2005**, me të cilin është lënë në fuqi **vendimi nr. 4120, datë**

⁸⁴ Shih për më tepër vendimin nr. 2606, datë 21.04.2007 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

24.06.2005, i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, vendim i cili është trajtuar nga ana ime në këtë punim. Ashtu siç është përmendur më lart, me anë të këtyre vendimeve nga ana e gjykatës është zgjidhur konflikti ndërmjet palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria tregtare “*Albania Duty Free Distribution*”, me të paditur Instituti i Sigurimeve INSIG sh.a dhe Avakotura e Shtetit, me objekt detyrimin e të paditurit që të paguajë shpërblimin e dëmit të rrjedhur nga rasti i sigurimit dhe me bazë ligjore nenet 1113 e vijues të Kodit Civil.

Gjykata e apelit Tiranë me vendimin e mësipërm, duke bërë të njëjtat konstatime të arritura nga ana ime që vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, është i drejtë dhe i bazuar, ndër të tjera arsyeton: “...Kolegji civil i kësaj gjykate çmon se, palët ndërgjyqëse kanë hyrë në mardhënie kontraktuale e specifikuar kjo me kontratën e sigurimit nr. 30, datë 02.06.2004 me afat një vjeçar, duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime. Brenda periudhës një vjeçare të kësaj kontrate, e konkretisht me datë 17.06.2004, rreth orës 24.00 në njësinë ku paditsja ushtron aktivitetin privat ka rënë zjarr.

...Përsa më sipër Kolegji Civil i kësaj gjykate çmon se duke iu referuar nenit 1136 të Kodit Civil dhe duke patur parasysh edhe vlerën e sigurimit të pasurisë, sipas kontratës objekt gjykimi, e cila arrin shumë prej 237 751 euro, kjo shumë e cila kërkohet nga paditësja nuk mund të jetë më e madhe se vlera e pasurisë së deklaruar në kontratë.

Kështu duke gjykuar për kohën e rënies së zjarrit i cili përkon me 15 ditë pasi palët kanë lidhur këtë mardhënie juridike (pra, rezulton brenda një kohe shumë të shkurtër nga ky moment), gjykata arrin në konkluzionin e bindet se vlera e mallit të dëmtuar nga zjarri, duhet të ketë qenë përafërsisht sa vlera e pasurisë e llogaritur prej tyre në momentin e hyrjes së palëve në këtë mardhënie, e për rrjedhojë vlera e caktuar nga ekspertët e marrë nga gjykata duhet të vlerësohet e drejtë.

Pretendimet e palës paditëse të pasqyruara në padi çmohen të drejta edhe nga ky kolegji gjyqësor edhe për faktin se duke iu referuar aktit të ekspertimit vlerësues të organit të Prokurorisë dt. 01.09.2004 i kryer gjatë hetimit të kësaj çështjeje dhe duke e krahasuar atë me aktin e ekspertimit të realizuar nga ekspertët gjyqësor, shuma e përcaktuar arrin të njëjtat vlera të shumës së dëmit të shkaktuar dhe të konstautuar edhe nga gjykata.

Pretendimet e palës së paditur të shprehur në kërkesën ankimore dhe gjatë gjykimit në shkallë të dytë se ekspertët janë të palicesnuar, vlerësohen si të pabazuara në ligj e prova.

...Gjithashtu pretendimi i palës së paditur për marrjen e ekspertëve nga fusha e shkencës së sigurimit (pra, të licensuar posaçërisht në këtë fushë), do të mendonim se do të krijonin konflikt interesash, pasi këta të fundit nuk do të mundin të kryenin detyrën funksionale të ekspertit në çështje të tilla për shkak të ushtrimit të aktivitetit të tyre në këtë fushë, aq më tepër që edhe ligji material nuk parashikon ndalime apo specifikime të veçanta për këto lloj gjykimesh...”.⁸⁵

Duke i bërë një analizë juridike vendimit të mësipërm të gjykatës së apelit Tiranë, konstatohet që pavarsisht nga fakti se nga ana e kësaj gjykate janë zbatuar drejt dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me sigurimin vullnetar të pasurisë, në arsyetimin e vendimit konstatohet se ai në pjesën më të madhe është një përsëritje e arsyetimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilin ai e lën në fuqi. Duke qenë se gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, një përsëritje e pjesshme e arsyetimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë është e pranueshme, por jo një përsëritje puthuajse totale, siç ka ndodhur në rastin konkret, dhe nisur nga sa më lart, mendoj se vendimi i gjykatës së apelit duhet të ishte arsyetuar në mënyrë më të plotë, sidomos në drejtim të bërjes së një analize juridike të konfliktit të lindur ndërmjet palëve, duke dhënë edhe zgjidhjet ligjore përkatëse.

⁸⁵ Shih për më tepër vendimin nr. 1007, datë 17.10.2005, të gjykatës së apelit Tiranë.

Një tjetër vendim i gjykatës së Apelit Tiranë që do të trajtohet nga ana ime në këtë punim është edhe **vendimi nr. 755, datë 10.04.2008**, i cili i përket palëve paditës A.B, i paditur shoqëria e sigurimeve INSIG, me objekt shpërblim dëmi dhe me bazë ligjore nenin 1113 e vijues të Kodit Civil, vendim i cili do të pasqyrohet nga ana ime nisur edhe nga fakti se ky vendim i gjykatës së apelit, ka kë në fuqi vendimin me **nr. 115 akti, datë 17.02.2007 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, i cili është trajtuar më lart nga ana ime në këtë punim. Vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit Tiranë, duke lënë në fuqi vendimin nr 115 akti, datë 17.02.2007 të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, ndër të tjera arsyeton: "...Gjykata e shkallës së parë, që gjykoi çështjen mbi padinë e paditësit ka arritur në përfundimin se rasti i sigurimit ka ndodhur dhe pala e paditur ka detyrimin që të shpërblejë dëmin që rrjedh nga kontrata e sigurimit. Nga ana e gjykatës konstatohet se rreziku i sigurimit, sipas përcaktimit kontraktor është bërë për një vlerë prej 3 000 000 lekësh dhe në rast ndodhje të ngjarjes, i padituri detyrohej që t'i paguante dëmin në vlerën e sigurimit, minus 10% të saj, pra, 2700 000 lekë.

Pretendimi i palës së paditur se rasti konkret nuk mbulohet nga kontrata e sigurimit sipas pikës 6/b të kontratës është i pabazuar, sepse sipas kësaj dispozite të cituar nuk mbulohen "Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprime të tjera të armatosura, pavarisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizje seperatiste, kryengritje popullore, puçe, grushte shteti, eksode, akte terroriste, trazirave, grevës, sabotimit". Siç shihet, këto raste që nuk mbulohen dëmet nga kontrata e sigurimit kasko, kanë të bëjnë me tronditje dhe prishje të rëndë të rendit dhe sigurisë publike, dhe nuk kanë të bëjnë me vjedhjen, qoftë kjo e hapur ose jo, apo me përdorimin e dhunës ose të armëve. Shprehja "veprim i armatosur", nuk ka kuptimin që pretendon pala e paditur, që i jep të drejtë asaj të mos mbulojë dëmin, sepse ajo si shprehje është vendosur në kontekstin e kryerjes së veprimeve të tilla të armatosura që kanë të bëjnë me gjendjen e luftës, pavarisht nga fakti nëse lufta është shpallur ose jo. Vetë formulimi i kontratës, për rastet që përjashton mbulimin e dëmeve, nuk lejon interpretime të tjera.

Në bazë të nenit 1113/a të Kodit Civil "me kontratën e sigurimit njëra palë (siguruesi), në qoftë se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet në rastin e pasurisë t'i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin pasuror, brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë". Në zbatim të kësaj dispozite, pala e paditur detyrohet që të dëmshpërblejë paditësin për shumën 2700 000 lekë të përcaktuar nga palët në kontratën e sigurimit. Shpërblimi i sigurimit është vlera maksimale për të cillën përgjigjet siguruesi kur vertetohet rasti i sigurimit, i cili në bazë të marrëveshjes së palëve të paqyruar në kontratën e sigurimit është 2700 000 lekë. Siguruesi (i paditur) duhet t'i paguajë paditësit këtë shumë që përbën shpërblimin e sigurimit...".⁸⁶

Nga vendimet e gjykatës së apelit Tiranë, i cili do të pasqyrohet nga ana ime në këtë punim është edhe **vendimi nr. 558, datë 18.03.2008**, me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr. **nr. 2388, datë 03.04.2007, i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë**, vendim i cili është trajtuar nga ana ime në këtë punim. Ashtu siç është cituar më lart, ky vendim ka si palë ndërgjyqëse; paditës Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), si të paditur shoqërinë "Albsig", me person të tretë shoqërinë "Sam Co", shpk, me objekt detyrimin e të paditurit të paguajë shumën 1600 000 që rrjedh nga i "Çertifikatës për sigurim kontrate" dhe me bazë ligjore nenet 1113 të Kodit Civil dhe ligjin nr. 7991, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik".

Gjykata e apelit Tiranë, duke bërë konstatimin sipas të cilit vendim i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar, prandaj duhet të lihet në fuqi, ndër të tjera arsyeton: "...Gjykata duke

⁸⁶ Shih për më tepër vendimin nr. 755, datë 10.04.2008, të gjykatës së apelit Tiranë.

gjetur këto kërtime të bazuara në provat shkresore me të drejtë ka vendosur në përfundim të gjykimit pranimin e padisë. Kjo zgjidhje përputhet me përcaktimet e bëra nga palët në kontratë. Ndonëse është pretenduar nga pala e paditur në kërkesën ankimore se, personi i tretë ka qenë korrekt dhe se e ka përmbushur detyrimin kontraktor, ndërsa për një pjesë nuk është pranuar malli nga paditësi, por një gjë e tillë nuk është provuar, përkundrazi nga korespondenca (e ndodhur në dosje), ndërmjet palëve del se le të kuptohet se personi i tretë s'ka qenë korrekt, s'ka përmbushur detyrimin në kohë e se për këtë edhe ana e paditur është e ndërgjegjshme pasi për të justifikuar këtë mospërmbushje të detyrimit, ka shpjeguar se ka bërë kallzim për ndjekje penale në prokurori ndaj presidentit të "Sam Co", shpk, për veprën e mashtrimit (shkresa nr. 102 prot), po ashtu në një shkresë tjetër (nr. 182/1 prot), ana e paditur pranon se subjekti (firma "Sam Co") ka abuzuar edhe me çertifikatën e garantimit të kontratës nr. 66, datë 19.05.2005. Në këtë gjendje çështja është e qartë dhe e provuar...".⁸⁷

Përsa i përket vendimeve të Gjykatës së Lartë që do të trajtohen në këtë punim, ashtu siç është theksuar edhe më lart, në këtë rast, nuk do të kufizohem vetëm në periudhën 2005-2010, dhe as vetëm në vendimet e gjykatës së shkallës së parë, Tiranë dhe të apelit Tiranë, por do të paraqes disa nga vendimet më interesante, që unë kam mundur të gjejë, në të cilat janë zgjidhur konflikte që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë. Kështu nga vendimet e Gjykatës së Lartë në të cilin është zgjidhur konflikti ndërmjet palëve që ka të bëjë me sigurimin vullnetar të pasurisë, vlen të përmendet **vendimi nr. 1060, datë 11.11.1999**. Në këtë vendim gjyqësor rrethanat e faktit rezultojnë të provuara si më poshtë: "Midis paditësit K.S dhe të paditurit INSIG, dega Pogradec, është lidhur një kontratë sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë, në maj të vitit 1996, për objektin "Lokal Bar-Restorant", i ndodhur pranë liqenit të Pogradecit. Me datë 14.03.1997, objekti i siguruar është djegur nga zjarri gjatë periudhës së trazirave të njohura që kanë ndodhur gjatë vitit 1997 dhe paditësi, me qëllim që të përfitonte nga kontrata e sigurimit, me datë 07.04.1997, ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim pranë të paditurit, duke pretenduar se zjarri në lokalin e tij kishte ndodhur në datën 02.04.1997. Dega INSIG, Pogradec, bazuar në Rregulloren nr. 2, datë 14.3.1997, "Për sigurimin nga zjarri", pika 1/a, 1/b, 2,3 dhe neni 6 pika "a" e ka konsideruar rastin si të padëmshpërblyeshëm duke mos pranuar kërkesën e paditësit për dëmshpërblim".

I ndodhur para këtyre rrethanave të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim nga i padituri INSIG, dega Pogradec, paditësi K.S, ka ngritur padi para gjykatës së rrethit gjyqësor, Pogradec me objekt detyrimin e të paditurit të shpërblejë dëmin që rrjedh nga kontrata e sigurimit, dhe me bazë ligjore nenet 113 e vijues të Kodit Civil. Gjykata e rrethit gjyqësor Pogradec me vendimin e saj nr. 146, datë 18.03.1998 ka vendosur pranimin e padisë së paditësit K.S dhe detyrimin e të paditurit INSIG, dega Pogradec t'i paguajë paditësit shumën 1 milion lekë. Mbi ankimin e të paditurit gjykata e apelit Korçë me vendimin e saj nr. 184, datë 22.09.1998, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Pogradec dhe rrëzimin e padisë.

Gjykata e Lartë e cila e ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e paditësit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit Korçë, vendim i cili mendoj se është i drejtë dhe i bazuar, për faktin se ngjarja që ka shkaktuar zjarrin dhe dëmtuar pronën e paditësit, ka qenë i përjashtuar shprehimisht nga palët në kontratë, si rast sigurimi dhe për pasojë i padituri nuk mund të detyrohet që të dëmshpërblejë paditësin. Kështu Gjykata e Lartë, duke argumentuar rrëzimin e padisë së paditësit për dëmshpërblim, ndër të tjera arsyeton: "...Gjykata e apelit me të drejtë ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë. Refuzimi i kërkesës së paditësit për

⁸⁷ Shih për më tepër vendimin nr. 558, datë 18.03.2008, të gjykatës së apelit Tiranë.

dëmshpërblim bazohet në nenin 20/3 të Rregullores ku përcaktohet se: “Në qoftë se i siguruari përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrembër dhe mashtruese faktin përpara siguruesit, fakte të cilat janë rëndësi për arsyen ose vleftën e dëmshpërblimit, siguruasi do të çlirohet prej detyrimit të dëmshpërblimit”, si dhe në nenin 6/a, sipas të cilit përjashtohen dëmet e shkaktuara nga veprimet e luftës, revolucionit, lufta civile, kryengritjes, grevat, aktet e terrorizimit dhe të sabotimit të organizuar. Ka qenë ana e paditur ajo që ka paraqitur prova të plota se ngjarja ka ndodhur me datën 14.03.1997, duke rrëzuar pretendimet e paditësit se ajo ka ndodhur me datë 2 prill 1997. Nga ana tjetër duke iu referuar nenit 6/a të Rregullores, pala e paditur turbëllirat që kanë ndodhur në qytetin e Pogradecit dhe elementet që parashikon që kjo dispozitë i përfshin në vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në Shqipëri. Ndryshe nga sa pretendon paditësi, as ana e paditur dhe as gjykata, për rastin në gjykim, nuk përse të përcaktojnë nëse trazirat e marsit 1997, të ndodhura në të gjithë Shqipërinë dhe në Pogradec, do të konsiderohen “Luftë civile, a revolucion, kryengritje”, etj. Gjykata më të drejtë ka konkluduar se ngjarjet e njohura botërisht të kësaj periudhe janë nga ato raste, që sipas nenit 6/a përjashtohen si dëme që janë marrë përsipër nga siguruasi në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit. ...”⁸⁸

Nga vendimet e Gjykatës së Lartë çmoj me vend të bëj pjesë të këtij punimi edhe **vendimin nr. 1063, datë 7.11.2002**, i cili edhe pse nuk është një vendim që e ka zgjidhur çështjen në themel, por, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues, vlerësoj se është një vendim me rëndësi, sepse në pjesën arsytuese të tij, janë shtruar disa probleme ligjore në lidhje me zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit vullnetar të pasurisë sipas Kodit Civil. Rrethanat e faktit për të cilat është marrë ky vendim nga ana e Gjykatës së Lartë rezultojnë të provuara si më poshtë: “Shoqëria tregtare “*Hafizur*” shpk ka lidhur një kontratë për sigurimin e mallrave gjatë transportit me të paditurin INSIG, dega Tiranë, me datë 09.07.1999, duke paguar primin e sigurimit në shumën 377 dollarë amerikan. Objekti i kontratës së sigurimit ka qenë sigurimi i mallrave që kjo shoqëri do të transportonte me anijen “*CMA DJAKARTA*”, nga Republika Popullore e Kinës për në Shqipëri. Nga ana e palës paditëse shoqërisë tregtare “*Hafizur*” shpk, është pretenduar se me datë 10.07.1999, anija që bënte trasnportin e mallrave të siguruara, gjatë lundrimit ka ngelur në rërë, në afërsi të Kajros, Egjipt dhe me gjithë përpjekjet e bëra nuk është bërë e mundur nxjerrja e saj, duke shkaktuar dëme paditësit në vlerën 32257 dollarë amerikanë”.

Duke qenë se ndërmjet palëve mosmarrëveshja e lindur nuk është zgjidhur me mirëkuptim, paditësi ka ngritur padi, ndaj të paditurit me objekt shpërblimin e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit dhe me bazë ligjore nenet 1113 e vijues të Kodit Civil. Mbi bazën e padisë së ngritur, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 3995, datë 14.12.2000 ka vendosur të pranojë padinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurin INSIG, dega Tiranë, t’i kthejë paditësit shoqërisë tregtare “*Hafizur*” shpk shumën prej 32257 dollarë amerikanë, vendim i cili është lënë në fuqi nga gjykata e apelit Tiranë me vendimin nr. 592, datë 15.05.2001.

Në prishjen e vendimit të mësipërm të gjykatës së apelit Tiranë, Gjykata e Lartë ndër të tjera arsyeton: “...Vendimi i marrë nga gjykata e apelit duhet prishur dhe çështja të dërgohet për rigjykim për arsyet si më poshtë:

Neni 1113 i Kodit Civil përcakton se:

“...Në kontratën e sigurimit, njëra palë siguruasi, në qoftë se vertetohet ngjarja e parashikuar në kontratë detyrohet:

⁸⁸ Shih për më tepër vendimin nr. 1060, datë 11.11.1999 të Gjykatës së Lartë.

a) në rastin e sigurimit të pasurisë t'i shpërblejë palës tjetër..., dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë...”.

Sa më sipër, gjykata duhet të provojës së pari, ekzistencën e mardhënies juridike të sigurimit, pra, veprimin juridik të kryer, (kontratën e sigurimit) mes palëve i cili të shprehë “vullnetin e palëve për krijimin, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve”.

Pala e paditur ka pretenduar se, nuk ka shprehur vullnetin e saj për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe ndaj personave që kanë nënshkruar në dëshminë e sigurimit, paraqitur si provë nga paditësit, është bërë kallzim penal, pasi nuk kanë qenë të autorizuar të kryejnë veprimin juridik.

Ky fakt, i cili nuk rezulton së është verifikuar nga Apeli ka rëndësi për çështjen dhe ndikon në dhënien e vendimit. Nga gjykata e apelit, t'i kërkohet me shkrim organit të hetimit nëse ka kallzim për ndjekje penale dhe në çfazë është hetimi, nëse ka filluar një hetim rreth kësaj çështjeje. Pasi të administrojë sa më sipër, gjykata duhet të vejë në bisedime nëse janë rastet që parashikon neni 1121 për “pavlefshmërinë e kontratës” kur:

- vertetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar
- ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës

dispozitë kjo që nuk është marrë fare në konsideratë, gjatë gjykimit të mëparshëm nga gjykata e apelit, e cila pranon apriori ekzistencën e kontratës dhe vlefshmërinë e saj.

Nëse rezulton e provuar lidhje e një kontrate sigurimi brenda kufijeve që kërkon neni 1113, 1114, 1115 të K. Civil, atëherë gjykata shqyrton sipas kërkimeve të palëve efektet e kontratës, përmbushjen e të drejtave e detyrimeve reciproke nga palët.

Në lidhje me sa më sipër gjykata e apelit duke pranuar apriori ekzistencën e veprimit juridik, ka shqyrtuar pasojat e tij, duke përcaktuar dëmin e ardhur anës paditur, në shumën 29548 dollarë amerikanë.

Por, edhe në këtë pjesë, gjykata nuk ka respektuar kërkesat e nenit 1113, 1127 të K.Civil, të cilat janë dispozita që kanë përcaktuar si kusht kryesor për shpërblimin e dëmit, vertetimin e ngjarjes së sigurimit dhe të sasisë së dëmit.

Paditësit, i cili ka barrën e provës, duhet t'i kërkohet të paraqesë dokumentacionet përkatëse, që vertetojnë që ka ndodhur ngjarja e sigurimit, (vendi ku ka ndodhur, procesverbalet përkatëse mbajtur sipas ligjeve të vendit ku ka ndodhur), përderisa bëhet fjalë për sigurimin e pasurisë, provat shkresore që vertetojnë sasinë e dëmit dhe njoftimet që i ka bërë siguresit, në lidhje me informatat që ka marrë për ngjarjen.

Sipas nenit 1127 të Kodit Civil, kur nga i siguruari nuk përmbushen detyrimet e mësipërme, siguresi ka të drejtë që të mos paguajë shpërblimin e dëmit.

Në rigjykim të hetohet: Elementi faj i domosdoshëm për ngarkimin me përgjegjësi të siguresit për shpërblimin e dëmit.

Nga i siguruari, nëse vertetohet ngjarja e sigurimit, konform nenit 1141 të Kodit Civil, të hetohet nëse janë marrë të gjitha masat që varen nga ai, për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar.

Sipas nenit 1143 të Kodit Civil:

“Siguresi shkarkohet nga detyrimi... nëse rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit...” gjë që nuk del të jetë analizuar me prova nga gjykata. ...”⁸⁹

Duke i bërë një analizë të shkurtër juridike vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë, vëmë re se ky vendim ngren çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të kontratës së sigurimit vullnetar të pasurisë sipas Kodit Civil, duke filluar me kuptimin e kontratës, dhe duke vazhduar më tej me detyrimet e palëve në këtë kontratë, më posaçërisht me detyrimet e të

⁸⁹ Shih për më tepër vendimin nr. 1063, datë 7.11.2002, të Gjykatës së Lartë.

siguruarit, si dhe duke përfunduar me rastet e pavlefshmërisë së kësaj kontrate, si dhe me rastet kur siguruasi nuk është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit. Nga ana e Gjykatës së Lartë, në vendimin e mësipërm, konstatohet se drejt janë ngritur një numër i madh çështjesh ligjore që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit vullnetar të pasurisë, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga gjykatat më të ulta në gjykimin e çështjes prej tyre. Por, nuk mund të mos konstatohet, po ashtu, se vendimi i Gjykatës së Lartë në arsyetimin e saj ka lënë disa detyra dhe ka ngritur disa çështja, të cilat nuk kanë qenë objekt i debatit gjyqësor ndërmjet palëve, në gjykatat më të ulta, të cilat i ka orientuar për zbatim gjatë rigjyimit të çështjes, zbatimi i të cilave do të çonte në rrëzimin e padisë së ngritur, gjë e cila nuk më duket e drejtë dhe nuk duhet që të jepeshin në arsyetimin vendimit nga ana e Gjykatës së Lartë.

Kështu në arsyetimin e vendimit të saj, që në fillim, ndërsa shtron për diskutim çështjen e legjitimitetit ose të drejtës së përfaqësuesve të palës së paditur për të lidhur kontratën e sigurimit, për të cilët ana e paditur pretendon se nuk e kanë patur këtë të drejtë dhe ka paraqitur kallëzim penal ndaj tyre, duke lënë detyrë gjykatave më të ulta që të hetojnë në lidhje me këtë fakt, qëndrim që më duket më se i drejtë, shtron për diskutim çështjen e pavlefshmërisë së kontratës së sigurimit në bazë të nenit 1121 të Kodit Civil, për mungesë ose pushim të ekzistencës së rrezikut të sigurimit, çështje e cila nuk ka qenë objekt mosmarrëveshje ndërmjet palëve, qëndrim i cili nuk më duket i arsyeshëm, pasi kalon kufijtë e pretendimeve të palëve. Në të njëjtën linjë arsyetimi, Gjykata e Lartë shtron për diskutim çështjen e “simulimit” të rastit të sigurimit, kur dëmi është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë nga i siguruari, konform nenit 1141 të Kodit Civil, gjë që sjellë edhe shkarkimin nga përgjegjësia të siguruasit për shpërblimin e dëmit, duke i lënë detyrë gjykatave më të ulta që të “analizojnë me prova një fakt të tillë”, ndërkohë që ky pretendim nuk është ngritur fare nga palët, arsyetim i cili përsëri nuk më duket i drejtë dhe i bazuar.

Por, ndërsa arsyetimi i Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjet e mësipërme, është i diskutueshëm dhe sipas mendimit tim nuk jep shembullin e një vendimi të arsyetuar, në mënyrën më të mirë të mundshme, në arsyetimin e vendimit të mësipërm nga ana e Gjykatës së Lartë, fatkeqësisht, vihet re edhe një fakt tjetër, i cili edhe pse pasqyrohet vetëm në dy rreshta të këtij vendimi, tregon se nga ana e kësaj Gjykate ka ngatërrim ose konfondim ndërmjet shpërblimit të dëmit nga siguruasi sipas kontratës së sigurimit, të rregulluar nga nenet 1113 e vijues të Kodit Civil dhe shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, të rregulluar nga nenet 608 e vijues të Kodit Civil. Për të qenë më të saktë në lidhje me atë se çfarë po dua të them, po e citoj shprehimisht këtë pjesë të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila ka këtë përmbajtje:

“Në rigjykim të hetohet: Elementi faj i domosdoshëm për ngarkimin me përgjegjësi të siguruasit për shpërblimin e dëmit”.

Kjo pjesë e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk ka asnjë lidhje me përgjegjësinë e siguruasit për shpërblimin e dëmit sipas kontratës së sigurimit të rregulluar nga Kodi Civil, sepse dispozitat që rregullojnë këtë kontratë, nuk kërkojnë që të ekzistojë asnjë element i fajit të siguruasit, në mënyrë që ai të detyrohet të shpërblimin e dëmit të siguruarit. Vertetimi i elementit faj, është i domosdoshëm në rastet e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor, të rregulluar nga neni 608 e vijues të Kodit Civil, prandaj kjo pjesë e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë është haptazi alogjike dhe e paligjshme, dhe si detyrë e lënë për gjykatat e ulta, sigurisht që nuk duhet të zbatohet prej tyre.

Një tjetër vendim të Gjykatës së Lartë të cilin mendoj që ta bëj pjesë të këtij punimi, është edhe **vendimi nr. 215, datë 21.1.2010**, vendim i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 7233, datë 9.12.2005 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. 264, datë 6.12.2006 të gjykatës së apelit, Tiranë. Ky vendim i Gjykatës së Lartë i referohet sigurimit të një mjeti motorik dhe ka si bazë

ligjore kryesore dekretin nr. 295, datë 1.12.1992, i cili siç është thënë që në fillim të këtij punim, nuk është objekt i trajtimit të temës time, por që ky konflikt do të pasqyrohet në këtë punim, sepse ka të bëjë me sigurimin kasko të këtij mjeti, sigurim i cili nuk është i detyrueshëm, por, përfshihet brenda konceptit të **sigurimit vullnetar të pasurisë**, pavarësisht se pasuria në këtë rast është mjet motorik. Rrethanat e faktit të këtij vendimi rezultojnë të provuara si më poshtë: "...Padiësi G.S ka pasur në pronësi një autoveturë të tipit "Renge Rover" të vitit 1997, me targë TR 5999I. Këtë mjet e ka siguruar pranë shoqërisë së sigurimeve "Atlantik", sh.a nëpërmjet kontratës së sigurimit "KASKO", nr. 000583, datë 10.06.2004, me afat sigurimi deri më datë 09.06.2005. Sipas kësaj kontrate, shoqëria e sigurimit "Atlantik" sh.a mbulonte automjetin e padiësit për dëmtimin e tij nga rënia e objekteve mbi mjetin motorik, breshëri, thyerjet e xhamit, vjedhja dhe grabitja, kundrejt shumës së sigurimit 3.000 000 lekë me vlerë të zbritshme 10%.

Me datë 19.05.2005, gjatë shkëmbimit me një automjet tjetër tip kamion, në aksin rrugor Dajt-Qafë-Mollë, automjeti i padiësit ka dalë jashtë rrugës dhe ka rënë në humnerë duke u dëmtuar plotësisht.

Padiësi ka njoftuar shoqërinë "Atlantik" sh.a për ngjarjen e ndodhur duke përshkruar rrethanat e ngjarjes në deklaratën e përpiluar prej tij me datë 20.05.2005. Përfaqësuesit e shoqërisë "Atlantik" sh.a kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se automjeti pronë e padiësit ka dalë jashtë përdorimit, por, me shkresën nr. 777 prot, datë 09.09.2005 "Kthim përgjigje" kjo shoqëri ka refuzuar të shpërblejë dëmin e shkaktuar në këtë rast për shkak se i siguruari "...nuk ka sinjalizuar Shërbimet e Policisë Rrugore për këtë ngjarje të rëndë, duke mosrespektuar për pasojë kushtet e përgjithshme të policës së sigurimit "Kasko".

Pas refuzimit të dëmshpërblimit nga ana e shoqërisë "Atlantik" sh.a, padiësi G.S ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve, i cili me shkresën nr. 1040/1 prot, datë 22.09.2005 i ka kërkuar kësaj shoqërie në bazë të nenit 163, pika "4" dhe nenit 156, pika "d" të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, ryshqytimin e kësaj praktike deri në plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit.

Me datë 06.10.2005 rezulton se pala e paditur e ka dëmshpërblyer padiësin G.S në shumën 10 000 euro, të cilën ky i fundit e ka tërhequr, por ka kërkuar gjyqësisht detyrimin e palës së paditur të paguajë diferencën e papaguar të detyrimit kontraktor sipas kontratës së sigurimit "Kasko". ..."

Gjykata e Lartë me vendimin nr. 215, datë 21.01.2010, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera arsyeton: "...Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur vlerëson se, shkaqet e parashtruara në rekurs nuk janë të tilla që ta bëjnë vendimin gjyqësor objekt rekursi të cënueshëm ligjërisht, përkundrazi, nga ana e këtij kolegji çmohet se vendimi është marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

Siç shihet nga përmbajtja e padisë dhe pretendimet lidhur më të në kuadrin e gjykimit, rezulton qartë se shkak për mosmarrëveshjen në gjykim është bërë mospërmbushja e një detyrimi kontraktor që buron nga kontrata e sigurimit "Kasko", nr. 000583, datë 10.06.2004 e lidhur mes palëve G.S në pozitën e të siguarit dhe shoqëria "Atlantik" sh.a në pozitën e siguruarit.

Të dy gjykatat kanë pranuar pa asnjë ekuivok se në rastin konkret është vertetur rasti i sigurimit, pra, brenda afatit të sigurimit makina e padiësit është dëmtuar plotësisht.

Pala e paditur megjithëse fillimisht ka refuzuar të shpërblejë palën padiëse, është provuar se e ka ekzekutuar pjesërisht këtë detyrim në rrugë vullnetare në favor të padiësit G.S.

Ndodhur në këto rrethana më te drejtë padiësi ka kërkuar gjyqësisht diferencën e shpërblimit sipas kushteve të kësaj kontrate.

Në prapsimet e saj ndaj padisë së paraqitur kjo palë ka mbajtur dy qëndrime: Një qëndrim që e pranon detyrimin e saj, por, e konsideron të përmbushur vullnetarisht pasi paditësi ka pranuar shumën 10 000 euro; dhe një qëndrim tjetër sipas të cilit për këtë dëm duhet të detyrohet Fondi i Kompensimit pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve.

Me të drejtë gjykatat i kanë konsideruar të pabazuara pretendimet e palës së paditur, pretendime të cilat janë përsëritur edhe në rekursin e paraqitur.

Fakti që automjeti i paditësit është dëmtuar nga një automjet “i paidentifikuar” nuk ndryshon asgjë në trajtimin e mosmarrëveshjes në gjykim.

Dekreti nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike dhe përgjegjesinë ndaj palëve të treta”, i miratuar me disa ndryshime me ligjin 7441, datë 01.12.1992, Kreu II, Fondi i kompensimit, neni 17, parashikon se “Personi, të cili i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit motorik, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, nga Fondi i Kompensimit, deri në vlerën minimale të shumës së siguruar, në qoftë se a) mjeti motorik, me të cilin u shkaktua dëmi, nuk mund të identifikohet...”, ndërsa neni 18 i këtij Dekreti përcakton shprehimisht rastet kur detyrohet të paguajë dëmin Fondi i Kompensimit e konkretisht “a) në rastin e përmendur në nenin 17, shkronja “a”- vdekja, dëmtimi i shendetit dhe dëmet pasurore, që e kalojnë vlefën 25 000 lekë, duke përjashtuar dëmin e shkaktuar nga mjeti motorik; ...”.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, konkludohet qartë se Fondi i Kompensimit pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve përjashtohet nga detyrimi i pagimit të dëmit që i shkaktohet mjetit motorik, për shkak se nga ana e këtij Fondi kompensohet vetëm vdekja, dëmtimi i shendetit dhe dëmet pasurore, që e kalojnë vlefën 25 000 lekë.

Në këtë kontekst nuk mund të ngarkohet me këtë detyrim Fondi i Kompensimit pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, pretendim i palës së paditur, të cilin me të drejtë e kanë rrëzuar gjykatat në arsyetimet e vendimeve të tyre.

I pambështetur konsiderohet nga ana e këtij kolegji edhe pretendimi tjetër - se detyrimi konsiderohet i përmbushur për shkak të faktit se paditësi ka pranuar shumën 10 000 euro, pasi në zbatim të nenit 1113 të Kodit Civil dhe kushteve të përgjithshme të kontratës objekt padie, pala kontraktuese është e detyruar që të paguajë diferencën e papaguar të dëmit të shkaktuar, në zbatim të parimit të shpërblimit të plotë të dëmit. ...”⁹⁰

Këto ishin disa nga vendimet gjyqësore të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, të gjykatës së apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat unë kam menduar që të paraqes në punimin tim, përse i përket verifikimit të rasteve praktike të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë. Nga këto raste praktike mund të konstatohet se, në përgjithësi, gjykatat shqiptare, të tre niveleve, i kanë zbatuar drejt dhe saktë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit të rregulluar nga Kodi Civil dhe vendimet e dhëna prej tyre janë të bazuara në prova dhe ligj.

Megjithatë, nga vendimet gjyqësore të cituara, rezulton se nga gjykatat shqiptare, sidomos ato të shkallës së parë dhe të apelit, ka një konfondim ose ngatërrim ndërmjet dispozitave ligjore të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit, me dispozitat ligjore të parashikuara në dekretin nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike dhe përgjegjesinë ndaj palëve të treta”, miratuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992, të cilat rregullojnë sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike. Në të ardhmen shpresoj që nga gjykatat të mos bëhet një ngatërrim i tillë, pasi fusha e veprimit të këtyre dy ligjeve është krejt e ndryshme, dhe do të isha i lumtur nëse ky punim do të kontribuonte sadopak për t’u bërë një qartësim i tillë. Së fundi, më

⁹⁰ Shih për më tepër vendimin nr. 215, datë 21.1.2010, të Gjykatës së Lartë.

duhet të them, në lidhje me praktikën gjyqësore që ka të bëjë me kontratën e sigurimit të rregulluar nga Kodi Civil se, duke iu referuar vendimeve gjyqësore të tre shkallëve të gjykimit, pavarësisht nga fakti se gjykatat i kanë zgjidhur drejt çështjet, ka vend për përmirësime në drejtim të arsyetimit të vendimeve, ku të bëhet një analizë më e plotë dhe e qartë e dispozitave ligjore që shërbejnë për zgjidhjen e konfliktit.

Konkluzione dhe rekomandime.

Pas trajtimit juridik të kontratës së sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, sipas Kodit Civil shqiptar, në fuqi, duke e krahasuar atë edhe me Kodin Civil italian, si dhe me praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare, mund të nxjerrim **disa konkluzione dhe rekomandime**, në lidhje me mënyrën e rregullimit të kësaj kontrate nga ana e këtij Kodi. Për nxjerrjen e këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve, **unë jam nisur nga një vështrim kritik që i kam bërë dispozitave të Kodit Civil, në fuqi, që rregullojnë kontratën e sigurimit të personit dhe pasurisë, si dhe i jam referuar dispozitave të Kodit Civil italian, si dhe praktikës gjyqësore shqiptare**, në lidhje me problemet që kanë dalë në praktikën e gjykatave tona për zbatimin e drejtë dhe të saktë të dispozitave ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë.

Nga trajtimi juridik si më sipër, **mund të konkludojmë se, në përgjithësi, Kodi Civil shqiptar, në fuqi, i bën një rregullim të plotë dhe bashkëkohor kësaj kontrate**, duke dhënë mundësi që ajo të zhvillohet dhe të zbatohet gjithnjë e më shumë në kushtet e ekonomisë së lirë të tregut. Në rregullimin juridik që i ka bërë kontratës së sigurimit Kodi Civil, në fuqi, ka përcaktuar drejt dhe saktë konceptin e kontratës së sigurimit, llojet kryesore të kontratës së sigurimit, sigurimin e pasurisë dhe të personit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të palëve.

Në rregullimin juridik të kontratës së sigurimit nga ana e Kodit Civil në fuqi, **një tjetër konkluzion që mund të nxjerrim është fakti se dispozitat ligjore të këtij Kodi për rregullimin e kësaj kontrate, janë marrë kryesisht në ligjin nr. 2359, datë 15.11. 1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet” dhe pjesa tjetër e dispozitave janë marrë nga Kodi Civil italian**. Ajo që të habit më shumë në këtë rast, është fakti tjetër se, pjesa më e madhe e dispozitave ligjore, në lidhje me rregullimin e kontratës së sigurimit, të parashikuara nga ligji “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”, i miratuar nga ligjvënësi ynë në vitin 1956, pra, në kushtet e shtetit socialist autoritar, përputhen në mënyrë të plotë me Kodin Civil italian, i cili siç dihet ka hyrë në fuqi në vitin 1942, çka do të thotë se duhet të dalim në një konkluzion disi të çuditshëm për kohën, sipas të cilit pjesa më e madhe e dispozitave të ligjit të vitit 1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet” që rregullojnë kontratën e sigurimit, janë marrë nga Kodi Civil italian i vitit 1942.

Në lidhje me **praktikën gjyqësore shqiptare** që ka të bëjë me kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, të rregulluar nga Kodi Civil, **konkluzioni i parë që mund të nxirret është fakti se praktika gjyqësore në lidhje me këtë kontratë është shumë e pakët dhe konfliktet gjyqësore janë shumë të rralla**, krahasuar kjo me kontratat e tjera. Kjo tregon konstatimin e bërë nga ana ime, që në fillim të këtij punimi se, në Shqipëri mungon tradita dhe kultura juridike për lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës, shëndetit dhe pasurisë dhe përderisa personat fizikë dhe juridikë e lidhin pak këtë kontratë, edhe konfliktet gjyqësore në lidhje me këtë kontratë do të jetë të pakta në numër.

Një tjetër konkluzion që mund të nxirret në lidhje me praktikën gjyqësore shqiptare që ka të bëjë me kontratën e sigurimit është fakti se, **në përgjithësi, gjykatat shqiptare, të tre niveleve, i kanë zbatuar drejt dhe saktë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit të rregulluar nga Kodi Civil dhe vendimet e dhëna prej tyre janë të bazuara në prova dhe ligj**. Megjithatë, nga vendimet gjyqësore të cituara, rezulton se **nga gjykatat shqiptare, sidomos ato të shkallës së parë dhe të apelit, ka një konfondim ose ngatërrim ndërmjet dispozitave ligjore të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit, me dispozitat ligjore të parashikuara në dekretin nr. 295, datë 15.09.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike**

dhe përgjegjësini ndaj palëve të treta”, miratuar me ndryshime me ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992, të cilat rregullojnë sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike.

Në lidhje me praktikën gjyqësore që ka të bëjë me kontratën e sigurimit të rregulluar nga Kodi Civil se, më duhet të them se, duke iu referuar vendimeve gjyqësore të tre shkallëve të gjykimit, pavarësisht nga fakti se gjykatat i kanë zgjidhur drejt çështjet, ka vend për përmirësime në drejtim të arsyetimit të vendimeve, ku të bëhet një analizë më e plotë dhe e qartë e dispozitave ligjore që shërbejnë për zgjidhjen e konfliktit. Kjo për faktin se në një pjesë të vendimeve konstatohet se, në pjesën arsyetuese të vendimit, gjykata nuk i përmend fare dispozitat ligjore ku ajo e bazon zgjidhjen e mosmarrëveshjes, dhe në ato raste kur gjykata i përmend, ajo i kalon ato përciptazi, pa iu bërë një analizë të plotë juridike atyre.

Përveç konkluzioneve të mësipërme, në lidhje me rregullimin nga Kodi Civil të kontratës së sigurimit, **mund të nxjerrim disa rekomandime**, ose disa ide për përmirësimin e dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me këtë kontratë. Këtë rekomandime duhet të mbahen parasysh nga ana e ligjvënësit shqiptar, me qëllim që ai të bëjë ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në Kodin Civil, në mënyrë që kontrata e sigurimit të rregullohet në mënyrë sa më të plotë dhe të saktë, duke iu dhënë mundësi subjekteve të së drejtës që të hyjnë sa më shumë në mardhënie juridike që kanë të bëjnë me fushën e sigurimeve.

Një nga rekomandimet që mund të bëhet në lidhje me kontratën e sigurimit, ka të bëjë **me formën e lidhjes së kësaj kontrate, e cila sipas nenit 1114 të Kodit Civil në fuqi, është vetëm në një formë konkrete, konkretisht në formën e dëshmisë ose policës së sigurimit që siguruari i lëshon të siguruarit**. Parashikimi i kësaj forme të lidhjes së kontratës së sigurimit, çka përbën një nga veçoritë e kësaj kontrate si kontratë ad’hezioni ose aderimi, mendoj se është e bërë nga ligjvënësi në mënyrën e duhur, sepse në këtë mënyrë standartizohen kushtet e kësaj kontrate në treg dhe mbrohen më mirë interesat e të siguruarit si palë më e pambrojtur.

Por, mendoj që ligjvënësi shqiptar duhej të kishte parashikuar që **kontrata e sigurimit të mund të lidhej edhe në formën e letrës më vlerë me urdhër ose tek prurësi**, çka do të ishte në përputhje me zhvillimin e shoqërisë në një ekonomi tregu, ku qarkullimi sa më i shpejtë i mallrave dhe shërbimeve, përbën një nga kyqet e suksesit të kësaj ekonomie. Fakti që kontrata e sigurimit mund të lidhet edhe në formën e një letre me vlerë me urdhër ose tek prurësi, është parashikuar nga Kodi Civil italian, i cili është miratuar që në vitin 1942, pra, para 50 vjetesh nga miratimi i Kodit Civil tonë dhe do të ishte e logjikshme dhe e pranueshme që edhe Kodi ynë Civil i vitit 1994 të kishte parashikuar këtë formë të lidhjes së kontratës së sigurimit. Në këto kushte mendoj se në nenin 1113 të Kodit Civil në fuqi të shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

“Dëshmia e sigurimit mund të lëshohet edhe në formën e një letre me vlerë me urdhër ose tek prurësi. Në një rast të tillë zbatohen, për aq sa është mundur, dispozitat ligjore që rregullojnë këtë kategori të letrave me vlerë”.

Duke iu referuar nevojës së Kodit Civil në fuqi për ndryshime dhe përmirësime të dispozitave që rregullojnë kontratën e sigurimit, mendoj se neni 1115 i Kodit Civil, i cili parashikon elementët që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, ka të meta, sepse nuk është parashikuar në këtë dispozita si një nga elementët që duhet të përmbajë dëshmia e sigurimit, **shuma e sigurimit ose shpërblimi i sigurimit**. Parashikimi në këtë dispozitë në mënyrë të shprehur i shpërblimit të sigurimit ose shumës së sigurimit, si një nga elementët e dëshmisë së sigurimit është i domosdoshëm, duke u nisur nga fakti se përderisa nga ligjvënësi është parashikuar në këtë dispozitë, si një element i domosdoshëm i dëshmisë së sigurimit, **primi i sigurimit**, i cili përfaqëson shumën që i siguruari i paguan siguruarit me lidhjen e kontratës, duhet të parashikohet si element i kësaj dëshmie edhe

shpërblimi i sigurimit, i cili është shuma që siguruesi i paguan të siguruarit me ndodhjen e ngjarjes (rastit) të sigurimit.

Për më tepër, po t'i referohemi rregullimit juridik të kontratës së sigurimit nga pikëpamja historike dhe t'i referohemi ligjit nr. 2359, datë 15.11. 1956 *“Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”*, konstatojmë se në nenin 432 pika “dh” e tij, ishte parashikuar **shuma e sigurimit ose shpërblimi i sigurimit**, si një nga elementët e domosdoshëm që duhej të përmbante dëshmia e sigurimit. Në këto kushte mendoj se në nenin 1115 të Kodit Civil në fuqi duhet të shtohet një pikë tjetër, ku pas shkronjës “ë” të shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) shumën e sigurimit që siguruesi detyrohet t'i paguajë të siguruarit, ose personit në doninë e të cilit është lidhur kontrata, me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit”.

Me qëllim që kontrata e sigurimit të kishte një rregullim sa më të plotë, mendoj se në Kodin Civil duhej të ishte rregulluar edhe çështja e afatit se kur fillon të sjellë pasoja juridike heqja dorë nga kontrata e siguresit, për shkak se i siguruari pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë ka dhënë informata të pasakta në lidhje me rrethanat që kanë rëndësi thelbësore për lidhjen e kontratës. Në rastet kur i siguruari pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë jep informata të pasakta ose hesht për rrethana që kanë rëndësi thelbësore për lidhjen e kontratës së sigurimit, neni 1119 i Kodit Civil parashikon se siguruesi ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar të siguruarin me shkrim, brenda 3 muajve nga marrja dijeni për një fakt të tillë.

Por, në këtë dispozitë nuk është parashikuar se kur fillon të sjellë pasojat për palët kjo heqje dorë nga kontrata nga ana e të siguruarit, dhe duke mos patur një parashikim të tillë, do të duhet të pranojmë se heqja dorë nga kontrata do t'i sjellë pasojat menjëherë pasi siguruesi e ka njoftuar të siguruarin për një fakt të tillë, gjë që mendoj se dëmton në mënyrë të padrejtë interesat e të siguruarit, në kushtet kur dhënia e informatave të pasakta ose heshtja për rrethana që kanë rëndësi thelbësore për lidhjen e kontratës, është bërë nga i siguruari pa dashje ose jo me pakujdesi të rëndë. Në këto kushte, me qëllim që të mbroheshin interesat e ligjshme të të siguruarit, duke vënë në balancë që të mos cënohen padrejtësisht edhe interesat e siguresit, mendoj që nga ana e Kodit Civil në fuqi, ashtu si dhe Kodi Civil italin, duhej të ishte parashikuar një afat i arsyeshëm, për shembull njëmuaj, pas të cilit do të fillonte që të sillte pasoja heqja dorë nga kontrata e siguresit në raste të tilla.

Parashikimi i një afati të tillë mendoj se është shumë i rëndësishëm, sepse vetëm pas kalimit të këtij afati, fillon që të sjellë pasoja juridike heqja dorë nga kontrata e siguresit dhe në qoftë se ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontrata ndodh para se të kalojë ky afat, siguruesi nuk ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, por, është i detyruar që të paguajë shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit. Në një rast të tillë shpërblimi i sigurimit që paguan siguruesi nuk përbëhet nga shuma që është përcaktuar në kontratë, por, ulet në proporcion me diferencën ndërmjet shumës së përcaktuar në kontratë dhe asaj që do të ishte zbatuar, në qoftë se do të njihej gjendja e vertetë e fakteve.

Nisur nga ajo që u tha më lart, mendoj se në nenin 1119 të Kodit Civil, pas paragrafit të parë të tij, të shtohet një paragraf i dytë (ndërkohë që paragrafi i dytë i këtij neni bëhet paragrafi i tretë) me këtë përmbajtje:

“Afati i heqjes dorë nga kontrata të siguresit, fillon pas një muaj nga njoftimi me shkrim që siguruesi i bën të siguruarit për heqjen dorë”.

Në Kodin Civil, në nenin 1125 të tij është përcaktuar se në qoftë se i siguruari nuk paguan primin e sigurimit ose këstin e parë të tij në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24 të ditës kur i siguruari paguan shumën që detyrohet, por, në këtë dispozitë dhe as në dispozitat e tjera të këtij Kodi, **nuk është parashikuar ndonjë afat konkret sesa mund të rrijë e pezulluar kontrata e sigurimit për**

këtë shkak, gjë që mendoj se përbën një të metë të ligjit e cila duhet rregulluar. Në këto kushte jam i mendimit që, duke qenë se kontrata e sigurimit, ashtu si të gjithë kontratat e tjera, ka një afat të fillimit dhe mbarimit të saj, ku për më tepër afati i fillimit dhe mbarimit të kontratës së sigurimit, është një element thelbësor i kësaj kontrate dhe është më i rëndësishëm se tek të gjitha kontratat e tjera, nga ana e ligjvënësit të parashikohet një afat i arsyshëm, konkretisht, **mendoj se duhet të jetë afati tre mujor**, gjatë të cilit kontrata e sigurimit qëndron e pezulluar dhe pas kalimit të këtij afati, siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Afati i mësipërm tremujor gjatë të cilit kontrata e sigurimit qëndron e pezulluar për faktin se siguruesi nuk paguan në kohë primin e sigurimit ose këstin e parë të tij, mendoj se duhet të zbatohet edhe për paragrafin e dytë të nenit 1125 të Kodit Civil në fuqi, ku të përcaktohet që siguruesi ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kontratës, pas kalimit të afatit të pezullimit të parashikuar në ligj. Me këtë rast konstatohet se paragrafi i dytë i këtij neni parashikon një afat 15 ditor, por ky afat nuk është afat i pezullimit të kontratës së sigurimit, për faktin se i siguruari nuk ka paguar primet e sigurimit në vazhdim, por, është një afat që ka të bëjë me ditën kur fillon pezullimi i kontratës së sigurimit, i cili sipas këtij paragrafi **sigurimi pezullohet nga ora 24 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit të primit të sigurimit.**

Pra, **ndërsa sipas paragrafit të parë të nenit 1125 të Kodit Civil, kur i siguruari nuk paguan primin e sigurimit ose këstin e parë të tij, kontrata e sigurimit pezullohet menjëherë**, sipas paragrafit të dytë, kur i siguruari nuk paguan këstet e primit të sigurimit në vazhdim, pasi ka paguar këstin e parë të tij, **kontrata e sigurimit nuk pezullohet menjëherë, por, pezullohet nga ora 24 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit për pagimin e këstit të primit të sigurimit.** Kjo do të thotë se, **ligjvënësi ynë për të njëjtën situatë juridike, mospagimi i primit të sigurimit ose kësteve të tij, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme, gjë që nuk më duket e drejtë, ndërsa në rastin e parë, kur nuk paguhet primi i sigurimit ose kësti i parë i tij, kontrata e sigurimit pezullohet menjëherë, ndërsa në rastin e dytë, kur nuk paguhet kësti ose këstet në vazhdim të primit të sigurimit, kontrata nuk pezullohet menjëherë, por, pezullohet pas kalimit të 15 ditëve nga dita që duhet të paguhej kësti i primit të sigurimit.** Afati prej 15 ditësh, nga i cili fillon pezullimi i kontratës së sigurimit në rastin e dytë, kur nuk paguhet këstet e primit të sigurimit në vazhdim, edhe sikur të interpretohet si afat brenda të cilit qëndron e pezulluar kontrata e sigurimit në këtë rast, pasi pasojat siç do ta shohim më poshtë janë të njëta, është një afat tepër i shkurtër dhe prandaj mendoj se nuk mund të zbatohet për këtë qëllim.

Në këto kushte si për paragrafin e parë të nenit 1125, kur i siguruari nuk paguan primin e sigurimit ose këstin e parë të tij, në të cilin ligji nuk ka parashikuar fare afat sa qëndron e pezulluar kontrata e sigurimit për këtë shkak, ashtu edhe në rastin e dytë, kur i siguruari nuk paguan këstet e primit të sigurimit në vazhdim, për të cilën ligji nuk ka parashikuar përsëri afat sa do të qëndrojë e pezulluar kontrata e sigurimit, por, ka parashikuar një afat 15 ditor pas së cilit fillon pezullimi i kontratës, është e nevojshme që ligjvënësi të mbajë të njëjtin qëndrim. Konkretisht në të dy rastet ligjvënësi duhet të parashikojë që, në qoftë se kontraktuesi nuk paguan primin e sigurimit ose një nga këstet e tij në afat, kontrata e sigurimit pezullohet për një periudhë prej 3 muajsh, duke filluar ky afat nga data kur kontraktuesi ishte i detyruar që të paguante primin e sigurimit ose këstin e tij, dhe me kalimin e këtij afati siguruesi të ketë të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Mirëpo në mënyrë që të bëhet një parashikim i tillë, duke iu referuar mënyrës sesi është hartuar neni 1125 i Kodit Civil në dy paragrafe, duke parashikuar sipas mendimit tim, në mënyrë të padrejtë, në mënyrë të ndryshme të njëjtën situatë juridike, është e nevojshme që të behen ndryshime rrënjësore në këtë dispozitë, duke u hequr fare paragrafi i dytë i këtij neni si i

panevojshëm. Nga ana tjetër fjalia e dytë e paragrafit të parë të nenit 1125 të Kodit Civil duhet që të riformulohet në këtë mënyrë:

“Në qoftë se kontraktuesi nuk paguan primin e sigurimit ose një nga këstet e tij në afat, kontrata e sigurimit pezullohet për një periudhë prej 3 muajsh, duke filluar ky afat nga data kur kontraktuesi ishte i detyruar që të paguante primin e sigurimit ose këstin e tij, dhe me kalimin e këtij afati siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës”.

Një tjetër të metë që përmban sipas mendimit tim neni 1125 i Kodit Civil është fakti se, nuk është parashikuar se çfarë ndodh me këstet e primit të sigurimit që ka paguar kontraktuesi, në rastet kur në kontratë është parashikuar që primi i sigurimit do të paguhet me këste, dhe ndodh zgjidhja e kontratës sepse kontraktuesi nuk paguan këstet e primit të sigurimit në vazhdim. Në një rast të tillë shtrohet pyetja: Çfarë ndodh me këstet e paguara nga kontraktuesi para zgjidhjes së kontratës? Duke qenë se në nenin 1125 të Kodit Civil dhe as në ndonjë dispozitë tjetër të këtij Kodi, nuk jepet përgjigje, as në mënyrë të shprehur dhe as të nënkuptuar në lidhje me këtë pyetje, jemi të detyruar që të pranojmë se në këtë rast do të zbatohen dispozitat e përgjithshme ligjore që kanë të bëjnë me zgjidhjen e kontratës.

Sipas dispozitave të përgjithshme kur palët zgjidhin kontratën me marrëveshje ndërmjet tyre ose për një shkak ligjor, siç është rasti konkret, zbatohet parimi i restitucionit të dyanashëm, pra, çdo gjë që i kanë dhënë palët njëra-tjetrës, u kthehet atyre dhe palët rievendosen në gjendjen e mëparshme. Në zbatim të këtij parimi, këstet që kontraktuesi ka paguar në kontratën e sigurimit, do t'i kthehen atij, pas zgjidhjes së kontratës, edhe pse kjo kontratë është zgjidhur për shkak se kontraktuesi nuk ka paguar këstet në vazhdim të primit të sigurimit, pra, kontrata është zgjidhur për faj të kontraktuesit.

Një zgjidhje e tillë ligjore që ofron në mënyrë të nënkuptuar ligjvënësi ynë, nuk më duket e drejtë dhe mendoj se në këtë rast cenohen në mënyrë të padrejtë interesat e ligjshme të siguruesit. Përderisa kontrata e sigurimit po zgjidhet për faj të kontraktuesit, ligjvënësi ynë do të duhej të kishte parashikuar që këstet e primit të sigurimit që kontraktuesi ka paguar para se të zgjidhej kontrata, i takojnë siguruesit, zgjidhje e cila është bërë edhe nga ana e Kodit Civil italian. Për këtë arsye mendoj që në nenin 1125 të Kodit Civil të shohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Kur nga palët është parashikuar që primi i sigurimit të paguhet me këste dhe kontraktuesi ka paguar një ose disa këste dhe më pas rezulton që kontrata zgjidhet për shkak se kontraktuesi nuk paguan këstet në vazhdim, këstet e paguara deri në zgjidhjen e kontratës i takojnë siguruesit”.

Nga trajtimi juridik i bërë më sipër nenit 1125 të Kodit Civil, i cili sipas mendimit tim ka nevojë për ndryshime thelbësore, ndryshime të cilat u cituan nga ana jonë më lart, si dhe duke u nisur nga fakti se këto ndryshime përfshijnë të gjithë strukturën e këtij neni, dhe në mënyrë që të jetë sa më e qartë përmbajtja e tij në tërësi, po pasqyroj në tërësi se si duhet të jetë përmbajtja e nenit 1125 të këtij Kodi:

Neni 1125

“Kontraktuesi detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se kontraktuesi nuk paguan primin e sigurimit ose një nga këstet e tij në afat, kontrata e sigurimit pezullohet për një periudhë prej 3 muajsh, duke filluar ky afat nga data kur kontraktuesi ishte i detyruar që të paguante primin e sigurimit ose këstin e tij, dhe me kalimin e këtij afati siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Kur nga palët është parashikuar që primi i sigurimit të paguhet me këste dhe kontraktuesi ka paguar një ose disa këste dhe më pas rezulton që kontrata zgjidhet për shkak se kontraktuesi nuk paguan këstet në vazhdim, këstet e paguara deri në zgjidhjen e kontratës i takojnë siguruesit”.

Një tjetër plotësim që ka nevojë Kodi Civil në lidhje me kontratën e sigurimit ka të bëjë me mënyrën ose formën e njoftimit të sigurvearit nga ana e të siguruarit për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, situatë e cila duhej që të ishte parashikuar në nenin 1126 të këtij Kodi, i cili flet detyrimin që ka i siguruari për të njoftuar sigurvearin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit. Në këtë dispozitë nuk parashikohet forma ose mënyra sesi i siguruari duhet të njoftojë sigurvearin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, çka për mendimin tim përbën mangësi dhe për këtë qëllim është e nevojshme që të bëhet plotësimi i kësaj dispozite duke u parashikuar në mënyrë të shprehur që, **i siguruari duhet të njoftojë me shkrim sigurvearin për ndodhjen e ngjarjes së sigurimit**, fakt ky i konfirmuar edhe nga praktika e zbatimit të kontratës së sigurimit ndërmjet palëve. Në këto kushte mendoj që në fjalinë e parë të nenit 1126 të Kodit Civil pas fjalëve: **“i siguruari detyrohet të njoftojë sigurvearin”**, të shtohen fjalët: **“me shkrim”**.

Një nga detyrimet më të rëndësishme që ka siguruari në kontratën e sigurimit të pasurisë është detyrimi për të paguar shumën e sigurimit ose shpërblimin e sigurimit në favor të të siguruarit ose personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, me ndodhjen e rastit të sigurimit. Në Kodin Civil janë parashikuar disa raste, të trajtuara nga ana ime më lart, sipas të cilave siguruari shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, raste të cilat janë parashikuar nga neni 1143 të Kodit Civil dhe që kanë kryesisht me rastet kur rasti i sigurimit (ngjarja e sigurimit) është shkaktuar me dashje ose pakujdesi të rëndë të të siguruarit ose të personit të tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, apo kur ajo është shkaktuar nga pjesëtarët madhorë të familjes së të siguruarit.

Një nga rastet e tjera të cilat mendoj që **siguruari mund të shkarkohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit në rastin e sigurimit të pasurisë, është edhe rasti kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit**⁹¹, rast i cili nuk është parashikuar në Kodin Civil. Mendoj se siguruari mund të shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar shpërblimin e sigurimit kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit, për faktin se këto të meta përbëjnë rrethana që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe masës së rrezikut të sigurimit të cilat siguruari nuk i dinte dhe nuk ishte si t'i dinte, për vetë natyrën që kanë këto të meta, në momentin e lidhjes së kontratës së sigurimit.

Mënyra sesi do të duhet të parashikohet përjashtimi i përgjegjësive së sigurvearit për pagimin e shpërblimit të sigurimit, kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit, mendoj se duhet të jetë me dispozita lejuese. Pra, palët mund të parashikojnë në kontratën e sigurimit që siguruari ka përgjegjësi për pagimin e shpërblimit të sigurimit edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit, por, kur palët nuk kanë parashikuar një klauzolë të tillë, si rregull, siguruari duhet të përjashtohet nga përgjegjësia. Në këto kushte mendoj se në nenin 1143 të Kodit Civil të shtohet një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

“Përveç kur palët kanë parashikuar shprehimisht ndryshe në kontratë, siguruari shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit”.

Më sipër trajtova një nga rastet kur siguruari mund të përjashtohet nga përgjegjësia për pagimin e shpërblimit të sigurimit, kur ngjarja e sigurimit ishte shkaktuar nga të metat e fshehta të sendit, rast i cili nuk ishte parashikuar në Kodin Civil. Nga ana tjetër, mendoj se në Kod mund të parashikohet një rast tjetër i kundërt, kur siguruari mund të detyrohet që të paguajë shpërblimin e sigurimit, rast i cili nuk është parashikuar në Kod dhe që ka të bëjë më ato rrethana kur ngjarja e

⁹¹Koncepti i të metave të fshehta të sendit është trajtuar nga ana ime në pjesët e tjera të këtij punimi dhe nuk do të ritrajtohet këtu për efekte të mospërsëritjes.

sigurimit, në rastin e sigurimit të pasurisë, është shkaktuar nga i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, për shkak të nevojës së madhe⁹² ose për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurvecit.

Përderisa nga ana e Kodit Penal është parashikuar që nuk ka përgjegjësi penale personi që kryen veprimin në kushtet e nevojës ekstreme, e cila është e barabartë me nevojën e madhe në këtë rast, për më tepër një gjë e tillë duhet të parashikohet nga Kodi Civil, i cili është një ligj që mbron të drejta më pak të rëndësishme se Kodi Penal, i cili ka si objekt kryesor mbrojtjen e të drejtës së jetës dhe lirive të personit. Në këto kushte është e domosdoshme që në Kodin Civil të parashikohet **si një nga rastet kur sigurveci detyrohet të paguajë shpërblimin e sigurimit, rasti kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, për shkak të nevojës së madhe.** Të njëjten gjë mund të themi edhe në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga i siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurvecit, ku edhe në këto raste sigurveci duhet të detyrohet për pagimin e shpërblimit të sigurimit. Kjo për faktin se, përderisa i siguruari ose personi i tretë kanë shkaktuar ngjarjen e sigurimit për shkak të veprimit të tyre për mbrojtjen e interesave të sigurvecit, pavarësisht nga fakti sesa kanë arritur që t'i mbrojnë këto interesa me veprimet e tyre, sigurveci mund të detyrohet për pagimin e shpërblimit të sigurimit në këto raste.

Përsa i përket mënyrës sesi do të duhet ta parashikojë Kodi Civil detyrimin e sigurvecit për pagimin e shpërblimit të sigurimit në favor të të sigurvecit në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga nevoja e madhe ose mbrojtja e interesave të sigurvecit, mendoj se edhe në këto raste ky detyrim duhet të parashikohet me dispozita lejuese, ku palët të kenë mundësi që me vullnetin e tyre ta përjashtojnë sigurvecin nga një detyrim i tillë. Nisur nga sa u trajtua më sipër, në mënyrë që të gjejnë zgjidhje dy situatat e mësipërme, kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga sigurveci ose personi i tretë në dobinë e të cilit është shkaktuar si rrjedhojë e nevojës së madhe ose mbrojtjes së interesave të sigurvecit, mendoj se pas nenit 1143 të Kodit Civil të parashikohet një nen i ri, neni 1143/a me këtë përmbajtje:

“Përveç kur palët kanë parashikuar shprehimisht ndryshe në kontratë, sigurveci detyrohet që të paguajë shpërblimin e sigurimit, në rastet kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar nga i

⁹² Për sqarimin e konceptit të “nevojës së madhe”, në këtë rast, mendoj se duhet t'i referohemi të drejtës penale dhe Kodit Penal, të cilin e njohin këtë koncept me emrin “nevoja ekstreme”. Sipas nenit 20 të Kodit Penal jemi para nevojës ekstreme, e cila siç u tha më lart, është e barabartë me nevojën e madhe sipas të drejtës civile, në rastet kur personi e kryen veprimin për të përballuar një rrezik real, të çastit, që e kërcënon atë, një person tjetër apo pasurinë nga një dëm i rëndë dhe i pashmangshëm me mënyra të tjera me kusht që të mos jetë provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zbrapsur.

Nga përcaktimi i mësipërm që i bëhet nevojës së madhe, rezulton se, në mënyrë që të jemi para këti rasti, duhet të ekzistojnë disa kushte, të cilat njihen edhe si kushte pozitive që duhet të ekzistojnë dhe nuk duhet të ekzistojnë disa kushte, që njihen me emrin kushte negative që nuk duhet të ekzistojnë.

Në mënyrë shumë të përmbledhur, kushtet pozitive janë:

- a) veprimi të kryhet nga nevoja për të shmangur një rrezik real;
- b) veprimi të kryhet nga nevoja për të shmangur një rrezik të çastit;
- c) rreziku real dhe i çastit duhet që të kërcënojë personin që kryen veprimin ose një person tjetër në jetën ose shëndetin apo pasurinë
- ç) dëmtimi që mund të vijë nga ky kërcënim në jetën ose pasurinë duhet të jetë i rëndë dhe i pashmangshëm me mjete të tjera.

Kushtet negative të nevojës së madhe, të cilat nuk duhet të ekzistojnë janë:

- a) veprimi të mos jetë provokuar prej personit;
- b) dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zbrapsur.

siguruari ose personi i tretë në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, për shkak të nevojës së madhe, ose mbrotjes së interesave të siguruesit”.

Kodi ynë Civil në nenin 1144 të tij parashikon se, në rastet kur pasuria e siguruar kalon nga një subjekt tek një tjetër, kontrata e sigurimit të pasurisë quhet e zgjidhur dhe në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjestim me kohën që mbetet deri në përfundimin e afatit të sigurimit. I vetmi përjashtim që bën legjilacioni ynë është në rastin e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike, sigurimi i cili rregullohet me ligj të veçantë dhe nuk është objekt trajtimi i temës tonë, ku kalimi i pronësisë mbi mjetin nga një person tek tjetri, nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, por, kjo kontratë vazhdon deri në fund të saj me pronarin e ri të mjetit.

Qëndrimi i mbajtur nga ana e Kodit tonë Civil në lidhje me sigurimin vullnetar të pasurisë, i ndryshëm nga ligji italian, për rastet kur pasuria e siguruar kalon nga një person tek tjetri, ku sipas ligjit tonë kjo përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, ndërsa sipas ligjit italian kontrata vazhdon normalisht, mendoj se nuk është i drejtë dhe duhet të rregullohet nga ana e ligjvënësit tonë. Në këtë rast, pavarësisht nga mendimi im që qëndrimi i ligjvënësit tonë për këtë çështje nuk është i drejtë, duhet të kemi parasysh se ekzistojnë argumente pro dhe kundër këtij qëndrimi që ka mbajtur ligjvënësi ynë. Një nga argumentet pro ose në favor të qëndrimit që ka mbajtur ligjvënësi ynë në këtë rast, është fakti se pavarësisht se objekti i kontratës është sigurimi i pasurisë, detyrimet në çdo kontratë janë personale dhe pala tjetër duhet të ketë dijeni në çdo kohë, se cili do të jetë subjekti që do t'i përmbushë këto detyrime.

Pikërisht duke u nisur nga fakti se detyrimet në një kontratë janë personale, si dhe duke u bazuar në faktin se në vendin tonë, për shkak të mungesës së traditës juridike në këtë fushë kontraktore do të lindnin probleme të ndryshme ndërmjet palëve, nga ana e ligjvënësit shqiptar është zgjedhur rruga më e shkurtër dhe me e sigurtë, sipas të cilës me kalimin e pronësisë së sendit të siguruar nga një person tek tjetri, kontrata e sigurimit zgjidhet. Por, kjo rrugë edhe pse është më e “shkurtër dhe e sigurtë”, mendoj se nuk është në interesin e palëve kontraktore që me kalimin e pronësisë së sendit të siguruar, nga një person tek tjetri, kontrata të zgjidhet. Përkundrazi, interesi i palëve në kontratën e sigurimit, ashtu si në çdo kontratë tjetër, është që kontrata të vazhdojë dhe palët të arrijnë që të kënaqin interesat e tyre dhe të realizojnë qëllimin për të cilin e kanë lidhur kontratën.

Duke vazhduar me argumente të tjera kundër qëndrimit të ligjvënësit tonë, në lidhje me këtë çështje, një nga argumentet kryesore pse nuk duhet që të zgjidhet kontrata e sigurimit të pasurisë me kalimin e pronës së siguruar nga një subjekt të tjetri, është fakti se në këtë rast kemi të bëjmë me sigurimin e pasurisë ose të sendeve dhe interesat e palëve nuk çënohen pavarësisht nga fakti se cili është pronar i sendit të siguruar. Për më tepër, që nuk do të ishte e arsyeshme dhe në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut që thjesht ndryshimi i pronarit mbi sendin e siguruar, të përbente shkak ligjor dhe automatik për zgjidhjen e kontratës, çka mendoj se është një zgjidhje në kundërshtim me interesat e siguruesit dhe të të siguruarit. Këtij arsytimi i shtohet edhe fakti se në një çështje analoge të rregulluar po nga ligjvënësi shqiptar me ligj të veçantë, dhe që ka të bëjë me sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike, është pranuar se kalimi i pronësisë mbi mjetin, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit të mjetit, prandaj të njëjtin qëndrim duhet të kishte mbajtur ligjvënësi shqiptar edhe në rastet e sigurimit vullnetar të llojeve të tjera të pasurisë.

Duke pranuar si alternativën më të drejtë qëndrimin e mbajtur nga ligji italian për këtë çështje, sipas të cilit kalimi i pronësisë mbi sendin e siguruar nga një person tek tjetri, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, do të duhet të parashikojmë edhe të drejtat dhe detyrimet që kanë palët në këtë rast, kur pasuria e siguruar kalon tek një person tjetër. Një nga detyrimet e të siguruarit në këto raste do të ishte, detyrimi për të njoftuar menjëherë siguruesin për shitjen e sendit të siguruar, si dhe të bëra e njoftimit blerësit të sendit, për ekzistencën e kontratës së sigurimit. Në

qoftë se i siguruari nuk e përmbush këtë detyrim, ai është i detyruar që të paguajë primet që duhen paguar pas datës së shitjes së sendit, pavarësisht se sendi i siguruar është shitur prej tij dhe me ndodhjen e rastit të sigurimit shuma e sigurimit përfitohet nga blerësi i sendit dhe jo nga i siguruari.

Po ashtu do të duhej të parashikohet që rast se i siguruari ka njoftuar blerësin e sendit të siguruar për ekzistencën e kontratës së sigurimit, të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit, i kalojnë blerësit të sendit të siguruar, nëse ky i fundit ka patur dijeni për ekzistencën e kontratës së sigurimit dhe brenda dhjetë ditëve nga mbarimi i afatit për pagimin e ardhshëm të primit të sigurimit, nuk kanë njoftuar siguruuesin se nuk dëshiron që të vazhdojnë kontratën e sigurimit. Siguruuesi nga ana e tij do të ketë të drejtë që të përfitojë primet e sigurimit për periudhën deri në momentin që blerësi bëjë një njoftim të tillë. Siguruuesi po ashtu, do ketë të drejtë që brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i mësipërm i marrë nga blerësi i sendit të siguruar, të heqë dorë nga kontrata, me anë të një njoftimi paraprak prej pesëmbëdhjetë ditësh, njoftim i cili mund të bëhet edhe me anë të letër rekomandesë.

Duke pranuar zgjidhjen e mësipërme të mbajtur nga ligjvënësi italian, mendoj që neni 1144 i Kodit tonë Civil të ndryshohet në këtë mënyrë:

“Shitja e sendit të siguruar nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit. I siguruari duhet të njoftojë siguruuesin për shitjen e sendit dhe blerësin për ekzistencën e kontratës, në të kundërt është i detyruar që të paguajë primet që duhen paguar pas datës së shitjes së sendit.

Të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit kalojnë tek blerësi i sendit të siguruar, nëse ky i fundit ka patur dijeni për ekzistencën e kontratës së sigurimit dhe brenda dhjetë ditëve nga mbarimi i afatit për pagimin e ardhshëm të primit të sigurimit, nuk ka njoftuar siguruuesin se nuk don që të vazhdojnë kontratën e sigurimit.

Siguruuesi ka të drejtë që të përfitojë primet e sigurimit për periudhën deri në momentin që blerësi të bëjë një njoftim të tillë.

Siguruuesi brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i mësipërm i marrë nga blerësi i sendit të siguruar, ka të drejtë që të heqë dorë nga kontrata, me anë të një njoftimi paraprak me shkrim prej pesëmbëdhjetë ditësh”.

Problemi i fundit që duhet diskutuar në lidhje me përmirësimin e Kodit Civil për sa i përket kontratës së sigurimit mendoj se është paragrafi i parë i nenit 1159 të Kodit Civil, i cili është përmendur edhe më parë nga ana ime kur është folur për të detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit të personit. Në lidhje me këtë paragraf të këtij neni që në fillim duhet të them se sipas mendimit tim, ky përbën një shembull të keq të teknikës legjislative dhe të hartimit të një dispozite ligjore, pasi në mënyrën sesi është shkruar nuk ka asnjë kuptim. Konkretisht ky paragraf parashikon:

“Ndryshimet e profesionit ose veprimtarisë së të siguruarit kur sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ata nuk rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruuesi nuk do ta kishte lidhur atë”.

Po t'i bëjmë një lexim të kujdeshëm këtij paragrafi dhe po të bëjmë një lidhje të tij me paragrafët e tjerë të këtij neni, çka në gjuhë juridike quhet interpretim sistematik i ligjit, do të konstatojmë se ky paragraf ka probleme të përkthimit në shqip ose probleme gjuhësore dhe është e habitshme sesi një gjë e tillë u ka kaluar redaktorëve gjuhësore të Kodit Civil, në supozimin se ky Kod para se të kthehej në ligj, ka patur, si çdo ligj tjetër, redaktorët e vet gjuhësorë. Kështu duke bërë thjesht punën e redaktorit gjuhësor jokompetent (sepse unë nuk jam gjuhëtar dhe për pasojë nuk jam kompetent për një gjë të tillë), do të shohim se po të heqim në fillim të fjalisë pas fjalëve ***“Ndryshimet e profesionit ose veprimtarisë së të siguruarit”*** pjesëzën ***“kur”***, si dhe në pjesën e dytë të fjalisë pas fjalëve ***“sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato”***, heqim pjesëzën ***“kur”***, do të shohim se ky paragraf ka plotësisht kuptim dhe arrin që të zgjidhë situatën juridike për

të cilën është parashikuar. Konkretisht pas bërjes së ndryshimeve të mësipërme, jo shumë të vështira, shohim se paragrafi i parë i nenit 1159 të Kodit Civil merr këtë përmbajtje:

“Ndryshimet e profesionit ose veprimtarisë së të siguruarit sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ata rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur atë”.

Çështja e fundit, jo me shumë rëndësi, që duhet rregulluar në lidhje me këtë paragraf të nenit 1159 të Kodit Civil është gjuha juridike e përdorur nga ligjvënësi në pjesën e parë të tij dhe konkretisht shprehja: “sjellin pushimin e efekteve të sigurimit”, shprehje e cila nuk është përdorur në asnjë vend tjetër nga ana e ligjvënësit në lidhje me kontratën e sigurimit. Kjo shprehje e përdorur nga ligjvënësi nuk më duket e saktë, pavarësisht nga fakti se në interpretim të saj ka kuptimin se “sjellin zgjidhjen e kontratës së sigurimit” dhe në mënyrë që ky paragraf të jetë sa më i saktë, mendoj që shprehja: “sjellin pushimin e efekteve të sigurimit”, të zëvendësohet me shprehjen: “sjellin zgjidhjen e kontratës së sigurimit”. Në këtë mënyrë pas rregullimeve gjuhësore dhe juridike, mendoj që paragrafi i parë i nenit 1159 të Kodit Civil të ndryshohet përfundimisht në këtë mënyrë:

“Ndryshimet e profesionit ose veprimtarisë së të siguruarit sjellin zgjidhjen e kontratës së sigurimit, në rast se ata rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur atë”.

Abatract

Në këtë punim është bërë trajtimi juridik dhe praktik i kontratës së sigurimit sipas dispozitave të Kodit Civil shqiptar, duke e ballafaquar atë edhe me praktikën gjyqësore në Shqipëri dhe jo trajtimi i kontratave të sigurimit të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e detyrueshëm të personit dhe pasurisë, sipas ligjeve të veçanta. Në këto kushte në trajtimin e kësaj teme, unë kam qëndruar strikt vetëm në rregullimin ligjor që ka bërë Kodi Civil për kontratën e sigurimit, në të cilin parashikohet sigurimi vullnetar i personit dhe pasurisë dhe nuk jam referuar në ligje të tjera, të cilat rregullojnë lloje të ndryshme të kontratave të detyrueshme të sigurimit, sepse kjo do të dilte jashtë objektit të temës time.

Punimi përbëhet nga katër pjesë kryesore; pjesa e parë dhe më e rëndësishme trajton rregullimin ligjor të kontratës së sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil shqiptar në fuqi. Në këtë pjesë do të trajtohen disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me kuptimin dhe veçoritë e kontratës së sigurimit, me të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë, ku në veçanti do të trajtohen detyrimet e të siguruarit në kontratën e sigurimit, si dhe të drejtat e sigurvearit në këtë kontratë.

Pjesa e dytë e këtij punimi i kushtohet, në mënyrë të përmbledhur, konceptit dhe veçorive të kontratës së sigurimit sipas sistemit ligjor anglo-sakson. Në këtë pjesë do të trajtohet kuptimi që ka kontrata e sigurimit sipas këtij sistemi ligjor, kushtet apo elementët që duhet të ekzistojnë në mënyrë që të jemi para një kontrata sigurimi, si dhe llojet kryesore të kontratës së sigurimit të pasurisë sipas sistemit anglo-sakson.

Pjesa e tretë e këtij punimi i referohet rregullimit të kontratës së sigurimit të personit dhe pasurisë sipas Kodit Civil italian, nga trajtimi i të cilës do të konstatojmë se një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit Civil shqiptar, janë marrë pikërisht nga Kodi Civil italian dhe trajtimi i shumë çështjeve juridike që kanë të bëjnë me këtë kontratë, është bërë në mënyrë të njëjtë, megjithatë, do të shohim se ka edhe ndryshime ndërmjet tyre. Trajtimi i kontratës së sigurimit sipas ligjit italian do të bëhet edhe në aspektin krahasues, duke e ballafaquar atë me Kodin Civil shqiptar, në mënyrë që të shikohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këtyre legjislacioneve, dhe të nxirret eventualisht ndonjë e metë e ligjit shqiptar dhe të pasqyrohet nevoja dhe mënyra sesi mund të rregullohen këto të meta në të ardhmen, në trajtimin ligjor të kontratës së sigurimit.

Pjesa e fundit e këtij punimi përbëhet nga analiza e praktikës gjyqësore shqiptare, të gjykatave të tre niveleve, më posaçërisht të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, të gjykatës së apelit Tiranë, për periudhën e viteve 2005-2010, si dhe të Gjykatës së Lartë për të gjithë periudhën pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil. Nga trajtimi i praktikës gjyqësore shqiptare në lidhje me kontratën e sigurimit, të rregulluar nga Kodi Civil, do të konstatohet nëse nga gjykatat shqiptare janë kuptuar si duhet dispozitat ligjore që rregullojnë kontratën e sigurimit vullnetar të personit dhe pasurisë, nëse rastet e praktikës gjyqësore janë të shumta apo të pakta në lidhje me këtë kontratë, dhe nëse vendimet gjyqësore e dhëna nga gjykatat në lidhje me këtë çështje janë të bazuar në prova e ligj dhe nëse janë të arsyetuara si duhet apo jo.

Fjalët kyqe

kontrata e sigurimit sipas Kodit Civil shqiptar, sigurimi i detyrueshëm, rasti i sigurimit, primi i sigurimit, sigurim vullnetar, sigurim i personit, sigurim i pasurisë, rreziku i sigurimit ose peril-i, praktika gjyqësore në lidhje me kontratën e sigurimit.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Kodi Civil Republikës së Shqipërisë në fuqi.
3. Kodi Civil i R.P.S.Shqipërisë i vitit 1982.
4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Ligji nr. 2359, datë 15.11. 1956 “*Mbi veprimet juridike dhe detyrimet*”.
6. Dekreti nr. 295, datë 15.09.1992 “*Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjetëve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë*”.
7. Ligji nr. 7641, datë 01.12.1992 “*Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 295, datë 15.09.1992, “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjetëve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”*”.
8. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë në fuqi.
9. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë në fuqi.
10. Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “*Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime*”.
11. Ligji nr. 9268, datë 29.07..2004 “*Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve*”.
12. Kodi Civil italian.
13. Semini, Marjana; “*E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e posaçme*”, Tiranë, 2002, faqe 181.
14. “*Obligimet dhe kontratat përgjithësisht*”, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Durrës, 1932, faqe 52-54.
15. Nuni, Ardian; “*Veprimet juridike*”, Tiranë 2000, faqe 68
16. Vendimi nr. 4120, datë 24.06.2005 i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.
17. Vendimi nr. 1120, datë 28.02.2006 i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.
18. Vendimi nr. 2388, datë 03.04.2007 i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë
19. Vendimi nr. 2606, datë 21.04.2007 i gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.
20. Vendimi nr. 1007, datë 17.10.2005 i gjykatës së apelit Tiranë.
21. Vendimi nr. 755, datë 10.04.2008, i gjykatës së apelit Tiranë.
22. Vendimi nr. 558, datë 18.03.2008 i gjykatës së apelit Tiranë
23. Vendimi nr. 1060, datë 11.11.1999 i Gjykatës së Lartë.
24. Vendimi nr. 1063, datë 7.11.2002 i Gjykatës së Lartë.
25. Vendimi nr. 215, datë 21.1.2010 i Gjykatës së Lartë

